



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:057879

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05568497

PS.nr.4/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Violeta Namani-Hajra –kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Musa Konxheli dhe Vesel Ismaili si anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Albert Haliti, në çështjen penale ndaj të pandehurve: **P.L, N.SH dhe E.B** për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, si dhe kundër të pandehurit **B.T** për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.40/2019, të datës 18.02.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2024, në prezencën e palëve në procedurë gjykata me datë **31.01.2024**, mori dhe shpalli publikisht dhe përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.P.L, nga i ati dhe nënës, e gjinisë, i lindur me datë, në, me vendbanim në fshatin, Komuna e, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Mjekësisë, Deputet, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit, shqiptar , shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

2. N.SH, nga i atidhe nënës, e gjinisë, i lindur me datë, në fshatin, me vendbanim në rrugën, në, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion Inxhinier i diplomuar i makinerisë, punon në Ministrinë e Infrastrukturës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

3. E.B, nga i ati dhe e ëma, e gjinisë, i lindur me datë, në, ku edhe jeton në lagjen, rruga, i martuar, baba i katër fëmijëve, magjistër i shkencave për Integritet Evropian, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit, mbrohet në liri.

4. B.T, nga i ati dhe e ëma e gjinisë, i lindur me datë, në fshatin, Komuna e, me vendbanim në, në, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer Master i Shkencave Juridike, punon në, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit, mbrohet në liri.

I. Të pandehurit P.L, N.SH, B.T dhe E.B në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

JANË FAJTORË

I.

Me datë 27.09.2017, në Ministrinë e Infrastrukturës në Prishtinë, në cilësi të personave zyrtar, i pandehuri P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërmintor (KDNM), i pandehuri N.SH - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe i pandehuri B.T - Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, në bashkëveprim dhe me dashje duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në atë mënyrë që të njëjtit në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042¹, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së² dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014, të datës 01.07.2014, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokolli 356/17, të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në një të anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, duke mos e përcaktuar koston financiare, veprim ky që i lë hapur mundësinë OE “Bechtel&Enka”³ që me datë 27.11.2017 të paraqes pranë punëdhënësit kërkesën për pagesën e shumës shtesë „Briefing

¹ Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042.

² Komiteti Drejtues Ndërmintor, (Në tekstin e mëtejshëm KDNM)

³ Operatori Ekonomik “Bechtel&Enka”, (Në tekstin e mëtejshëm OE “Bechtel&Enka”)

Package” në vlerë prej 63 milion Euro në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve, e cila kërkesë me pas ka zbritur në vlerën prej 53,100,000.00 Euro, ku si pasojë e këtyre veprimeve të të pandehurve, sipas rekomandimit të Komitetit Drejtues Ndërministror, kërkesa e OE „Bechtel&Enka” është aprovuar për pagesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/50, i datës 05.06.2018, shumë kjo e cila është në kundërshtim të plotë me opinionin e mbikëqyrësit të kontratës “Hill Internacional”⁴ në lidhje me pakon informative të kontraktuesit të titulluar “autorizim për zgjatjen e afatit kohor për përfundimin e punës dhe adaptimit të drejtë çmimi kontraktues” i datës 21 dhjetor 2017, me ç ‘rast, si pasojë e veprimeve të të pandehurve buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

II. Të pandehurit P.L dhe E.B,

Në vazhdimësi nga data 27.09.2017 e deri më 05.06.2018, në Prishtinë në cilësinë e personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërministror dhe E.B - Këshilltar i lartë politik i Ministrit P.L, me dashje, në bashkëveprim me njëri-tjetrin, duke keqpërdorë detyrën dhe autoritetin zyrtar, kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim që t’i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, ashtu që duke i shfrytëzuar pozitat zyrtare, me rastin e zbatimit (ekzekutimit) të projektit “Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit R6 “, sipas kontratës nr. 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik me nr.04/L-042, Rregulloren nr.02/2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe Statutin dhe Kodin e Sjelljes së Komitetit Drejtues Ndërministror⁵, në atë mënyrë që:

a. I pandehuri P.L, pas nënshkrimit të marrëveshjes me OE „Bechtel&Enka” si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së, në cilësinë e kryesuesit të KDNM-së, pa e informuar dhe dhe pa e marrë pëlqimin e anëtarëve të tjerë të KDNM-së, e ka angazhuar të pandehurin E.B në cilësinë e këshilltarit të tij politik, që të merr pjesë në negociata me OE “Bechtel&Enka”, me qëllim të përcaktimit të kostos financiare sipas marrëveshjes së datës 27.09.2017⁶, detyra këto jashtë fushëveprimit dhe kompetencave të cilat i ka këshilltari politik,

⁴ Kompania e Kontraktuar nga Qeveria e Kosovës për mbikëqyrje të punimeve për ndërtim të autostradës Hill Internacional.

⁵ Statuti dhe Kodi i Sjelljes së KDNM-së, i datës 20 qershor 2012.

⁶ Marrëveshja me nr. 356/17 e datës 27.09.2017.

- b. Ndërkaq, i pandehuri E.B në cilësi të këshilltarit politik, sipas udhëzimeve dhe në bashkëpunim me të pandehurin P.L, duke i tejkaluar kompetencat e tij zyrtare në kundërshtim me rregullat e përcaktuara si në pikën (a) të këtij dispozitivi, ka zhvilluar biseda me përfaqësuesit e OE „Bechtel&Enka” dhe në pajtim të plotë me të pandehurin P.L, janë dakorduar që në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve deri më datë 31.12.2018, Ministria e Infrastrukturës të paguaj kosto financiare shtesë në llogari të OE „Bechtel&Enka” në vlerë prej 45 milionë Euro, e cila shumë me shpenzimet e TVSH prej 18% arrin shumën prej 53,100,000.00 Euro;
- c. Me qëllim të realizimit të planit të tyre, i pandehuri P.L me ndihmën e të pandehurit E.B, duke vepruar në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së Komitetit Drejtues Ndërministror, në tërësi kanë injoruar dhe anashkaluar anëtarët e tjerë të KDNM-se dhe Njësinë për Implementimin e Projektit, organe këto të cilat sipas Statutit kanë pasur autorizime të zhvillojnë biseda dhe të marrin vendime për të gjitha çështjet që ndërlidhen me realizimin e këtij projekti, e për më tepër edhe për çështjen e zhvillimit të bisedimeve dhe përcaktimin e kostos për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve;
- ç. Në vazhdim, i pandehuri P.L me ndihmën e të pandehurit E.B, në drejtim të realizimit të qëllimit, respektivisht pranimit të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro, ka injoruar në tërësi opinionin e kompanisë mbikëqyrëse të projektit „Hill International”, sipas të cilit opinion shuma reale dhe e lejuar për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve është 14,778,654.87 Euro, pikërisht siç ishte paraqitur në pikën A të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” , për dallim nga pika B dhe C e kërkesës⁷ për kosto financiare shtese, të cilat janë totalisht të pa arsyetuara dhe të papranueshme⁸;
- d. Për më tepër injorimi i opinionëve të kompanisë mbikëqyrëse „Hill International” vjen në pah edhe atëherë kur vet i pandehuri P.L këtë opinion fare nuk e ka prezantuar në asnjërin prej takimeve të KDNM-së të mbajtura për këtë qëllim, nuk i ka njoftuar antarët e KDNM për rolin e kompanis mbikqyrëse „Hill International” në këtë projekt, edhe për kundër faktit se i njëjti me datë 13.12.2017, së bashku me të pandehurin E.B, kanë kërkuar nga Drejtori i Njësisë së Implementimit të Projektit, që të kërkoj opinion/raport nga kompania mbikëqyrëse

⁷ Opinioni i Hill International, dhjetor 2017, fq. 14-15 pika B parasheh 36.3 milion euro në emër të pajisjeve dhe pika C parasheh 10.0 milion euro në emër të pengesës për realizimin e projektit.

⁸ Opinioni i Hill International, dhjetor 2017, referuar konkluzioneve në tërësi me theks të veçantë fq. 15-16.

rreth kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për shumën prej 63 milion Euro, e cila kompani me datë 21.12.2017 kishte dhënë opinionin, sipas të cilit ka konsideruar se shuma e arsyeshme e kostos shtesë për zgjatje të afatit për përfundim të punimeve është 14.778,654.87 Euro;

dh. Në vazhdim të realizimit të qëllimit të tyre, i pandehuri E.B, me datë 01.06.2018 në kundërshtim të plotë me përgjegjësitë dhe detyrat e tij, në bashkëpunim me të pandehurin P.L, i kanë bërë presion Drejtorit të Departamentit Ligjor të MI-së, A.K, duke i kërkuar ndryshim të opinionit ligjor⁹ paraprak në të cilin opinion rreth kërkesës për kosto financiare, përveç tjerash është konstatuar se: „Opinione sqaruese të tjera konsideroj se mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe kompania mbikëqyrëse „Hill International” si përfaqësues i punëdhënësit dhe Departamenti i Prokurimit Publik si nënshkrues i kontratës të cilët posedojnë njohuri të specializuara”, ashtu që, për ta realizuar këtë i pandehuri E.B, përmes e-mailit zyrtar¹⁰ i ka dërguar të njëjtit, draft opinionin të shkruar¹¹ që sipas tij duhej të ishte i shkruar dhe nënshkruar nga vet A.K, i cili nën presion është detyruar ta ndryshoj versionin origjinal të opinionit të parë ligjor dhe duke rënë nën presionin e të pandehurve ka hartuar versionin e ri të opinionit ligjor¹², duke e hequr emrin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill International”, dhe duke e lënë si palë kompetente për “Opinione sqaruese të tjera konsideroj se mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe Departamenti i Prokurimit Publik si nënshkrues i kontratës të cilët posedojnë njohuri të specializuara”, veprime këto që i kanë paraprirë ekzekutimit të pagesës për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve;

e. Tutje, i pandehuri P.L si kryesues i KDNM-së, me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë me Statut për këtë projekt, duke fshehur dhe mos paraqitur para anëtareve të tjerë të KDNM-së gjendjen reale, respektivisht opinionin e kompanisë mbikëqyrëse „Hill International” dhe duke prezantuar opinionin ligjor të zyrës ligjore në versionin të cilin se bashku me të pandehurin E.B ia kishin imponuar Drejtorit të Zyrës Ligjore A.K, i ka shtyrë anëtarët e KDNM-së të cilët të gjendur në një situatë të tillë para fakteve të pa verteta, që në takimin e datës 05.06.2018, të marrin vendim¹³ duke i rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të aprovoj kërkesën e OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro

⁹ Opinioni ligjor i datës 01.06.2018 me nr. protokollit 5124, i lëshuar nga Drejtori i Departamentit Ligjor të MI-së, A.K.

¹⁰ E-maili i datës 01.06.2018, ora 09:14, i dërguar nga i pandehuri E.B te Drejtori i Departamentit Ligjor, A.K.

¹¹ Draft opinionin i datës 01.06.2018, i hartuar nga i pandehuri E.B i cili i është dërguar A.Kt, bashkangjitur me e-mailin si në fusnotën nr. 4.

¹² Opinioni ligjor i datës 01.06.2018 me nr. protokollit 5142.

¹³ Vendim i KDNM-së, i datës 05.06.2018, me nr. protokollit 5237, drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës.

në emër të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve, e që përfundimisht, me datë 05.06.2018, Qeveria, e gjendur në një situatë të tillë bazuar mbi faktet e prezantuara nga i pandehuri P.L dhe pas propozimit të tij, ka marrë vendim¹⁴ që OE “Bechtel&Enka”, t’i paguhet shuma prej 53,100,000.00 Euro;

f. Pra, bazuar në faktin se kompania mbikëqyrëse „Hill International” ka dhënë opinionin¹⁵ se vlera prej 14,778,654.87 Euro, është vlerë reale dhe e vetmja që duhet t’i paguhet OE „Bechtel-Enka” në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve për projektin në fjalë, me të cilin vlerësim është pajtuar edhe OE „Bechtel&Enka”¹⁶, si dhe duke iu referuar diferencës me shumën prej 53,100,000.00 Euro të aprovuara për pagesë, rrjedhë se si pasojë e veprimeve inkriminuese të të pandehurve, buxhetit të Republikës së Kosovës i është shkaktuar dëm në shkallë të madhe në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

- **Më këtë i pandehuri P.L në bashkëkryerje me të pandehurit N.SH Sharti dhe B.T, si dhe në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurin E.B kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe neni 77 të KPRK-së.**

Andaj gjykata me aplikimin e neneve 7,17, 38, 39,40, 42, 59, 62, 65, 69, 70, 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 dhe neni 77 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, 450 dhe 452 të Kodit të Procedurës Penale¹⁷, të pandehuriit :

G J Y K O N

I.Të pandehurit P.L, i shqipton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej 3 vite e 8 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ne bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.3 të KPRK-së, të pandehurit **P.L**, i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

¹⁴ Vendim i Qeverisë, i datës 05.06.2018, me nr. protokollit 01/50.

¹⁵ Opinioni i datës 21 dhjetor 2017, sipas shifrës PXX-000 01.00GP/S1513.

¹⁶ Drafti i Aneks-kontratës në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bechtel-Enkës, e datës 15.08.2016.

¹⁷ Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejshëm KPP-së), nr.08/L-032, i datës 14.07.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 18.02.2023.

Në bazë të nenit 65 par 1 të KPRK-së, të pandehurit **P.L** t'i **NDALOHET** për 3 vite e 6 muaj ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

II. Të pandehurin **N.SH** i shqipton, **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 vit e 8 muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ne bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.3 të KRPK-së, të pandehurit **N.SH**, i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në bazë të nenit 65 par 1 të KPRK-së, të pandehurit **N.SH**, t'i **NDALOHET** për 2 vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

III.Të pandehurit **E.B** i shqipton, **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej 3 vit e 3 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ne bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.3 të KRPK-së, të pandehurit **E.B** i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në bazë të nenit 65 par 1 të KPRK-së, Të pandehurit **E.B** t'i **NDALOHET** për 3 vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

IV.Të pandehurit **B.T** i shqipton, **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 vit e 8 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ne bazë të nenit 62 par 2 nën par 2.3 të KRPK-së, të pandehurit **B.T** i cakton;

DËNIMIN PLOTËSUES

Në bazë të nenit 65 par 1 të KPRK-së, Të pandehurit **B.T** t'i **NDALOHET** për 2 vite ushtrimi i funksionit në administratë publike apo funksioneve në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Obligohet të pandehurit se cili veç e veç ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **(300) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me aktakuzën PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, ka akuzuar të pandehurit P.L, N.SH dhe E.B për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të pandehurin B.T me aktakuzën PPS.nr.40/2019, të datës 18.02.2022 ka akuzuar për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, më datë 03.03.2022 ka marr Aktvendim me të cilin ka bashkuar procedurën penale të lëndës PS.nr.4/2022, në të cilën të pandehur janë P.L, N.SH dhe E.B, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, me lëndën PS.nr.10/2022, në të cilën në cilësi të pandehurit është i pandehuri B.T, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2018, të datës 18.02.2022, ashtu që kundër të pandehurve do të udhëhiqet një procedurë e përbashkët penale me numër të lëndës PS.nr.4/2022.

Gjykata, në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 04.05.2022, i ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, i ka udhëzuar të njëjtit në vështrimin të nenit 248, mbi të drejtën e deklaramit ose jo të pranimit të fajësisë, të pandehurit P.L, N.SH, E.B dhe B.T, në prani të mbrojtësve të tyre deklaruan se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale me të cilat i ngarkon aktakuza. Andaj, gjykata të njëjtit i udhëzoi për të drejtën e tyre që brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh mund të parashtrojnë Kërkesë për Hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave.

Në seancën e shqyrtimit të dytë me datë 17.06.2022, mbrojtësi i të pandehurit P.L, av.M.D, mbrojtësi i të pandehurit N.SH, av.D.M, mbrojtësi i të pandehurit E.B, av.A.S, dhe mbrojtësi i të pandehurit B.T, av.U.V, kanë elaboru kërkesat për kundërshtimet e provave dhe hudhja e aktakuzës më pas është prezantuar përgjigjja e prokurorit të PSRK-së rreth kërkesës së mbrojtësve, ku gjykata për pretendimet e palëve në procedurë ka vendos jashtë seance me vendim.

Më datë 24.06.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, mori Aktvendimin PS.nr.4/2022, me të cilin refuzoi si të pabazuar Kërkesat për hedhje të Aktakuzës dhe Kundërshtimin ndaj Provave, të parashtruar nga Mbrojtësit e të pandehurve P.L, N.SH, E.B dhe B.T.

Me datë 22.08.2022, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti Special mori Aktvendim PN.S.nr.41/22, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtëseve të pandehurve P.L, N.SH, E.B dhe B.T, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.4/2022, të datës 24.06.2022, i njëjti vendim vërtetohet.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor¹⁸, me datë 03.02.2023, i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre ligjore, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurori

¹⁸ Të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 311 par.1 të KPP-së, janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresa e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është regjistruar me audio ose video incizim për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

i Prokurorisë Speciale, të pandehurit P.L, N.SH, E.B dhe B.T, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, dhe meqenëse të pandehurit e lartcekur nuk e kanë pranuar fajësinë për këto vepra penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 323 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

2. Fjala përfundimtare e palëve¹⁹

Prokurori i PSRK në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të gjitha pikave të Aktakuzave me numër PPS.nr.40/2019, e datës 04.02.2022, kundër të pandehurve P.L, N.SH dhe E.B dhe datës 18.02.2022 kundër të pandehurit B.T, aktakuza të cilat janë bashkuar sipas vendimit të gjykatës, duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave në përputhje të plotë me të gjitha rregullat e Kodit të Procedurës Penale, është provuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivet e Aktakuzës dhe dyshimi i bazuar mirë se në veprimet e të pandehurve të lartcekur manifestohen të gjitha elementet esenciale të veprave penale që u vihen në barrë. Tutje, ka shtuar se aktet mbi bazën e të cilave është implementuar projekti „Rruga 6“ (autostrada Prishtine – Hani i Elezit) kanë qenë: Vendimi i Qeverisë, Nr. 06/78 i datës 12.06.2012, Statuti dhe Kodi i Sjelljes, Kontrata me numër të prokurimit MI/12/050/517 e datës 01.07.2014, Kontrata me nr. protokoli /13/075/212 e datës 30.10.2014, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Kompanisë mbikëqyrëse „Hill International“. Në rastin konkret, referuar provave të administruara gjatë shqyrtimi gjyqësor, sipas prokurorisë është vërtetuar bindshëm fakti se në veprimet e të pandehurve janë manifestuar elementet e veprës penale nga neni 422, paragrafi 1 dhe 2, e për më tepër nën par. 2.1, ngase të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkalluar kompetencat dhe nuk i kanë përmbushë detyrat zyrtare, me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në atë mënyrë që të njëjtit, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokoli 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe

¹⁹ Prokurori i shtetit, si dhe mbrojtësit e të pandehurve, fjalën përfundimtare trupit gjykues ia kanë dorëzuar në formë të shkruar të cilën e kanë elaboruar ndërsa të pandehurit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 26.01.2024 kanë dhënë fjalën përfundimtare.

ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, duke mos e përcaktuar koston financiare. Gjithashtu është vërtetuar bindshëm se edhe në veprimet e të pandehurit E.B të kryera në bashkëveprim me të pandehurin P.L, të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës, janë manifestuar elementet e veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Sipas prokurorisë në rastin konkret ekziston bashkëkryerja sepse për tu konsideruar bashkëkryerja, i rëndësishëm është ekzistimi i aspektit objektiv (që secili nga pjesëmarrësit të ndërmerr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale) dhe aspekti subjektiv (manifestimi i vullnetit për të kryer veprën penale), e që në rastin konkret sipas prokurorisë janë gërshetuar të dy aspektet, ngase gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor pas administrimit të provave, është vërtetuar se secili nga të pandehurit me veprimet e tyre ka pasur rol të rëndësishëm në realizimin e veprës penale në mënyrën siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Pra, janë vërtetuar veprimet konkrete të secilit prej tyre, të cilët me dashje, duke shfrytëzuar detyrat dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat dhe nuk i kanë përmbushë detyrat zyrtare, me qëllim që t’i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër. Prokuroria vlerëson se provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, kanë vërtetuar në mënyrë të detajuar veprimet inkriminuese të të pandehurve, kohën dhe mënyrën e kryerjes, se veprës penale si dhe dëmin e shkaktuar Buxhetit të Republikës së Kosovës. Provat në të cilat gjene mbështetje kjo aktakuzë identifikojnë qartë kryerësit e veprave penale dhe veprimet e tyre përmes të cilave adresohet edhe përgjegjësia penale e tyre. Padyshim është vërtetuar se të pandehurit veprimet e tyre inkriminuese i kanë kryer me dashje, duke realizuar qëllimet e tyre të planifikuara me parë. Andaj, duke u bazuar në të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokuroria ka konsideruar se janë vërtetuar në tërësi pretendimet e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të paraqitura si në aktakuzë dhe mbi këtë bazë kanë kërkuar nga Gjykata që të pandehurit P.L, N.SH, E.B dhe B.T, t’i shpallë fajtorë për veprën penale që aktakuza i ngarkon dhe t’i dënoj me dënim maksimal të përcaktuar për veprën penale e cila u ngarkohet të pandehurve. Me rastin e caktimit të dënimit, Gjykata të merr parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, përkatësisht dhe në veçanti: Intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, siç është në rastin konkret, dëmtimi i buxhetit të Republikës së Kosovës, në shkallë të madhe që si i tillë, përveç tjerash dëmton funksionimin ekonomik të vendit, bazën materiale të kushteve të jetesës, me çka do mund të shkaktoheshin pasoja të shumta për sigurinë dhe stabilitetin e vendit dhe jetën normale të qytetarëve. Shkallën e lartë të përgjegjësisë penale të të akuzuarve, marrë parasysh pozitat e tyre zyrtare dhe paramendimin

dhe qëllimin për të kryer veprën penale. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, veçanërisht faktin se kanë shfrytëzuar dhe keqpërdor B.Tn e institucionit dhe pozitat zyrtare që u janë besuar. Gjithashtu me rastin e matjes së dënimit, gjykata të këtë parasysh qëllimin e dënimit, i cili synon që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose demot e shkaktuara nga vepra penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Sa i përket propozimit për dënimit plotësues: Ndalimi ushtrimit të funksionit në administratën publike apo funksioneve në shërbime publike, prokuroria vlerëson se bindshëm është vërtetuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale e cila përfshihet në kapitullin XXXIII.

Mbrojtësi i të pandehurit P.L – Av.M.D në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë procesit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, e cila aktakuzë nuk ka arritur të i përmbushë kërkesat bazike ligjore, duke qenë kundërthënëse dhe e paqartë, ku nuk është arritur të përshkruhet saktë se në çfarë vendi, mënyrë apo kohe ka vepruar dhe cilat janë veprimet inkriminues të të mbrojturit të tij, e as nuk është vërtetuar se ku kanë përfunduar 53 milionët. Tutje, ka shtuar se projekti i autostradës R6 është themeluar dhe ka filluar me vendimin e Qeverisë nr.06/78 të datës 12.06.2012, e po ashtu kontrata me ‘‘Bechtel Enka’’ është lidhur me 01.07.2014, pra shumë kohë para se i mbrojturi i tij të merrte përgjegjësi në mandatin e tij si ministër. Po ashtu, ka deklaruar se e gjithë rrjedha e procedurës është proceduar përmes Komitetit Drejtues Ndërministror, i cili ka qenë i përbërë nga 5 ministri. Ka shtuar se i mbrojturi i tij ka qenë në një situatë në të cilën do të kishte rrezikuar arbitrazhin për Republikën e Kosovës, me çka nëse nuk do të vepronte atëherë do të i kushtonte buxhetit të shtetit edhe më tepër në fazat e mëvonshme. Kërkesat e vazhdueshme të Bechtel Enka dhe kërkesat për shtyrjen e alokimit të mjeteve nuk janë bërë nga i mbrojturi i tij, por nga ish ministrat e financave. Roli i të mbrojturit të tij ka qenë rekomandues, e jo vendimmarrës, pra vetëm si propozues dhe atë jo vetëm në emrin e tij, por me votat e të gjithë anëtarëve të KDNM, i cili komitet edhe ka rekomanduar transaksionin e 53 milion euro të Qeveria e Kosovës. Pagesa prej 53 milionëve ka qenë e pa alternativë, pasi që në të kundërtën si alternativë e vetme ka qenë Arbitrazhi, e cila do të kushtonte shumë më shumë. Tutje, ka shtuar se lidhur me çështjen e shtyrjes së afateve dhe alokimit të mjeteve, çështje të tilla janë jashtë përgjegjësive të kompanisë mbikëqyrëse Hill International, dhe të njëjtat kanë qenë në kompetencë të vetëm palëve kontraktuese që janë operatori ekonomik ‘‘Bechtel Enka’’ dhe Qeveria e Kosovës. Ndërsa,

lidhur me statutin dhe kodin e sjelljes ka deklaruar se i njëjti është dokument irelevant pasi që nuk ka datë e as emër se kush e ka nxjerr atë statut, e as nuk e ka të përcaktuar kohën e hyrjes në fuqi. Ka shtuar se nga dëgjimi i dëshmitarit A.K është vërtetuar faktin se i njëjti nuk ka pasur presion nga i mbrojturi i tij, e po ashtu i njëjti në pyetjen: nëse e ka ditur që i mbrojturi i tij e ka parë opinionin e Hill International, i njëjti është përgjigjur se: ‘*nuk jam në dijeni*’. Ndërsa, nga dëgjimi i dëshmitarit R.Q, është vërtetuar fakti se problemet lidhur me alokimin e mjeteve buxhetore lidhur me projektin R6 kanë filluar që nga viti 2015, e kanë vazhduar deri në përfundimin e projektit. Po ashtu, i njëjti dëshmitar është përgjigjur se: Opinioni i kompanisë mbikëqyrëse Hill International nuk është pranuar nga NJIP, e as nuk e kanë gjetur në arkivin e MI sepse nuk ka pasur numër evidencë. Po ashtu ka deklaruar se NJIP në formë zyrtare çdo herë ka bërë kërkesë që të rritet nga operatori alokimi i mjeteve buxhetore, e as që ka dëgjuar se ministri të ketë bërë ndonjë shkelje apo keqpërdorimi rreth projektit në fjalë. Për transaksionin prej 53 milionësh ka deklaruar se organ vendimmarrës ka qenë Qeveria e Kosovës. Tutje, ka shtuar se vazhdimi i kontratës është bërë në bazë të vendimit paraprak të KDNM dhe për këtë vendim është marrë edhe opinionin ligjor i KRPP-së, e që në bazë të këtyre dokumenteve edhe ai si udhëheqës i NJIP është pajtuar për zgjatjen e afatit të kontratës. Sikur të ishte nënshkruar aneksi i kontratës bazë, në kohën e komitetit që e ka drejtuar ministri Zharku në shumë prej 14.7 milion euro, nuk kishte me ardhur te kostoja prej 63 milion. Sipas mbrojtjes, nga dëgjimi i dëshmitarit B.H, është vërtetuar se bindja e dëshmitarit B.H, i cili ka qenë edhe anëtar i KDNM ka qenë se nëse nuk realizohet pagesa, çështja do të shkonte në arbitrazh, e po ashtu do të bllokoheshin punimet, ndoshta për 10 vitet e ardhshme deri sa të zgjidhej çështja në arbitrazh. I njëjti dëshmitar, ka deklaruar se fillimisht ka votuar kundër pagesës, mirëpo Kryeministri Haradinaj i është drejtuar me fjalët se: ‘*nëse dështon kjo pagesë, Kosova do t’i humbë së paku 200-300 milion euro, dhe se përfaqësuesi i Bechtel Enkes i ka thënë se meqë jeni shtet i ri po dëshirojmë të gjejmë një zgjidhje për të mos shkuar në komiteti*’, dhe kjo ka bërë që i njëjti të ndërrojë mendimin dhe të votoj pro. Tutje, ka shtuar se mos-realizimi i pagesës prej 14.7 milion nga qeveritë e kaluara, e sikur edhe i mbrojturi im P.L të mos-realizonte pagesën prej 53 milion, Qeveria e ardhshme do të rrezikonte një shumë sipas Bechtel Enke-s në shumë prej 200-300 milion euro. Ka deklaruar se ka kërkuar opinionin ligjor dhe se kur ka shtuar në takim me z.Haradinaj i njëjti i ka thënë se janë plotësuar kriteret, por opinionin ligjor nuk e ka pasur në letër. Kur është ballafaquar me emailin të cilin e ka shkëmbyer, e në të cilin ka qenë i bashkëngjitur edhe opinionin ligjor, dëshmitari është përgjigjur se: ‘*nuk më kujtohet*’. Për fund, ka deklaruar se vendimi për transaksionin prej 53 milion është marrë nga Qeveria e Kosovës dhe të gjithë anëtarët e qeverisë kanë votuar pro. Ndërsa, nga dëgjimi i dëshmitarit B.A sipas

mbrojtjes është vërtetuar fakti se opinionin e kompanisë Hill nuk është pranuar në formën zyrtare pasi që i njëjti ka deklaruar se nuk e dinë se a e ka përcjellë opinionin apo jo. Nga dëgjimi i dëshmitares A.R sipas mbrojtjes është vërtetuar faktin se në takimin me drejtorin e Bechtel Enka kanë diskutuar për arsyeshmërinë e pagesës së projektit shtesë, dhe se në rastin e opinionit ligjor e njëjta është bazuar në mirëB.Tn e asaj që i është sqaruar nga P.L. Ka shtuar se nuk e dinë nëse P.L e ka pas në posedim opinionin ligjor. Lidhur me këtë çështje ka deklaruar se komiteti nuk ka marrë rol vendimmarrës për këtë projekt sepse ka qenë një vlerë e lartë dhe kanë qenë vetëm dy opsione, ose ky, ose mundësia që të dërgohet në arbitrazh(kështu i është thënë). Në pyetjen e mbrojtjes nëse shkresat që arrijnë në rrugë jozyrtare shqyrtohen nga një ministër, dëshmitarja ka refuzuar të përgjigjet. Nga dëgjimi i dëshmitarit A.H, sipas mbrojtjes është vërtetuar fakti se kontrata është nënshkruar para vitit 2014. Gjatë mandatit të tij ka paguar vetëm aq punime sa ka pasur mjete, duke mos arritur ta përmbushin në tërësi pagesën për përfundimin e punimeve. Projekti nuk ka përfunduar me rastin e përfundimit të mandatit të tij. Lidhur me deklarin e dëshmitarit L.ZH, mbrojtja pretendon se dëshmia e tij ishte e mangët, konfuze, e paqartë dhe e mbushur me tendenca e motive politike, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata të mos ia fal B.Tn. I njëjti dëshmitarë në deklarin e tij më shumë ka dalur në rolin e ekspertit gjyqësor dhe i cili tërthorazi ka pranuar se nuk ka arritur ta lexojë kontratën në tërësi dhe se nuk e dinë saktë se me dispozitat e ligjit të prokurimit se si është rregulluar çështja në fjalë. Nga dëgjimi i dëshmitarit R.H, sipas mbrojtjes është vërtetuar fakti se vendimi për pagesën prej 53 milion euro për konzorciumin Bechtel Enka është bërë në mbledhje të hapur të Qeverisë së Kosovës dhe atë pa vërejtje dhe me vota unanime nga të gjithë ministrat, i cili vendim sipas dëshmitarit ka qenë i drejtë, duke qenë se ka qenë e domosdoshme mbylla e projektit R6, pasi në të kundërtën çështja do të mund të kalonte në arbitrazh. Nga dëgjimi i dëshmitarit Georgious Pappainous, sipas mbrojtjes është vërtetuar fakti crucial se mendimet/opinionet e Hill International nuk kanë qenë të karakterit detyrues për Qeverinë e Kosovës dhe se vonesat në pagesa kanë qenë evidente qysh nga fillimi i projektit e deri në përfundim të tij dhe se nuk janë shkaktuar nga qeveria ku funksionin e ministrit e ka ushtruar i mbrojturi i tij. Për fund, mbrojtja pretendon se pas administrimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve është vërtetuar fakti se autorizimi i transaksionit prej 53 milion euro është bërë me datë 05.06.2018 nga Qeveria e Kosovës me vota unanime. Po ashtu është vërtetuar fakti se kanë ekzistuar komplikime buxhetore dhe vonesa në pagesa të cilat janë trashëguar nga qeveritë e kaluara si pasojë e papërgjegjësisë në vendim-marrje lidhur me këtë projekt. Sipas mbrojtjes, nga administrimi i provave është vërtetuar edhe fakti se sikur të mos kryhej pagesa prej 53 milion konzorciumit Bechtel Enka, do t'i sillte dëme të mëdha buxhetit të Kosovës në të ardhmen duke përfunduar

çështja në arbitrazhe, e po ashtu punimet do mbeteshin të bllokuara dhe të papërfunduara me vite. Bazuar në të thënat si më lartë, mbrojtja ka pretenduar se nuk është arritur të vërtetohet asnjë element i veprës penale përmes të cilës do të mund të inkriminohej i mbrojturi i tij, e po ashtu nuk është vërtetuar me prova bindëse se qëndrojnë elementet e veprës penale me të cilën është ngarkuar, andaj edhe i ka kërkuar gjykatës që të njëjtin ta lirojë nga akuza sipas nenit 363 par.1 nënpar.1.3.

I pandehuri P.L në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi i të pandehurit N.SH, Av.F.L në fjalën përfundimtare ka deklaruar së pari më lejoni që ti kthejmë të pavërtetat në fjalën përfundimtare të PSRK-së ti kundërshtojmë tash menjëherë, një është në faqen 5, par.1 ku konstatohet se ndryshimi prej 10% ku 5% janë në emër të tantiemës dhe 5% për punë shtesë, nuk qëndron për shkak se këto janë diçka krejt tjetër prej asaj çka ka paraparë kontrata bazë e që ka qenë 10% më shumë apo më pak nga vlera e përgjithshme e kontratës e që në rastin konkret është diku 8% mbi vlerën e kontratës për punë që kanë rrjedhë si pasojë e vazhdimit të afatit pra që është ende nën limitin e paraparë me kontratë me nenin 13.1 nëse nuk gaboj që e vërtetoj edhe dëshmitari i PSRK-së përfaqësuesi i kompanisë Hill International Georgious Pappainous, e PSRK-ja ende pretendon në diçka të pavërtetë, çështja e dytë është në faqen 12 par.i fundit ku tenton që një provë e cila kurrë nuk është lidh mes askujt nuk është nënshkrua nga askush ta shesin si draft të nënshkruar dhe atë thuhet kështu: “si provë me rëndësi është administruar draft ankesa kontrata me nr.të prokurimit MI12/050/512 e lidhur mes MI dhe Bechtel Enkas”, ju lutem tregoni kush e ka nënshkrua këtë nga se kurrë në jetë nuk është nënshkruar nga askush?! Pra janë dy të pavërteta të thëna në fjalën përfundimtare të PSRK-së. Sa i përket fjalës përfundimtare për të mbrojturin tim i cili akuzohet se ka shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare duke i tejkalua kompetencat, duke mos përmbush detyrat zyrtare me qëllim me i shkaktua dëm buxhetit të RKS, unë edhe gjatë marrjes në pyetje të të njëjtit e kam pyet mos ka diçka kundër neve apo këtij vendit se po na habit PSRK-ja që ka thënë që ke përfitua ti diçka, ky formulim ndodhë vetëm në ato raste kur ose nuk din çka je tu bo sun e lidh kërkund çështjen tonde ose ki frikë, ki frikë me hetua personin apo institucionin i cili ka nënshkrua 53 milionëshin për me ju pagu Bechtelit sepse me ju thanë N.SHt dhe dy të tjerëve në këtë dispozitiv se keni veprua në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik së paku u dashtë me thanë e keni shkel qat nen. U dashtë me thanë se keni veprua në kundërshtim me statutin dhe kodin e mirësjelljes por nuk është asnjëra as tjetra dhe prandaj gjeneralizohen çështjet kështu pa u thirre specifikisht në

asnjë nen në asnjë paragraf. Po këta paskan marrë një vendim mbi zgjatjen e një afati dhe po akuzohen që skeni paraparë shumë sepse shuma paska dashtë me qenë 14 milion po pse atëherë ai që ka paraparë shumën 14 milion se ka nënshkrua kontratën, a paska mujtë Qeveria me dërgua në arbitrazh me thënë s'pajtohem na me qit kërkesën e juaj Bechtelit?! Kanë mujtë. A kanë mujtë me negociua jo 14 milion, 1 milion kanë mujtë edhe qata me bo. Pra, këta po akuzohen se ja keni qel rrugën dikujt me lyp pare, sa të dojnë ata. E unë muj me ja lyp dikujna sa du pare për me mbrojte po n varët a mi jep ai. E me shku me ble ni bukë me mi lyp 1 mijë euro po ti ja jep 50 cent se ashtu është. Pra, ja kemi mundësuar dikujt me kërkua sa të dojeni pare dhe dikush tjetër me aprovua atë kërkesë, e qajo që e ka aprovua mos me guxua me thirr si qatë të dyshimte, por me i thirr këta si kinse ja kanë qelë rrugën spo muj me kuptua. Kush tha se qenka në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik nënshkrimi i zgjatjes së afatit, veç një dëshmitar L.ZH i cili nuk i ka kaluar as 14 milionëshi i cili ai pretendojnë e as nuk e ka nënshkrua as vet ai e as Bechteli. A.K drejtor i zyrës ligjore, R.Qj drejtor i njësisë implementuese dytë këtu na kanë thënë se zgjatja e afatit ka qenë tërësisht ligjore dhe e domosdoshme, çështja e pagesës së shumave ka qenë çështje e qeverisë dhe komitetit. Dëshmitari George përfaqësues i Hill International na tha se zgjatja e afatit ka ndodhë shumë më herët por me këta persona është bërë vetëm formalizimi i saj sepse qeveritë tjera nuk kanë arritë me bërë formalizimin e saj se punët shtesë dhe afati shtesë ka paraparë 10% të kontratës bazë dhe e egjeti edhe me nen se cili nen e parasheh atë duke e demasku një të pavërtetë që prokuroria tentonte me shitë si të vërtetë. Pra, kjo me këtë që ka tentuar PSRK me bo është sikur gjykata e shkallës së parë në këtë rast MI-ja ka marrë një vendim dhe gjykata e shkallës së dytë KDNM në këtë rast e ka aprovua, pastaj ka shkuar në shkallën e tretë në këtë rast në Qeveri edhe dikush me ardhë me kërkua përgjegjësi prej gjykatës së shkallës së parë qikjo ka ndodhë. N.SH ka veprua konform ligjit, nuk e ka shkelë asnjë nen të ligjit të prokurimit publik, ka pas shkresën protokorale nga zyra e prokurimit, mendimin e Ramë Qupeves drejtor i NJIP, A.K drejtor i zyrës ligjore, mendimin e zyrës ligjore të Kryeministrit të RKS, mendimin e KRPP dhe gjitha këto i kanë dhënë të drejtë dhe i japin edhe sot të drejtë me vepru në mënyrën qysh ka veprua dhe se me veprimin e tij dhe të bashkakuzuarve në këtë dispiozitiv ka përfitua vetëm vendi jonë dhe qytetarët e RKS. Prandaj, ju propozoj që konform nenit 363 par.1 të KPPRK-së N.SHn ta lironi nga aktakuza sepse as nga një provë e vetme juridike faktike nuk ekziston se i njëjti ka kryer veprën penale por ekziston një thënjë e një dëshmitari dhe një eksperti të cilët dytë kanë thënë ku ke pa ti zgjatje të afatit pa kosto! E ajo bazë ligjore nuk ka por ka në mendjen e tyre një interpretim a është dashakeq apo nga mos njohuria e tyre e dijnë ata më se miri.

I pandehuri N.SH në fjalën në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe dëshiroj të shtoj se kjo marrëveshja për zgjatjen e afatit në asnjë mënyrë nuk është shkaktar i 53 milionëshit, ky është një keqinterpretim e cila u paraqit si e miratuar e që në fakt nuk është e miratuar. Zgjatja e afatit pika 3 e marrëveshjes thotë gjitha klauzolat janë të pandryshuara, PSRK në asnjë rast nuk e ka menduar se çka kishte me ndodhë nëse nuk ishte arritë marrëveshja. Nuk ka të bëjë vetëm njëra palë e tjetra ndash pajtohu ndash mos u pajto, ajo ka mujtë me u bo por lënda kishte me shku në arbitrazh, ndërsa zgjatja nga ana jonë ka mundësua përfundimin e punimeve. Ne nuk kemi caktuar kosto, koston e ka caktuar kontrata, rruga është tani e përfunduar dhe e shfrytëzuar nga qytetarët. Sido që të kisha veprua unë kisha me përfundua me një aktakuzë, kështu po del sipas kësaj, psh sot jam pse e kam nënshkrua por do të isha edhe pse nuk e kam nënshkrua, ndërsa unë më i kënaqur jam që e kam nënshkrua dhe që rruga është përfunduar.

Mbrojtësit e të pandehurit E.B, Av.A.S av.T.XH, në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se i gjithë procesi i kësaj lende nga veprimet paraprake të stadi të parë të hetimeve, pastaj ngritja e aktakuzës e shume veprime të tjera, lidhen me përpilimin e opinionit ligjor të cilin e kishte kërkuar Kryesuesi – Kryeministri R.SH që ky raport të përpilohet shpejtë brenda një dite, e qe ketë opinion ligjore e kishte përpiluar drejtori i zyrës ligjore z.A.K, andaj edhe shtrohet pyetja si mundet që një jurist me përvojë 12 vjeçare i cili e ka përpiluar këtë raport, me vonë të pretendojë që opinionin ka qenë jo i ligjshëm pasi sipas tij ka pasur presion nga E.B, duke e paraqitur rastin në polici ditën e nesërme pasi që e vendimi ishte aprovuar në Qeveri. Pra, si policia ashtu edhe prokuroria kanë qenë në njohuri për këtë, dhe kanë pasur afatin 30 ditor për t'u ankuar në gjykatë nëse kanë vlerësuar se është i kundërligjshëm, e po ashtu kanë mundur të kërkojnë caktimin e masës së përkohshme të sigurisë me qëllim që të bllokohet ekzekutimi i pagesës prej 53.1 milion, e që një gjë të tillë nuk e kanë bërë. Tutje, kanë shtuar se nga administrimi i provave është vërtetuar se në veprimet e te pandehurit E.B si këshilltar politik i ministrit të infrastrukturës nuk manifestohen asnjë nga elementet esenciale të figurës së veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Për t'u konsideruar kryerja e kësaj vepre sipas nenit 31 të KPK-së (bashkëkryerje) duhet të ketë marrëveshje paraprake, kontribut esencial dhe lidhje kauzale me pasojat dhe të vërtetohen elementet esenciale, të cilat janë: *kufijtë e autorizimeve* të cilat rrjedhin nga pozita zyrtare, *detyrat dhe kompetencat* vendim-marrëse të zyrtarit apo personit përgjegjës, të cilat në rastin e këshilltarit politik *nuk ekzistojnë* dhe nuk kanë mundur të *tejkalohe*, përveçse të *uzurpohen* dhe nuk mund të manifestohen përmes *ndikimit, presionit, lajthitjes apo të mashtrimit*, siç pretendon prokuroria, pasi këto përbëjnë figurën e veprave tjera penale të

veçanta, dhe nuk mund të konsiderohen si veprime me të cilat kryhet vepra penale e keqpërdorimit të autoritetit, e cila është vepër penale specifike që lidhet me cilësitë e kryesit të veprës, pra kryhet vetëm si person zyrtar, dhe në fund duhet të ekzistoj edhe lidhja kauzale në mes të veprimeve dhe pasojave të shkaktuara. Vendimi final me të cilin ishte shkaktuar pasoja, pagesa e 53,1 mil. Euro, ishte marrë nga Qeveria e Kosovës, në bazë të rekomandimit të KDNM-së, e ky i fundit në bazë të opinionit ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës. Pra, në asnjërin prej këtyre akteve juridike i pandehuri E.B nuk ka marrë pjesë dhe as që ka mundur të merr pjesë, bazuar në kufizimet e kompetencave dhe autoritetit të tij sipas nenit 22 dhe 23 të Rregullores nr. 02/2011. Tejkalimi i këtyre kompetencave, me veprimet të cilat atij i mvishen, nuk mund të përbëjnë figurën e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit, pasi edhe me tejkalim të kompetencave të tij, vepra penale sipas dispozitivit të aktakuzës nuk do të mund të kryhej nga këshilltari politik pa i uzurpuar kompetencat e dikujt tjetër, pasi që këshilltari sipas kësaj rregullore nuk ka kompetenca ekzekutive, administrative dhe as të drejtë për ndërhyrje në shërbimin civil, por vetëm të i përcjellin mesazhet e eprorit tek shërbyesit civil. Konstatimi i prokurorisë se pjesëmarrja e E.Bsi këshilltar i ministrit në takimet e KDNM-së, ishte në kundërshtim me kompetencat e këshilltarit është gabim: sepse përgjigjja mund të kuptohet në nenin 51, par. 3 të Rregullores nr. 09/2011 se Punës së Qeverisë, në të cilin thuhet: *“Me pajtimin e Kryesuesit, zyrtarët tjerë ose ekspertët e jashtëm mund të marrin pjesë në takimet e Komisionit, por pa të drejtë vote”*. Tutje, ka shtuar se nga dëshmitë e V.LL, B.Ht, R.Ht, vërtetojnë se ishin vet anëtarët e KDNM që kishin negociuar me Bechtel Enken në takimin e dt. 19.04.2018, dhe po ashtu dëshmitari R.H ka konfirmuar faktin se operatori ishte i vendosur të kërkonte të drejtën e tij edhe përmes procedurës gjyqësore, në rast se do të dështonte arritja e marrëveshjes. Lidhur me raportin e kompanisë mbikëqyrëse i njëjti ka deklaruar se ai vetëm ka kalkuluar koston e zgjatjes së afatit të kontratës edhe për 11.3 muaj, por nuk ka konstatuar asnjëherë të drejtën e kompanisë kontraktuese për të kërkuar zgjatjen e afatit dhe lidhur me pranimin e shkresave, i njëjti ka shtuar se nga dëshmia e B.A A.Kj, asistent ekzekutiv i kabinetit të ministrit dhe dëshmitarit A.Z, shef i kabinetit të ministrit, mund të kuptohet se kush ishte përgjegjës për pranimin e shkresave dhe si bëhej pranimi i shkresave dhe se Këshilltari politik, nuk e ka për detyrë të pranojë shkresa në emër të njësisë për administrimin e dokumenteve apo si arkivist dhe as t'i përcjell ato më tutje. Ka shtuar se opinionin publik ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e raportit të kompanisë mbikëqyrëse dhe kjo vërtetohet nga procesverbali i raportimit të ministrit në komisionin parlamentar ZHEITI me datë 19.01.2018. E po ashtu, dëshmia se i pandehuri E.B kishte kërkuar opinion nga udhëheqësi i NJIP R.Q lidhur me opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill International, vërtetohet nga emaili i datës 27.12.2018 nga E.B të R.Q, cc P.L dhe A.Z dhe

përgjigja në email me datë 28.12.2017. Me datë 18.01.2018, ora 09:15 min. R.Q udhëheqës i NJIP ka dërguar te A.Z, N.SH, cc. Xhavit Alijaj, Fatos Mani, Pjeter Ndou dhe tek ai, raportin e kompanisë mbikëqyrëse Hill International deri në periudhën e raportimit dhe me një përmbledhje të gjendjes së projektit deri me datë 19.01.2018, në të cilin nuk është përmendur opinionin e tyre i datë 27.12.2017. Lidhur me pretendimet për presion ndaj drejtorit të Departamentit Ligjor, i njëjti ka deklaruar se nga dëshmia e dëshmitarit A.K mund të kuptohet se opinionin e kërkuar e kishte hartuar vet dhe sipas mendimit të tij, sepse kështu ka deklaruar në deklaratën e tij dhe kështu e ka konstatuar prokuroria edhe në aktakuzë. Por, ky dëshmitar duke dashur që të shmangë përgjegjësinë nga vetja për hartimin e opinionit joprofesional, ka lajthitur prokurorinë për t'i drejtuar hetimet ndaj personit tjetër dhe jo ndaj tij si hartues i atij opinionit. Një fakt i tillë vërtetohet edhe nga dëgjimi i dëshmitarit A.Z, si dhe nga dëgjimi i vetë të pandehurit E.B, e po ashtu fakti se A.Kt i janë dorëzuar të gjithë dokumentet e nevojshëm për përgatitjen e opinionit është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarit R.Q. Lidhur me raportin e ekspertit të prokurorisë, mbrojtja ka deklaruar se prokuroria e kishte ngarkuar ekspertin me detyra jashtë kompetencave të saja . Një prej detyrave ishte përcaktimi i kompetencave, detyrave dhe përgjegjësive të personave përgjegjës, e që *eksperti financiar nuk mund të ketë për detyrë përcaktimin e kompetencave të personave përgjegjës*, pasi nuk bëhet fjalë për ekspertizë ligjore, por për atë *financiare* të përlllogaritjes së dëmit të shkaktuar ndaj palës së dëmtuar. Për më tepër, *eksperti e kishte konstatuar shkaktimin e dëmit prej 39.8 mil euro, duke zbritur kështu pjesën prej 14,78 mil euro*, e cila po qe së do ishte paguar me kohë kontraktorit nuk do të vinte deri te kërkesa e tyre prej 53 mil. Euro. Në anën tjetër, përgjegjës për mos pagesë të shumës prej 14,78 mil euro ishte ish kryesuesi i KDNM, dëshmitari i prokurorisë L.ZH, i cili edhe përkundër vendimit të KDNM për aprovim të aneksit për zgjatje të afatit me koston prej 14,78 mil euro, *kishte dështuar të nënshkruaj aneksin. Në këtë mënyrë, e kishte bartur përgjegjësinë nga vetja tek ministri i ardhshëm P.L.* Duhet përmendur faktin se dëshmitari Zharku deri në ditën e fundit të afatit për përfundimin e hetimeve *ishte i dyshuar*, por përkundër këtij fakti, eksperti nuk e kishte konstatuar rolin e tij në dështimin për të nënshkruar aneksin e vitit 2016. Prandaj, mund të konsiderohet se raporti i ekspertit nuk është hartuar sipas standardeve dhe rregullave të profesionit dhe si të tillë nuk duhet ti falet B.T. Lidhur me pretendimet për mashtrim apo lajthitje, mbrojtja ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i tillë, pasi që anëtarët e KDNM i kishin pasur të gjitha materialet në dispozicion përfshirë kërkesën e Bechtel Enka dhe raportet e rregullta të kompanisë mbikëqyrëse Hill International, poashtu në opinionin ligjor të MI-së (nga dëshmitari A.K) dorëzuar në ZKM shkruante se opinionet tjera profesionale duhet të kërkohen nga organet për mbikëqyrjen e kontratës. Atëherë, përse anëtarët e KDNM dhe Qeveria nuk e kanë kërkuar

opinionin e kompanisë mbikëqyrëse të vitit 2016 dhe vitit 2017, apo edhe ndonjë opinion tjetër ad-hoc dhe si e konstatoi prokuroria fshehjen e raporteve? Pa u vërtetuar, nëse ky raport ishte dorëzuar zyrtarisht përmes njësisë për administrimin e dokumenteve, nuk mund të pretendohet dhe as të vërtetohet fshehja e tij nga kushdo qoftë. Për më tutje, opinionin ligjor i Departamentit Ligjor të MI-së nuk ka karakter obligativ, pasi ai është opinion d.m.th. *rekomandim këshillëdhënës*, por edhe në këtë opinion thuhet se opinionet tjera duhet të merren nga organi për mbikëqyrjen e kontratës dhe departamenti i prokurimit publik. Qeveria e Kosovës, tani palë e dëmtuar, ka qenë në dijeni për kërkesën e kompanisë BEGP për pagesë të mjeteve për zgjatje të afatit të kontratës, pasi vet e kishte kërkuar zgjatjen që nga viti 2015 dhe kishte marrë edhe një opinion nga kompania mbikëqyrëse në vitin 2016 dhe një opinion ligjor nga ZKM kur e kishte kthyer çështjen për vendosje të KDNM. Prandaj, vendimi i qeverisë i datës 05.06.2018, ka qenë vendim i informuar mirë me opinion ligjor të Ministrisë dhe në kuadër të kompetencave të saj sipas rregullores nr. 02/2011 dhe i pandikuar nga askush. Lidhur me mundësitë për moszbatim të vendimit të qeverisë, mbrojtja ka deklaruar se qeveria ka mundur mos ta zbatonte vendimin në bazë të nenit 26 të Rregullores 09/2011, sepse kontrata për pagesë të mjeteve sipas vendimit të datës 05.06.2018, ishte nënshkruar me datë 05.09.2018. Dëshmitari F.K, edhe në deklaratë gjatë procedurës paraprake edhe në seancë gjyqësore e ka konfirmuar se qeveria ka mundur të anulonte në çdo kohë vendimin e datës 05.06.2018 dhe se ishte vet ai si Sekretar i Përgjithshëm që nuk e kishte rekomanduar aprovimin e këtij vendimi. Në anën tjetër, dëshmitari R.H, si kryeministër e konfirmoi se qeveria i kishte të gjitha dokumentet e nevojshme dhe se të gjitha procedurat ishin përfillur para marrjes së vendimit, dhe se në momentin e shqyrtimit të propozim vendimit nuk kishte kundërshtime apo kërkesa për argumentim shtesë nga ndonjë anëtar i KDNM-së apo anëtar i qeverisë. Vendimi për aprovimin e kërkesës së Behtel Enkes për pagesë të 53 mil euro ishte marrë me unanimitet gjatë mbledhjes së qeverisë me datën 05.06.2018. Si përfundim, ka shtuar se pagesa prej 53.1 mil euro është pasojë, ndërsa shkak i kësaj pasaje është kërkesa e qeverisë për zgjatje të afatit të kontratës që nga viti 2015, të dakorduar me kompaninë kontraktuese fillimisht pa kosto dhe më pas të dakorduar edhe me koston prej 14,78 mil euro, dhe të refuzuar nga pala e dëmtuar në vitin 2016 si dhe vonesat në realizimin e punëve të planifikuara nga kontraktori sipas kontratës, si rezultat i mungesës së buxhetit të qeverisë. Këto dy veprime të palës së dëmtuar, nga viti 2015, kanë dërguar drejt kërkesës për kompensim nga kompania kontraktuese në vitin 2018. Pra, siç mund të kuptohet qartazi, kostoja e paguar në vitin 2018, është si rezultat i veprimeve të gabuara të palës së dëmtuar që nga viti 2015 dhe 2016, të cilat nuk mund të përjashtojnë assesi përgjegjësinë që këto veprime ngërthejnë, siç bëri prokuroria kur amnistoi shumën prej 14,78 mil. Euro, për të mos e llogaritur në vlerën totale të

demit, sipas saj ndaj buxhetit të shtetit. Si i akuzuar për bashkëkryerje të veprës penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar, dhe shkaktimit të dëmit ndaj buxhetit të shtetit prej 53,1 mil. Euro, i pandehuri E.B, bazuar në kufizimet e kompetencave dhe autoritetit të tij sipas nenit 22 dhe 23 të Rregullores nr. 02/2011, nuk ka marrë pjesë dhe as që ka mundur të merr pjesë në lëshimin e opinionit ligjor të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës, marrjen e vendimit të KDNM-së për rekomandim qeverisë për aprovimin e kërkesës së kontraktorit, dhe përfundimisht në marrjen e vendimit të qeverisë së datë 05.06.2018, me të cilin është aprovuar kërkesa e kompanisë kontraktuese, veprime këto, të cilat prokuroria pretendon se e kanë dëmtuar buxhetin e shtetit. Prandaj, aktakuza ndaj të pandehurit E.B për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar nuk gëzon mbështetje në fakte dhe në prova, e gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se ajo është plotësisht e pabazë , andaj edhe i ka propozuar gjykatës që në pajtim me nenin 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK, të pandehurin E.B ta liroj nga të gjitha pikat e aktakuzës.

I pandehuri E.B në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe shton se në faqen 9 të fjala përfundimtare të prokurorisë thuhet se si rezultatet i presionit të pandehurve P.L dhe E.B ishte ndryshuar opinionin ligjor duke hequr emrin e kompanisë mbikëqyrëse Hill, dhe duke lenë si palë kompetent vetëm departamentin e prokurimit, e që kjo nuk është e sakte dhe kjo mund të vërtetohet në faqen 2 të opinionit ligjor ku thuhet se opinionet tjera mund të kërkohej nga organi përgjegjës për zbatimin e kontratës dhe departamenti i prokurimit. Ne fq 13 të fjalës përfundimtare të PSRK thuhet se në procesverbalet e takimeve të KDNM të datës 09 mars 2018, 19.04.2018, 31.05.2018 dhe 05.06.2018 janë vërtetua veprimet inkriminues të P.L dhe E.B, referuar këtyre provave ka rezultuar se përmes një shkresë të datës 9 mars 2019 i pandehuri P.L si ministër i infrastrukturës e kishte caktuar të pandehurin E.B për të negociuar pretendimet e prokurorisë me 63 milion euro, me asnjë provë materiale nuk ekziston shkresa e datës 9 mars 2016. Ne faqe 15 të fjalës përfundimtare të PSRK par i parë thuhet se është vërtetuar se kjo kompani ka dorëzuar në kabinetin e ministrit P.L dhe këshilltari i tij, tani i pandehuri E.B opinionin e muajit dhjetor 2017, e vërteta është se dëshmitari i prokurorisë asnjëherë nuk e ka pohuar se opinionin e kompanisë mbikëqyrëse e ka dorëzuar as te P.L as te E.B. Ne faqe 20 të fjalës përfundimtare të prokurorisë në paragrafin e dyte qëndron edhe një e pavërtetë ku përmendet dëshmitaret A.R, V.LL, B.H dhe B.H dhe F.K ku thuhet sipas PSRK se këta dëshmitar i pandehuri P.L në bashkëpunim me E.B kane zhvilluar bisedime me Betchel enka, por që nga deklaratat e këtyre dëshmitareve asnjëherë nuk ka pohuar se ka zhvilluar negociata P.L dhe E.B dhe përkundrazi është deklaruar se është negociuar nga

këta me anëtarët e KDNM kane negociuar me Betchel enka. Ne faqe 23 paragrafi 3 ku përshkruhet mbrojtja e të pandehurve në pjesën e E.B thuhet se i njëjtit ka pohuar faktin se ka negociuar me Bechtel enka për shumën 63 milion euro, dhe këtu ka shtrembëruar deklaratat e mija dhe ka sajuar një pohim të paqenë kinse të akuzuarit. Mbrojtësi e mi potencuan gjitha faktet me rendësi përmes të cilave vërtetohet përtej çdo dyshimi se vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në formën e përshkuara nga prokuroria në aktakuze nuk mund të kryhet nga një këshilltar politik duke u bazuar në kufizimet e kompetencave të cilat dalin nga rregullorja 02/2011. Prokuroria duke e shfaqur haptazi pamundësinë e tyre për të hetuar dhe mbledhur prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet shkaktimi i pasojës është marrë vetëm me pasojën, por jo edhe me shkakun e saj. Pasojat në këtë çështje penale është vendimi i qeverisë për pagës prej 53 milion euro operatori ekonomik, por nëse ka qene vendimi i drejt ose jo nuk mund të vërtetohet në proces penale sikurse ky këtu, ajo që është dashur të hetohet është shkaktari i kësaj pasoje, si erdhi dhe kush e shkaktoj, a kishte mundësi të parandalimit të shkakut nga erdhi pasoja, e për këto gjera nuk mund të gjendet përgjigjja në aktakuzën e prokurorisë, por në provat e mbledhura nga vet prokuroria mund të kuptohet fakti se shkak i pagesës 53 milion ishte neglizhenca në vazhdimësi e qeverisë e Kosovës nga 2015 e tutje për të ndare mjetet buxhetore për projektin R6. E kemi dëshmuar me prova se si gjatë vitit 2015, 2016 dhe fillim 2017 ishte negociuar në vazhdimësi zgjatja e afatit të kontratës në fillim pa asnjë kosto për qeverinë, e me vonë edhe me kosto të cilën edhe pse të dakorduar qeveria nuk e nënshkroi asnjëherë aq më tepër ish kryesues i KDNM edhe pse kishte autorizimin e komitetit nder ministror por edhe përgjigjet e qeverisë se është komitetit që duhet të merret me këtë çështje, ish kryesuesi Lutfi Zhakru dështoj ta nënshkruar dhe kështu ka hapur rrugë operatorit ekonomik që të kërkoj pagese shtese përveç asaj për çka ishin dakorduar. Ne raportin e ekspertit financiar të prokurorisë theksohet fakti i dëmtimit të buxhetit të shtetit prej 39 milion euro, duke zbritur shumën prej 14.7 milion euro e cila sipas prokurorisë ishte arsyetuar. Nëse marrim parasysh faktin se raporti i këtij eksperti ishte hartuar gjatë fazës së hetimeve ndërsa deri në momentin e fundit të përfundimit të hetimeve i dyshuar ishte edhe L.ZH si kryes i komitetit ndërministror, atëherë shtrohet pyetja kush i dha të drejte ekspertit financiar që të arsyetoj shumë prej 14.7 milion euro si diçka e arsyeshme. Andaj përveç vërejtje të mbrojtës lidhur me kredibilitetin e këtij eksperti që raportin e tij e bën tejet jo profesional dhe jashtë rregullave të profesionit dhe të njëanshëm dhe që është në kundërshtim me detyrat e tij. Ne fund pas administrimit të gjitha provave personale, materiale formale kërkoj nga ju që të shqyrtoni me kujdes të gjitha këto prova dhe gjatë marrjes së vendimit lidhur me çështjen penale dhe me pikat e akuzës me të cilat ngarkohem të keni parasysh se kompetencat e këshilltarit politik nuk e mundësojnë në asnjë mënyrë konsumimin e veprës

penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare si në aktakuze, e me përshkrim faktik për pjesëmarrje në negociata të paautorizuara, për presion ndaj drejtorit të departamentit ligjor dhe lajthitjes së një qeverie të një shtetit demokratik i cili pretendon të anëtarësohet në BE. PSRK duke me akuzuar mua si këshilltar politik i një ministri për lajthitje të qeverisë së Kosovës e ka zbehur autoritetin e qeverisë por edhe gjithë shtetit të Kosovës në raport me qëndrueshmërinë e saj, zbatimin e ligjit dhe përmbushjen e detyrave që dalin nga Kushtetuta e këtij vendi. Nëse një qeveri mund të lajthitet nga një këshilltar dhe një ministër atëherë nuk besoj që ajo qeveri dhe ai vend ka perspektiv të ndritshme në të ardhmen. Kërkoj nga gjykata, që në pajtim me nenin 363 par ,1 nën par ,1.3 të KPP-së, të lirohem nga pikat e akuzës së PSRK.

Mbrojtësi i të pandehurit B.T – Av.U.V në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës del se prokuroria të mbrojturës e tij e mban përgjegjëse për nënshkrimin e Marrëveshjes së datës 27.09.2017, me arsyen se kjo marrëveshje është nënshkruar në kundërshtim me aktet juridike, për shkak të mos përcaktimit të kostos financiare në emër të zgjatjes së afatit të punimeve. *Lidhur me kundërligjshmërinë e veprimeve të pandehurit*, mbrojtja pretendon se nga seancat e mbajtura nuk është vërtetuar se veprimet e të mbrojturës së tij kanë qenë të kundërligjshme, qoftë në ndonjë dispozitë ligjore apo edhe kontraktuale dhe se prokuroria në asnjë moment nuk e ka përcaktuar se kundër cilës dispozitë ligjore konkrete apo cilit nen konkret (duke qenë se kemi të bëjmë me normë blankete) ka vepruar i mbrojturi i tij, me çka e bënë aktakuzën abstrakte dhe të pakonkretizuar, me çka mbetet e paqartë edhe fakti se si është manifestuar tejkalimi i kundërligjshëm i kompetencave. Lidhur me këtë çështje, mbrojtja i është referuar edhe praktikës gjyqësore (Aktgjykimit PML.nr.77/21 të Gjykatës Supreme të datës 19.04.2021) në të cilin aktgjykim është përcaktuar qartë se: ‘ *kur dispozita blankete e Kodit Penal, si element të figurës së veprës penale përcakton që duhet të cenohet një normë e një ligji tjetër, në raste të tilla duhet të vërtetohet dhe përcaktohet saktë se cila dispozitë e ligjit tjetër është cenuar dhe e cila duhet të jetë normë konkrete dhe nuk duhet mjaftuar vetëm me përcaktimin e ligjit të cenuar* ’’. Lidhur me kompetencë e nënshkrimit të marrëveshjes së datës 27.09.2017, mbrojtja konsideron se nënshkrimi i bërë nga i mbrojturi i tij ka qenë i ligjshëm (pjesë e përgjegjësisë së tij), e në të njëjtën kohë ka qenë edhe i domosdoshëm. Ka shtuar se nënshkrimin e ka bërë në kuadër të përgjegjësisë meqë i mbrojturi i tij ka qenë Drejtor i Divizionit të Prokurimit Publik, dhe Ministria e Infrastrukturës ka qenë ministri përfutuese nga realizimi i projektit të ndërtimit të Autostradës R6, e cila ministri në të njëjtën kohë ka qenë edhe autoriteti kontraktues i cili ka realizuar procedurat e prokurimit në lidhje me kontratën bazë dhe realizimin e tërësishëm të këtij projekti, e që për shkak të këtyre dy fakteve, marrëveshja e datës

27.09.2017 është nënshkruar nga i mbrojturi i tij. Fakti se ky nënshkrim ka qenë legjitim dëshmohej edhe nga emaili i datës 05.08.2016 i z.Jeton Curri – Drejtor i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, i cili gjatë komunikimit që kishte pasur me Kryesuesin e KDNM-së – L.ZH, lidhur me draft-aneksin e vitit 2016, e kishte njoftuar se lidhur me draft aneksin e kontratës, kjo çështje rregullohet në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik, kjo në linjë me atë që ka theksuar KRPP, e që nga një njoftim i tillë konfirmohet fakti se Ministria e Infrastrukturës ka pasur jo vetëm të drejtë, por edhe detyrim nënshkrimit e marrëveshjes 27.09.2017 për zgjatjen e afatit të përfundimit të hetimeve. Një fakti i tillë, vërtetohet edhe nga dëshmitari F.K, i cili kishte qenë Sekretar i Përgjithshëm në Zyre të Kryeministrit, i cili gjatë dëgjimit të tij para gjykatës me datë 17.07.2023 ka deklaruar se: *‘Ne e kemi kthyer përgjigjen zyrtare sepse nuk është përgjegjësi e Qeverisë t’i ndaj mjetet, për arsye se Ministria përgjegjëse i ka mjetet...’*. Se Ministri, Sekretari dhe Drejtori i Prokurimit të Ministrisë kanë qenë përgjegjësit e vetëm për nënshkrimin e marrëveshjeve vërtetohet edhe nga një mori provash materiale, duke përfshirë edhe kontratën bazë, e cila kontratë është nënshkruar nga po të njëjtit zyrtarë që ishin në detyrë në atë kohë. Nga të njëjtit zyrtarë janë nënshkruar edhe kontratat me kompaninë mbikëqyrëse *‘Hill International’*, për angazhimin e saj si Këshilltare e Transaksionit. Njëjtë është vepruar edhe me draft-aneksin të aprovuar nga KDNM e datës 30.09.2016, ku në pjesën e nënshkrimeve është paraparë që drafti të nënshkruhet nga Ministri, Sekretari dhe Drejtori i Prokurimit të Ministrisë. Në Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM, nuk ekziston asnjë klauzolë ku përcaktohet se KDNM bënë lidhjen e kontratave, e për më tepër nuk ekziston ndonjë kontratë apo marrëveshje e nënshkruar nga KDNM me ndonjë palë kontraktuese, por vetëm aprovime apo rekomandime për marrëveshje të tilla. *Lidhur me mos përcaktimin e kostos në marrëveshjen e datës 27.09.2017 dhe ligjshmërinë e saj*, mbrojtja konsideron se pretendimi i prokurorisë në aktakuzë lidhur me këtë çështje, paraqet një kontradiktoritet nga ajo që është shprehur nga prokuroria në shqyrtim gjyqësor. Kjo pasi që në aktakuzë prokuroria pretendon se mos-përcaktimi i kostos i ka lënë hapur mundësinë Operatorit Ekonomik të paraqes kërkesë për kosto shtesë, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka pretenduar se mos-përcaktimi i kostos i ka hapur apo i ka krijuar mundësinë Operatorit Ekonomik të paraqes kërkesë për kosto shtesë. Mbrojtja konsideron se një marrëveshje e tillë, pa kosto të përcaktuara ka ardhur si nevojë e domosdoshme për shkak të mënyrës se si ka rrjedhur procesi i ndërtimit të autostradës, e cila marrëveshje nga deklarimi i vetë të mbrojturit del se është nënshkruar 3 muaj para skadimit të afatit të paraparë me kontratën bazë, e që për shkak të pamundësisë së përfundimit të punimeve në kohën e përcaktuar për faj të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik do t’i ndërprejë punimet duke lënë punë në gjysmë për shkak të mungesës

së alokimeve buxhetore, e që kjo mungesë është fakt i pakontestueshëm nga të gjitha palët procedurale. Fakti se kjo marrëveshje duhej lidhur patjetër, të mbrojturit të tij ia kishte sqaruar në detaje edhe Udhëheqësi i NJIP-së z.R.Q, i cili kishte sqaruar se autostradat mund të mbetet e papërfunduar për shkak të mos formalizimit të dakordimit të palëve, të cilin qëndrim e ka mbajtur edhe në shqyrtim gjyqësor kur është dëgjuar si dëshmitar. Ndërsa, fakti se marrëveshja ishte lidhur vetëm për zgjatjen e afatit, pa kosto financiare, ka qenë për faktin se çështja lidhur me afatin nuk kishte qenë ndonjëherë kontestuese mes palëve, e që zgjatja e afatit të punimeve ishte i ligjshëm vërtetohet edhe nga një mori provash materiale, siç janë shkresat GP/S0735 e datës 29.09.2016, P XK-00001.00/GP/S0082 e datës 15.05.2015 të kompanisë mbikëqyrëse ‘Hill International’, në të cilat shkresa ka theksuar se me kërkesë të punëdhënësit, aneksi duhet të ndryshojë kohën e implementimit duke shtyrë afatin e përfundimit të punimeve dhe se në opinionin e tyre amandamenti i parë i kontratës është esencial për zbatim të kontratës, e po ashtu përfaqësuesi i Hill International edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte deklaruar se kjo marrëveshje nuk është e dëmshme dhe as nuk e ka dëmtuar buxhetin. Sipas mbrojtjes, ligjshmërinë e zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve e ka konfirmuar edhe dëshmitari L.ZH i cili kishte deklaruar se vendimi për zgjatje të afatit ka qenë i drejtë, për shkak se ka qenë zgjatje e afatit dhe nuk ka pasur të bëjë me diçka tjetër, e po ashtu fakti i tillë është vërtetuar edhe nga dëshmitari A.K i cili në seancën e datës 06.02.2023 ka deklaruar se zgjatja e afatit ka qenë e ligjshme, mirëpo e njëjta është bazuar vetëm në shkresat që i ka pasur në posedim. Për më tepër, ka shtuar se i mbrojturi i tij në mënyrë që të kujdE.B për ndërmarrjen e veprimeve të ligjshme, në vitin 2016 i ishte drejtuar KRPP-së me opinion interpretues. *Lidhur me ekspertizën*, mbrojtja konsideron se ekspertiza nuk është punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor pasi që gjatë hetimeve eksperti është cilësuar si ekspert financiar, ndërsa në shqyrtim gjyqësor si ekspert i prokurimit. Eksperti A.SH në kohën kur është punuar ekspertiza nuk figuron në listën e eksperteve gjyqësor(as financiar, e as të prokurimit), e po ashtu në listën e eksperteve gjyqësor të publikuar në vitin 2023 figuron në listën e eksperteve financiar, por jo në listën e eksperteve të prokurimit. Më tutje, mbrojtja konsideron se eksperti i ka tejkaluar kompetencat dhe detyrat e tij. I njëjti ka deklaruar se të pandehurit me nënshkrimin e marrëveshjes së datë 27.09.2017 kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, por kur është pyetur se në kundërshtim me cilin nen apo dispozitë, i njëjti është përgjigjur se: ‘*nuk kam përgjigje*’. I njëjti, ka deklaruar se veprimet e të pandehurve kanë rënë ndesh me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM, e që sipas mbrojtjes një dokument i tillë nuk është akt i cili rregullon procedurën e prokurimit publik, dhe për më tepër ky dokument nuk është aprovuar nga ndonjë institucion, i mungon vula e protokollimit dhe nënshkrimi përkatës, e si i tillë nuk ka efekt juridik për palët. Mbrojtja, për më

tepër konsideron se eksperti ka vepruar në kundërshtim me nenin 136.2 të KPP-së duke qenë se i njëjti është deklaruar lidhur me fajësinë e të pandehurve, e që në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, kur raporti i ekspertit nuk është në pajtim me këtë nen, nuk është i pranueshëm. Ekspertiza është edhe e mangët për faktin se në asnjë pjesë të saj nuk ka ndonjë kalkulim financiar të ofruar, me çka do të mund të konstatohet nëse ka dëm të shkaktuar apo jo. Andaj, vlera e dëmit e pretenduar nga prokuroria nuk mund të merret si e tillë, pa u provuar e njëjta. Eksperti ka konstatuar se marrëveshja e datës 27.09.2017 ligjërisht është dashur të përcaktojë koston, ndërsa vetë KRPP-ja ka theksuar se që nga nënshkrimi i kontratës, zbatohen dispozitat kontraktuale të dakorduara mes palëve dhe rregullat e FIDIC-ut, e që kjo është absurde se si një ekspert financiar mund të lëshohet në interpretime të tilla, ndërsa autoriteti kompetent ka konstatuar se nuk mund të ofrojë interpretime lidhur me këtë kontratë. *Lidhur me dëshminë e dëshmitarit L.ZH*, mbrojtja konsideron se deklarimi i tij se marrëveshja është e kundërligjshme duke qenë se nuk është përcaktuar kostoja, nuk qëndron për arsye se dëshmitari për asnjë moment nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë se në kundërshtim me cilën dispozitë ka vepruar kur është lidhur marrëveshja e tillë. Për më tepër, mbrojtja konsideron se dëshmitari L.ZH gjatë kohë sa ka qenë Kryesues i KDNM ka pranuar një shkresë nga Operatori Ekonomik lidhur me vazhdimin e kohës së përfundimit të punimeve, e që për këtë propozim z.Zharku nuk e ka refuzuar propozimin me arsyetimin se i njëjti është i kundërligjshëm. *Lidhur me opinionin e kompanisë mbikëqyrëse 'Hill International'*, mbrojtja konsideron se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se para nënshkrimit të kontratës së datës 27.09.2017, paraprakisht është dashur të kërkohet opinion nga kompania mbikëqyrëse, pasi që Hill International vetëm se kishte dhënë opinionin e saj në vitin 2016. Fakti se një opinion i tillë nuk ka pasur nevojë të kërkohet, vërtetohet edhe përfaqësuesi i kësaj kompania, ku nga deklarimi i tij në shqyrtim gjyqësor del se çështja e afatit të përfundimit të punimeve ishte dakorduar mes palëve dhe nuk kishte nevojë për një opinion tjetër rreth të njëjtës çështje. Po ashtu, i njëjti dëshmitar ka deklaruar se: ‘ *Ministria nuk ka pasur obligim të kërkojë opinion nga kompania mbikëqyrëse*’ dhe se ka mundur të dakordohet me operatorin ekonomik, pa u kërkuar paraprakisht opinionin e Kompanisë Mbikëqyrëse. Kështu ka deklaruar edhe dëshmitari R.Q si Udhëheqës i NJIP-it, i cili po ashtu ka mohuar se ka ekzistuar ndonjë opinion i kompanisë mbikëqyrëse se nuk duhet të bëhet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve. Sipas mbrojtjes, është i paqëndrueshëm pretendimi i prokurorisë se shuma që është dashur t’i paguhet operatorit ekonomik ka qenë në vlerë prej 14,778 milion euro, dhe se shuma e koston shtesë është dashur të kalkulohet vetëm sipas shumës së penaltive ditore në vlerë prej 40.000 Euro, që kinse OE paska pasur të drejtë t’i shqiptojë Ministrisë së Infrastrukturës për shkak të vonesës, pasi që neni 8.7 i kontratës bazë ka përcaktuar se vlera e penaltisë ditore ka

qenë në vlerë prej 40.000Euru dhe OE nuk ka pasur në kompetencat e tij që Ministrisë së Infrastrukturës të mund ti shqiptojë dënime kontraktuale, për shkak të rënies në vonesë, pasi që një përgjegjësi të tillë e ka pasur vetëm Ministria e Infrastruktures, ndaj Operatorit Ekonomik. Fakti se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm vërtetohet edhe me opinionet e Hill International në të cilat është kalkuluar shuma vlera e kostos shtesë prej 14.778 milion euro, e që në asnjë rast nuk është kalkuluar në bazë të penaltive ditore. Fakti i tillë është vërtetuar edhe nga dëshmitari L.ZH. *Lidhur me marrëveshjen e datës 27.09.2017 dhe kërkesën e operatorit*, mbrojtja pretendon se pretendimi i prokurorisë se kjo marrëveshje i ka mundësuar OE të paraqesë kërkesë në vlerë prej 63 milion euro është absurd, pasi që OE ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga viti 2015, dhe si rrjedhojë e pamjaftueshmërisë buxhetore ka realizuar punë as sa ka pasur buxhet të ndarë, e që ka dërguar në vonesën e realizimit të projektit dhe çështja e kostos shtesë ka qenë e hapur në kontratën bazë(neni 2) dhe këtë nuk e ka mundësuar marrëveshja e datës 27.09.2017, pasi me këtë marrëveshje është zgjidhur çështja e afatit, ndërsa çështja e kostos ka mbetur të zgjidhet me vonë pasi që të aprovet në Qeveri. Përveç kësaj, marrëveshja e datës 27.09.2017 nuk ka pasur as ndikim konstituiv në rritjen e vlerës së kompensimit OE, siç është pretenduar nga prokuroria dhe një fakt i tillë vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit Georgus Papaioannou. Fakti se është nënshkruar marrëveshja pa kosto, nuk do të thotë se kosto e përcaktuar më vonë nuk ka mundur të jetë e njëjtë si përpara. Tutje mbrojtja ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se i mbrojturi i tij së bashku me të pandehurit e tjerë kanë rekomanduar shumën e kërkuar në vlerë prej 53 milion euro nga KDNM, pasi që 13 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes i njëjti është transferuar nga Divizioni i Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe nuk ka pasur mundësi për të ndikuar në këtë aspekt. *Lidhur me protokollin e datës 22.09.2017 të lëshuar nga i mbrojturi i tij në cilësi të UD të Drejtorit të Departamentit të Prokurimit*, mbrojtja konsideron se opinionin e tillë nuk e ka cilësinë e opinionit ligjor apo të rekomandimit, siç kanë pretenduar të pandehurit P.L dhe N.SH, pasi që ky protokoll nuk është asgjë më shumë se sa një akt-përcjellës përmes të cilit aneks-kontrata pasi që ishte nënshkruar nga i mbrojturi i tij, ka kaluar për nënshkrim tek persona tjerë, gjegjësisht te z.Lekaj dhe z.Shatri. *Lidhur me dashjen për kryerjen e veprës penale*, mbrojtja konsideron se te i mbrojturi i tij nuk ekziston dashja për dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, pasi që i njëjti për të konstatuar se nënshkrimi i marrëveshjes është i ligjshëm, i është drejtuar KRPP-së nëse zgjatja e afatit të punimeve ishte i rregullt. Po ashtu, i njëjti ka qenë i gatshëm të nënshkruaj draft-aneksin e vitit 2016, ku shuma e përcaktuar për kosto shtesë ka qenë 14.778 milion euro dhe një fakt i tillë vërtetohet edhe nga dëgjimi i dëshmitarit L.ZH, i cili ka deklaruar se:” *Besoj që do ta kishte nënshkruar, pasi nuk ka drejtë me refuzuar si Drejtor i*

Prokurimit”. Si përfundim, mbrojtja konsideron se me asnjë provë konkrete nuk është vërtetuar përgjegjësia penale e të mbrojturit të tij, pasi që veprimet janë ndërmarr në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive të tij. Nuk është provuar se ka tejkaluar apo nuk i ka përmbushur detyrat e tij dhe as nuk është provuar qëllimi që ky i pandehur të përfitojë për vete apo tjetrin apo ti shkaktoj dëm tjetrit. Andaj, edhe i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të nxjerrët Aktgjykim lirues sipas nenit 363 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.3 të KPRK-së.

I pandehuri B.T në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kamë për të shtuar asgjë.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

- Provat personale

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat e propozuara nga palët në procedurë, janë n dëgjuar dëshmitarët: A.K, R.Q, B.A, A.R, B.H, V.LL, B.H, F.K, R.H, A.Z, L.ZH, A.H, I.R, G.O, eksperti A.SH, ndërsa në cilësinë e provave materiale është lexuar deklarata e dëshmitarit R.A, ndërsa në cilësinë e provave materiale janë administruar provat e propozuara në aktakuzës, provat e propozuara nga palët në procedurë që ju përkasin të pandehurve të lartë cekur, për veprën penale për të cilat akuzohen.

Gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurve, si dhe ato në favor të tyre, duke i mundësuar të pandehurve dhe mbrojtëseve të tyre, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegjeje, i vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, ashtu që pas administrimit të provave vërtetoi këtë gjendje faktike.

Për të vërtetuar këtë gjendje faktike, gjykata në shqyrtim gjyqësor, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga prokurori i shtetit, provat e propozuara nga palët në procedurë si me poshtë:

3.1 Deklaratat e dëshmitarëve;

3.1.1, Dëshmitari **A.K**, në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.02.2023, dhe datë 06.02.2023, ka deklaruar se pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës e ka mbajtur nga data 15.03.2018 deri me datë 15 shtator 2018, ku ka pasur kompetencë shqyrtimin e legjislacionit primar, sekondar, shqyrtimin e marrëveshjeve, interpretimi i legjislacionit, ku me datë 31 maj 2018 dhe 1 qershor 2018, i është kërkuar një opinion ligjor për me dhanë për një projekt kapital, auto rrugën Prishtinë - Shkup, për çështjen e një borxhi të pretenduar, ashtu që me datë 31 maj 2018, unë kam qenë i ftuar në zyrën e këshilltarit të lartë ligjor E.B, dhe aty i njëjti më ka kërkuar që ta bëjë një opinion ligjor për çështjet që ka të bëjë me 53 milionëshin, dhe kërkesa ime ka qenë me pas kërkesën me shkrim, por më ka thanë se është e mjaftueshme kjo që e them me gojë, dhe mi ka prezantuar në formë të shkruar një shkresë me tri faqe dhe ka thanë se kërkesë e kabinetit të ministrit është që me i përpunua në opinionin ligjor, unë të njëjtën shkresë e kam pa në prezencën të tij dhe kam kërkuar që të njëjtën me ma dërgua në formë elektronike, unë nuk e kam marrë atë kopje, dhe të njëjtën ditë ma ka dërgua postes elektronike - në email, pas shqyrtimit të kësaj shkrese dhe pas vlerësimit në zyrën time me të vërtetë ka qenë një rast që ma ka shkaktua shqetësim për shkak se një shkresë me tri faqe ku në atë shkresë me terma financiar kishte përshkrimin se si ministria i'a ka borxh 63 milion € "Bechtel Enka", aty ajo shkresë nuk ka pas llogo, unë nuk e disha a është shkresë e "Bechtel Enka" a është e ministrisë apo e kujt, se nuk kishte nënshkrim, nuk e disha se kush është autor i saj, dhe faktikisht ata donin që përmes meje me bo atë shkresë zyrtare – ligjore, dhe mua me më bo autor të sajna domethënë me më zyrtarizu pa kanë unë autor i asaj shkrese, të njëjtën ditë unë i 'a kam kthye me email këshilltarit të lartë ligjor E.B, kam deklaruar që unë as kam njohuri para nënshkrimit të kësaj kontrate me "Bechtel Enka", as nuk kam njohuri gjatë nënshkrimit të kësaj kontrate, as nuk kam njohuri gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, edhe kam kërkuar që për këtë opinion të ju drejtohem kompanisë mbikëqyrëse të kontratës për ekzekutimin e kontratës, menaxherit të kontratës, apo këshilltarit të transaksionit që ka hartuar kontratën, sepse si kam njoftuar se çdo opinion i imi ligjor në këtë çështje do të jetë jo meritore, ndërsa ditën e nesërme me datë 1 qershor 2018, më kanë ftuar prapë në zyrën e këshilltarit të lartë ligjor E.B, ma ka prezantuar një opinion shkresë në emrin tim dhe më ka thanë me nënshkruaje, me një përmbajtje më të thjeshtë, temat financiare i ka hequr, por për shkak të katër rreshtave të fundit nuk e kam nënshkruar, se në ata katër rreshta ceket se kërkesat e "Bechtel Enka", janë në harmoni me kontratën bazë duke pas parasysh se kontratën bazë nuk e kam pa me sy asnjëherë, pastaj i

kam thanë këtë opinion dërgoma në email, ta shikoj dhe ta analizoj, dhe të njëjtin ma ka dërguar, kur ma ka dërguar faktikisht unë kam filluar sipas mënyrës time për arsye se aty filloj të tensionohej situata, këshilltari politik E.B më tha “nuk bon ti me pengu kabinetin e ministrit” me arsyetimin se unë në atë moment e ndieja veten që jam në presion dhe i kam thanë se këtë opinion nuk e nënshkruaj pa me mi dërgua shkresat për këtë çështje, dhe të njëjtën kohë e ka thirr Ramë Çupeven, Drejtorin e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, ja ka diktuar cilat shkresa me mi dërgu në formë elektronike, dhe i njëjti mi ka dërgua, kontrata bazë nuk ka qenë, ka qenë aneks kontrata, këshilla prej zyrës së kryeministrit por në asnjë shkresë nuk e kam pa që e ka verifikua që na ja kemi borxh ndonjë autoriteti 53 milion €, pastaj unë në bazë të shkresave që i kam pas e kam hartuar një opinion ligjor vetëm sa i përket zgjatjes të aneks kontratës duke u bazua në 6 - 7 dokumente tjera që i kam pas, dhe kanë kërkuar opinionin me dhanë brenda ditës me arsyen se atë e ka kërkuar kabineti i ministrit, nga këshilltari i ministrit konkretisht më ka thënë “ju po e pengoni punën e kabinetit të ministrit dhe nëse nuk i zbaton politikat e kabinetit ke me pas pasoja”, unë të njëjtën ditë e kam përgatit atë opinion sa i përket zgjatjes së kontratës, ndërsa sa i përket borxhit unë nuk kam dhanë opinion as nuk kam konfirmuar se na i kemi borxh “Bechtel Enka”, ndërsa lidhur me këtë temë për opinion sqarues ju kam thanë ju lutem drejtojuni kompanisë mbikëqyrëse e cila ka pas përgjegjësi teknike, financiare, ligjore për ekzekutimin e kontratës, kompania Hill i kontraktuar për këtë qëllim dikun mbi 8 milion € ka qenë vlera, pastaj unë e kam dërguar këtë opinion përmes arkivës dhe në formë elektrike ja kam dërguar ministrit P.L pasi që më ka thënë këshilltari politik i tij E.B me ja dërgua ministrit, mirëpo gjatë të njëjtës ditë më ka thirr urgjent kabineti i ministrit, dhe kur kam shkuar aty prapë me kanë drejtuar te këshilltari i ministrit E.B, dhe ai më ka thanë me hjek se nuk e ke bo mirë, opinionin duhesh me hjek kompaninë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, për arsye se më ka thanë se kjo nuk ka kompetencë për këtë punë, dhe aty kemi pas mospajtime shumë, duke me thanë se ti je duke punuar kundër kabinetit të ministrit, nuk e respekton çka të themi na, aty ai ka kërkuar urgjent me hjek kompaninë “Hill Internacional”, me arsyen pse nuk ka kompetencë asgjë në këtë temë, kam shkuar prapë në zyrën time ata kanë dashtë me hjek një përfundimtare, mirëpo unë e kam hjek vetëm fjalën të kompanisë “Hill Internacional”, pastaj ka mbetur prapë që opinionin sqarues me kërkua prej Departamentit të Prokurimit rreth borxhit, nga personi përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe kështu ju kam thanë se opinionin bazohet nga shkresat që mi kanë dërguar më parë dhe opinionin ligjor është vetëm për kabinetin dhe jo obligativ, dhe e kam hjek kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, nga presioni që kam pas nga këshilltarit të kabinetit E.B se sipas tij se mund të kem pasoja sepse ti pe bllokoni punën e kabinetit të ministrit, prapë më kanë thirr pasi që e kam dërguar këtë shkresë duke me bërë presion se pse nuk e ke hjek

pjesën përfundimtare, unë nuk kam pranuar me bo ndryshime dhe në mënyrë demonstrative kam dalë nga kabineti i ministrit e kam fik telefonin dhe kam shkuar në shtëpi, më pas deklaron me vet faktin që janë bërë ndërrimet në opinion ligjor nënkuptohet ministri P.L ka qenë në dijeni, për faktin se ndërrimin e opinionit ligjor ka qenë kërkesë e këshilltarit politik E.Bt që ta dërgoj drejt te ministri në imelin e tij dhe gjithçka është komunikuar përmes këshilltarit E.Bt, pasi që ajo ditë ka qenë me e rënda që 23 vjet që e ushtroj profesionin, atë ditë e kam ndjerë presionin, më pas ka deklaruar se nuk më kujtohet saktësisht por kam ndjetë afërsisht 15 - 16 ditë pushim mjekësor, dhe në momentin kur jam kthyer në punë nuk kam pas më problem, deri në momentin kur është ndërruar sekretari, ministër aktual që ka qenë ministër P.L, atëherë sekretari më kanë pezulluar nga puna në mënyrë të kundërligjshme me datë 21.12.2018, ku gjykata caktoj masë e përkohshme për kthim në punë diku në tetor 2019 dhe derisa kanë qenë në pushtet këta nuk e kanë zbatuar vendimin e gjykatës dhe kur ka ardh Qeveria e re me datë 09.03.2020, jam kthyer në punë, më pas ka deklaruar se “Hill Internacional” ka qenë e kontraktuar për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës ka qenë menaxher teknik, financiar dhe ligjor, pasi që ai ka bërë certifikimin të pranimit të punës dhe certifikimi i pagesave nuk është paguar pa i miratuar ato punime e njëjta kompani, gjithashtu më pas sqaron se hetuesi policor i ka kërkuar shkresat, unë ja kam dërguar të gjitha shkresat, ka qenë maj i vitit 2018, ndërsa dëshmitari në deklaratat dhënë në prokurori me data 25.11.2021, dhe në polici me data 26.04.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancat e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se i pandehuri E.B me dashje, në bash kryerje dhe në dijeninë e të pandehurit P.L i ka bërë presion dëshmitarit të lartcekur për hartimin e opinionit ligjorë, ashtu që me datë 31 maj 2018, e ka ftuar në zyrën e tij dhe i ka prezantuar një shkresë dhe i ka thanë se kërkesë e kabinetit të ministrit është që me i përpunua shkresën e lartcekur në opinionin ligjor, ku shkresa kishte përshkrimin se si ministria i'a ka borxh 63 milion € “Bechtel Enka”, ku gjykata vërteton se të pandehurit e lartcekur donin që përmes dëshmitarit atë shkresë ta kthejnë në opinion ligjor, dëshmitari të njëjtën ditë i 'a ka kthye përgjegjjen me email të pandehurit E.B, ku ka deklaruar që unë skam njohuri për kontratën me “Bechtel Enka”, ka kërkuar që për këtë opinion ju drejtoheni kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, i pandehuri E.B ditën e nesërme me datë 1 qershor 2018, e ka ftuar në zyre dëshmitarin dhe i ka prezantuar një opinion me emrin e tij dhe i kanë thanë me nënshkruaje, dëshmitari nuk e ka nënshkruar pasi që në katër rreshta ceket se kërkesat e “Bechtel Enka” për borxhin 63 milion € janë në harmoni me kontratën, ka vazhduar duke i bërë presion i pandehuri E.B dëshmitarit se “nuk bon ti me pengu kabinetin e ministrit dhe nëse nuk i zbaton politikat e

kabinetit ke me pas pasoja”, nënë presion të njëjtën ditë dëshmitari e ka përgatit opinion sa i përket zgjatjes së kontratës, ndërsa sa i përket borxhit nuk ka dhanë opinion as nuk ka konfirmuar se na i kemi borxh “Bechtel Enka”, ndërsa lidhur me këtë temë për opinion sqarues ju kam thanë ju lutem drejtojuni kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, e në formë elektrike ja ka dërguar ministrit P.L pasi që i ka thënë i pandehuri E.B me ja dërgua ministrit, gjatë të njëjtës ditë e ka thirr urgjent i pandehuri E.B, duke i bërë presion të madhë me hjek kompaninë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, për arsye se më ka thanë se kjo nuk ka kompetencë për këtë punë, dëshmitari ka hartua opinionin ligjor e ka hjek vetëm fjalën të kompanisë “Hill Internacional”, pastaj ka mbetur prapë që opinionin sqarues me kërkua prej Departamentit të Prokurimit rreth borxhit, nga personi përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe opinionin ligjor është vetëm për kabinetin dhe jo obligativ, prap e ka thirr i pandehuri E.B duke i bërë presion se pse nuk e ke hjek pjesën përfundimtare, dëshmitari nuk ka pranuar me bo ndryshime, e ka fik telefonin dhe ka shkuar në shtëpi, gjykata vlerëson se të pandehurit E.B dhe P.L e kanë ditë në detaje rolin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, në këtë projekt, sipas gjykatës përpjekjet e mdhaja të pandehurve të lartcekur për fshehjen e rolit të kompanisë mbikëqyrëse në këtë projekte, vërtetohet se me dashje direkte kanë ndërmarr veprime të kundërligjshme duke i bërë presion me qellim që dëshmitarit A.K të largoj nga opinionin ligjor emrin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova materiale, në dy opinionet ligjore, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë, që vërteton gjendjen faktike në këtë çështje penale.

3.1.2 Dëshmitari **R.Q** në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.02.2023 dhe datë 30.03.2023, ka deklaruar se në Ministrinë e Infrastrukturës punoj nga viti 2001, nga viti 2002 jam drejtor i departamentit për infrastrukturë rrugore, pozitë të cilën e ushtroj edhe sot, ndërsa pas nënshkrimit të kontratës në mes të MI dhe “Bechtel Enka” për realizimin e projektit të autostradës Prishtinë Hani Elezit në shtator të viti 2014, me vendim të kryesuesit të Komiteti Drejtues Ndërmnistror është formuar njësi për implementimin e projektit, e që menaxher i asaj njësie kam qenë unë dhe njësi ka qenë e përberë nga stafi teknik dhe një jurist dhe një piar, në këtë projekt, me datë 12.06.2012, qeveria e RKS, ka krijuar me vendim Komiteti Drejtues Ndërmnistror për realizimin e projektit të autostradës Prishtinë -Hani i Elezit, sipas vendimit të qeverisë së RKS, anëtar të komitetit përveç ministrit të MI, kanë qenë ministrat e ministrive MF, MTI, MZHE, votat në komitet janë në marrë në forma afirmative dhe ka qenë e domosdoshme vota e ministrit të Infrastrukturës dhe vota e ministrit të Financave për marrjen e vendimit, pasi që i njëjti ka qenë zëvendës i komitetit, ndërsa Kodi i mirësjelljes për komitetin drejtues është votuar në vitin

2012, nga ana e komitetit, nuk ka pasur vendim të Qeverisë për këtë çështje, ku në vitin 2012 ky status i është përcjell ministrave përkatës si pjesë e komitetit në atë kohë, ku kodi dhe statusi ka përcaktua mënyrë si funksionin komiteti, mënyrën e votimit, detyrat si funksionon si dhe njësinë për implementim të projektit e cila ka pas rolin e një sekretariati për nevoja të komitetit, ku njësia për implementimin e projektit është marr me të gjitha aktivitetet operationale në realizimin e këtij projekti, ku përfshihet obligimi i aktiviteteve në marrjen e pëlqimeve, lejeve të gjitha obligimeve që dalin nga legjislacioni i Kosovës, në mënyrë që të sigurohet ekzekutimi i punimeve pa pengesa në trast, ka qenë përgjegjës për kordinimin e aktiviteteve në kompanitë publike, ujësjellës, kanalizim, postë, telefon, hidrosisteme, kek, postën e të gjitha lokacionet ku preken instalimet publike të cilat është dashur që të diskutohen dhe të merren pëlqime të nevojshme nga këto kompani në mënyrë që kontraktori të ketë qasje pa pengesë në realizimin e punëve, po ashtu kemi marr me përgatitjet e laborateve të shpronësimit në bashkëpunim me ministrin relevante, me dëgjimet publike, me çështjet mjedisore dhe të gjitha obligimet të cilat dalin sipas ligjit lidhur me të gjitha aktivitetet të cilat janë të domosdoshme që kontraktori të ketë qasje të pa penguar në ekzekutimin e punimeve janë ndërmarr nga ana e njësisë për implementim të projekti, NJIP ka pasur raporte të rregullta me Komiteti Drejtues Ndërministror, ka përgatitur raporte sipas kërkesës së komitetit, ka marr pjesë në takimi me ftesë të komitetit dhe në rast se është kërkuar nga komiteti ka dhënë sqarime për çështje teknike, kemi marr pjesë në takim por jo gjithmonë, sikurse se njësia për implementim të projektit të kishte resurse të nevojshme do të kishte kompetencë për përgatitjen e agjendës dhe pjesën administrative për komunitet, prej fillimit të krijimit të njësisë ka pasur resurse shumë të mangëta, fillimisht kanë qenë 5 persona pas zgjedhjeve në vitin 2015, kanë ngelur vetëm 3 persona, 2 inxhiniera dhe një ekonomist, nuk kanë pasur kapacitete e as mundësi që të mirremi me çështjet administrative, zakonisht ftesat dhe agjenda është përgatitur nga kabineti i ministrit ndërsa minutat e takimit janë mbajt nga zyra e informimit, po ka pasur raste që nuk jemi ftuar nga ministria, në praktikat e realizimit të projekteve të këtilla është praktikë që të ftohemi por nuk është obligim, ndërsa përveç se kemi qenë anëtarë të njëjesisë ne kemi qenë të ngarkuar edhe me punët e rregullta të ministrisë kështu që kjo ka qenë një ngarkesa shtesë, me ardhjen e ministrit Lekaj, njësisë ju kanë shtuar edhe 2 anëtar por asnjëherë njësi nuk ka pas më shumë se 5 anëtarë të cilët kanë qenë pjesë e kësaj trupe, ndërsa vendimet e Komiteti Drejtues Ndërministror i kemi marr çdo herë përmes arkivës së ministrisë në formë zyrtare, por nuk i kemi marr procesverbalet e takimeve kur nuk kemi qenë prezent, janë marr vendime edhe pse ne nuk kemi qenë prezent, pasi që njësia i raporton komitetit dhe komitetit nuk i raporton njësisë për arsye se hierarkia është se komiteti është i nivelit më i lartë, ne nuk mund të përcaktojmë se çfarë vendimi merr komiteti apo llojin e vendimin, po ashtu

NJIP e ka furnizuar me material komitetin për çdo muaj janë dorëzuar raportet e rregullta të kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, për implementim të projektit po ashtu edhe njësisë për implementim të projektit ka përgatitur shkresa të nevojshme dhe raporte për nevojat e komitetit, më pas deklaroi se në vitin 2012 me vendim të Komiteti Drejtues Ndërmënytor merret vendimi për fillimin e procedurave për ndërtimin e autostradës Prishtinë- Hani i Elezit, më vonë është inicuar procesi i projektit për kompaninë mbikëqyrëse, ka qenë një proces i hapur i prokurimit pas përfundimit të procesit të prokurimit kompania “Hill Internacional”, i ka plotësuar kushtet teknike dhe financiare dhe është lidhur kontrata në nëntor të vitit 2014, dhe ka qenë për kohëzgjatjen e projektit deri në praninë dorëzimit të tij dhe 2 vite për periudhën e garancionit, për arsye se projekti pas përfundimit i ka pasur edhe dy vite garancion, kompania mbikëqyrëse “Hill Internacional”, ka qenë e ndërlidhur në baza ditore me NJIP me kordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me pjesën operationale të projektit, ndërsa me Komiteti Drejtues Ndërmënytor ka qenë në baza të rregullta duke ofruar ekspertizë dhe përkrahje të komitetit në të gjitha fazat e realizimit të këtij projekti KDNM, ka marrë parasysh dhe ka vepruar konformë sugjerimeve të kompanisë Hill Internacional, pasi që kompania Hill internacional ka menaxhuar me kontratë dhe gjatë procesit të menaxhimit në vazhdimësi ka përgatitë raporte të rregullta të cilat i janë dorëzuar njësisë dhe komitetit, kjo kompani mbikëqyrëse ka përkrahë komitetin me ekspertizë profesionale, sa herë është kërkuar nga ana e komitetit, e që ekspertiza në dijeninë time është kërkuar dy herë, me rastin e zgjatjes së afatit të vazhdimit të kontratës ku ka qenë ministri Zharku-kryesues i komitetit, ku kompania ka përgatitë dhe dorëzuar opinionin lidhur me këtë çështje, rasti i dytë ka qenë kur është bërë kërkesa nga ana e komitetit, në kohën e ministrit Lekaj për vlerësimin e zgjatjes së afatit në fund të vitit 2017, këto kanë qenë raporte që janë bërë lidhur me vlerësimin e zgjatjes së afatit të kontratës në raport me kërkesën e komitetit nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional, më pas ka deklaruar se pagesa e faturimi në vlerën prej 53 milion euro, është bërë pas marrjes së këtij vendimi nga ana e qeverisë së RKS, nuk jemi konsultuar si njësi dhe me komitetin nuk kemi marrë pjesë në vlerësimin e propozimit nga ana e Bechtel enkës, pasi që kompania Hill Internacional, përgatitë planin e pagesave dhe nga ana e kompanisë certifikuese janë realizuar edhe pagesat konform këtij plani, pasi që Hill Internacional na ka thënë se ata nuk kanë qenë të pajtimit për vlerën prej 53 milion euro, para se të ekzekutohen 53 milion euro ka qenë mendimi i Hill Internacional, se shumë mund të i paguhet Bechtel enkës është 14.7 milion është kostoja, ndërsa vazhdimi i kontratës është bërë më pak se 4 muaj, para se me përfunduar afatit i rregullt i kontratës, ky vazhdim i kontratës është bërë pas është marrë edhe opinionin ligjor i KRPP, si organ kompetent ligjor lidhur me prokurim, dhe më pas është bërë edhe pas dhënies së opinionit ligjor nga zyra ligjore e Ministrisë,

ku në bazë të këtyre dokumente si udhëheqë i NJIP, jam pajtuar që të vazhdohet me zgjatjen e afatit të kontratës, ndërsa dëshmitari në deklaratën e dhënë në prokurori dhe në polici, në prokurori me data 16.12.2021, dhe me datë 20.12.2021, ndërsa në polici me data 28.01.2019 dhe me datë 19.02.2020, ka deklaruar njëjtë si në seancat e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se cilat kanë qenë detyrat dhe përgjegjësit e NJIP, i drejtuar nga i njëjtit dëshmitarë, që është formuar me vendim të KDNM, ku NJIP ka pasur raporte të rregullta me Komiteti Drejtues Ndërministror, ka përgatitur raporte sipas kërkesës së komitetit, ka marr pjesë në takimi me ftesë të komitetit, ku njësia për implementim të projektit ka pas rolin e një sekretariati për nevoja të komitetit, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit është vërtetuar Kodi i mirësjelljes për komitetin drejtues është votuar në vitin 2012, nga ana e komitetit, nuk ka pasur vendim të Qeverisë për këtë çështje, ku në vitin 2012 ky status i është përcjell ministrave përkatës si pjesë e komitetit në atë kohë, ku kodi dhe statusi ka përcaktua mënyrë si funksionin komiteti, mënyrën e votimit, detyrat si funksionon, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit vërtetohet se në momentin kur është themeluar KDNM, sipas Kodin dhe statusin e mirësjelljes për komitetin drejtues, vendimet për këtë projekt i merr KDNM, e jo si në rastin konkret Ministri , sekretari dhe drejtori i prokurimit lidhin marrëveshje për këtë projekte në kundërshtim me Kodin dhe statusin e mirësjelljes për komitetin drejtues, sipas dëshmitarit më vonë është inicuar procesi i projektit për kompaninë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, i ka plotësor kushtet teknike dhe financiare dhe është lidhur kontrata në nëntor të vitit 2014, ku kompania mbikëqyrëse “Hill Internacional”, ka qenë e ndërlidhur në baza ditore me NJIP me kordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me pjesën operationale të projektit, ndërsa kompania mbikëqyrëse “Hill Internacional”, me Komiteti Drejtues Ndërministror ka qenë e ndërlidhur në baza të rregullta duke ofruar ekspertizë dhe përkrahje të komitetit në të gjitha fazat e realizimit të këtij projekti KDNM, pasi që kompania Hill internacional ka menaxhuar me kontratë dhe gjatë procesit të menaxhimit në vazhdimësi ka përgatitë raporte të rregullta të cilat i janë dorëzuar njësisë dhe komitetit, kjo kompani mbikëqyrëse ka përkrahë komitetin me ekspertizë profesionale, sa herë është kërkuar nga ana e komitetit, e që ekspertiza në dijeninë e tij është kërkuar dy herë, me rastin e zgjatjes së afatit të vazhdimit të kontratës ku ka qenë ministri Zharku-kryesues i komitetit, ku kompania ka përgatitë dhe dorëzuar opinionin lidhur me këtë çështje, rasti i dytë ka qenë kur është bërë kërkesa nga ana e komitetit, në kohën e ministrit Lekaj për vlerësimin e zgjatjes së afatit në fund të vitit 2017, nga kjo dëshmi gjykata vlerëson se kompania mbikëqyrëse Hill internacional ka

dhënë ekspertiza profesionale na ka thënë se ata nuk kanë qenë të pajtimit për pagesën e vlerën prej 53 milion euro, para se të ekzekutohen 53 milion euro ka qenë mendimi i Hill Internacional, se shumë që mund të i paguhet Bechtel enkës është 14.7 milion është kostoja, ku sipas gjetjes së gjykatës të pandehurit P.L dhe E.B në vazhdimësi doni që të mos merret mendimi profesional nga kompania e thirrur për këtë çështje, me veprimet e tyre të kundërligjshme i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme buxhetit të Republikë së Kosovës, nga dëshmia e dëshmitarit vërtetohet se faturimi i vlerës prej 53 milion euro, është bërë pas marrjes se këtij vendimi nga ana e qeverisë se RKS, nuk janë konsultuar si njësi dhe me komitetin nuk kemi marrë pjesë në vlerësimin e propozimit nga ana e Bechtel enkës, po ashtu gjykata vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit të pandehurit P.L dhe E.B për vlerën prej 53 milion nuk janë konsultuar me NJIP, duke pas parasysh rolin e të njëjtët në këtë projekt, andaj gjykata e vlerëson e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova materiale, që vërteton gjendjen faktike në këtë çështje penale.

3.1.3 Dëshmitarja **A.R.**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 03.04.2023, deklaroi se në periudhën kohore 2017, kam qene ministre e mjedisit dhe planifikimit hapësinorë në RKS, këtë pozite e kam pasur prej datës 11 shtator 2017 deri me datë 1 gusht 2018, gjatë kësaj periudhe kam qene anëtare e KDNM, që është përbërë edhe nga anëtarët e tjerë nga kabineti qeveritare, për projektin e autostradës Prishtine –Hani Elezit R6, është diskutuar në mbledhjet e këtij komiteti, ku kryesues i këtij komiteti ka qenë Ministri i infrastrukturës P.L, në mbledhje jam ftuar me ftesë nga Ministria e Infrastrukturës, këto takime i ka udhëhequr kryesisht ministri Lekaj, me sa më kujtohet ka marre pjesë këshilltari politik E.B, në një nga takimet unë e kam deleguar zv. ministrin Fatmir Matoshi, i cili nuk më ka dhënë ndonjë informatë se është diskutuar në atë datë ndonjë aneks kontratë, si dhe gjatë pjesëmarrjes sime nuk me është diskutuar aneks kontratë për zgjatjen e aftit të përfundimit të punëve dhe nuk është përmendë kompania Hill Internacional në mbledhjen e KDNM, kam kërkuar sqarime për kërkesën e Bechtel enkes dhe kam kërkuar që të pajisen me dokumentacione të nevojshme që këshilltaret juridik në kuadër të kabinetit tim ti analizojnë, dhe pas disa takimeve pasi që nuk jam pajise me shkresa, e kemi bërë një kërkesë edhe me imail ku kemi kërkuar që të pajisemi me shkresa, dhe për shkak të mos marrjes së shkresave unë nuk kam votuar Pro, pastaj më vonë këshilltaret e kanë marrë dokumentacionin por nuk di të them se a janë kanë të mjaftueshme, e kanë analizuar dhe më kanë sugjeruar që të kërkoj një opinion ligjorë nga ekspertë të fushës brenda administratës së MI, nëse duhet apo nuk duhet të aprovohet shumën e vlerës prej 53 milion euro, a duhet të paguhet apo jo, Bechtel enkes, sepse mësa mbaj mend është diskutuar edhe arbitrazhi, ku na është thënë se shteti i Kosovës do të pësojë dëm në shuma marramendëse, dhe në fund

është vendosur që të mos votohet si Komitet, por të procedohet për vlerësim dhe votim në Qeverinë e Kosovës, ku në mbledhjen e parafundit që është majte në zyrën kryeministrit, ku unë kam qenë me një agjendë tjetër dhe jam vonuar në atë takim bukur gjatë, në atë takim është diskutuar se duhet të qartësuar të gjitha procedurat për të vazhduar më tutje, është marrë vendimi që të rekomandohet qeveria për vlerësim dhe aprovim, e duke e pas parasysh që është kryeministria ka mundësi të shtjerrë filtrat ligjorë, unë kam menduar që janë shtjerrë të gjitha filtrat ligjore brenda kryeministrisë, pikërisht arsyeja e vetme që më ka bindë ka qene që vetëm ta nënshkruaj raportin që të procedohet për vlerësim dhe miratim në Qeveri, me sa më kujtohet është proceduar dhe është votuar në Qeveri, ka ardhë arsyetimi si çdo pike e rendit te ditës, po ashtu sqaron se unë e kam pas këshilltarin tim prej fillimit të mbledhjes së fundit në KDNM, dhe nuk me kujtohet qe ka pas opinion ligjor, mesa me kujtohet ministri Lekaj na ka njoftuar se tani më kemi një opinion ligjore dhe unë jam bazuar në mirëB.Tn e asaj që ju është sqaruar nga P.L në rastin e opinionit ligjorë e kam vendosur më tutje, që të procedohet në qeveri për vlerësim dhe votim, e sikurse të ishte dashtë ta votoj komitetit një gjë të tillë, atëherë do të ishte dashur të shihet edhe opinionit ligjor, andaj komiteti në këtë rast nuk e ka bartë përgjegjësinë ligjore dhe ka kërkuar edhe opinion ligjore sepse ka qene një vlerë e lartë, kompleksitetit, dhe kanë qenë dy opsione ose ky, ose mundësia që të dërgohet në arbitrazhe, këto na janë thënë, më pas sqaron se me imail i kam kërkuar z .L.ZH shuma që duhet ne si shtet ti paguajmë Bechtel enkes, dhe ai po në imail ma ka dërguar-një përgjigjeje me këtë informacion 14.7milion euro, ndërsa dëshmitarja në deklaratat dhënë në prokurori me datë 25.01.2022, dhe në polici me datë 04.04.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e kësaj dëshmitare, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se si anëtare e KDNM, për projektin e autostradës Prishtine –Hani Elezit R6, deri në takimet e fundit nuk është pajisur me as një shkresë, por pas pranimit të shkresave konsideron se të njëjta nuk kanë qenë të mjaftueshme, nga dëshmia e dëshmitares vërtetohet se në takimet e KDNM as një here nuk është diskutuar për marrëveshjen e zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve dhe nuk është përmendur as një here kompania Hill Internacional, pasi që gjykata gjen se të pandehurit P.L dhe E.B kanë prezantuar rrethana faktike të pavërteta tek anëtaaret e KDNM, sipas kësaj dëshmie ju është thënë se i kemi dy rrugë të paguhet pagesa prej 53 milion euro kompanisë Bechtel enka, apo çështje të shkoj në arbitrazhe dhe qeverisë së RKS të pësoj dëme marramendëse, të pandehurit e lartcekur i jonë shmangë të marrin opinion ligjorë nga kompania Hill Internacional, e thirrur dhe e paguar nga RKS për këtë projekte, por nënë presion të madhë ndaj dëshmitarit A.K, kanë marrë opinionin ligjor nga departamenti ligjorë të ministrisë së

infrastrukturës, dhe sipas dëshmisë së dëshmitares në mbledhjen e KDNM, i pandehuri P.L e ka konstatuar se tani e kemi opinionin ligjor, po nuk ja ka prezantuar anëtarëve të KDNM në shikim dhe vlerësim, ku sipas vlerësimit të gjykatës të mos kuptohet nga anëtarët KDNM se i njëjtit opinion ka qenë i dedikuar vetëm për nevoja të kabinetit e jo për çështjen në fjalë, dëshmitarja me mirëbesim në thëniet e të pandehurve të lartcekur ka votuar pro këtij vendim, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitares së lartcekur është reale dhe e sinqertë, gjen mbështetje në provat material në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.4 Dëshmitari **B.H**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 04.04.2023, deklaroi nga data 11 shtator 2017, në pozitën e Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, kamë qenë anëtarë i KDNM për menaxhimin e projektit “Arber Xhaferi”, në takimin e kryesuesit të KDNM, në të cilin është diskutuar detyrat dhe përgjegjësitë rreth projektit, ku në takimin e parë është prezantuar dhe kemi diskutuar për kërkesën e Benktel Enkës, për shumë në vlerë mbi 60 milion euro, nga kryeministri në atë kohë z.Haradinaj dhe ministri i linjës P.L, na ka thënë se për shkak të afatit të shkurtë në kontratë me Benktel Enka është dashtë të merren vesh për ta zgjatur afatin, më pas deklaroi se nuk jam pajisur me statutin dhe kodin e etikës të KDNM dhe se emrin kompania Hill Internacional e kam dëgjuar nga prokurori për here të parë, dhe nga hetuesit kur jam marrë në pyetje pasi që për kompaninë në fjale nuk është diskutuar në komitet dhe nuk ju kujtohet që është dhënë ndonjë opinion ligjor i të njëjtës kompani, pasi që ne i kemi mbajtur dy apo tre takime në zyrë të Kryeministrit, dhe aty është debatuar gjatë rreth dhënies apo pagesën prej 53 milion euro, dhe kemi kërkuar nga ministri i linjës që të gjitha këto propozime apo arsyetime të na i hedhin edhe në letër, e dyta kërkesë e imja personalisht ka qenë që të sigurohet një opinion ligjorë se a jemi në përputhje me ligjin për ekzekutimin e këtyre mjeteve dhe e treta ka qenë se ky komitet a ka pas kompetenca ekzekutive që të e vendosë rreth kësaj pagese dhe kam kërkuar që të ndërrohet vendimi që të shkojë me propozim në qeveri dhe ky vendim të merret nga një organ më i lartë se ne siç ishte qeveria, andaj është miratuar edhe nga ministri i linjës dhe nga kryeministri qëndrimi im, në takimin e fundit kryeministri në atë kohë z. Haradinaj dhe ministri P.L, që të dy mu kanë drejtuar dhe më kanë thënë z. Hasani se janë plotësuar të dy kërkesat tuaja, ka ardhë propozimi i ministrit P.L si dhe opinionin ligjorë, besoj se kjo është konstatuar në procesverbal të atij takimi, bindja ime si anëtarë i KDNM ishte se nëse ne nuk e realizojmë këtë pagesë, çështja do të shkojë në arbitrazhe, dhe jemi ardhë në një moment që unë e kam pas një votë kundër, deri në ditën e fundit dhe jam bind se në rast se nuk realizohet kjo pagesë rruga “Arber Xhaferi”, do të bllokohet dhe dëmet ekonomike do të jenë shumë të larta, pasi që më

kujtohet se kryeministri z.Haradinaj në atë kohë më është drejtuar me fjalët:” Ministri Hasani , në qofëtse dështon kjo pagesë, Kosova do ti humb së paku 2-3 qind milion euro, sepse përfaqësuesi i Benchtel enkës na kanë thënë se duke marrë parasysh se jeni shtet i ri, po do jna me e gjet një zgjidhje, të mos shkojmë me arbitrazhe dhe të gjejmë zgjidhje”, kjo ka qenë kthesa ime e votës në pro dhe nuk kam guxua me e marrë atë përgjegjësi që sot t’ia shpëtojmë Kosovës rreth 53 milion, ndërsa nesër po ia humbi 2-3 qind milion euro, frika ime ka qenë se Benchtel Enka ka qenë i përgatitur me kërkesat e tij, më pas deklaroi se kam qenë në njohuri se ka qenë papërgjegjësi e qeverisë së kaluar, mos realizimi i pagesë prej 14.7 milion, dhe sikur të mos e realizonte edhe P.L pagesën prej 53milion, qeveria e ardhshme do ta rrezikonte një shumë prej 200 qind apo 300 qind milion euro, më pas deklaroi se në takimin e KDNM, kur unë kamë paraqit kërkesë për opinion ligjor, kryeministri ju ka drejtuar në atë mënyrë , i ka thënë:” E.B merrne dhe bëne opinionin, pasi që këtë opinion e kërkon ministri Hasani”, unë nuk kam parë atë opinion ligjor dhe nuk ia di përmbajtjen ndoshta mund të ndodhë që ai opinion ligjor të jetë edhe negative, unë kam menduar se kur të jepet opinionin ligjor gjithçka është në rregull, unë mendoj se ministria e linjës ka bërë vlerësim të mjaftueshëm duke e dërguar edhe në qeveri, që ka kaluar të gjitha filtrat, ndërsa dëshmitari në deklarata dhënë në polici me datë 26.03.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se në takimet e tij si anëtarë i KDNM, nuk i është përmendur as një here kompani Hill Internacional, për here të pare për këtë kompani ka n dëgjuar gjatë marrjes në pyetje në polici dhe në prokurori, ku gjykata gjen se të pandehurit P.L dhe E.B kanë prezantuar rrethana faktike të pavërteta tek anëtarëve e KDNM, sipas kësaj dëshmie ju është thënë se i kemi dy rrugë të paguhet pagesa prej 53 milion euro kompanisë Bechtel enka, apo çështje të shkoj në arbitrazhë dhe qeverisë së RKS të pësoj dëme marramendëse, sipas dëshmisë së dëshmitarit ku citon se kryeministri z.Haradinaj në atë kohë më është drejtuar me fjalët “ Ministri Hasani , në qofëtse dështon kjo pagesë, Kosova do ti humb së paku 200-300 qind milion euro”, e sipas vlerësimit të gjykatës dëshmitari i lartcekur i gjendur në një pozitë të tillë, nga frika se siç thotë vetë nuk e ka marrë mbi supë rrethanat e pavërteta të paraqitur nga të pandehurit të lartcekur dhe nga kryeministri i asaj kohe R.H, të pa bazuara në ekspertizë profesionale nga kompania mbikëqyrës e projektit Hill Internacional, nënë presionin e të thënave të pa vërtetave si më lartë ka vendosur pro votimi të shumës prej 53 milion euro për kompaninë Bechtel enka, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit kuptojnë se i njëjti nuk e ka pasur në shikim dhe vlerësim opinion ligjor të Ministrisë së infrastrukturës pasi që sipas tij ky opinion mundë të ketë jetë negative, kjo rrethanë nuk

përputhet me mbrojtjen e të pandehurve të lartcekur që kanë deklaruar se anëtarët e KDNM janë pajisur me opinion ligjor, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitarit të lartcekur është e singertë, gjen mbështetje në provat material në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.5 Dëshmitari **B.H.**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 12.07.2023, deklaroi qëndrojnë në tërësi pranë deklaratës të më hershme pasi që nuk kam qenë pjesë e këtij komiteti, e kam pas të deleguar me autorizim të veçantë zëvendës ministrin z.Fatmir Gashi në takimet e KDNM, për shkak të numrit të madh të punëve nuk kam pas mundësi të marrë pjesë në të gjitha komitetet, kjo ka qenë përgjegjësi ekskluzive me të gjithë autorizimin e plotë që zv.ministri Fatmir Gashi ta përfaqësoj MF, unë besoi se ka vepruar në përputhje me ligjin, me rregulloret dhe procedurat që kanë qenë në fuqi ka vepruar me autorizim dhe asnjëherë për këtë proces nuk ka marrë këshilla, instruksione, aprovim, refuzim për çështje të caktuara, pasi që ne e kemi marrë detyrën në shtator të vitit 2017, ka qenë një situatë ku paralelisht është dashtë me zhvillu dy procese buxhetore, rishikimin e buxhetit për vitin 2017 dhe përgatitjen e buxhetit për vitin vijues duke pas për bazë që janë edhe afatet ligjore për shkak të ngarkushmerisë me punë, në ditën kur është mbajtur mbledhja e qeverisë ku është vendosur për këtë pikë të rendit të ditës, kamë qenë në seancë të kuvendit ku rend dite ka qenë një ligj apo projekt ligj që është dashtë të prezantohet nga sponsorizuesi në këtë rast unë si ministër i financave dhe kjo mund të dëshmohet për mos prezencën time në mbledhje të qeverisë duke ju referuar procesverbalit transkriptit të mbledhjes, pasi që jam në dijeni se ky projekt do të ndërtohet, një projekt që ka qenë i nevojshëm në aspektin ekonomik dhe të rëndësisë të veçantë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, janë zhvilluar procedura, ndërsa më datë 23.04.2018 kamë qenë ministër i ministrisë së financave, ne si MF vazhdimisht kemi pranuar kërkesa nga organizata buxhetore, mirëpo dihet procesi buxhetor trajtohet në procedurë dhe brenda ligjit, qoftë për buxhet të rregullt qoftë për rishikim të buxhetit apo në 3 mujori e fundit për rirregullim sipas ligjit të buxhetit, i cili menaxhohet nga ligji për financa publike dhe përgjegjësi, më pas deklaroi se unë si ministër nga tetori 2017 sa i përket këtij projekti e kam marrë me vonesë në pagesë, pastaj janë kryer pagesat sipas punëve të realizuara dhe në fund është kryer edhe pagesa shtesë për secilën unë nuk mundem me fole me kompetencë a është dashtë me qenë kjo shumë apo cila shumë është dashtë me qenë dhe janë bërë komplet pagesat që kanë qenë për vitet sa nuk kam qenë ministër, pasi që kompania ka muajt me e zvogëluar dinamikën ekzekutimin të punimeve si rezultat i mos përcjelljes me pagesa, dhe mendoi se është dashtë me u koordinu me palën kontraktuese, që pala kontraktuese me i nda mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës, pasi që pagesat janë realizuar një pjesë në vitin

2017, një pjesë në vitin 2018, ndoshta ka mbete edhe ndonjë pjesë për vitin 2019, pagesat janë realizuar për punë të kryera, ndërsa nuk mundë të flasë për shumën prej 53 milionëve dhe nuk kamë mundësit me sqaruar pse kanë ndodhë vonesat me ekzekutimit të projektit se ska qenë fushë e përgjegjësive të mija, ndërsa dëshmitari në deklaratën dhënë në polici me datë 17.04.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se me autorizim të veçantë e ka dërguar në takimet e KDNM, zëvendës ministrin z.Fatmir Gashi, për shkak të numrit të madh të punëve nuk kam pas mundësi që vetë personalisht të merr pjesë në takimet e KDNM.

3.1.6 Dëshmitari **B.A A.Kj**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 13.07.2023, deklaroi se sipas kontratës kam pas pozitën asistent i lartë ekzekutiv në kabinetin e ministrit MI, detyrat dhe përgjegjësitë kanë qenë kryesisht administrative, sekretariale si dhe me raste edhe organizative, detyrat administrative kanë përfshi çështjet që kanë të bëjnë me dokumente që kanë ardh, kërkesat, njoftimet, e-mailat në kabinetin e ministrit të drejtuara për ministrin Palë Lekaj, sekretarialet për organizimin e takimeve sipas agjendës, organizimin e vizitave brenda dhe jashtë vendit, sa më kujtohet mua rregullisht kemi pranua dokumente përfshi edhe dokumente nga kompania Hill International, pas shikimit të opinion të kompania mbikëqyrëse ‘Hill international’ e ka dërguar në MI, shkresës të datës 21 dhjetor 2017, opinionin në lidhje me pakon informative dhe të kontraktuar të titulluar ‘autorizim për zgjatjen e afatit kohorë për përfundimin e punës dhe adaptimin e drejt të çmimit kontraktues, dëshmitarit deklaroi se unë e kam pa këtë faqe dhe kam verifikua se ky është nënshkrimi im, që i bjen që unë atë shkresë e kamë pranua, këtë e kamë konfirmuar edhe në deklaratën në polici se e kamë pranuar personalisht unë atë shkresë, por nuk më kujtohet dokumenti në fjalë por as përmbajtja, gjë për të cilën më kanë pyet edhe hetuesit, përfaqësuesit e kompanisë ‘Hill International’ kanë ardh edhe vet ata personalisht i kanë deponu dokumentet, dokumente që janë adresua i kam shpërnda sipas përgjegjësive time tek personat përgjegjës, kryesisht dokumentet që kanë qenë në adresë të ministrit i kam shpërnda se në parim çdo dokument e kam dorëzua tek këshilltari E.B, i cili pastaj më ka drejtua sipas llojit të kërkesës se ku duhet t’i adresoj dokumentet qoftë ministri qoftë personat tjerë përgjegjës, në pyetjen se a ka ndodhë ndonjë shkresë mos mu përcjellë te ministri apo këshilltari i ministrit, dëshmitari përgjigjet se jam shumë i sigurt sipas detyrave që më janë dhen i kam përcjellë gjithmonë dokumentet në adresat e caktuara, kanë qenë disa raste sikur për kompaninë ‘Hill internacional’, që shpesh na kanë ardhë dokumentet pa u regjistrua në arkivë, dhe ne i kemi kalua me përcjellje në dorë pa evidencë te personi përgjegjës, por edhe nga palët e tjera, sipas

procedurave të mia të punës kryesisht kanë rrjedhë në këtë formë, shkresën e ‘Hill internacional’, para se të hyn tek ministri janë filtruar nga personat përgjegjës për shkak të volumit të lartë të punës, sa më kujtohet ka ekzistua një libër i protokollit për regjistrimin e dokumenteve dalëse me nënshkrimi e ministrit ose dokumenteve që janë përcjellë përmes ministrit, ka qenë një rregullore e kabinetit sa më kujtohet mua me ndarjen e përgjegjësive në kabinet ministri Lekaj më ka than se kur vijne shkresat duhet të filtrohen përmes këshilltarit të lartë ligjorë E.B para se të shkoj tek ministri, më pas deklaroi se anëtarëve të komitetit drejtues ndërministror ka qenë praktikë me dërgua gjithmonë agjendën për takimin edhe sipas disa rasteve ju kemi dërgua edhe materiale që paraprakisht të përgatiten për takim, përmbajtja e materialeve nuk e kam ditur dhe nuk e kam dërgua krye në vetë, por atë material ma ka dërgua dikush që të ja u dërgoj , u dashtë mu përgatit edhe agjenda, ndërsa dëshmitari në deklaratën e dhënë në polici me datë 20.02.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se opinion e kompanisë mbikëqyrëse ‘Hill international’ të dërguar në MI, me datë 21 dhjetor 2017, e ka pranuar personalisht vet dhe në parim çdo dokument ja ka dërguar të pandehurit E.B, dhe sipas udhëzimit të tij, çdo dokument e ka dërguar dokumentin në adresën përkatëse, gjykata gjen se i pandehuri E.B e ka pranuar opinionin e lartë cekur, duke marr parasysht se në vazhdimësi të pandehurit P.L dhe E.B në takimet e KDNM, e kanë fshehur ekzistencën e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, nga të njëjtit është fshehur edhe opinion ligjor me arsyetimin se të njëjtin opinion ligjor nuk është pranuar MI, po ashtu opinionin ligjor është dërguar në MI, vërtetohet edhe nga dëgjimi i përfaqësuesit të kompanisë Hill Internacional, është vërtetuar se opinion ligjor e kemi dërguar direkt në kabinet e MI pa vulë të protokoli sepse kështu na është kërkuar nga MI, ku si dëshmi për pranimin personal të opinion ligjore nga ana e dëshmitarit të lartcekur, ja kanë dërguar shkresën origjinal në polici, të cilën shkresë pas shikimit nga ana e dëshmitarit e ka pranuar se personalisht e ka pranuar opinion ligjor të Hill Internacional, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur është e sigurtë, gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitareve të n dëgjuar në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.7 Dëshmitari **V.LL**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 13.07.2023, deklaroi se pozitën e ministrit e kam ushtrua nga muaji shtator 2017 deri në muajin janar 2020, gjatë asj kohe ka qenë projekt i ndërtimit të rrugës Arbën Xhaferi, projekti ka parapa një komision

ndërministror ku kanë qenë 5 ministra të udhëhequr nga ministri i infrastrukturës, dhe si pozitë e ministrit që kam mbajtur në atë kohë, më ka takuar të jem anëtar i komitetit ndërministror për këtë projekt të caktuar, në takimet e këtij komiteti ka pasur diskutime për vlerën shtesë që ka kërkuar kompania Bechtel Enka për shkak të vonesave të pagesave sipas planeve të paracaktuara në marrëveshje, të paktën kështu është raportua në mbledhje nga kryesuesi i komitetit ose pjesët tjera të stafit të MI-së, vlera e saktë e kërkesës nga Bechtel Enka ka qenë dikun mbi 63 milion € afërsisht, shqetësimi kryesor ka qenë që mos pagesa e një detyrimi të tillë mundë të përfundoj në arbitrazh, si dhe mundë të zgjasë mos përfundimin e projektit në një kohë të pa caktuar, kjo ka qenë shqetësim i paraqitur në komitet nga ana e anëtarëve që kemi diskutua së bashku, kemi kërkuar nga kryesuesi i komitetit me negociua tutje me Bechtel-it, në mënyrë që ta ulim koston e atij shpenzimi, pas negociatave kemi kërkuar opinion nga kryesuesi i komitetit për ta sqaruar rrjedhën e këtij rekomandimi se si të vazhdohet tutje, pasi që kohën kur kam qenë në komitet informatat kanë qenë të limituara, nuk kam pas njohur dhe nuk është përmendë kompani mbikëqyrëse Hill international, nuk kam pranua ndonjë raport nga mbikëqyrësi i kontratës Hill internacional në kuadër të komitetit, nuk besoj të kem qenë i njoftuar për një raport të tillë prandaj nuk kemi ditë me kërkuar një raport të tillë, andaj me datë 5 qershor 2018, komiteti ndërministror, nxjerrë vendim lidhur me marrëveshje për pagesën e shpenzimeve shtesë prej 53.1 milion euro, e me të cilën e rekomandon qeverinë ta miratoj këtë, arsyetimi ka qenë në bazë të opinionit ligjorë të lëshuar nga kryesuesi i komitetit, por edhe pas prezantimit nga kryesuesi që janë bërë negociata apo janë shtjerrë negociatat me këtë operatori duke e ulur koston në minimumin e mundshëm të cilën shumë pastaj si komitet e kemi aprovuar, pas sjelljes të këtyre dy diskutimeve, njëra ka qenë opinionit ligjorë dhe tjetra një arsyetim që ato negociata kanë ndodhë dhe e kanë zvogëluar shumën e paraqitur nga Bechtel Enka, nuk më kujtohet se a e kam pas dosjen e kontratës bazë apo pjesë të kontratës që lidhen me lejimin apo mundësinë e pagesës shtesë, kanë qenë diskutime të ndryshme brenda komitetit me ambasadën me të cilën kemi shqyrtua cilat janë dëmet e mundshme në rast të mos pagesës së kësaj kërkesë, ndërkohë informatat që kanë qenë mbi tavolinë sikurse mos pagesat me kohë shkaktojnë kosto si për vonesë të projektit dhe pagesa të punëtorëve, makineri, është ditë dhe është pas parasysh se një detyrim ndaj Bechtel-it ka qenë i domosdoshëm, kurse sa i përket pjesës – presionit, ka qenë diskutim se në rast se mos aprovimit mundë të ndodhë që ky projekt të përfundoj në arbitrazh që do vonoj projektin për kohë të pa caktuar por edhe dëmin që mundë të jetë më i madh sepse gjatë kohës së arbitrazhit do futëshin kosto shtesë dhe nëse Bechtel-i do e fitonte rastin shuma do ishte shumë më e madhe, ndërsa dëshmitari në deklaratën e dhënë në polici me datë 03.04.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se ka qenë anëtar i komitetit ndërmënytor për këtë projekt, në takimet e këtij komiteti ka pasur diskutime për vlerën shtesë mbi 63 milion € që ka kërkuar kompania Bechtel Enka për shkak të vonësive të pagesave, sipas gjetjes së gjykatës kështu i është raportua në mbledhje nga kryesuesi i komitetit P.L dhe stafi i MI, i njëjti ka parqet para anëtareve të komiteti fakte të pa vërteta, të pa bazuar në dokumentacione përkatës, qëllimi i tij dhe i të pandehurit E.B ka qenë vetëm të krijojnë një pasqyrë jo ekzistues, duke keqpërdorur B.Tn e anëtarëve të komiteti, të njëjtit anëtar të komiteti për shkak të neglizhencës dhe mos hulumtimi të njohurive bazike rreth këtij projekti, ju kanë besuar të pandehurve të lartcekur dhe nga të thënat e tyre janë shqetësuar se mos pagesa e një detyrimi të tillë mundë të përfundoj në arbitrazh, pasi që sipas dëshmitarit gjykata gjen se në komitet informatat kanë qenë të limituara nuk është përmendë asnjëherë kompani mbikëqyrëse Hill International, pasi që të pandehurit P.L dhe E.B në takimet e KDNM, e kanë fshehur ekzistencën e kompanisë mbikëqyrës Hill Internacional, nga të njëjtit është fshehur edhe opinion ligjor me arsyetimin se të njëjtit opinion ligjor nuk është pranuar MI, gjykata gjen se dëshmitari si anëtar i komiteti ndërmënytor ka qenë në presion nga prezantimi i të pandehurve se në rast se mos aprovimit të kërkesës së Bechtel Enkes ky projekt të përfundoj në arbitrazh dhe dëmin që mundë të jetë shumë më i madh, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur është e singertë, nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale për veprimet e kundërligjshme të pandehurve P.L dhe E.B.

3.1.8 Dëshmitari **F.K**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.07.2023, deklaroi se kamë qenë në pozitë të sekretarit të përgjithshëm pranë zyrës së Kryeministrit, përgjegjësitë dhe detyra e mia parashihen me rregullore të qeverisë, është zyrtari me i lartë civil në zyrën e kryeministrit, menaxhon me resurset njerëzore, burimet, buxhetin, planet e punës së zyrës të kryeministrit si dhe zbatimin e atij planit si dhe koordinimin me sekretaret e përgjithshëm në ministri dhe për ministri, si dhe sekretarin e Kuvendit dhe të presidencës, më pas deklaroi se ka ardhë kërkesa që lidhet me projektin autostradën Prishtinë – Hanë Elezit e kemi kthyer përgjigjen zyrtare sepse nuk është përgjegjësi e Qeverisë ti ndajë mjetet, për arsyeje se ministria përgjegjëse i ka mjetet dhe kemi kërkuar një opinion nga ministria e Financave, por ka pas disa difekte që nuk i ka plotësuar kjo kërkesë, nuk i ka kalu disa kriteret që parashihen me rregulloren e qeverisë, pasi që këto mjete janë në planifikim të buxhetit të ministrisë së tyre, pastaj duhet të dërgohet tek ministria e financave që këto mjete duhet të ndahen, dhe kjo dedikohen me kod të caktuar, pastaj duhet një opinion i zyrës ligjore pranë ministrisë që e paraqet kërkesën për mjete, të gjitha këto

duhet të jenë të nënshkruara pastaj me një shkresë përcjellëse të nënshkruhen nga ana e sekretarit dhe nga ana e ministrit pastaj dorëzohet në arkivin e zyrës së kryeministrit, pastaj ne e kemi afatin kohor që duhet ti shqyrtojmë ato shkresa a janë në përputhje me kushtetutën, rregulloren dhe legjislacionin në fuqi, a janë të parapara me buxhetin e qeverisë dhe planin e punës së qeverisë, e nëse të gjitha plotësohen, unë ia procedoj për propozim të gjitha pikat që i plotësojnë kriteret për të vendosur në mbledhjen e radhës së qeveris, në detaje nuk më kujtohet por janë të arkivuara në kohën e qeveris Mustafa, ndërsa propozim në qeverinë Haradinaj ka kaluar direkt dhe jo përmes zyrës time dhe është kompetencë e kryeministrit dhe qeverisë, ku direkt sipas rregullores nga kryeministri mund të vendoset ndonjë rast i caktuar në fillim të takimit të qeverisë, kryeministri i pyet ministrat se a janë dakord me rendin e ditës, a ka kush për të shtuar ndonjë pike apo për të hequr, apo mund të bëhet propozimi nga ministri përkatës si në rastin konkret, pastaj kryeministri e qet në votim, ku votojnë ministrat, pasi që përgjegjësia ime është vetëm të shqyrtoj propozimet që deponohen pranë zyrës sime si pika të rregullta të rendit të ditës, ndërsa sa i përket pikave të rendit të ditës të propozuara direkt në mbledhje të qeverisë është përgjegjësi e kryeministrit, e qeverisë dhe e kabinetit qeveritarë që parashihet me rregullore, ndërsa sa i përket kërkesës prej 53 milion euro e Benktel Enka, e datës 05.06.2018, nuk është proceduar përmes zyrës time, ndërsa në rastin konkret kur propozohen si me datë 05.06.2018, është aprovuar në rend të ditës që të procedohet propozimi nga ana e qeverisë si ka qenë kërkesa e Benktel Enka në atë moment e njëjta shkresë duhet të protokollohet për të vazhduar më tutje mbledhja si në këtë rast, si dhe çdo vendim që nënshkruhet nga kryeministri protokollohet dhe ju dërgohet të gjithë ministrive si vendim i rregullt, në bazë të përvojës time asnjë vendim i komitetit ndërministrorë nuk është sjellë për qeveri për të marrë ndonjë vendim, zakonisht kane fuqi ekzekutive vendimet e marra ne kuadër të komitetit ndërministrorë është e paraparë me rregullore, po ashtu sqaron se rishikim i buxhetit zakonisht ndodhë 4-5 muaj pasi të miratohet buxheti i qeverisë, kur e sheh të arsyeshme qeveria koordinimin e bën me ministrinë e financave, pastaj plotësim ndryshimi i buxhetit pasi që harmonizohen se vijjnë kërkesa të ndryshme sillen në qeveri, nëse miratohet dërgohen në kuvend, nëse i miraton kuvendi hyn në fuqi, ndërsa sa i përket ndarjes shtesë të mjeteve pa miratimin e ministrisë së financave nuk mund të hyjë në mbledhje të qeverisë si pikë e rendit të ditës, e nëse qeveria jep pëlqimin pastaj procedohet merret vendimi, vendimi i marrë është përgjegjësi kolektive e qeverisë, mundet sot qeveria ta miratoje dhe brenda 24 orëve ta anulojë atë vendim, me arsyetim ose jo, ndërsa dëshmitari në deklaratën dhënë në polici me datë 30.01.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se ka qenë në pozitën të sekretarit të përgjithshëm pranë zyrës së kryeministrit, ka ardhë një kërkesa që lidhet me projektin autostradën Prishtinë – Hanë Elezit nga MI, i kemi kthyer përgjigjen zyrtare sepse nuk është përgjegjësi e qeverisë ti ndajë mjetet, gjykata gjen se kërkesa ka qenë e pa kompletuar me dokumentacion, në kohën e qeveris Mustafa, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se propozim në qeverinë Haradinaj ka kaluar direkt, jo përmes rrugëve zyrtare, është bërë propozimi nga ministri përkatës si në rastin konkret pastaj kryeministri e qet në votim, ku votojnë ministrat, nga kjo dëshmi vërtetohet se sa i përket pikave të rendit të ditës të propozuara direkt në mbledhje të qeverisë është përgjegjësi e kryeministrit, e qeverisë dhe e kabinetit qeveritarë që parashihet me rregullore, po ashtu nga kjo dëshmi vërtetohet se kërkesës prej 53 milion euro e Benktel Enka, është aprovuar në rend të ditës, e njëjta shkresë protokollohet, çdo vendim që nënshkruhet nga kryeministri protokollohet dhe ju dërgohet të gjithë ministrive si vendim i rregullt, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur është e sinqertë, gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitareve të ndërguar në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.9 Dëshmitari **R.H**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 29.09.2023, ka deklaruar se nga shtatori i vitit 2017 deri në shkurt 2020, kamë qenë Kryeministër i Republikës së Kosovës, projekti i autostradës R6 –Hani i Elezit ka qenë projekt aktiv, kamë marrë pjesë në takimin e KNDM, të datës 31.05.2018, propozoj ti referoheni procesverbaleve të takimeve të mbajtura, e mbështes procesverbalin çdo gjë që është në transkript është ashtu, është aprovuar pa asnjë vërejtje vlera 53milion, ka qenë vendimin unanimitet të dëshmojnë edhe transkriptetka, ka qenë i drejtë vendimi bazuar në procedurat e vendimmarrjes së brendshme për mbylljen e projektit, me arsyeje se projekti në fjalë do të ndërpritej dhe pa mbylljen e obligimit financiarë i njëjti do të kalonte në instancat tjera, në arbitrazh, më pasë deklarom se kryetari i qeverisë merr vendime në bazë të punëve të instancave përkatëse dhe nuk i shqyrton dokumentacionin që i ka shqyrtuar ministria përkatëse, ekziston praktikë e komuniteteve ndërministrorë, realisht ky komitet e përgatitë bazën e cila ministri është e nevojshme për krijimin e një komiteti të tillë, po flas për praktikat e përpunimit, përgatitjes, për vendimmarrje dhe mënyrën e marrjes së vendimit, të gjitha aspektet e tjera i mbështetëse: transkriptën, dokumentacionin dhe të gjitha shkresat që ekzistojnë në lëndë, se lënda ka kaluar në etapat e veta të arritjes së vendimmarrjes, pra i mbështes të gjitha, e konfirmoj që Qeveria pra e ka votu obligimin financiar ndaj operatorit, operatori ka qenë insistues që të përmbillet obligimi financiarë, në të kundërtën do të ndërpritej puna në autostradë dhe do të shihemi në arbitrazhë, kjo gjendje ka qenë nga qeveritë e kaluara,

e trashëguar, qëndrimi ka qenë gojor nga përfaqësuesi i Bechtel enkës, se nëse nuk do të realizohet do ta merrni shkresën se do të jeni të paditur në arbitrazh, ndërsa kompania Hill Internacional ka qenë palë e kontraktuar për të bërë mbikëqyrjen e projektit, propozimi final i KNDM, ndoshta nuk është dërguar drejtpërdrejtë tek unë por tek zyra për takimin e qeverisë, pas shikimit të dokumentit të datës 05.06.2018, të KDNM, me të cilën rekomandohet qeveria e Kosovës ta aprovojë kërkesën për shpenzime shtesë për konzorciumin Benklel Enka në shumën prej 53.1 milion, deklaroi në takimin e qeverisë ky dokument ka ekzistuar, kemi qenë në dijeni edhe unë edhe ministrat e tjerë që kanë marrë pjesë në KNDM për këtë vendim, për mua si kryetar i qeverisë mund të lind dyshimi kur ka kundërshtime, nga ministri i linjës, ministrat prezent, ka qenë një temë e madhe është diskutuar në të gjitha nivelet, operatori e ka pranuar përmbyllje paraprake pa kosto, e për shkak të vonësive të qeverive, për shkak të ndërprerjes së mandatit kjo çështje është trashëguar e ka pas edhe përkeqësim në raport me operatorin, kryetari i qeverisë në çdo takim të grupit ndërministror merr pjesë edhe për informatë edhe për përcjellje të lëndës, nëse ajo çështje do të jetë për votim, e njëjta edhe do të vlerësohet, procedohet edhe do të votohet, ky rast është konsideruar si çështje e rëndësishme dhe shumë e ndjeshme, nuk qëndron konstatimi i prokurorit sepse vendimi i KNDM nuk është vendim final, se kanë të drejtë me dhënë propozim, dhe pa u votua në qeveri nuk konsiderohet vendim i tyre, dhe nuk është i prerë, mos përcjellja e afateve kohore të obligimeve financiare nga qeveritë, ka rezultuar se vazhdim i kohore me shumë se koha e kontraktuar është kërkuar që të rikontraktohet, e që nuk është bërë, është akumuluar në këtë qeveri, edhe ne kemi mujt me ia lënë një qeverie tjetër, mirëpo ne kemi ndërmarr hapa, në pyetjen se a jeni njoftua lidhur me opinionin e kompanisë mbikëqyrës Hill Internacional, për punët shtesë ku parashihet vlera 14, 788 euro, dëshmitari ka deklaruar se opinionin i dhënë është një vit më parë, dhe një vit e bën ndryshimin edhe në kosto, dhe koha për operatorin ka qenë humbje, dhe kryetari nuk kërkon opinion kur lënda është e kompletuar, lënda i ka kaluar të gjitha etapat dhe të gjitha procedurat në formë të rregullt.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se ka qenë në pozitën e kryeministrit në kohën e projekti të autostradës R6, ka marrë pjesë në takimin e KNDM, gjykata gjen se dëshmitari nuk ka njohuri se si është themeluar KDNM për këtë projekt, nuk ka njohuri për rëndësinë e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional në këtë projekt ku sipas dëshmisë së tij nuk duhet të merret për bazë një opinion i viti 2017, i kompani Hill Internacional, pasi që është bërë një vit më parë dhe një vit e bën ndryshimin edhe në kosto, sipas dëshmitarit gjykata vërteton se kryetari i qeverisë merr vendime në bazë të punëve të instancave përkatëse dhe nuk i shqyrton dokumentacionin që i ka shqyrtuar ministria përkatëse, nga kjo gjykata gjen

se nuk është bërë as një vlerësim i dokumentacion nga kryeministria në lidhje me kërkesën për shumen prej 53 milion, këtë kryeministri i asaj kohe ja ka besuar vetme ministrisë përkatëse me ministër të pandehurin P.L, sipas dëshmisë së dëshmitarit qeveria pra e ka votua obligimin financiar ndaj operatorit, obligim ky që ka qenë e trashëguar nga qeveritë e kaluara, në të kundërtën do të ndërpritej puna në autostradë dhe do të shihemi në arbitrazhë, sipas vlerësimit të gjykatës këto deklaramë të dëshmitarit janë të pa bazuar në fakte dhe në prova, vetëm se në bindjen e dëshmitarit janë krijuar rrethana të pa vërteta të prezantuara nga ministri përkatës i pandehuri P.L në lidhje me kërkesën e Bechtel enkës, e njëjta dëshmi nuk gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitareve relevant të n dëgjuar në këtë çështje penale, pasi që gjykata gjen se është krijuar një pasqyrë e pa vërtet dhe e pa bazuar në fakte në njohurit e dëshmitarit të lartcekur, ku sipas deklaramëve të tija nuk ka pas njohuri bazike në lidhje me projektin në fjalë, dhe të gjitha informata e marra në lidhje me këtë projekt, ja ka besuar ministrisë përkatëse të drejtuar nga i pandehuri P.L.

3.1.10 Dëshmitari **A.Z** në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 29.09.2023 dhe me datë 02.10.2023, ka deklaruar se pozitën shëf i kabinetit në MI, e ka pranuar në shtator 2017 deri në shkurt të vitit 2019, ka pas për detyrë koordinimin e detyrave të kabinetit ministrit, implementimin politikave në kordinim me sekretarin e ministrisë së infrastrukturës, ku sekretar ka qenë N.SH, ndërsa për pranimin e shkresave brenda kabinetit të ministrit ka qenë para zyra përgjegjëse, i cili është marrë me pranimin dhe administrimin e dokumenteve të cilat ose kanë ardhë përmes arkivues së ministrisë, e të cilat janë protokoluar në librin e protokollit të ministrit nga asistenti i lartë ekzekutiv ka qenë B.A, të gjitha dokumentet që kanë qenë për ministrin, për zv ministrat, sipas rregullativave ligjore ka qenë e obligueshme që të protokollohen me datën e hyrjes dhe nëse ka pas me ju drejtua ndonjë departamenti të ministrisë edhe me datën prej kur kane ardhë në kabinetin e ministrisë, në dijeninë time, në asnjë rast pa u protokollu nuk është procesu asnjë dokument për arsyeje se është kundërligjore, më pas deklaroi se në 100 përqind të takimeve KNDM kam qenë prezent, në takimin e datës 31.05.2018 ka pas diskutime ku kryeministri ka kërkuar që të sigurohet një opinion ligjore nga departamenti ligjor në MI, brenda një ditë, brenda 24 orëve, në datën e njëjtë janë udhëzuar nga zyra e ministrit që të ftohet telefonohet drejtori i departamenti ligjore, që në atë kohë ka qenë z.A.K dhe i njëjti për fatin tonë të mirë ka qenë prezent, ka qenë fizikisht në objektin e MI, dhe pa vonesë na është bashkëngjitur kabinetit të ministrit, i është përcjellë kërkesa e kryeministrit që me e sigurua një opinion ligjorë për kërkesa e Benchel enkes përballë qeverisë së Kosovës, të sigurohet brenda 24 orëve, drejtori i departamentit ligjorë ka qenë i stepur dhe i habitur, ndoshta pak nervoz dhe i pasigurtë nëse

mundet ta hartojë brenda ditës dhe me arsyetimin se nuk e njeh lëndën në tërësi, nga udhëheqësi i njësish për implementimit e projektit Rame Qypeva i janë ofruar drejtorit të departamentit ligjore dokumentet duke përfshirë edhe kontratën baze, më pas deklaroi se në çdo mbledhje që është thirrë në takime të KMND, janë përgatitë dosjet fizike për të gjithë anëtarët komitetit, janë përcjellë edhe me email dokumentet prej asistentit të lartë ekzekutiv, çdo gjë është diskutuar në KNNDM është e transkriptuar nga procesverbalet e mbajtura.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur se ka qenë shef i kabinetit në MI, sipas tij pranimi i shkresave brenda kabinetit të ministrit janë protokolu në librin e protokollit të ministrit nga asistenti i lartë ekzekutiv B.A, po ashtu nga kjo dëshmi gjejmë se në takimin e datës 31.05.2018 , ka qenë prezent kryeministri asaj kohe, i njëjti ka kërkuar që të sigurohet një opinion ligjore nga departamenti ligjor në MI brenda 24 orëve për kërkesën prej 53 milion të OE Bechtel enkës, nga kjo dëshmi vërtetohet se pas njoftimi të drejtorit të departamentit ligjorë A.K për kërkesën për opinion ligjor brenda 24 ore, i njëjti ka qenë i stepur dhe i habitur me arsyetimin se nuk e njeh lëndën në tërësi, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit A.K për pozitën e njëjtit që e vërteton gjendja faktike në këtë çështje penale sa i përket kësaj pjese, ndërsa sa i përket pjesës së dëshmisë për procedure e pranimi të shkresave pran MI, dëshmia e tij nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit B.A A.Kj ku ka deklaruar se vet personalisht i ka pranuar shkresat dhe ka deklaruar se nuk janë regjistruar në ndonjë libër shkresat që janë pranuar direkt në kabinet e MI, janë regjistruar vetëm shkresat që kanë dalë nga kabineti i MI.

3.1.11 Dëshmitari **L.ZH**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 02.10.2023, ka deklaruar se si ministër në MI kam filluar me datë 8 apo 9 në muajin dhjetor të vitit 2014, për projektin e autostradës Arbër Xhaferi, kontrata është nënshkruar diku nga fillimi i korrikut 2014, kështu që e kemi gjet kontratën e nënshkruar si qeveri e re kur jemi emëruar në dhjetor 2014, kontratat e ka pas shumë prej 600 milion euro, e lidhur ne mes konzorcionin Bechtel enka dhe qeverise se RKS, konkretisht MI , ajo që ka qenë evidente ka qenë mospërputhja e kontratës me ndarjen buxhetore në bazë të ligjit te buxhetit, kështu që është dashtë menaxhim i kontratës me Bechtel Enkën, që ata të punojnë në përputhje me ndarjet buxhetore në bazë të ligjit të buxhetit, me alokimin e mjeteve, punët kanë vazhduar normal në vitin 2014, kanë punua ma pak, ka qene të ndara 80 apo 85 milion ata kanë shfrytëzuar diku 55 milion, në vitet 2015 dhe 2016 kanë qenë vite që ata kanë vazhdua me punë, ata kanë punua ma shumë në përputhjeje me ndarjet buxhetore të ligjit të buxhetit, rregullisht ata deri në fund të vitit kanë punua pak ma shumë, por që i kemi

pagua, në mbledhjet e fundit të vitit kemi projekte që nuk janë krye, mjetet e janë bartë në projektin e Benkel Enka, në bazë të vendimit të qeverisë, e drejtë ligjore kjo, po na kemi pas gjithmonë një sh përputhje të vogël por të gjitha faturat janë paguar në vitin 2014, edhe në vitet 2015 dhe 2016 është e njëjta situatë, nuk ka asnjë rast që Bechtel enka e ka bërë një shkresë që e ka kryer punën dhe nuk e kemi paguar borxhin, kjo vërtetohet edhe me raportet financiare të qeverisë së Kosovës, të cilat i përmbajnë obligimet e qeverisë natyrisht përfshirë edhe obligimet e Bechtel Enkes, ndërsa sa i përket vitit 2017, ka vazhduar puna, na kemi ndarë shumën mbi 100 milion , por me 8 apo 9 maj ka ra qeveria në vitin 2017, ata kanë filluar punën në mars me intezitet më të lartë duke marrë parasysh se gjatë dimrit ka qenë inteziteti më i vogël i punës, pagesat e shkurtit, mars, prill, maj janë kryer të gjitha pagesat në rregull për arsyeje se ka qenë një shifër e madhe e ndarjes së buxhetit, në vlerë prej 170 milion apo 200 milion euro, nga mesi i vitit 2016, ka qenë evidente që nuk ka mujt me u krye kontrata sipas afatit kohor të përcaktuar deri në janar 2018, tre vjet e gjysmë, 42 muaj, kemi biseduar me mbikëqyrësin e punimeve me menaxherin e kontratës Hill Internacional, për me e gjet një zgjidhje, për shkak të vazhdimit të kontratës –afatit të kryerjes së punimeve, në mungesë të mjeteve të ndara me buxhet, kemi pas biseda dhe në bazë të tyre kemi ardhur në përfundim që në përputhje me kontratën të zgjasim afatin e punimeve për 11 muaj deri në fund të vitit 2018, në përputhje me rekomandimin dhe shkresën e Hill Internacional, pasi që e njëjta kompani ka qenë menaxher i kontratës sipas rregullave dhe udhëzuesit operativ të ligjit publik të prokurimit, kompania Hill Internacional është menaxher i kontratës që nënkupton se mban përgjegjësi për realizimin e saktë të punimeve dhe zbatimin çdo dispozite të kontratës, i mbikëqyrë pagesat për kompaninë Bechtel Enka, është çështje ligjore dhe se pa menaxher të kontratës nuk mund të realizohet asnjë kontratë e punëve publike, na si komision ndërministror jemi mbledhë, e kemi shqyrtuar propozimin e Hillit dhe e kemi aprovuar, ka qenë zgjatja e afatit të punimeve dhe kostoja e asaj zgjatje, afati ka qenë 18 janar 2018 dhe deri me 31.12.2018, ndërsa kostoja e përgjithshme ka qenë 14 milion e 788 mijë euro, është e drejtë e komitetit me marr një vendim të tillë e pastaj e kemi përcjellë ankës kontratën në qeveri dhe pas dy muajve, në dhjetor qeveria e ka kthyer me përgjigjen se nuk kemi nevojë me ndërhyrë në proces, me arsyeje se KNDM , ka kompetenca të mjaftueshme më u marr me të dhe natyrisht qeveria ka pas konsultime të vazhdueshme me Bechtel enkën, ku ne Bechtel enkës, ia kemi bërë të qartë që vendimi është në rregull në përputhje me kontratën dhe ne do ta nënshkruajmë kontratën për vazhdimin e punimeve para përfundimit të kontratës aktuale, kemi pritë me përfundua kjo kontratë, pastaj me zgjatë afatit, për këtë është pajtuar Bechtel enka, dhe e vetmja çështje që nuk janë pajtuar kanë kërkuar që menjëherë ta nënshkruajnë kontratën , dhe ne ju kemi sqaru se do të përpiqemi që gjatë vitit 2017, të ketë ndarje më të madha buxhetore

dhe eventualisht të mos jetë zgjatja për 12 muaj, të jete afat më i shkurtër deri në 6 muaj, ka qenë me rëndësi se është përcaktuar procedura sesi me u caktua kostoja, në bazë të shkresave të Hillit, është një milion në muaj në përputhje me kontratën dhe është garancioni i performancës për punët e kryera në përputhje me afatin e shtymë, pasi që ska të drejtë ligjore të bëhet një pagesë për Bechtel Enken, pa mbikëqyren e kompanisë Hill Internacional, menaxheri i kontratës është ai qe e përcakton vlerën e kontratës në këtë rast kompania Hill Internacional, e ka pas obligim ministri Lekaj ta shqyrtojë aneks kontratën e vitit 2016, është para se me e nënshkruar ankes kontratë në verën e 2016 kemi pas kërkesë nga Bechtel enka në vlerë prej 25-26 milion nuk e di saktë, por të njëjtën kërkesë nuk ka mundur ta arsyetojë, jemi konsultuar si obligim ligjor me kompaninë Hill Internacional dhe të njëjtit na kanë konfirmuar se nuk ka bazë kontraktuale kërkesa e tillë, më pas deklaroi se forma e kontratës ka qenë me çelësa në dorë, çdo kontrate e parasheh zgjidhjen e kontestit, ekziston edhe arbitrazhi, në rastin konkret kur ministër ka qenë Lekaj nuk besoj se do të kishte shkuar në Arbitrazh, nuk mundet dikush vetëm me të frigu se do të padis, pa pas ndonjë borxh, në këtë rast konzerciumi Bechtel enka nuk ka mundur me shku në arbitrazh pa kurrfarë baze aktuale, po ishte ai rast Hill kompania e mbrojtur Qeverinë e Kosovës se e ka obligim kontraktore, Hill është dashtë të japë mendimin konkret dhe ata e mbrojnë qeverinë e KS sipas kontratës, për atë arsyeje është paguar kompania Hill, ndërsa lidhja e një marrëveshje pa kosto besoj që është gabim, pasi që ministri Lekaj nuk ka pas të drejtë të lidh marrëveshje pa mendimin e kompanisë Hill sepse është kundërligjore, është gabim të lidhet një kontratë pa kosto sepse ju i hapni rrugë për definim apo rishqyrtim të asaj kostoje, pa kosto është e kundërligjshme, unë nuk e di që mundet të nënshkruhet një kontrate pa kosto, si parim, në ligjin për prokurimin publik nuk ekziston mundësia me e nënshkrua një kontratë pa vlerë, është në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, gjithashtu është çështje ligjore se nuk kanë pas të drejtë ta procedojnë marrëveshjen pa mendimin e menaxherit të kompanisë Hill Internacional, për arsyeje se nëse ndodhe situata të shkojë në Arbitrazh dhe kompania Hill duhet ta mbrojë për shka se janë paguar për atë, po ashtu deklaroi se nuk ka qenë e nevojshme të bëhet pagesa prej 53milion, është keq menaxhim, duke ju referuar nënshkrimit të një shume që ka qenë në kundërshtim me kontratën dhe rekomandimit të dhënë nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional, nuk ka askush të drejtë me anashkaluar menaxherin e kontratës Hill internacional si menaxheri i kontratës e ka për obligim me e mbikëqyrë dhe me e zbatu kontratën në tërësi, dhe ka raportuar tek njësia për implementimin e projektit, këshilltarë financiarë ligjor dhe operativ është menaxheri, më pas deklaroi se për vitet 2014-2015-2016 me ligjin e buxhetit për këtë projekt kanë qenë të ndara 285milion euro, të parapara për këtë projekt, kurse kontrata ka qene 600 milion euro, më shumë se dyfishi i paraparë për atë projekt, njoftim nga qeveria për

kompaninë ka qenë publike dhe me mirëbesim nga qeveria dhe Bechtel enka, ne e kemi nda buxhetin në përputhje me projeksionet buxhetore dhe punët janë kryer në kontiunitet me buxhetin e ndarë, kontrata ka qenë me çelësa në dorë, me shumë fikse, shume e cila ka mund të tejkalohet ka qenë 10 % në përputhje me ligjin e prokurimit publik, për çka ka qenë kjo 5 % ka qenë tantiema dhe 5 % për punë të tjera, Tantiema nënkupton kur duhet të paguani kur nuk ka trase gurë, dhe kur e merrni diku tjetër, duhet të paguani, sipas kontratës materiali gurorë apo çka do që gjendet nga traseja nuk ka tantiemë, kurse materiali që merret jashtë punishteje është dashtë të paguajë tantiemë, dhe për 5 % për punë të paparame-shtesë, psh e kemi parapa trasenë e keni një largpërçuese dhe disklokimi i largpërçuesi konsiderohet si punë e papapararë, kontrata e ka pas vlerë fikse 600 milion euro, deri tek pagesa e 14milion e 788 mije euro, e cila pagesë paraprakisht është aprovuar nga menaxheri i kontratës përbëhet prej dy pjesëve, pjesa e parë është e papapararë në aneksin e kontratës prej 1 milion euro, e që përfshinë koston fikse të kontraktorit që nënkupton se kontraktori ka shpenzime fikse që duhet me u paguar pavarësisht a punon apo jo, psh qiraja, sigurimi punishtes etj, dhe të gjitha këto janë fikse janë papapararë që janë 1milion euro në muaj, për zgjatjen e afatit prej 11muaj e 10 ditë, ajo kosto është llogaritë për 12 milion e 500 mijë euro pa tvsh dhe kur të shtohet tvsh bëhet 14 milion e 788 mije euro, pasi që në kontratë ekzistojnë penalet një milion euro në ditë e kemi nëse kërkojmë zgjatje të afatit apo kemi vonesa, ndërsa 1 milion e dyqind mijë euro e ka Benkl enka nëse ata kërkojnë më e zgjatë afatin, kjo është e cekur në aneks kontratë.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet se në muajin dhjetor të vitit 2014, ka qenë ministër në MI, projektin i autostradës Arbër Xhaferi, ka qenë i nënshkruar, ka pas mospërputhja e kontratës më me ndarjen buxhetore në bazë të ligjit të buxhetit, kështu që është dashtë menaxhim i kontratës me Bechtel Enkën të punojnë në përputhje me ndarjet buxhetore në fundit të vitit kemi projekte që nuk janë krye, mjetet e janë bartë në projektin e Bechtel Enka, në bazë të vendimit të qeverisë, gjykata gjen se edhe pse nuk ka pas buxhet të mjaftueshëm, janë krye punime në përputhje me buxhetin e ndarë, po ashtu nga e njëjta dëshmi vërtetohet se faturat të viteve 2014, 2015 dhe 2016, për vitin 2017, për muajin shkurtit, mars, prill, maj janë paguar të gjitha këto vërtetohen edhe me raportet financiare të qeverisë së Kosovës, e jo nga të pandehurit në këtë çështje penal të cilët vazhdimisht janë thirr në mos pagesat e realizuara nga qeveritë e më hershme e kanë pru kërkesën prej 53 milion, dhe as një here nuk ja kanë afruar gjykatë as një faktur të vetëme që nuk ju ka paguar faktura koncerzimit Bechtel enka, nga kjo dëshmi vërtetohet se nga mesi i vitit 2016, nuk ka mujt me u kry kontrata sipas afatit kohor të përcaktuar deri në janar 2018, kanë biseduar me mbikëqyrësin e punimeve

me menaxherin e kontratës Hill Internacional, për me e gjet një zgjidhje, kemi ardh në përfundim që në përputhje me kontratën të zgjasim afatin e punimeve për 11 muaj deri në fund të vitin 2018, e kemi shqyrtuar propozimin e Hillit dhe e kemi aprovuar, ka qenë zgjatja e afatit ka qenë 18 janar 2018 dhe deri me 31.12.2018, ndërsa kostoja e përgjithshme ka qenë 14 milion e 788 mijë euro, është e drejtë e komitetit me marr një vendim të tillë e pastaj e kemi përcjellë ankës kontratën në qeveri dhe pas dy muajve, në dhjetor qeveria e ka kthyer me përgjigjen se nuk kemi nevojë me ndërhyrë në proces, me arsyeje se KNDM , ka kompetenca të mjaftueshme më u marr me të, kemi pritë me përfundua kjo kontratë, pastaj me zgjatë afatit, gjykata vlerëson se të gjitha veprimet janë marrë sipas rekomandime të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, pasi që sipas dëshmitarit ska të drejtë ligjore të bëhet një pagesë për Bechtel Enken, pa mbikëqyren e kompanisë Hill Internacional, menaxheri i kontratës është ai që e përcakton vlerën e kontratës në këtë rast kompania Hill Internacional, pas që lidhja e një marrëveshje pa kosto është gabim, pasi që ministri Lekaj nuk ka pas të drejtë të lidh marrëveshje pa mendimin e kompanisë Hill sepse është kundërligjore, është gabim të lidhet një kontratë pa kosto sepse ju i hapni rrugë për definim apo rishqyrtim të asaj kostoje, pa kosto është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, sipas dëshmitarit është vërtetuar se është çështje ligjore se nuk kanë pas të drejtë ta procedojnë marrëveshjen pa mendimin e menaxherit të kompanisë Hill Internacional, po ashtu vërtetohet se nuk ka qenë e nevojshme të bëhet pagesa prej 53milon, nga kjo dëshmi gjykata gjen se ka qenë keq menaxhim i nënshkrimit të një shume që ka qenë në kundërshtim me kontratën dhe rekomandimit të dhënë nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional, po ashtu nga kjo dëshmi vërtetohet se në rastin konkret ministër Lekaj nuk besoj se do të kishte shkuar në arbitrazh pa kurrfarë baze aktuale, po ashtu ka sqarua për gjykatë se shume e cila ka mund të tejkalohet ka kontrata bazë ka qenë 10 % në përputhje me ligjin e prokurimit publik, për çka ka qenë kjo 5 % ka qenë taniema dhe 5 % për punë të tjera, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur është e singertë, gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitareve të n dëgjuar në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.12 Dëshmitari **A.H**, në seancën e shqyrtimi gjyqësor me datë 03.10.2023 deklaroi se kamë pas njohuri për projektin e autostradën Arbër Xhafer, unë kam qenë ministër i financave nga dhjetori i vitit 2014 deri në verën e vitit 2017, prej momentit si ministër kamë qenë anëtarë i KNDM prani MI, sipas vendimit të qeverisë kur është themeluar KNDM, sipas dijenisë time është themeluar në momentin kur është nënshkruar kontrata për projektin e lartcekur në qeverinë para se unë të jem ministër i financave, kamë marrë pjesë në disa takimet e mbajtura të KNDM,

është diskutuar për progresin e projektit dhe sa më kujtohet se çdo gjë është iniciuar dhe të gjitha që i kam thënë janë në procesverbalin takimeve të mbajtura, projektin e ka mbikëqyrë kompania mbikëqyrëse e kontraktuar Hill Internacional, kosto e aneks kontratës në dijeninë time është caktuar nga kompania mbikëqyrëse, ajo që mund të them se kjo kompani është kontraktuar për të menaxhuar kontratën që ka shërbye në mes qeverisë në njërin anë dhe kompanisë ndërtuese, si e kuptoj unë menaxheri i kontratës është ai që e menaxhon nga momenti i lidhjes së kontratës deri në përfundimin e asaj kontrate është autoriteti i vetëm që vendosë se si procedon me kontratë, ndërsa detyrë e ministrit të financave është që të mbledhë kërkesat buxhetore të ministrive përkatëse dhe këto ti përmbledhë në draftin e buxhetit, i cili shkon në qeveri dhe miratohet në kuvend, pra nuk është ministri i financave ai që kujdE.B për ndarjen e buxheteve individuale për projekte, ministrat përkatës bëjnë kërkesa e nevojshme buxhetore, në përputhje me mundësitë buxhetore ministria e financave i bën bashkë dhe ia prezanton qeverisë për miratim në përputhje me buxhetin, me sa e di unë të gjitha obligimet financiare lidhur me këtë kontratë janë kryer, pra nuk ka naj faturë që lidhet me këtë projekt e që ka mbete pa paguar nga buxheti i shtetit, në atë kohe kemi qenë në program në fondin monetarë ndërkombëtare dhe mbikëqyrja e financave është bërë në mënyrë të detajuar dhe çdo vendim është marrë me dakordimin e FMN, më pas deklarom se me informatat që kam në korrik të vitit 2014, është nënshkruar kontrata, në buxhet ska pas mjete të mjaftueshme për kontratën e nënshkruar, atëherë buxheti ka qenë rreth 200 milion euro për këtë kontratë i paraparë në buxhetin tre vjeçarë, kontrata ka qenë në shumë prej 600 milion euro, ka qenë shqetësim i ministrit të linjës vazhdimisht që të akomodohet kjo kontratë brenda buxhetit vjetor në përputhje me ligjin për financave publike dhe vazhdimisht kemi nda buxhet shtesë në mes vitit kur bëhen bilancet e projekteve që nuk janë realizua, kemi nda buxhet shtesë në rastin e rishikimit të buxhetit kur rialokohen mjetet prej një projekti në një projekt tjetër në çdo rishikim buxhetor dhe fund vit, kemi nda mjete shtesë, ajo që dua të them është se kur është nënshkruar kjo kontratë nuk ka pas buxhet të mjaftueshëm për këtë projekt, jemi munduar ti dalim zot kësaj kontrate me alokime shtesë, sepse ska pas buxhet të mjaftueshëm por është ministri i linjës L.ZH është përkujdese për këtë, ndërsa se çka e ka shty dhe si ka vepruar qeveria pasardhëse unë nuk mund të jap vlerësim, se në momentin kur miratohet një buxhet vjetorë janë parashikimet edhe për dy vitet në vijim, dhe çdo shifër në buxhet është ligj, çdo qeveri apo ministër ka për obligim ti zbatojë ato, obligimet mund të ngecin 3-4 muaj deri në 6 muaj apo sa të vie qeveria, në parim jo ama ne e kemi një administratë që përkujdE.B për punët administrative të projekteve, ky ka qenë një ndër projektet më kryesore të qeverisë për shkak se ka qenë shumë i madh, andaj i kemi dhënë prioritet me angazhimin edhe të ministrit të linjës, ndërsa zgjatje të afatit të punimeve kur ti vjen

fundi kontrata mund të vazhdohet sipas provizioneve të kontratën bazë dhe sipas rekomandimit të kompanisë mbikëqyrëse të atij projekti, komiteti nuk ka vlerësuar shumë, shuma është vlerësuar nga menaxheri i kontratës nga kompania mbikëqyrëse, shumë mund ta gjeni në traskriptet mbledhjeve të KNDM, është shuma për korrektësi, 14 milion euro, që vlerësimi që ka dhënë menaxheri i kontratës, e keni një autoritet publik që është ministria e infrastrukturës dhe qeveria, dhe në mes tyre është kompania mbikëqyrëse, në bazë të ligjit të prokurimit publik autoriteti kontraktues ka për obligim të zbatojë rekomandimet e kompanisë mbikëqyrësit Hill në bazë, përgjigjja është se ka qenë i obliguar KNDM që ti përmbahet rekomandimeve të kompanisë Hill Internacional, jam i obliguar ta them se sipas ligjit asnjë kontratë nuk mund të nënshkruhet nëse nuk ka buxhet, pra në këtë rast është nënshkruar një kontratë pa qenë plotësisht e reflektuar në buxhet, kur kam ardhë unë si ministër i financave e kam gjet të nënshkruar një kontratë pa buxhetin e nevojshëm për pagesë, çdo vit është nda buxhet shtesë për këtë projekt mbi buxhetin e paraparë duke ju referuar mundësive buxhetore që i ka shteti i Kosovës.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet ka qenë ministër i financave deri në verën e vitit 2017, ku projektin R6 e ka mbikëqyrë kompania mbikëqyrëse e kontraktuar Hill Internacional, dhe kosto e aneks kontratës është caktuar nga kompania mbikëqyrëse, nga e njëjta deklaratë vërtetohet se të gjitha obligimet financiare lidhur me këtë kontratë janë kryer, pra nuk ka naj faturë që lidhet me këtë projekt e që ka mbete pa paguar nga buxheti i shtetit, po ashtu vërtetohet se buxhet ska pas të mjaftueshme për kontratën e nënshkruar, atëherë buxheti ka qenë rreth 200 milion euro për këtë kontratë i paraparë në buxhetin tre vjetarë, kontrata ka qenë në shumë prej 600 milion euro, ka qenë shqetësim i ministrit të linjës L.ZH vazhdimisht që të akomodohet kjo kontratë brenda buxhetit vjetor në përputhje me ligjin për financave publike dhe vazhdimisht kemi nda buxhet shtesë në mes vitit kur bëhen bilancet e projekteve që nuk janë realizua, kemi nda buxhet shtesë në rastin e rishikimit, jemi munduar ti dalim zot kësaj kontrate me alokime shtesë të mjeteve, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitarit të lartcekur është e sinqertë, gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitarit L.ZH i n dëgjuar në këtë çështje penale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale.

3.1.13 Dëshmitari **I.R**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 01.12.2023, ka deklaruar se me datë 21.07.2016 pranë KRPP është bërë kërkesa për interpretim të klauzolave të kontratës në fjale duke qene se LPP eshte ligj procedural i cili rregullon fushën e prokurimit publik nga inicimi e deri te dhënia e kontratës pra në funksion të KRPP është edhe interpretimi i dsipozitva

ligjore të LPP dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, ndërsa në funksion të KRPP nuk është edhe interpretimi apo sqarimi i kushteve të kontratës sepse kur një kontrate nënshkruhet dhe hynë në fuqi ajo është ligj për palët kontraktuese, si e tillë duhet të implementohen në përputhje me kushtet e përgjithshme të kontratës dhe në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës dhe kur do që ka mospërputhje mes kushteve të përgjithshme dhe të veçanta mbizotërojnë kushtet e veçanta, ndërsa për çdo kontest kontraktual palët duhet të bëjnë përpjekje që ta zgjedhin me marrëveshje në të kundërtën secila pala ka drejt me iu drejtuar gjykatës, pra behet fjale për kontratat në implementim, siç ka qene edhe pergjigja me datë 01.08.2016, duke u bazuar në nenin 81, bëhet fjalë për menaxhimin e kontratave dhe neni 70 i Rregullores për Prokurimit Publik është sqaruar çështja e menaxhimit të kontratës, përveç interpretimit të LPP dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik nuk është në funksion të KRPP edhe interpretimi i klauzolave të kontratës. shkresa e datës 01.08.2016 është dhënë në përputhje me kërkesë e bere nga AK i datës 21.07.2016, pavarësisht me cilat rregulla lidhet kontrata është jashtë funksionit të KRPP interpretimi i çfarëdo kontrate apo situatave të caktuarave si rezultat i kontratave të nënshkruara, përveç interpretimit të dispozitivat të LPP kur të vendosen kushtet në kontrate, KRPP nuk interpreton kushtet e kontratës sa i përket rregullave të fidikut në këtë rast, LPP ka parapare rregullat cilat duhet të zbatohen nga autoritete kontraktuese gjate aktivitetit të prokurimit publik, ndërsa sa i përket kushteve të përgjithshme dhe të veçanta edhe nëse nuk janë përmend në shkrese tek menaxhimi i kontratës, ekzistojnë edhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta dhe kurdo që në kushtet e veçanta vendoset një rregull apo dispozite që përfshinë rregullat tjera qofte edhe i legjislacionit tjetër mbetet në përgjegjësinë e palëve kontraktuese që kurdo që ka kontest kontraktuar me zgjidh sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta, duke u mbështetur në legjislacionin përkatës.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur, nga e njëjta vërteton se KRPP nuk interpreton kushtet e kontratës sa i përket rregullave të fidikut në këtë rast, LPP ka parapare rregullat cilat duhet të zbatohen nga autoritete kontraktuese gjate aktivitetit të prokurimit publik, nga kjo dëshmi gjykata gjen se kur një kontrate nënshkruhet dhe hynë në fuqi ajo është ligj për palët kontraktuese, si e tillë duhet të implementohen në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe me kushtet e veçanta të kontratës siç ka qene edhe pergjigjja e datës 01.08.2016 KRPP, gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në prova materiale të procedura në këtë çështje penale.

3.1.14 Dëshmitari **Georgius Papaioannou**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 04.12.2023, deklaroi në fillim të nëntorit të vitit 2014, Hill Internatonal ka pas kontratë për

shërbime me MI, Hilli e ka marrë rolin e përfaqësuesit të punëdhënësit, unë kam qenë përfaqësues i Hill International, do të thotë nëse i merrni kontratën e shërbimeve aty janë të përshkruara në hollësi shërbimet që janë ofruar prej kompanisë Hill, ideja ka qenë që Hill International me i mbikëqyr punët dhe po ashtu me asistua ministrinë në menaxhimin financiar të vet kontratës, unë kam qenë udhëheqës që e kam menaxhua projektin në teren, kontrata ka qenë në vlerë prej 599 rreth 600 milion, në kontratë janë tri subjekte, punëdhënësi MI, kontraktuesi Bechtel enka, dhe Hill International është përfaqësuesi i kontratës në mes të Bechtel enka dhe MI, kur flasim për procedurën e menaxhimit financiar procedura ka qenë si në vijim Bechtel enka ka kërkuar nga Hill Internacional që çdo muaj me i paraqit faturat dhe sasinë e punëve në mënyrë që të mbështetet shuma e paraqitur në fatura, ne fillimisht kemi marrë kontratën me pa për me shikua se a janë në përputhje me kontratën dhe kemi verifikuar sasitë qysh është e cekur në kontratë, sa herë që kemi pas dallim ose ndryshim e kemi korrigjuar dhe nëse kemi gjet diçka që është kërkuar nga kontraktori ne i kemi korrigjuar edhe ato, edhe nëse ka pas probleme me cilësinë e punëve edhe sipas kontratës kemi pas të lejuar që me bo zbritje, edhe këto raste ne i kemi përpilua një dosje me të gjitha këto dokumente dhe kemi nxjerrë një faturë të re dhe ja kemi dorëzuar MI për pagesë, dua me përmend se i kemi pas 28 ditë për me i vlerësua këto ndryshime, me bo korrigjimin dhe me nxjerr faturën dhe me ja dorëzuar MI, në fillim të muajit prill të vitit 2016, edhe më herët gjithmonë ka qenë çështja e alokimeve buxhetore kanë qenë të mangëta ose të shkurta nga ana e Qeverisë, pra buxheti i pakt, Bechtel enka në vitin 2014-2015, e ka përgatitur një tabelë dhe ja ka dorëzuar MI duke i thënë kjo çka kryhet do të paguhet, për punën që është kryer ajo është paguar, meqenëse ka pas deficit buxhetor atëherë diskutimet janë zhvilluar që nga viti 2015 në kohëzgjatje e afatit për përfundimin e punimeve, dhe Hilli si kompani e ka mbështet këtë propozim dhe me pa se sa kohë shtesë kërkohet, gjatë vitit 2016 janë zhvillua diskutimet ma të organizuara, në shtator neve na është kërkuar nga MI për me dorëzuar planin e ndryshimeve me shumat e dakorduara, duke vijuar marrëveshjen mes palëve për zgjatjen e kësaj periudhe 11 muaj e diçka, do të thotë ne është dashtë me bo kosto për këtë periudhën e zgjatjes për periudhën që jemi dakordu, sipas ofertës financiare që e ka paraqit Bechtel enka, do të thotë shpenzimet e përgjithshme për operimet në vend ose lokacion, ka qenë 1 milion euro per muaj, do të thotë 11.4 muaj nëse shumëzohen me 1 milion euro na ipen 11 milion euro, edhe 1 milion për sigurimin e vend punishtes, dhe tvsh 18%, arrin shumën 14.778 milion euro, kjo është paraqit nga ne si shume minimale që MI të ja paguaj për kontraktorin për këtë periudhën e zgjatjen prej 11 muaj deri me datë 21.12.2018, për zgjatjen e afatit për përfundimin e punimeve, un jam një prej atyre që e kam nënshkrua këtë vlerësim, kam pas përgjegjësin e plot ose përfundimtare për koordinimin dhe miratim, ndërsa ne nuk jemi konsultua

nga MI për marrëveshjen e nënshkruar me datë 27.09.2017, ne si Hill Internacional nuk kemi dit për ekzistencën e këtij dokumenti, ky dokument që është komunikua ndërmjet palëve e kemi marr kopjen e këtij dokumenti në dhjetor të viti 2017, pasi që punëdhënësi na ka kërkuar neve me leshu një opinion, kështu që ky dokument me datë 15 dhjetor 2017 na është dorëzua në tersi , e ne brenda 6 dite e kemi dhënë mendimin ton me datë 21 dhjetor 2017, letra referues është S1513, periudha kohore ka qen shume e shkurtër, dhe përshtypja ime lidhur me dokumentin është shpreh në këtë shkresë, dy pikat B me vlerë prej 30.8 milion dhe artikulli C në vlerë prej 8.5 milion kontraktori nuk ka jep asnjë arsytim që ka qen bindes për të lejua shumen gjithsej të këtyre 46 milionave me tvsh, mbështetja për këtë ka qen pothuajse jo-ekzistencë, nuk ka pas dokumentacion mbështetës për me arsyetuar shifrat e parave, ku me datë 21 dhjetor 2017 e kemi dhënë opinionin ton për shumen 14.778,00 milion euro, opinionin i është dorëzuar drejt për drejt kabinetit të ministrit MI, do thotë letra 1513 , pranuesi personalisht e ka marr nga kabineti i ministrit, do te thotë na jena udhëzuar nga MI që këtë opinion të mos përcjellët përmes arkivues por me shku përmes kabinetit të ministrit, na jem këshilltar të MI, MI ose mun mi pranua propozimet tona ose jo, ndërsa vendimi për pagesën 53.1 milionave është publiku me datë 5 qershor 2018, kemi gjet si fakt se si MI ministria e ka pas opinion ton që nga dhjetori i vitit 2017, pas 6 muajve të këtyre negociatave me kontraktorin është vendos mi paguar 53 milion euro, meqenëse se Hill International ska qen pjesë e këtyre përcaktimeve pasi që deri me datë 5 qershor 2018, ne sjemi kontaktua fare, 53.1 milion nuk është pagua me mbulua deficitin buxhetor, qëllimi i kësaj shume 53.1 milion ka qen me i mbulua shumen gjithsej që e ka krijuar Bechtel enka, për me i përfundua punët deri me datë 31.12.2018, më pas deklaroi se janë dispozitat e kontratës , kontrata thotë nëse një fature nuk është paguar brenda 56 ditëve atëherë kontraktori e dërgon letrën njoftuese për me zvogëluar vëllimin e punëve ose me i pezullua punimet, do te thotë me zgjat këtë pezullim dhe që mund të rezultojë me ndërprerjen e kontratës, ndërsa sa i përket arbitrazhit dëshmitari përgjigjet se nuk e di se çfarë do të ndodhte në të ardhmen ka qen pjesë e përgjegjës tone ta këshilloim MI për buxhetin e planifikuar, ndërsa dëshmitari në deklaratë të dhënë në polici me datë 06.02.2019, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimi gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet ka qenë përfaqësues i kompanisë Hill International, në kontratë kanë qenë tri subjekte, punëdhënësi MI, kontraktuesi Bechtel enka, dhe Hill International është përfaqësuesi i kontratës në mes të Bechtel enka dhe MI, procedura ka qenë se Bechtel enka ka kërkuar nga Hill Internacional që çdo muaj me i paraqit faturat dhe sasinë e punëve, për ti dërguar fakturat MI për pagesë, sipas vlerësimit të

gjykatës Hill International e ka bërë certifikim e punëve dhe fakturave për këtë projekt, po ashtu nga kjo deklarata kuptohet se që nga viti 2015 ka pas deficit buxhetor për këtë projekte si pasoj e kësaj është diskutuar zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve, që sipas vlerësimit të Hill International, është përpiluar aneks marrëveshja e vitit 2016, për periudhën prej e zgjatjes 11 muaj, ka qen 1 milion euro për muaj, ka arrit shumën 14.778 milion euro, më pas gjykata gjen se dëshmitari nuk është konsultuar nga MI për marrëveshjen e nënshkruar me datë 27.09.2017, një kopjen e këtij dokumenti e kanë pranuar në dhjetor të viti 2017 nga MI, e njëjta i ka kërkuar me leshu një opinion, gjykata gjen se kompania Hill Internacional me datë 21 dhjetor 2017, përpilon opinion e shpreh në shkresë se kërkesat e Bechtel enkës në dy pikat B me vlerë prej 30.8 milion dhe artikulli C në vlerë prej 8.5 milion janë të pa arsyetuara dhe nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion, sipas vlerësimit nuk duhet të paguhen, ndërsa shuma 14.778,00 milion euro, është e bazuar, sipas dëshmitë së dëshmitarit vërtetohet se ky opinion i është dorëzua drejt për drejt kabinetit të ministrit MI, pasi që janë udhëzuar nga MI që këtë opinion të mos përcjellët përmes arkives por me shku përmes kabinetit të ministrit, gjykata vlerëson se që nga fillimi i mandatit të pandehurit P.L dhe E.B e kanë ditë për rolin dhe rendësin e Hill Internacional në këtë projekt, por me dashje direkte në vazhdimësi si në rastin konkret e kanë planifikuar edhe mënyrën e dërgimit të opinion ligjor në MI, duke kërkuar nga dëshmitari që dërgimi i opinionit të mos bëhet përmes arkivës por direkt në kabinetin e ministrit, në mënyrë që të gjejnë pretekst se të njëjtin opinion nuk e kemi pranuar dhe nuk e kanë parë, ku gjykata vlerëson se të pandehurit ligjërisht nuk kanë mundur të veprojnë në asnjë hap në drejtim të këtij projekti pa konsultë të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, po ashtu nga kjo dëshmi vërtetohet se për pagesën 53.1 milionave nuk është kontaktua fare kompania Hill Internacional, pasi që sipas dëshmitarit vlera prej 53.1 milion nuk është pagua me mbulua deficitin buxhetor, por me i mbulua shumen gjithsej që e ka krijuar Bechtel enka, për me i përfundua punët deri me datë 31.12.2018, ku sipas gjetjes së gjykatës dëshmitari vlerëson që vetëm vlera prej 14, 778 milion ka qenë e arsyetuar, ndërsa pika B dhe C nuk pa pas bazë për pagesën, dhe nuk ka njohuri se si ka ardhur deri te kjo pagesë qeveria e Kosovës, por gjykata vlerëson se kjo shtate është krijuar nga veprimet e kundërligjshme të pandehurve P.L dhe E.B, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur është e sinqertë, gjen mbështetje në provat material, nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale sa i përket pagesës së kundërligjshme prej 53 milion.

3.1.15 Dëshmitari **R.** Anë dëshminë e tij të dhënë në polici me datë 12.02.2019, e lexuar në cilësi të provës materia ka deklaruar se është drejtor i projektit për Bechtel&Enka (BEGP),²⁰ ndërsa nga data 04.11.2016 është menaxher i Rrugës 6 Autostrada Prishtinë - Hani Elezit. Lidhur me kontratën mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe konzorciumit “BEGP” të datës 01.07.2014 “me çelësa në dorë”, dëshmitari ka deklaruar se definicioni i “çelësave në dorë” nënkupton se “Bechtel Enka “ ishte përgjegjëse për dizajnimin dhe ndërtimin e projektit në shkëmbim të shumës së vendosur në marrëveshje dhe në fund të kontratës ne si kompani duhet të dorëzojmë një autostradë të përfunduar tek punëdhënësi. Tutje shton se kontrata ishte firmosur në vlerë prej 599 milion Euro dhe ndryshimi i ligjit për TVSH nga 16 % në 18% e rriti vlerën e kontratës në 608 milion Euro. Lidhur me mënyrën e pagesave, i njëjti ka deklaruar se kompania Bechtel ka pasur një tabelë të pagesave (Schedule of payment) sipas marrëveshjes së akorduar me klientin dhe çdo pjesë pune që ne kryejmë ka një përqindje të përcaktuar. Andaj kompania Bechtel ka paraqitur progresin në bazë të kësaj përqindje dhe ne si kompani paguhemi sipas kësaj përqindje, ndërsa lidhur me kërkesën e datës 23.09.2014 të dërguar nga BEGP për Ministrinë e Infrastrukturës, dëshmitari ka deklaruar se kjo tregon kërkesat e kontratës për buxhetin e Qeverisë, se në vitin 2014 na duhen 70 milion Euro në vitin 2015 na duhen 220 milion, në vitin 2016 na duhen 205 milion Euro dhe në vitin 2017 na duhen 104,9 milion Euro dhe kjo nuk ka qenë tabelë e pagesave (Schedule of payments), po ka qenë njoftim se sa mjete na duhen në nga buxheti i Qeverisë në baza vjetore sipas kontratës baze, sipas dëshmitarit lidhur me këtë kërkesë BEGP, asnjëherë nuk kishte pranuar përgjigje as nga Ministria e as nga kompania mbikëqyrëse e kontratës „Hill International”, edhe pse Ministria ka qenë e obliguar që të na përgjigjet dhe nëse nuk përgjigjet brenda 21 dite konsiderohet e pranuar në bazë të kontratës, ndërsa dëshmitari ka deklaruar se për zgjatje të afatit ishte filluar të bisedohet në fillim të vitit 2015, që kur në kuptuam se nuk kishte buxhet të mjaftueshëm për atë vit që të përfundojnë punimet, sepse çdo vit në janar dhe shkurt publikohet buxheti i Qeverisë dhe nga kjo ne e kuptojmë se sa është alokuar për projektin Rruga 6, pastaj ne e njoftojmë Qeverinë që buxheti i alokuar për Rruga 6 është me pak se sa na është dashur dhe nga qershori i vitit të kaluar nuk jemi paguar për punët e kryera, ndërsa lidhur me mos alokimin e mjaftueshëm për projektin R6, dëshmitari ka deklaruar se në qofte se planifikojmë punë 200 milion Euro për atë vit, në parashikojmë punë që të ekzekutojmë 200 milion Euro, e kur buxheti është me pak se ajo që është kërkuar ne nuk mund të alokojmë aq sa duhen njerëz materiale, makineri dhe të arrijmë datën e përfundimi, pasi që në fillim të vitit ne e dimë që Qeveria nuk ka fonde, ajo që ne

²⁰ Operatori ekonomik Bechtel&Enka (Në tekstin e mëtejshëm BEGP),

mund të bëjmë është që ne të asistojmë Qeverinë dhe të punojmë në baze të fondeve që ata kanë, përndryshe do të detyroheshim të dorëzojmë fatura për fondet të cilat ata nuk i kanë, shembulli me perfekt është ajo që ndodhi vitin e kaluar dhe këtë vit, ku ne kemi performuar punë në akordancë me buxhetin e kërkuar dhe Qeveria ka pasur të pamundur të paguaj fatura që nga viti i kaluar, kjo situatë neve si kompani na dërgon ta ushtrojmë të drejtën tonë sipas kontratës të ngadalësojmë punën ose ta ndërprejmë punën si rezultat i pagesave të vonuara dhe Qeveria është e detyruar të bëjë pagesa sipas kontratës për të gjitha kostot që vijnë si rezultat i ndërprerjes ose ngadalësimit të punës dhe për çdo vlerë të shtyrjes së afatit këtë e parasheh artikulli 16.1 në kontratë, ndërsa lidhur me kërkesën e konzorciumit Bechtel&Enka drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës për zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve me kosto shtesë, dëshmitari ka deklaruar se diskutimi për këtë çështje ka filluar në vitin 2015 dhe ka zgjatë deri me datë 05.06.2018 kur edhe Qeveria ka marrë vendim për pagesë, konkretisht në vitin 2015 u ra dakord që të shtyhet afati dhe u diskutua që kostoja të jetë prej 14,7 milion Euro por nuk u aprovua asnjëherë, më pas deklaroi se lidhur me vlerësimin bërë nga ana e “Hill Internacional” për kosto shtesë prej 14,7 milion Euro lidhur me zgjatjen e afatit deri me 31.12.2018 që duhej të paguaj Ministria e Infrastrukturës, dëshmitari ka deklaruar se ai nuk ka qenë pjesë e këtyre diskutimeve, ndërsa me datë 27.09.2017 ishte nënshkruar marrëveshja në mes të palëve (MI&BEGP) për zgjatje të afatit të punimeve deri me datë 31.12.2018 dhe në kohën kur ishte firmosur marrëveshja për shtyrjen e afatit prej 347 nuk ka pasur asnjë çështje të mbetur komerciale përveç koston së zgjatjes së afatit dhe deri me sot ne konsiderojmë se nuk ka asnjë çështje tjetër të mbetur përveç kësaj, ndërsa deri të shuma 63 milion Euro e kërkuar nga Bechtel&Enka për zgjatje të afatit deri me 31.12.2018 dëshmitari ka deklaruar se qofte se ju keni lexuar dokumentin ka tre pika kryesore: Zgjatja - kjo ka të bëjë me kosto indirekte, e dyta është pajisjet dhe e treta mungesa e efikasitetit (humbja e produktivitetit). Shuma prej 63 milion Euro nuk tregon vlerën reale të shtyrjes së afatit por ishte në frymën e bashkëpunimit dhe BEGP kishte premtuar që do merr vetëm koston reale dhe gjatë diskutimeve BEGP kishte rënë dakord që të hejë 10 milion Euro nga pika Disruption pika C dhe nga shuma 63 milion në 53.1 milion Euro, ka deklaruar se në qofte se i referohemi fushës së shërbimeve të kompania “Hill Internacional”, shtyrja e afatit dhe alokimi i buxhetit nuk ishte në fushën e veprimit të tyre dhe për këtë diskutim ishte vetëm me Ministrinë e Infrastrukturës, ndërsa lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 05.06.2018 për kompensim të 53.1 milion Euro për zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve në Rrugën 6, ka deklaruar se referuar kontratës, vlera e kontratës nuk mund të ndryshohet derisa një marrëveshje e tillë ishte firmosur nga palët dhe ishte nënshkruar me 5 shtator 2018. Sipas dëshmitarit,

shtyrja e afatit ishte rënë dakord në shtator 2017, të gjithë ranë dakord se 347 dite duhet shtyre punimet, ndërsa vlera u ra dakord të vendoset me vone dhe kjo marrëveshje ndodhi me 5 shtator 2018, kurse zgjatja deri me 01 qershor u ra dakord mes palëve me ane të frymës së mirë. Tt me zero kosto për Qeverinë për t'i dhënë mundësinë Qeverisë të paguaj shumën e rënë dakord.

Gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur nga e njëjta vërtetohet ka qenë përfaqësues i operatorit ekonomik Bechtel&Enka, që ka sqaruar për gjykatës se çdo vit në janar dhe shkurt publikohet buxheti i Qeverisë dhe nga kjo në e kuptojmë se sa është alokuar për projektin Rruga 6, pasi që në fillim të vitit në e dimë që Qeveria nuk ka fonde, ajo që në mund të bëjmë është që në të asistojmë Qeverinë dhe të punojmë në baze të fondeve që ata kanë, sipas gjetjeve të gjykatës vërtetohet se kjo dëshmi gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit L.ZH i cili ka deklaruar se operatorit ekonomik Bechtel&Enka, ka punuar atë sa ka pas buxhet për këtë projekte, sepse këtë e kanë kuptuar operatorit i lartcekur në rastin e publikimit të buxhetit të Republikës së Kosovës për çdo vit, me këtë dëshmi vërtetohet se si janë zhvilluar punët nga operatorit ekonomik Bechtel&Enka, pasi që duke u bazuar në shkresa e lëndës dhe në dëshmitë të dëshmitareve të ndërgjyqur në këtë çështje penale gjykata gjen se qysh në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate nuk ka pas buxhet për këtë projekte, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit të lartcekur kuptohet kërkesa për vlerën prej 63 milion nuk është bërë si rezultat i vonës në pagesa siç pretendojnë të pandehurit gjatë këtij procesi gjyqësor, por kjo kërkesë -dokumenti ka tre pika kryesore: Zgjatja - kjo ka të bëjë me kosto indirekte, e dyta është pajisjet dhe e treta mungesa e efikasitetit (humbja e produktivitetit), nga kjo dëshmi vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje penale të vlerësuar si më lartë, ndërsa sa i përket kërkesës në vlerë 63 milion, për ta vlerësuar se njëjta kërkesë është e bazuar, nuk qëndron deklarimi i dëshmitarit të lartcekur, pasi që gjykata gjen se për këtë ka qenë kompetent ta vlerësojë kompani mbikëqyrëse Hill Internacional, ku të pandehurit P.L dhe E.B ju kanë shmang kompanisë së lartcekur me qëllim të realizimit të qëllimeve të tyre.

3.2. Deklarata e ekspertit;

3.2.1 Eksperti financiar **A.SH** në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 01.12.2023, ka deklaruar se në për këtë projekt ka pasur një statut dhe kod të sjelljes në baze të se cilit i ka ndare

përgjegjësitë e komitetit drejtues ndërministror, përgjegjësie e ministrisë për implementim dhe përgjegjësitë e eksperteve të jashtëm dhe këshilltar të transaksionit dhe mbi bazën e statutit dhe kodit të sjellës janë parapare përgjegjësitë e qarta lidhur me këte projekt, pra se si do të inicionet procedura e prokurimit, dhe nga kush do të udhëhiqet, kush do ti aprovoj apo miratoj kërkesat ligjore në këtë projekt, kush do të jete në komunikim të drejtpërdrejt nga komunitetin drejtministror, cilat janë përgjegjësitë e këshilltarit të transaksionit apo eksperteve të jashtëm, sipas statusit komiteti ndërministror ka përgjegjësi për aprovimin e buxheteve dhe shqyrtimin e raporteve të rregullta të progresit lidhur me projektin, shqyrtimin e konkluzioneve ligjore, teknike dhe financiare të këshilltarit të transaksionit dhe njësisë për implementim të projektit, shqyrtimin dhe aprovimin të gjithë dokumenteve vendimtare të projekt, përfshirë termat e referencës, kontratat etj, pasi që për çdo projekt angazhohet mbikëqyri i punimeve, si në rastin konkret kompania Hill, e cila është kontraktuar nga Qeveria e Kosovës për ta mbikëqyr kontratën në fjale se a po ekzekutohet me përputhje me kushtet e kontraktuara, më pas deklaroi se marrëveshja e datës 27.09.2017, është nënshkruar pa kosto financiare, e cila kosto është dashur të përcaktohet ka qenë në përgjegjësi të komitetit ndërministror me vendos për këtë çështje, në rastin konkret nuk ka vendos komiteti, në parim nuk ka marrëveshje nëse nuk dihet kostoja financiare, sepse marrëveshja duhet të përmbaj aspektet teknike, ligjore dhe financiare, ky proces i është nënshkrua dispozitave të LPP dhe as aneksi kontrata nuk njehet pa e pasur në përmbajtjen e saj anenë komerciale, pra buxhetin që planifikohet të shfrytëzohet për atë çështje, pra saktësohet shuma se sa keni me paguar dikujt me të cilin lidhni kontrate, dhe pa këtë element konsiderohet jo ligjore, pra kjo i bie që i len derën hapur për me paguar sa ai ka kërkesë, pasi që fillimisht ka pas një draft marrëveshje për shtyrje të afatit me shume prej 14 milion, dhe kompania që ka mbikëqyr projektin ka konstatuar se pika A është bere mbi bazën e kalkulimeve që është bërë për vlerën 14.1 milion, pra në këtë vlere ka bere një përlllogaritje mujore nga 1 milion dhe ia ka shtuar shumën e sigurimit 1 milion e 104 mijë duke e kalkuluar edhe TVSH dhe ka mbet shuma 14.1 milion, ndërsa dy pozicionet B dhe C në kërkesën e Bechtel enkes, nuk kane qene të pranueshme për kompaninë HILL sepse nuk janë të justifikuara, thjeshte nuk dihet për çka janë meqë nuk parashihen në kontrate, këtu kemi kontrate me çmim fiks ku pavarësisht rrethanave qeveria nuk paguan asnjë çmim tjetër përveç 10%, pra 10% nënkupton edhe për punët që janë brenda kontratës por rritet vëllimi por edhe për pune që nuk janë të parapara në kontrate por që janë të nevojshme për implementimin e projektit, në rastin konkret ky 10% të ndahet në dy 5%, njeri në emër të tantjenes që nëse materiali është me lartësi me shume se 20 km, të paguhet si shtese 5% për operatorin, dhe 5% për shtim të sasive të punëve, në rastin konkret nuk janë respektuar dhe pasojat janë se janë paguar 53 milion euro , të cilat nuk dihet për çka janë

paguar, nga e kane burimin, janë paguar në emër të vonesave për pagesa, por ka zgjatej të afatit edhe përtej afatit të shtyrë në dhjetor 2018, por në qershor 2019 ka përfunduar, është dashur të respektohet statuti, vendimin është dashur ta marr komiteti ndërministror duke marre për baze informacionet nga kompania mbikëqyrëse dhe parimisht pa informacionet e kompanisë mbikëqyrëse nuk ka mundur të merret vendimi nga komiteti dhe këto janë konstatuar nga ana ime si parregullsi të procesit, paraprakisht aneks kontrata e vitit 2016 është dashur të jete brenda suazave sepse edhe kompania Hill thotë se nuk e din për çka janë këto kosto të kërkesës së Bechtel enkës, andaj mbeteni në tërësi pranë raportit të ekspertizës të datës 07 Maj 2021.

Gjykata vlerëson dëshminë e ekspertit të lartcekur, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se sipas Statutit dhe kodit të KDNM, kompetent për marrjen e vendime për projektin R6, ka qenë komiteti, e jo ministri ku i njëjti me sekretarin dhe drejtorin e prokurimi ka nënshkruar marrëveshje e datës 27.09.2017, pa kosto financiare, sipas ekspertit ky proces i është nënshkruar dispozitave të LPP dhe as aneksi kontratën nuk njih pa e pasur në përmbajtjen e saj anenë komerciale, ashtu edhe marrëveshja duhet të përmbaj aspektet teknike, ligjore dhe financiare, pa këto elemente konsiderohet jo ligjore, pra kjo i bie që i len derën hapur për me pagua sa ai ka kërkesë, nga dëshmia e ekspertit vërtetohet se ka qenë 10%, e lejuar në kontratën bazë të ndahet në dy 5%, njeri në emër të tantjenes dhe 5% për shtim të sasive të punëve, ekspertit gjen se ky 10% në rastin konkret nuk është respektuar dhe pasojat janë se janë paguar 53 milion euro , të cilat nuk dihet për çka janë paguar, nga e kane burimin sepse nuk kane qene të pranueshme për kompaninë Hill, e njëjta ka konstatuar se pika A është bere mbi bazën e kalkulimeve që është bërë për vlerën 14.1 milion, ndërsa dy pozicionet B dhe C në kërkesën e Bechtel enkes, nuk janë të justifikuara, thjeshte nuk dihet për çka janë meqë nuk parashihen në kontrate, sipas vlerësimit të ekspertit gjykata vërteton se vendimin-marrëveshjen është dashur ta merr komiteti ndërministror duke marre për baze informacionet nga kompania mbikëqyrëse dhe parimisht pa informacionet e kompanisë mbikëqyrëse nuk ka mundur të merret vendimi nga komiteti dhe këto janë konstatuar si parregullsi në këtë proces, gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitareve relevantë të n dëgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale të procedura në këtë çështje penale.

3.3 Provat materiale;

3.3.1 Nga leximi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërministror, me nr. 06/78, i datës 12.06.2012,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 12.06.2012 Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr vendimin Nr.06/78 për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërministror për zhvillimin e projektit ‘‘Rruga 6’’ (Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit), i cili komitet është përbërë nga 5 anëtar, ku njeri prej tyre ka qenë Kryesues i Komitetit. Kryesues i Komitetit është vendos Ministri i Infrastrukturës, ndërsa anëtar të komitetit janë vendosur Ministri i Financave, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.*

3.3.2 Nga leximi i Statuti dhe Kodi i Sjelljes i Komitetit Drejtues Ndërministror, i datës 20.06.2012,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Komiteti drejtues ndërministror (tutje- KDNM) në kuadër të përgjegjësiëve të saj ka pasur përcaktimin e politikave dhe sigurimin e kordinimit ndërministror gjatë gjithë fazave të projektit, dhe mbikëqyrjen e këtij projekti në kohë, pra pas vlerësimit të kësaj provë do të kuptohet qartë se KDNM është organi kryesor dhe i vetëm vendimmarrës në realizmin e projektit duke përfshirë edhe anën financiare, gjithashtu do të kuptohet edhe roli i kryesuesit të KDNM-së, i cili është person kyq në funksionimin e këtij projekti. Ndërsa, Njësia për Implementimin e projektit(NJIP) ka qenë përgjegjëse për menaxhimin teknik të projektit dhe ka shërbyer si sekretariat teknik i KDNM. Me këtë dokument janë përcaktuar edhe përgjegjësit e Këshilltarit të Transaksionit i cili ka pasur si detyrë ofrimin e shërbimeve të këshillave strategjike, ligjore, teknike dhe financiare për KDNM dhe NJIP. Me këtë dokument është lënë hapësira edhe e angazhimit të ekspertëve të jashtëm nëse kërkohet. Po ashtu, me këtë dokument është përcaktuar edhe kodi i mirësjelljes me të cilin është përcaktuar parimi i ruajtjes së konfidencialiteti, paanësisë, transparencës etj. Pra në këtë status do të kuptohet se janë të caktuara përgjegjësit në mënyrë të detajuar të komitetit ndërministror. I njëjtit është administruar në cilësi të provës në këtë çështje penale, I cili status është kundërshtuar për prejardhjen e tij nga mbrojtësi e të pandehurve B.T dhe N.SH Sharti, ku sipas vlerësimit të gjykatës ky Statut&Kodi i Sjelljes i KDNM, në pamje vizuale kuptohet qartë se është i punuar për përcaktimin e rregullave të funksionimit të KDNM, për projektin autostrada Prishtinë –Hani Elezit, pas që në çdo flet e ka këtë logo, dhe sipas dëshmitarit R.Q drejtor i NJIP, ka deklaruar se prej fillimi ka qenë në këtë projekte, dhe ka*

vërtetuar për gjykatën se Statutin dhe Kodin e Sjelljes e kanë vendosur dhe votuar anëtarët e KDNM gjatë vitit 2012, andaj qëndrimet e mbrojtjeve të lartcekur janë të pa bazuara.

3.3.3 Nga leximi i Kontratës me nr. ID.017/2014, e datës 01.07.2014, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Operatorit Ekonomik “Bechtel&Enka ‘’,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Ministria e Infrastrukturës dhe Operatorit Ekonomik “Bechtel&Enka ‘’, ka lidhur kontratën me nr.ID.017/2014 për ndërtimin e autostradës R6, me të cilën kontratë është përcaktuar vlera totale e punimeve ka përfshirë shumën prej 599,944.263 Euro, e po ashtu është përcaktuar që koha e përfundimit të punëve nuk mund të kalojë 42 muaj(1278 ditë), deri me datë 19.01.2018 do të bëhet përfundimi i punimit, ndërsa në këtë provë pas analizimit të saj do të shihet se këtu janë përcaktuar edhe kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të kontratës duke përcaktuar edhe obligimet dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Po ashtu, me këtë kontratë është përcaktuar edhe mundësia e zgjatjes së kohës së përfundimit të punimeve, për shkaqet si në vijim: një ndryshim(përveç nën klauzolës 13.3), për shkak të ndonjë vonese që jep të drejtën për zgjatjen e kohës së punimeve dhe për çdo vonesë, pengesë ose parandalim që shkaktohet ose i atribuohet punëdhënësit(klauzola 8.4 lidhu me 20.1). Gjykata, gjen se me asnjë dispozitë nga kjo kontratë nuk është paraparë mundësia që të shtyhet afati me kërkesë të operatorit ekonomik si rezultat i mungesës së buxhetit.*

3.3.4 Nga leximi i Kontratës me nr. Prot. /13/075/212 e datës 30.10.2014, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë mbikëqyrëse „Hill International’’,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 30.10.2014 Ministria e Infrastrukturës dhe Kompania “Hill International” kanë lidhur kontratë me të cilën kjo kompani është caktuar si mbikëqyrëse e ndërtimit dhe shërbimeve menaxhuese në rrugën Nr R6 Prishtinë - Hani i Elezit, nga kjo provë do të vërtetohet qartë fakti se Ministria e Infrastrukturës me qëllim të realizimit dhe mbikëqyrjes së realizimit të projektit E6, për shkak të rëndësisë së këtij projekti ka kontaktuar një kompani profesionale si kompaninë mbikëqyrëse “Hill International” që kishte obligime dhe të drejta në kuadër të kësaj kontratë, e njëjta kompani duke ju referuar rregullave kontraktuale kishte obligim ti jep opinionet e saj për këto*

projekte, duke përfshirë për implementimin e projektit në aspektin financiar dhe këto opinione ishin obligative për autoritetin kontaktues, pra për Ministria e Infrastrukturës .

3.3.5 Nga leximi i Kontratës me nr. Prot. 9981, e datës 22.10.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë mbikëqyrëse „Hill International”;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 22.10.2018 Ministria e Infrastrukturës dhe Kompania mbikëqyrëse Hill International kanë lidhur kontratën me të cilën kanë zgjatur afatin për kompletimin e shërbimeve për 3 muaj nga 47 në 50 muaj, deri më 31 Dhjetor 2018 si rezultat i zgjatjes së kohës së përfundimit të dhënë në kontratën e punës. Tarifa e plotë për shërbimet e ofruara në bazë mujore do të jetë 143,921.74 Euro duke përfshirë edhe TVSH-në. Përveç kësaj është paraparë tarifë prej 10,000.00 Euro përfshirë TVSH për testimet mujore laboratorike.*

3.3.6 Nga leximi i Kontratës me nr. Prot. 3086, e datës 07.02.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë mbikëqyrëse „Hill International”;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 07.02.2018 Ministria e Infrastrukturës dhe Kompania mbikëqyrëse Hill International kanë lidhur kontratën me të cilën kanë zgjatur afatin për kompletimin e shërbimeve për 5 muaj nga 42 në 47 muaj, deri në 30 Shtator 2018. Çmimi total për shërbimet e ofruara nga Këshilluesi është rishikuar në 7,930,116.70 Euro përfshirë vlerën e TVSH-së së shumës së përgjithshme të kontratës ose një rritje prej 9.98% të kontratës origjinale me çmimin.*

3.3.7 Nga leximi i Draft Aneks – Kontrata me nr. Prok. MI/12/050/512, e vitit 2016, në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe OE “Bechtel&Enka”;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me ankesin e kontratës nr. prokurimit. MI/12/050/512, e vitit 2016 dhe me numër identifikues të kontratës: ID.017/2014 nën-klauzola 1.1.3.3(afati i përfundimit) dhe nën klauzola 8.2(Afati i përfundimit) ne kushtet e veçanta të kontratës është fshirë dhe është zëvendësuar me: ‘Afati i përfundimit të punimeve nuk duhet të kalojë 53 muaj e 19 ditë nga data e fillimit, përveç rastit të ndonjë shtyrje të afatit të përfundimit sipas nën-klauzoles 9.4(shtyrja e afatit të përfundimit të*

punimeve)'' . Afati i përfundimit të punimeve të tre seksioneve nuk do të jetë më vonë se 31 Dhjetor 2018, pa kosto shtesë ndaj punëdhënësit që mund të vijë si pasojë e kësaj shtyrje deri me 31 Dhjetor 2018. Kjo shtyrje vjen si rezultat i shtrëngimeve buxhetore të punëdhënësit.

3.3.8 Nga leximi i Vendimit mbi aprovimin e Aneksit të kontratës, i datës 30.09.2016;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Komiteti Drejtues Ndërmintor në takimin e datës 30.09.2016 ka aprovuar aneks-kontratën '' Projekti për dizajnimin dhe ndërtimin e Rrugës 6 Prishtinë – Hani i Elezit me konzorciumin Bechtel Enka dhe i ka rekomanduar Qeverisë së RKS-së që të miratojë këtë vendim, pasi që duke u bazuar në opinionin të kompanisë mbikëqyrëse Hill Interacional për përfundimin e punimeve është lidhur draft aneks kontratën me datë 30.09.2016, ku palët kontraktuese përfundimisht ishin dakorduar që zgjatja e aftit të përfundimit të punimeve të ketë datën 31.12.2018, në një kosto prej 14.778.00 milion Euro duke përfshirë edhe TVSH-në, sipas gjetjes së gjykatës për kohë të njëjtë dhe punë të njëjtë si në rastin konkret në këtë çështje penale, është anashkaluar kompania mbikëqyrëse Hill Internacional dhe është paguar shuma prej 53 milion euro.*

3.3.9 Nga leximi i Procesverbaleve të takimeve të Komitetit Drejtues Ndërmintor të datave 09.03.2018, 05.04.2018, 19.04.2018, 31.05.2018 dhe 05.06.2018,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se KDNM ka mbajtur takim me datë 09.03.2018 ku si pika të rendit të ditës ka pasur ndër tjera edhe; Shqyrtimi i kërkesës së kontraktorit për shpenzime shtesë për zgjatje të kontratës dhe vonesat në pagesa etj. Në këtë mbledhje i pandehuri P.L në cilësi të Kryesuesit të Komitetit ka bërë një ekspozë të detajuar të zhvillimeve dhe ecurisë së Projektit "Rruga 6" (Autostrada Prishtinë-Hani i Elezit duke vene theksin tek zgjatja e kohës së implementimit të kësaj kontrate, vonesat në pagesa si rezultat i të cilës ka ardhur edhe pretendimi i kompanisë ndërtuese "Bechtel & Enka" dhe kërkesa për pagesë shtesë prej 63 milionë eurosh, i pandehuri P.L me tutje i ka informuar anëtarët edhe për ecurinë e projektit deri me tani dhe pritjet se kur ky projekt do të përfundojë, i pandehuri P.L ka thënë se deri në Qershor të 2018-ës do të përrurohet edhe segmenti deri në Doganaj, kurse i tërë projekti pritët të përfundojë në fund të vitit 2018. Ai i ka njoftuar anëtarët edhe për realizimin e pagesave sipas viteve ku në vitin 2014 janë paguar 55 milionë e 468 mijë euro, në*

vitin 2015 janë paguar 112 milionë e 124 mijë e 859 euro, në vitin 2016 janë paguar 155 milionë e 978 mijë euro, në vitin 2017 janë bërë 179 milionë e 124 mijë e 901 euro dhe në vitin 2018 është bërë pagesa prej 37 milionë euro, e që në total pagesa deri me tash janë bërë 539 milionë e 816 mijë 778 euro. I pandehuri P.L i ka njoftuar anëtarët e komitetit se arsyeja e këtij takimi është edhe marrja e një vendimi lidhur me kërkesën e kompanisë ndërtuese në emër të shtyrjes së afateve dhe vonesave të pagesave që ti paguhen edhe 63 milionë euro, e për të cilat pas 4 muaj negociatash nga ekipi negociator i Ministrisë së Infrastrukturës është arritur të ulet në 45 milionë euro pa TVSH dhe se tashme ka ardhur deri në piken që ose të shkohet në ankimim, ose të behet pagesa, i pandehuri P.L i ka informuar anëtarët edhe për kërkesën që do t'ia bëje zyrës ligjore të kryeministrit për marrjen e një opinionit ligjor lidhur me kërkesën e kompanisë ndërtuese, si dhe u ka dhënë një mendim lidhur me mundësinë e shkuarjes në arbitrazh, e që sipas i pandehurit P.L kompania Bechtel & Enka deri më tani në historiatin e saj nuk ka humbur asnjë beteje dhe që nëse shkohet në këtë variant Buxheti i Kosovës do të humbiste shumë më shumë se sa shuma e pretenduar dhe kërkuar nga kjo kompani, lidhur me këtë, anëtari i KDNM-së B.H e ka pyetur se për çfarë është pagesa që po kërkohet nga kontraktori dhe nëse kjo e tejkalon vlerën e kontraktuar fillimisht si dhe nëse ka buxhet të planifikuar për këto pagesa, i pandehuri P.L është përgjigjur se: pagesa kërkohet si rezultat i shtyrjes së afatit 1 vjeçar të punimeve si pasojë e mos shlyerjes së obligimeve për tri vite me radhë, po ashtu, ka shtuar se çmimi del mbi vlerën e kontraktuar fillimisht, plus 10% që është i paraparë me kontratën për punë shtesë si dhe se nuk ka buxhet të planifikuar dhe se buxheti duhet siguruar nga fondet e AKP-së. Tutje, këshilltari- anëtari tjetër i KDNM-së Fatmir Gashi ka kërkuar që të merren fillimisht të gjitha informacionet dhe shifrat e pastaj të dërgohet vendimi në Qeveri, e që i pandehuri P.L ka shtuar se të gjitha informatat dhe shifrat janë. Tutje, Fatmir Gashi ka kërkuar që fillimisht duhet të ulen dhe të bisedojnë që të sigurohen të hollat e pastaj të merret vendimi. Ashtu, ka deklaruar edhe anëtari tjetër V.LL i cili ka thënë që është mirë që vendimi të merret sa më shpejt, por nuk është e thënë sot. Lidhur me këtë, i pandehuri P.L ka deklaruar se nuk guxojmë të kemi vonesa dhe se për këtë vendimin e merr Qeveria, ndërsa komiteti vetëm e rekomandon. Pas raportimit të drejtorit të projektit të kompanisë ‘‘Bechtel&Enka’’ – Riyadh Alkhazjeri, anëtarët e KDNM-së kanë kërkuar që të vazhdohet me negocimin e marrëveshjes me këtë kompani për ulje të çmimit, dhe për këtë është pajtuar edhe i pandehuri P.L, por i cili ka shfaqur drojën se vetëm mund të humbet kohë, pasi që sipas tij janë shtjerrur të gjitha mundësitë për negocim. Në rrethana të tilla, i pandehuri P.L dhe anëtarët tjerë janë dakorduar që vazhdohet me negocimin e shumës prej 45 milion(nga 63

milion) me OP Bechtel Enka dhe se nxjerrja e vendimit për rekomandim në Qeveri të shtyhet për takimin tjetër.

- *Në takimin e radhës të datës 05.04.2018 i pandehuri P.L ka pohuar se MI ka negociuar shumë prej 63 milion të pretenduar nga Bechtel Enka, nëpërmjet Këshilltarit E.B dhe kanë ardhë në përfundim që pretendimet e Bechtel Enka nga 63 milion të zbriten në 45 milion(pa TVSH). Tutje, i është dhënë fjala Këshilltarit të pandehurit E.B i cili ka informuar anëtarët për procesin e ri negocimit me kontraktuesin dhe se kontraktuesi ka paraqitur në mënyrë analitike koston e zgjatjes së kontratës, e cila ka ardhur si rrjedhojë e mos pagesave të shumave të parapara nga Qeveria e Kosovës ndaj kontraktorit. Në këtë proces ri-negocimi ka qenë prezent edhe këshilltari i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, i cili e ka parë se kostoja e kontraktorit është kosto reale pa fitim. Pra, behet fjale për një kosto që kontraktorit i nevojitet për t'i kryer punët, shembull: Nga flota prej 1000 veturave që i ka, kontraktori i ka futur vetëm 150 vetura, pra vetëm ato që i nevojiten e të cilat i ka cekur me muaj, shembull gatë verës për tre muaj i nevojiten, ndërkaq dimrit kostoja është zero sepse nuk i nevojiten ato, kjo është kosto reale që e mbulon nevojën për ndërtim të kësaj pjese të autostradës, për ta kompletuar kontratën me sukses, i pandehurit E.B ka thënë se të gjithë janë pajtuar që kjo është kosto reale, pra shuma prej 45 milionë euro pa TVSH, pas ri-negocimit ka deklaruar se nuk kanë pasur vërejte më nga këshilltari i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, pas këtij raportimi, anëtarja e KDNM-së ka deklaruar se duhet pasur vigjilencë lidhur me këtë çështje, në mënyrë që të jenë në një linjë, qoftë tash ky komitet me atë që ka qenë përpara sepse ka kundërthënie mes asaj çka ata kanë marrë vendim dhe asaj çfarë po bëjmë në tash, tutje ka shtuar se këshilltari ligjor i ka thënë se meqë është kontrata me para publike, nuk duhet të jetë konfidenciale, në mënyrë të sheh nënin që përcakton penalet në rast të vonesave, ka kërkuar që të ketë një opinion ligjor nga Ministria e Infrastrukturës dhe një opinion financiar nga Ministria e Financave që do t'ia lehtësonte punën shumë. Të njëjtin mendim e ka shprehur edhe anëtari V.LL. Lidhur me këtë, i pandehuri P.L ka shtuar se ajo që e shqetëson atë është stërzgjatja e marrjes së vendimeve në Komitetin Ndërministror, sepse kjo mund t'i kushtojë Qeverisë së Kosovës dhe ka koston e vet, se ky Komitet nuk guxon të bije në të njëjtën situatë sikur ish-Qeveria dhe ish-ministri, sepse sikur të ishin marrë vendimet me kohë nuk kishin me u ballafaquar me këtë çështje, që është me rëndësi për vendin dhe që ka kosto bukur të madhe. Ajo që vlen të theksohet është se është i interesuar si Ministër i Infrastrukturës që ky proces të merr epilog çfarëdo të jetë ai, sepse sipas informacioneve dhe të dhënave që i ka dhe përvojës që e ka kompania kontraktuese edhe në shumë shtete të botës, asnjëherë nuk i ka humbur rastet dhe kjo mund t'i kushtojë me së paku*

afro 180 milionë Qeverise së Kosovës dhe ose duhet të pajtohemi me këtë shume nëse kemi konsensus dhe Qeveria duhet të marrë një vendim sa më parë, ose nëse nuk dakordohen, pajtohet me çfarëdo vendimi të këtij Komiteti dhe pastaj të mos bije barra tek ai personalisht, por edhe te Ministria e Infrastrukturës. Sipas tij, "Bechtel & Enka" është këmbëngulëse që t'i kryej të gjitha procedurat dhe se ia kanë bërë të qartë se për shkak të komunikimit shumë të mirë me ta, nuk e kane dërguar çështjen në Arbitrazh, përndryshe ata dakordohen që t'i fillojnë procedurat menjëherë, me çka do të ndërpritej puna dhe do t'i kushtojë shumë, shumë më tepër Buxhetit të Kosovës. As në këtë takim komiteti nuk ka arritur të marrë ndonjë vendim lidhur me këtë çështje dhe të gjithë anëtarët e komitetit janë pajtuar që Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës ti drejtohet Kryeministrit të Kosovës për situatën e krijuar në komitet.

- Takimi i radhës është mbajtur me datën 19.04.2018 në të cilin takim i pandehuri P.L ka hapur diskutimin duke elaboruar tërë ecurinë e kërkesës së kontraktorit "Bechtel & Enka", projekt-marrëveshjes së operatorit ekonomik "Bechtel & Enka" lidhur me shpenzimet indirekte për periudhën e zgjatjes së kontratës deri me 31.12.2018. Më pas Kryesuesi i Komitetit i pandehuri P.L, ia ka kaluar falën këshilltarit të pandehurit E.B, për të shpjeguar procesin e negociatave për ulje të shumës së pretenduar nga kontraktori dhe deri ku është arritur me këto negociata. I pandehuri E.B ka shpjeguar se kanë mbajtur një takim me këshilltarët e ministrave anëtare të Komitetit (Këshilltari i Ministrit për Ambient dhe Planifikim Hapësinor, Këshilltari i Ministrit për Zhvillim Ekonomik dhe ai i Tregtisë dhe Industrisë), të cilët janë takuar dhe kanë shtjelluar pretendimet e kontraktorit, ku prezent ka qenë edhe përfaqësuesi i kontraktorit "Bechtel & Enka", i cili kishte prezantuar shkurtimisht kërkesat për shpenzime indirekte të cilat ata i kane si pasojë e zgjatjes së kontratës për 11.4 muaj dhe mbulimin e kostos së këtyre shpenzimeve, i pandehuri E.B ka sqaruar se kjo nuk ka të bëjë me çmimin e dakorduar, ngase ai çmim është fikse dhe nuk ndryshon, e ka elaboruar këtë takim të mbajtur me tutje ka thënë se ka qenë mendim unanimitet i këshilltareve që kjo çështje të shtjellohet me tej nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të merret vendim nga kreu me i lart i shtetit, ngase kjo është kërkesë e cila del prej kontratës dhe ka të bëjë me aneksin i cili është nënshkruar me datë 27 shtator 2017, por që ka të bëjë me shpenzimet në atë aneks e për të cilat nuk janë dakorduar. Si përfundim i pandehuri E.B ne emër edhe të këshilltareve tjerë të pranishëm në atë takim, ka sugjeruar që kjo çështje të vendoset nga Komiteti Ndërministror në mënyrë që të rekomandohet me tutje për në Qeveri. KDNM në këtë mbledhje ka votuar me 3 vota pro (pro ka votuar edhe i pandehuri P.L) dhe 2 abstenime rekomandimin që çështja të dërgohet në Qeveri.

- Në takimin e datës 31.05.2018 ka marrë pjesë edhe Kryeministri i Kosovës R.H. Në këtë takim, i pandehuri P.L ka bërë një ekspozitë të projekt-marrëveshjes me OP'' Bechtel Enka'', për shpenzime shtesë për shkak të zgjatjes së afatit të kontratës. Anëtarët e KDNM-së ka kërkuar që dokumentacioni rreth kësaj çështje të plotësohet edhe me Opinionin Ligjor të Departamentit Ligjor të MI-së, ngase sipas tij anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë vendim për këtë çështje, e po ashtu ka kërkuar shpjegim se pse anëtarët e KDNM-së nuk mund ta kenë kontratën e nënshkruar me Bechtel Enka, kur vendimi që kanë marrë derivon si pasojë e mos zbatimit të asaj kontrate. Lidhur me këtë, Kryeministri R.H ka kërkuar nëse ka vendim zyrtar nga Departamenti Ligjor i MI lidhur me ligjshmërinë e pagesave shtesë, e për të cilën çështje i pandehuri P.L ka thënë se nuk ka vendim zyrtar, por janë bërë konsultime me këtë departament dhe këshilltarin juridik të pandehurin E.B, ku kanë ardhur në përfundim se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që ky projekt-vendim të aprovohet për procedim të mëtejshëm. Kryeministri i Kosovës në këtë takim e ka ngarkuar të pandehurin E.B që të merr një opinion zyrtar nga Departamenti Ligjor i MI, e pastaj në mbledhjen e radhës të merret vendimi.
- Në takimin e datës 05.06.2018, ku prezent ka qenë edhe Kryeministri R.H, i cili ka deklaruar se meqë janë siguruar dokumentet e kërkuar nga mbledhja e kaluar janë krijuar kushtet për të marrë vendim, ashtu që në këtë takim KDNM unanimisht ka miratuar vendimin që Qeveria e RKS-së ta aprovojë kërkesën për shpenzime shtesë për konzorciumin Bechtel Enka, në vlerë prej 45 milion euro dhe me shpenzime të TVSH prej 18% (në shumë prej 8 milion e 100 mijë euro), në shumë të përgjithshme prej 53 milion e 100 mijë euro. Gjykata vlerësimin e detajuar të procesverbaleve si në datat e lartcekura, e ka bërë tek gjetje e gjykatës si më poshtë.

3.3.10 Nga leximi i Opinionit të kompanisë mbikëqyrëse "Hill International", me nr. P XK-00001.00/GP/S0735, i datës 30.09.2016,

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se kompania mbikëqyrëse Hill International me datë 30.09.2016 ka dhënë opinionin me nr.Ref: P XK- 00001.00/GP/S0735, me të cilin ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës se aneksi kontrata e projektit të ndërtimit të autostradës R6 në mënyrë që të jetë efektive duhet të përmbajë kërkesat e punëdhënësit dhe orarin e pagesave. Po ashtu, me kërkesë të punëdhënësit aneksi i kontratës duhet të shtyjë afatin e kompletimit të punimeve për 347 ditë(11 muaj dhe 13 ditë) në një kosto prej 14.778.00 milion Euro duke përfshirë edhe TVSH-në, nga 1,278 ditë në 1,625 ditë, ashtu që koha e kompletimit duhet të ndryshojë në 53 muaj dhe 13 ditë, ngase kjo provë e vërteton një

fakt shumë të rëndësishëm në këtë proces gjyqësor sepse e njëjta kompani për mes këtij dokumenti e kishte njoftuar Ministrin e Infrastrukturës, se aneks kontrata për zgjatjen e afateve të përfundimeve të punimeve duhet të përmbaj dy kërkesa kryesore e siç janë: ajo teknike dhe komerciale, dhe duke ju referuar provave të tjera për këtë shkresë, ishte i njoftuar edhe i pandehuri B.T në pozitën ushtruese në detyrën e drejtorit të prokurimit në Ministrin e Infrastrukturës, dhe për kundër që i njëjti ka qenë në njohuri se aneks marrëveshjen e mëparshme e cila kishte vlerë 14.778 milion Euro, e kanë ditur se nuk ka qenë në kompetencën e të pandehurve dhe ministrisë që të nënshkruajnë marrëveshjen e datës 29.09.2017, pa kosto financiare.

3.3.11 Nga leximi i Marrëveshjes e lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe OE “Bechtel&Enka”, me nr. 356/17, e datës 27.09.2017;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 27.09.2017, në Ministrinë e Infrastrukturës në Prishtinë, në cilësi të personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërministror (KDNM) dhe N.SH - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe B.T - Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokolli 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, pa e caktuar koston financiare, sipas gjetjes së gjykatës të pandehurit e lartcekur në bashkëkryerje duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat me qëllim që t’i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në atë mënyrë që të njëjtit, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokolli 356/17 të datës 27.09.2017, duke mos e përcaktuar koston financiare, veprim ky që i lë hapur mundësinë OE “Bechtel&Enka” që me datë 27.11.2017 të paraqes pranë punëdhënësit kërkesën për pagesën e shumës shtesë „Briefing Package” në vlerë prej 63 milion Euro në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve, e cila kërkesë me pas ka zbritur në vlerën prej 53,100,000.00 Euro, ku si pasojë e këtyre veprimeve të pandehurve, sipas rekomandimit të*

Komititeti Drejtues Ndërministror, kërkesa e OE „Bechtel&Enka” është aprovuar për pagesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/50 i datës 05.06.2018, shumë kjo e cila është në kundërshtim të plotë me opinionin e mbikëqyrësit të kontratës “Hill Internacional” në lidhje me pakon informative të kontraktuesit të titulluar “autorizim për zgjatjen e afatit kohor për përfundimin e punës dhe adaptimit të drejtë çmimi kontraktues” i datës dhjetor 2017, me ç ‘rast, si pasojë e veprimeve të të pandehurve buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

3.3.12 Nga leximi i Opinionit të kompanisë mbikëqyrëse „Hill International”, me nr. P XK-00001.00GP/S1513, i datës 21.12.2017,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania mbikëqyrëse Hill International me dokumentin nr. P XK-00001.00GP/S1513, të datës 21.12.2017, ia ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës opinionin e kërkuar me datë 17.12.2017 sipas kërkesës me nr.9418, nga se kjo provë e vërteton faktin se kompania mbikëqyrëse ka dhënë opinionin e saj rreth kërkesës së kontraktuar për pagesë shtesë në vlerë prej 53 milion Euro për zgjatjen e afatit e përfundimit të punimeve, në këtë opinion kompania mbikëqyrëse e projektit ka bërë një elaborim të vlerësimit të gjendjes që nga nënshkrimi i kontratës e deri tek situata të kërkohej nga operatori Bechtel&Enka që ti kompensohet shuma 53 milion Euro, sipas këtij opinionit fillimisht ishte paraparë që kontrata të zgjatet nga 42 deri në 48 muaj, konkretisht deri me datën 20.07.2018 dhe kjo pa ndonjë kosto shtesë, me kusht që të rregullohen artikujt komercial që kanë të bëjnë me materialin e ndërtimit, ndriçimit dhe pitelevë të trafikut. Sipas kompanisë mbikëqyrëse çështja së përfundimit të punimeve nuk ka qenë çështje në vete pasi që drejtpërdrejtë lidhet me draft aneks kontratën e dakorduar më datën 30.09.2016, ku palët kontraktuese përfundimisht ishin dakorduar që zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve të ketë datën 31.12.2018, në një kosto prej 14.778.00 milion Euro duke përfshirë edhe TVSH-në. Ky opinion i kompanisë mbikëqyrëse e sqaron se kërkesa e kompanisë Bechtel&Enka është e arsyetuar vetëm në piken A të saj, e cila e kap shumën prej 14.778 milion Euro, ndërsa në piken B. në emër të pajisjeve ka kërkuar shumën prej 36.3 milion Euro si dhe në piken C. në emër të pagesës në realizim të projektit ka kërkuar shumën në vlerë prej 10 milion, ka dhënë vlerësimin profesional se pika B dhe C janë të pa arsyetuara dhe të papranueshme, që nënkupton që shuma përtej 14.778, më konkretisht që është paguar prej 53 milion Euro diferenca e cila i është paguar kompanisë Bechtel&Enka ka qenë e pa*

bazuar dhe e pa arsyetuar, mirëpo përkundër kësaj kompania punë kryerëse në rastin konkret Bechtel&Enka ka realizuar pagesën në tërësi sipas kërkesës së tyre dhe kjo si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të pandehurve në këtë çështje penale.

3.3.13 Nga leximi i Dokumentit të kompanisë mbikëqyrëse ‘‘Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1896 të datës 05.09.2018 dhe PXX-00001.00/GP/S1882 e datës 09.08.2018;

- *Pas administrimit të Dokumenti i kompanisë mbikëqyrëse ‘‘Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1882 e datës 09.08.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania mbikëqyrëse Hill International me datë 09.08.2018 ka kërkuar nga Ministri i Infrastruktues i pandehuri P.L që të zbatohet neni 2 i ankes të kontratës, ashtu që të nxjerrët një ankes i ri ku do të përfshihet përveç kostos shtesë për zgjatje të afatit të kompletimit EoT edhe detaje se si do të implementohet pagesa e kostos shtesë. Po ashtu, të definohen edhe kërkesat e punëdhënësit, përkatësisht variacionet, në mënyre që të mos mbeten çështje komerciale të pazgjdhura. Tutje, ka theksuar faktin se edhe pse kontraktori ende nuk ka dorëzuar ndonjë ankesë të detajuar lidhur me këtë, por vetëm njoftimin për ankesë, ashtu që në rast të dështimit të formalizmit të marrëveshjes mund të shpie kontraktorin në marrjen e vendimit për aplikim të ankesës në Gjykatë të Arbitrazhit.*

Pas administrimit të Dokumenti i kompanisë mbikëqyrëse ‘‘Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1896 të datës 05.09.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania mbikëqyrëse Hill International me datë 05.09.2018 i është drejtuar Ministrit të Infrastrukturës P.L të cilin e ka njoftuar se kalkulimet e fundit të dorëzuara nga ana e kontraktorit për ndryshimet e kostos shtesë të pajisjeve në thelb nuk ndryshojnë asgjë nga ato që kanë prezantuar në shkresën e tyre PXX-00001.00/GP/S1882 e datës 09.08.2018, kështu që shkresa e tillë mbulon kërkesën e parashtruar nga ana e tij. Sipas gjetjes së gjykatës dokumentet e lartcekura i janë dërguar Ministrisë së Infrastruktues nga Kompania mbikëqyrëse Hill International, pas aprovimit nga Qeveria e Kosovës për aprovimin e pagesës në vlerën prej 53 milion për operatorin ekonomik Bechtel&Enka.

3.3.14 Nga leximi i Dokumentit nga kompania mbikëqyrëse ‘‘Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1966, e datës 15.02.2019, e dorëzuar në Kabinetin e Ministrit të Infrastrukturës mbi dorëzimin e opinionit të datës dhjetor 2017;

- *Pas administrimit të kësaj prove, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 21.12.2017 Kompania mbikëqyrëse Hill International ka dorëzuar dokumentin me nr. P XK-00001.00/GP/S1513 të datës 21.12.2017 - Opinion mbi dosjen informuese të kontraktuesit me titull “ E drejta për zgjatjen e kohës për kompletimin dhe përshtatjen e barabartë të çmimit të kontratës”, tek Kabineti i Ministrit të Infrastrukturës dhe këtë dokument e ka pranuar z.B.A A.Kj – Asistent i Ministrit(i cili e ka nënshkruar pranimin) ku ofrohet si dëshmi dokumenti me nënshkrim i tij dhe data e pranimit të këtij dokumenti, këtë e vërteton edhe dëshmia e këtij dëshmitari të dëgjuar në këtë çështje penale që ka deklaruar se e kamë pranuar unë personalisht këtë dokument, dhe në parim të gjitha dokumente i kamë dërguar tek këshilltari politik E.B dhe e njëjti më ka udhëzuar se cilit departament i përkasin dokumentet, jam i bindur qind për qind se e kamë procedura këtë dokument si çdo dokument tjetër, që vërteton faktin se opinionin e Kompanisë mbikëqyrëse Hill International i datës 21.12.2017 , është dorëzuar në kabinetin e Ministrin e Infrastrukturës të drejtuar nga ministri i pandehuri P.L dhe është pranuar nga i pandehuri E.B, ku të njëjtit të pandehur gjatë mbrojtjet së tyre e mohojnë se e kanë pranuar opinionin e lartcekur, e i cili opinion e ka përmbajtjen se nuk arsyetohet kërkesa e OE Bechtel enkës, për shumen prej 53 milion, kjo kërkesë është e pa bazuar.*

3.3.15 Nga leximi i Opinioneve Ligjor me nr. prot. 5142 dhe 5124, të datës 01.06.2018, nga leximi i komunikimeve përmes e-mailit zyrtar të datës 31.05.2018 dhe 01.06.2018, në mes të E.B, A.K dhe R.Q,

- *Pas administrimit të komunikimeve elektronike të datës 31.05.2018 dhe 01.06.2018 gjykata ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 31 maj 2018 ka përcjellë një email tek Drejtori i Departamentit Ligjor A.K me subjekt: “memo shpjeguese për kërkesën e Bechtel – Enkes”, në të cilën email A.K, në të njëjtën ditë është përgjigjur se nuk mund të jep opinion sqarues lidhur me kontratën për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, pasi që asnjëherë nuk ka qenë pjese dhe nuk ka pasur qasje në atë kontratë, e as nuk ka njohuri të specializuara për atë kontratë, andaj opinionin sqarues duhet ta jep ai që ka pasur qasje në kontratë, për këtë edhe i është lutur që të i drejtohet menaxherit të kontratës dhe kompanisë mbikëqyrëse dhe ekipit që ka marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kontratës apo këshilltarit të transaksionit të angazhuar për negocimin dhe hartimin e kontratës. Nga kto prova, gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 01 Qershor 2018 ka*

përcjellë një email tek Drejtori i Departamentit Ligjor A.K me subjekt:” Shkresa për opinionin ligjor”, të cilit email ia ka bashkëngjitur edhe attachments: “Shkresa për ministrin – DL”, dhe në atë email i ka kërkuar përmirësime A.Kt , po të njëjtën ditë A.K ia përcjell përmes emailit opinionin sqarues ligjor(në ora 12:23), si dhe opinionin ligjor(në ora16:04) drejtuar të pandehurit P.L(ish-ministër), duke mbajtur në Cc, të pandehurit E.B dhe N.SH. Po ashtu, me të njëjtat prova gjykata ka vërtetuar faktin se Departamenti Ligjor i MI-se, e ka dhënë opinion ligjor lidhur me zgjatjen e afatit te kontratës në mes të MI-së dhe operatorit ekonomik Bectel & Enka, për ndërtimin e autostradës R6, Prishtine-Hani i Elezit të datës 27.09.2017 nr.i prot.356/2017, ndërsa nuk kanë dhënë opinion ligjor, rreth ligjshmërisë për pagesën e shpenzimeve shtese të operatorit ekonomik Bectel & Enka. Gjykata vlerëson se këto janë prova të rëndësishme me të cilat vërtetohen veprimet inkriminuese të pandehurve P.L dhe E.B, pasi që opinionin ligjor i propozuar si provë në vlerësim të tij do të shihet se është lëshuar nga drejtori i departamentit ligjor A.K, ku i njëjti në versionin e parë gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 01.06.2018 Drejtori i Departamentit Ligjor A.K ka dërguar përgjigje(Opinionin sqarues ligjor me nr. Protokolli 5124) (ora 12:23) të drejtuar të pandehurit P.L, lidhur me zgjatjen e afatit të kontratës në mes të MI dhe Bechtel Enka për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, ashtu që ka shprehur se vazhdimi i kësaj kontrate është bërë në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Prokurimit si dhe me kontratën me operatorin, ka konstatuar se “opinione sqaruese lidhur me koston financiare mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional si përfaqësues i punëdhënësit dhe departamenti i prokurimit të MI-së si nënshkruese e kontratës e cila posedon njohuri të specializuara”, si dhe e ka njoftuar se vlera e shpenzimeve shtesë për zgjatjen e afatit nuk është e përcaktuar në amendamentin e kontratës. Po ashtu, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 01.06.2018 Drejtori i Departamentit Ligjor A.K ka dërguar përgjigje(Opinioni ligjor me nr. 5142) (ora16:04) në drejtim të pandehurit P.L lidhur me zgjatjen e afatit të kontratës në mes të MI dhe Bechtel Enka për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, ashtu që ka shprehur se vazhdimi i afatit të kontratës është në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Prokurimit si dhe me kontratën me operatorin, ndërsa lidhur me koston financiare “mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe departamenti i prokurimit publik të MI-së,si nënshkrues të kontratës pasi që posedojnë njohuri të specializuara”, pasi që opinionin ligjor i Departamenti ligjor ipet për kabinetin e ministrit dhe nuk është obligativ, nga kjo vërtetohet se me kërkesën e të pandehurve P.L dhe E.B, drejtori departamentit ligjor A.K në verzionin e dytë të opinionin ligjor ka konstatuar “se opinionin lidhur me koston

financiare mund të japin personat përgjegjës të kompanisë mbikëqyrëse (duke larguar emrin e Hill Internacional), dhe departamenti i prokurimit të MI-së, e në raport me këtë përmes kësaj provë do të vërtetohet se duke mos qenë të kënaqur me këtë opinion të A.Kt, i pandehuri E.B me referimet e tij dhe me dijeninë e të pandehurit P.L ka ushtruar presion tek dëshmitari A.Kt, ku këtë presion e ka konfirmuar edhe në dëshminë e tij të dhënë në këtë çështje penale, dhe si përfundim i gjithë kësaj ka rezultuar se departamenti ligjor i Ministrisë së Infrastrukturës ka përgatitur një opinion tjetër i cili ishte në favor të kërkesës të të pandehurve të lartcekur dhe si rrjedhojë e krejt kësaj të njëjtit edhe përkundër sugjerimeve të drejtorit të departamentit ligjor A.K, kanë anashkaluar opinionet e kompanisë mbikëqyrëse të projektit Hill Internacional, dhe përmes opinionit të dytë ligjor të siguruar në mënyrën e elaboruar si më parë, pas përpjekjeve të kundërligjshme të pandehurit P.L dhe E.B për të larguar në këtë opinion emrin e Hill Internacional, kanë arritur të përgatisin bazën ligjore e cila do të arsyetonte veprimet inkriminuese të tyre për finalizimin e pagesave shtesë në vlerë prej 53 milion Euro, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës. Po ashtu, gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtori i Departamentit Ligjor A.K me datë 01.06.2018 ka përcjellë tek hetuesi policor Aziz Sallahu Opinionet ligjore me nr.5142 dhe 5124 të datës 01.06.2018 lidhur me zgjatjen e afatit të kontratës në mes të MI dhe Bechtel Enka për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, marrëveshjen në mes të MI-së dhe Bechtel Enka me nr.prot.7493 të datës 27.09.2017 dhe me prot. të Kabinetit të Ministrisë 356/17 të datës 27.09.2017; Shkresat e KRPP-së nr.96/2016 të datës 04.08.2016; Shkresën elektronike (e-mail) të z.Skender Gashi, të datës 30.06.2016; Shkresën elektronike (e-mail) e z.Rame Qupeva të datës 1 Qershor 2018, e cila në bashkëngjitje i ka, Marrëveshja në mes MI-se dhe Bectel & Enka, me prot.7493 të datës 27.09.2017 dhe me prot. të Kabinetit të Ministrisë 356/17 të datës 27/09/2017, Shkresa e KRPP-se nr.96/2016, datë 04.08.2016, shkresat e z.B.T, L.ZHt, Jeton Oruqi, Skender Gashit; Shkresën elektronike (e-mail) e z.Jeton Oruqi të datës 05.Gusht 2016; Shkresën elektronike (e-mail) e z.Jeton Oruqi të datës 11 korrik 2016; Shkresën elektronike (e-mail) e z.L.ZHt, të datës 05 Gusht 2016; Shkresën elektronike (e-mail) e z.L.ZH të datës 11 korrik 2016; Shkresën elektronike (e-mail) e z.L.ZH, të datës 28 Qershor 2016; Shkresa e z.B.T me ref.7494 të datës 27.09.2017; Shkresa e z.B.Tt me nr.prot.3897 të datës 21.07.2016; Shkresa elektronike e z.E.B, të datës 31 maj 2018 e cila në bashkëngjitje ka pasur Memorandum shpjegues për kërkesën e Bectel Enka; Shkresën elektronike (e-mail) e A.Kt, të datës 31 Maj 2018, drejtuar E.B; Shkresën elektronike (e-mail) e z.E.B, të datës 1 Qershor 2018, tema për dhënien e opinionit ligjor, e cila në bashkëngjitje e

përmban një propozim të opinionit ligjor, të përgatitur në emër timin nga E.B për Ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës, e mban datën 01.05.2018.

3.3.16 Lexohet Përgjigjja nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik²¹, Prot. 96/2016, e datës 04.08.2016, në Kërkesës Nr. 91/2016, e datës 21.07.2016, lidhur me interpretimin e dispozitave të kontratës për “Ndërtimin e Autostradës Route 6 Prishtinë – Hani i Elezit”, përgjigjja e shkruar nga Sami Uka – Kryesues i Departamentit të Rregullave dhe Abdyl Limani – Ekspert i Prokurimit,

- *Gjykata, pas administrimit të kësaj prove ka vërtetuar faktin se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik me dokumentin me nr. Prot. 96/2016, të datës 04.08.2016 ka kthyer përgjigjen në kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës me nr.91/2016 të datës 21.07.2016, ku ka përcaktuar se LPP dhe legjisalcioni sekondar i prokurimit, përcaktojnë se implementimi i kontratës duhet të bëhet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, andaj është në kompetencë dhe përgjegjësi të Autoriteti Kontraktues që kontratat e lidhura në mes palëve kontraktuese AK²² dhe OE implementues, ti implementojnë ashtu siç është përcaktuar në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të saj. Tutje, ka shtuar se KRPP nuk bënë interpretimin e klauzolave të kontratës dhe rasteve që ndodhin gjatë menaxhimit dhe implementimit sepse në këtë kontratë siç shihet në fusnotë të saj, krahas LPP janë zbatuar edhe rregullat e FIDIC-ut, kështu që kjo çështje mbetet në përgjegjësi të AK dhe OE si palë kontraktuese, që duke iu referuara ligjeve në fuqi dhe rregullave të FIDIC-ut të ndërmarrin veprimet konform tyre.*

3.3.17 Nga leximi i Protokoll për nënshkrimin e vazhdimit të kohëzgjatjen se afatit të kontratës për projektin „R6”, me nr. 7494, e datës 27.09.2017,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtori i Divizionit të Prokurimit B.T, me Kërkesën 7494 të datës 27.09.17 i është drejtuar Ministrit të Infrastrukturës P.L dhe Sekretarit të Përgjithshëm U.D N.SH, lidhur me protokollin për nënshkrimin e vazhdimit të kohëzgjatjes së afatit të kontratës për projektin R6 Prishtinë – Hani i Elezit, ku e ka njoftuar se është përgatitur shkresa dhe është e gatshme për nënshkrim për zgjatjen e afatit deri me 31.12.2018, ndërsa çështja e koston financiare për vazhdimin e kontratës të diskutohet*

²¹ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (Në tekstin e mëtejme KRPP),

²² Autoriteti Kontraktues (Në tekstin e mëtejme AK),

dhe miratohet me përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës , gjykata gjen se e njëjta shkresë është përpiluar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pas që të njëjta rregulla nuk njohin marrëveshje-aneks apo kontratë pa kosto financiare, e në mungesë të elementit kosoto financiare e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, ku me nënshkrimin e saj inkorporohen veprimet e kundërligjshme të pandehurve P.L, N.SH dhe Bersim Tahiri, pasi që të njëjtit po ashtu nuk kanë qenë kompetent për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, po ashtu gjykata gjen se të njëjtit dokumente ju ka referuar i pandehuri N.SH në mbrojtjen e tij ka deklaruar “ se në bazë të opinionit të marr nga Drejtori i Divizionit të Prokurimit i pandehuri B.T, ka konstatuar se gjithçka është në rregull unë e kam nënshkruar marrëveshjen e datës 27.09.2017”.

3.3.18 Nga leximi i Raportit nga Thesari i Kosovës i Pagesave të ekzekutuara për OE „Bechtel&Enka”, me nr. Prot. 31, te datës 19.02.2021,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Thesari i Kosovës duke vepruar sipas kërkesë së prokurorisë të datës 15.02.2021, me datë 19.02.2021 ka dorëzuar raportin e përmbledhur të pagesave për përfituesin Bechtel Enka për kontratën e lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës, nga i cili raport figuron se:*
 - *për vitin 2014 – shuma prej 90,817,283.30;*
 - *për vitin 2015 – shuma prej 112,124,85986;*
 - *për vitin 2016 – shuma prej 155,978,020.57;*
 - *për vitin 2017 – shuma prej 179,124,901.26;*
 - *për vitin 2018 – shuma prej 142,631,883.34;*
 - *për vitin 2019 – shuma prej 49,605,938.90;*
 - *për vitin 2020 - shuma prej 10,379,391.78.*

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se se pagesat për vitet 2014-2015 dhe 2016, që janë realizuar në llogarinë e kompanisë Bechtel&Enka, arrin në vlerë më shumë se gjysmën e vlerës së kontratës, andaj nuk qëndrojnë pretendimet e të pandehurit P.L qe qeveritë e më hershme kanë pasur vonesa në pagesa të fakturave në këtë projekte, po ashtu nuk qëndron as pretendim i të pandehurit P.L se në kohen e marrje së mandatit pas daljes në teren vetëm 10% e punëve kanë qenë të kyra në teren, krejt ky deklarami i tij ka pas për qëllim që ti shmangies përgjegjësit penale, pasi që i njëjtit pretendime e tij nuk i ka arsytuar me as një provë të vetëme në këtë drejtim, nuk i ka ofruar gjykatës as një faktur të vetme për mos pagës nga qeveritë e*

kaluara për këtë projekt, nuk i ka ofruar gjykatës as një shkresë të kompanisë Bechtel&Enka, që qeveria e Kosovës i ka mbet borxh për këtë projekt për vitet që i njëjti pretendon.

3.3.19 Nga leximi i Raportit nga Ministria e Infrastrukturës për ekzekutimin e pagesave për OE „Bechtel-Enka“, me nr. Prot. 1302, e datës 15.02.2021,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se zyrtari përgjegjës në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës ka dorëzuar materialin lidhur me pagesat sa i përket projektit të autostradës R6 nga viti 2014 deri në pagesën e fundit me datë 02.10.2020, në të cilin material figuron edhe pagesa e aneks kontratës në shumën prej 53,100,000.00 Euro, si pasojë e veprimeve të kundërligjshme të pandehurve në këtë çështje penale.*

3.3.20 Nga leximi i Procesverbalit të mbledhjeve të 49 dhe 50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 29.05.2018 dhe 05.06.2018,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje e 49 me datë 29.05.2018, në të cilën mbledhje si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe shqyrtimi i kërkesës së konzorciumit Bechtel Enka për shpenzime shtesë sipas Aneksit të Kontratës për Projektin e ndërtimit të auto rrugës Prishtinë – Hani i Elezit. Në këtë mbledhje ka prezantuar edhe Ministri i Infrastrukturës, këtu i pandehuri P.L, i cili në këtë mbledhje ka deklaruar se komiteti drejtues ndërministror me shumicë votash ka vendosur që çështja e shqyrtimi të kërkesës së konzorciumit Bechtel Enka për shpenzime shtesë në shumën prej 53 milion euro sipas Aneksit të Kontratës për Projektin e ndërtimit të auto rrugës Prishtinë – Hani i Elezit të vendoset nga Qeveria e Kosovës. Tutje, i pandehuri P.L ka shtuar se Qeveria lidhur me këtë kërkesë ka dy mundësi: 1). Aprovimi i marrëveshjes dhe autorizimi i Ministrisë së Infrastrukturës për nënshkrimin e saj dhe 2).Mos-aprovimi i marrëveshjes dhe ndërprerja e punimeve dhe dërgimin e çështjes për vendosje në arbitrazhin ndërkombëtar. Sipas vlerësimit të gjykatës se ky deklaram i të pandehurit P.L, ka pas për qëllim finalizimin e veprimeve të vazhdueshme të kundërligjshme të tij, pasi që ky deklaram i tij nuk ka mbështetje në asnjë provë të vetme, pasi që i njëjti ka interpretuar para anëtarëve të qeveris fakte të pa vërteta në lidhje me këtë projekt, krejt kjo është bërë me qëllim të finalizimi të pagesë për operatorin ekonomik Bechtel Enka. Po ashtu, nga administrimi i provës gjykata ka vërtetuar faktin se Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje e 50 me datë 05.06.2018, ku ka prezantuar edhe Ministri i*

Infrastrukturës, këtu i pandehuri P.L, i cili në këtë mbledhje ka deklaruar se marrëveshja për pagesën e 53 milion euro shtesë është arritur ashtu që konzorciumi Bechtel Enka është pajtuar të heqë dorë nga e drejta për shpërblimin e dëmit për shkak të vonesave në pagesa nga Qeveria e Kosovës për vitet 2014-2018. Nga pagesa prej 53 milion, e 100 mijë euro të bëhet në këste të barabarta deri me datën 1 Qershor të vitit 2019. Në emër të Komitetit Drejtues Ndërministror i ka rekomanduar Qeverisë të merr vendimin lidhur me këtë çështje. Qeveria në këtë mbledhje ka marrë vendim me të cilin është aprovuar rekomandimi në fjalë, ashtu siç është paraqitur nga i pandehuri P.L. Sipas vlerësimit të gjykatës deklarimet e të pandehurit P.L nuk kanë qenë të bazuara në fakte, vetëm kanë pas për qëllim arritjen e qëllimi të pandehurit për realizimin e kundërligjshëm të pagesës prej 53 milion euro, sipas gjetjes së gjykatës drejtuesi i qeveris dhe anëtarët e saj, të asaj kohe, të n dëgjuar në cilësi të dëshmitareve në këtë çështje penale nuk kanë pas njohuri bazike në lidhje me këtë projekt, andaj të njëjtit e kanë besuar thinjet e të pandehurit P.L, me thinjet e tij anëtarëve KDNM ju ka vënë presion, se kjo çështje do të shkojë në arbitrazh dhe dëmet për shtetin e Kosovës do të jenë marramendëse, pasi që këtë e kanë dëshmuar anëtarët e KDNM edhe në dëshmitë e tyre të n dëgjuar në këtë çështje penale, pasi që të njëjti kanë deklaruar se kanë votuar me mirëbesim pro këtij vendimi.

3.3.21 Nga leximi i Raportit të Ministrit të Infrastrukturës së datës 19.01.2018 dhe Procesverbali i mbledhjes së Komisionit Parlamentar të datës 23.01.2018;

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Ministri i Infrastrukturës, këtu i pandehuri P.L, me datë 19.01.2018 ka paraqitur raportin me nr.079/18 për Komisionin Parlamentar për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, duke vepruar sipas kërkesës së këtij komisioni lidhur me pretendimet për penale nga kontraktuesi Bechtel Enka sa i përket ndërtimit të autostradës Arben Xhaferi. Në këtë raport, si përfundime i pandehuri P.L ka paraqitur se kjo kontratë për ndërtimin e autostradës ishte paraparë të përfundojë me 20 Janar 2018, por që për shkak të vonesave në pagesën e shpenzimeve të ndërtimit nga Qeveria e Kosovës, kjo e fundit ka kërkuar zgjatjen e afatit deri me 31.12.2018. Shpenzimet për këtë zgjatje të afatit nuk janë dakorduar. Kontraktori ka kërkuar 63 milion Euro nga shuma e dakorduar më parë prej 14.8 milion Euro. Ka shtuar se ka mbetur që MI dhe kontraktori të definojnë saktë shpenzimet për këtë periudhë dhe të shmangen të gjitha pretendimet tjera të mundshme kontraktuale të cila do të ishin jashtëzakonisht të pafavorshme.*

Këtij raporti i ka bashkëngjitur si shtojcë raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës së ndërtimit të autostradës Arber Xhaferi.

- Po ashtu, nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit Parlamentar për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal me datë 23.01.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se Ministri i Infrastrukturës, këtu i pandehuri P.L ka prezantuar në këtë komision ku si pikë e rendit të ditës ka qenë edhe pretendimet për penale nga kontraktuesi Bechtel Enka sa i përket ndërtimit të autostradës Arben Xhaferi. Në këtë komision i pandehuri P.L ka raportuar lidhur me zgjatjen e afatit për përfundimin e punimeve, ku ka deklaruar se marrëveshja për zgjatjen e afatit është nënshkruar pa u definuar kostoja financiare. Ka deklaruar se nënshkrimin e kontratës pa kosto e kanë bërë pasi që kanë pranuar një letër nga kontraktori ku thuhet se nëse nuk nënshkruhet, punimet ndërpriten dhe shkohet në arbitrazh. Ka deklaruar se nëse do të shkonte në arbitrazh buxhetit të Kosovës do të i kushtonte 200-300 milion euro. Duke qenë se anëtarët e komisionit nuk janë pajtuar me të pandehuri P.L në disa çështje dhe me qëllim të qartësimin të situatës, komisioni e ka ndërprerë raportimin dhe ka kërkuar nga i pandehuri P.L që të raportojë për secilën çështje në interes të komisionit duke ia ofruar raportet dhe materialet që i janë kërkuar. Sipas gjetjes së gjykatës deklarimi i të pandehurit P.L, se “ për shkak të vonësive në pagesën e shpenzimeve të ndërtimit nga Qeveria e Kosovës, kjo e fundit ka kërkuar zgjatjen e afatit deri me 31.12.2018. Shpenzimet për këtë zgjatje të afatit nuk janë dakorduar, Kontraktori ka kërkuar 63 milion Euro nga shuma e dakorduar më parë prej 14.8 milion Euro”, vërtetohet se thëniet në vonesa në pagesa të shpenzimet nga qeveritë e kaluar janë të pa bazuar në prova, siç është vlerësuar më lartë, po ashtu vërtetohet se i pandehuri P.L ka qenë në njohuri të plotë për vlerën prej 14.8 milion Euro, të dakorduar për intervalin e njëjtë kohor për zgjatjen e afatit të përfundimi të punimeve, por i njëjti nuk ju ka referuar dhe nuk e ka marr për bazë opinionet e kompanisë mbikëqyrës Hill Internacional, më pas i pandehuri P.L ka “ deklaruar se nënshkrimin e kontratës pa kosto e kanë bërë pasi që kanë pranuar një letër nga kontraktori ku thuhet se nëse nuk nënshkruhet, punimet ndërpriten dhe shkohet në arbitrazh. Ka deklaruar se nëse do të shkonte në arbitrazh buxhetit të Kosovës do të i kushtonte 200-300 milion euro”, sipas gjetjes së gjykatës i njëjti deklarim është i pa bazuar, sepse gjatë mbrojtjes së tij, gjykata ka kërkuar nga i njëjti që ti sjell gjykatës dokument të operatorit ekonomik „Bechtel-Enka” ku thuhet se nëse nuk nënshkruhet marrëveshja, punimet ndërpriten dhe shkohet në arbitrazh, që e vërtetoj thënien e të pandehurit si më lart, i njëjtit ka deklaruar se nuk kemi asnjë dokument me*

shkrim, por na kanë thënë vetëm në mënyrë verbale përfaqësuesi i „Bechtel-Enka“, andaj me deklaramet e tij kanë pas për qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale.

3.3.22 Nga leximi i „Briefing Package “ – Pako informuese nga OE „Bechtel&Enka“, nëntor 2017;

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se OE''Bechtel Enka'' në Nëntor 2017 ka përgatitur një pako informuese për Ministrinë e Infrastrukturës lidhur me të drejtën për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve dhe përshtatjen e drejtë të çmimit kontraktues. Në këtë pako informuese, operatori ekonomik ''Bechtel Enka'' në hyrje të saj falënderon Ministrinë e Infrastrukturës për ndryshimin e kontratës së nënshkruar nga palët me datë 27 Shtator 2017, duke zgjatur kohën e përfundimit të punimeve deri me 31 Dhjetor 2018. Tutje, ka paraqitur prapavijën faktike ku ka përfshirë: përgjegjësitë e kontratës – detyrimet e palëve, përmbledhjen e korrespondencës, qasjen proaktive për zbutjen e ndikimit të mangësive në alokimin e buxhetit – e drejta për zgjatje të afatit për përfundim të punimeve si dhe e drejta për kompensim për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në të cilën pjesë ka theksuar se kompensimi për zgjatjen e kohës për përfundimin e punimeve vlerësohet në 63 milion euro, sipas gjetjes së gjykatës këtë kërkesë e ka bazuar në tri pika dhe atë: në pikën A. në emër të prolongimit të punës ka kërkuar shumën prej 16.6 milion Euro , në pikën B. Në emër të pajisjeve ka kërkuar shumën prej 36.3 milion Euro si dhe në pikën C. në emër të pagesës në realizim të projektit ka kërkuar shumën në vlerë prej 10 milion Euro, mirëpo ajo çka është e rëndësishme dhe që është në harmoni edhe me opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, është fakti se kjo kërkesë nuk përmban saktësisht pajisjet në shumën 36.3 milion Euro, prandaj edhe kompania mbikëqyrëse Hill Internacional në opinionin e saj ka dhënë vlerësimin profesional se pika B dhe C janë të pa arsyetuara dhe të papranueshme, mirëpo përkundër kësaj kompania punë kryerëse në rastin konkret Bechtel&Enka ka realizuar pagesën në tërësi sipas kërkesës së tyre dhe kjo si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të pandehurve në këtë çështje penale. Për fund, si përmbledhje ka paraqitur se operatori ekonomik''Bechtel Enka'', ka komunikuar herët dhe shpesh në lidhje me mangësitë buxhetore dhe ndikimin e mundshëm dhe efektin përfundimtar që kjo do të kishte në projektin dhe aftësinë e Bechtel Enka që të kryej punën brenda afatit të përfundimit të punëve sipas kontratës fillestare, e të cilat komunikime kishin qëllimin e deklaruar të përpjekjes për të punuar me MI-në për të menaxhuar fondet e disponueshme për projektin. Si rezultat i shtimit të kohës për përfundimin e punëve, ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që të jap një përshtatje të drejtë të çmimit të kontratës në shumë prej 63 milion Euro. Tutje, ka theksuar se në*

vitin 2017 alokimi i projektit buxhetor është shkurtuar nga 240 milion euro të kërkuara, ku deri në Tetor vetëm 131 milion euro janë alokuar në projekt, me një 50 milion euro ende për t'u konfirmuar, duke dhënë në total prej 181 milion euro, e që ky buxhet bie në 59 milion euro më pak se buxheti i kërkuar. Për fund, ka theksuar se mirëpret që të punojë me Mel në mbështetje të QK të alokoj një projekt buxhet të mjaftueshëm për 2018, i cili është vendimtar për ekzekutimin e punëve të mbetura.

3.3.23 Nga leximi i Vendimit mbi Rekomandim i Komitetit Drejtues Ndërmnistror, me nr. Prot. 3624, i datës 20.04.2018,

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Komiteti Drejtues Ndërmnistror me datë 20.04.2018 ka nxjerr vendimin nr.3624 me të cilin i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shqyrtojë kërkesën e konzorciumit Bechtel&Enka për mbulimin e shpenzimeve indirekte lidhur me ankesin e kontratës të nënshkruar me datë 27.09.2017 për përfundimin e punimeve në autostradën R6, deri me datë 31.12.2018 si dhe projekt marrëveshjen, përmes kësaj prove do të vërtetohen aktivitetet e komitetit drejtues ndërmnistror lidhur me rekomandimin që i është bërë qeverisë për shqyrtimin e kërkesës se operatorit ekonomik Bechtel&Enka, vërteton faktin se bazuar në marrëveshjen e datës 27.09.2017, e lidhur në mes të MI-së dhe Operatorit Ekonomik "Bechtel&Enka", pa kosto financiare, lind pasoja që fillimisht ministria e pranon letrën informuese nga kontraktori për kompensimin e shumës prej 63 milion Euro, pasi që sipas gjetjes së gjykatës bazuar në opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional kërkesa e operatorit ekonomik Bechtel&Enka për piken B dhe C, është e pa bazuar, e pa argumentuar, por ky opinion nuk i ka penguar të pandehurit P.L dhe E.B ti realizojnë veprime e tyre të vazhdueshme të kundërligjshme, deri në finalizimin e kësaj pagese.

3.3.24 Nga leximi i Memorandum shpjgues nga Kryesuesi i KDNM-se, P.L, me nr. 477/18, i datës 04.06.2018,

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Kryesuesi i KDNM-së i pandehuri P.L ka paraqitur të anëtarët e komitetit Memorandumin shpjgues lidhur me kërkesën e operatorit për kompensimin e shpenzimeve indirekte për shkak të zgjatjes së afatit të kontratës për ndërtimin e autostradës R6, me të cilin memorandum i pandehuri P.L ka kërkuar nga anëtarët e komitetit që të marrin vendim me të cilin do të rekomandohet Qeveria e Kosovës që të aprovojë kërkesën e operatorit për pagesë të shpenzimeve për zgjatje të kontratës sipas

marrëveshjes së arritur me Ministrinë e Infrastrukturës. Kjo pasi që punë kryesi ka kërkuar mbulimin e shpenzimeve reale për zgjatjen e kontratës për periudhën prej 11.3 muajsh deri me datë 31.12.2018 dhe se MI e ka bindur punëkryesin që të heqë dorë nga e drejta e kërimit të shpërblimit të dëmit për shkak të vonesave të pagesave për vitet 2014-2018, e cila do të mund të ishte objekt shqyrtimi në arbitrazhin ndërkombëtar, e që një gjë e tillë do të ishte e padëshirueshme për Qeverinë e Kosovës për shkak të epilogut të tij të pasigurte për shkak të aplikimit të ligjeve të Anglisë dhe Uellsit të Britanisë së Madhe, e jo të ligjeve të aplikueshme në vendin tonë, sipas vlerësimit të gjykatës thënie e lartcekura të pandehuri P.L, thjesht kanë qenë të pa vërteta- të pa bazuar në prova dhe fakte, qëllimi i tij i vetëm ka qenë realizimi i pagesës prej 53 milion euro për OE Bechtel enka, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës.

3.3.25 Nga leximi i Vendimit mbi Rekomandim i Komitetit Drejtues Ndërmnistror, me nr. Prot. 5237, i datës 05.06.2018,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se KDNM me vendimin me nr.5237 të datës 05.06.2018 i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës ta aprovojë kërkesën për shpenzime shtesë për konzorciumin Bechtel Enka, në vlerë prej 45 milion euro dhe me shpenzime të TVSH prej 18%(në shumë prej 8 milion e 100 mijë euro), në shumë të përgjithshme prej 53 milion e 100 mijë euro, sipas vlerësimit të gjykatës në kundërshtim me opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, ku është konstatuar se është fakti se kjo kërkesë e OE Bechtel Enka, nuk përmban saktësisht pajisjet në shumën 36.3 milion Euro, prandaj ka dhënë vlerësimin profesional se pika B dhe C, të kërkesës të operatorit ekonomik Bechtel Enka, janë të pa arsyetuar dhe të papranueshme, më çka vërtetohet se kjo kërkesë procedohet në qeveri si pasoj e veprimeve të kundërligjshme të pandehurve në këtë çështje penale.*

3.3.26 Nga leximi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/50, i datës 05.06.2018,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Qeveria e Kosovës me vendimin Nr.01/50 të datës 05.06.2018 ka aprovuar kërkesën konzorciumit Bechtel & Enka për të ndarë mjetet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për vazhdimin e ndërtimit e rrugës nacionale R6, auto-rruga "Arben Xhaferi, Prishtinë – Hani i Elezit deri me 31.12.2018 sipas Marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës të datës 27.09.2017. Me të njëjtin vendim, ka autorizuar Ministrinë e Infrastrukturës për nënshkrimin e marrëveshjes me konzorciumin*

Bechtel & Enka për mbulimin e shpenzimeve në shumë prej 45.000.000,00 dhe shpenzimet e TVSH-së prej 18% në shumë prej 8.100.000,00 dhe pagesën e kësaj shume ta bëjë sipas afateve të pagesës në marrëveshje. Po ashtu, është obliguar Ministria e Financave të sigurojë mjetet për mbulimin e shpenzimeve sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe të bëjë alokimin e tyre në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës, sipas vlerësimit të gjykatës më këtë vendim janë finalizuar veprime e vazhdueshme të kundërligjshme të pandehurve P.L dhe E.B, për realizimin e pagesës prej 53 milion, të cilës pagesë i ka parapri në masë të madhe marrëveshja e datës 27.09.2017, e nënshkuare nga të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënëse në njërin anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, pa e caktuar koston financiare, sipas gjetjes së gjykatës të pandehurit e lartcekur në bashkëkryerje duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në atë mënyrë që të njëjtit, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë nënshkuar marrëveshjen me numër protokolli 356/17 të datës 27.09.2017, duke mos e përcaktuar koston financiare, e si pasojë e këtyre veprimeve kundërligjshme të pandehurve të lartcekur është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës.

3.3.27 Nga leximi i Marrëveshjes së lidhur në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe operatorit ekonomik „ Bechtel&Enka ‘’, me nr. 356/17, e datës 27.09.2017,

- *Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Ministria e Infrastrukturës dhe OE Bechtel & Enka me datë 27.09.2017 kanë lidhur marrëveshje me të cilën është zgjatur koha e përfundimit të punimeve për 347 ditë, dhe atë nga 18 Janar 2018 deri me 31 Dhjetor 2018. Ndërsa, lidhur me çështjet tjera komerciale të mbetura hapur është përcaktuar se do të trajtohen me mbulesë të veçantë, sipas gjetjes së gjykatës kjo provë vërteton se të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T kanë nënshkuar marrëveshjen me kontraktorin Bechtel&Enka për zgjatjen e afatit për 11 muaj e 13 ditë, për përfundimin e rrugës së autostradës Prishtinë – Hanë i Elezit, ajo çka është e rëndësishme dhe që është thelbi i kësaj çështje penale, është që kjo marrëveshje është nënshkuar nga të pandehurit e lartë cekur pa e konstatuar koston financiare, për këtë arsye i është dhënë mundësia kompanisë punë kryerëse Bechtel&Enka, që të parashtrojë kërkesë për kompensim shtesë për këtë periudhë kohore vetëm sipas vlerësimit të saj, pasi që sipas vlerësimi*

të gjykatës po të ishte e përcaktuar kostoja financiare në këtë marrëveshje, atëherë do të ishte e pamundur që vlera e kompensimit për këtë shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve të jetë mbi 14 milion Euro, sepse ashtu do të ishte vlerësuar dhe do të ishte caktuar nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional.

3.3.28 Nga leximi i Kërkesës për dorëzim të Raportit të kostos shtesë së OE „ Bechtel&Enka ’’, nga Ministria e Infrastrukturës me nr. Prot. 6410, e datës 04.07.2018,

- *Gjykata pas administrimit të kësaj prove ka vërtetuar faktin se Ministri i Infrastrukturës, tani i pandehuri P.L ka paraqitur kërkesë për dorëzimin e raportit të kostos shtesë së kontraktorit Bechtel Enka tek Udhëheqësi i ekipit të kompanisë mbikëqyrëse Hill International George Papaioannou, me të cilën ka kërkuar raporte para se të nënshkruaj Marrëveshjen – Aneksin për zgjatjen e punimeve në shumë prej 53.1 milion(me TVSH), e cila shumë është aprovuar edhe me Vendimin e Qeverisë të datës 05.06.2018. Konkretisht, ka kërkuar raport të detajuar mbi bazën e kërkesës së kontraktorit Bechtel Enka për shumën e pretenduar prej 53.1 milion lidhur me zgjatjen e afatit të punimeve si dhe raport të detajuar dhe arsyetuar lidhur me kërkesat për miratimet e aktiviteteve shtesë sipas klauzolës 13 të kontratës.*

3.3.29 Lexohet Shkresa nga kompania mbikëqyrëse „Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1882, e datës 09.08.2018,

- *Pas administrimit të Dokumenti i kompanisë mbikëqyrëse „Hill International’’, me nr. PXX-00001.00/GP/S1882 e datës 09.08.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania mbikëqyrëse Hill International me datë 09.08.2018 ka kërkuar nga Ministri i Infrastrukturës i pandehuri P.L që të zbatohet neni 2 i ankes të kontratës, ashtu që të nxjerrët një ankes i ri ku do të përfshihet përveç kostos shtesë për zgjatje të afatit të kompletimit EoT edhe detaje se si do të implementohet pagesa e kostos shtesë. Po ashtu, të definojen edhe kërkesat e punëdhënësit, përkatësisht variacionet, në mënyrë që të mos mbeten çështje komerciale të pazgjidhura. Tutje, ka theksuar faktin se edhe pse kontraktori ende nuk ka dorëzuar ndonjë ankesë të detajuar lidhur me këtë, por vetëm njoftimin për ankesë, ashtu që në rast të dështimit të formalizimit të marrëveshjes mund të shpie kontraktorin në marrjen e vendimit për aplikim të ankesës në Gjykatë të Arbitrazhit (e njëjta me prove 5.12), e njëjta provë përmban opinionin e njëjtë sikur opinionet e elaboruara më lartë nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional. Nga kjo provë gjykata vërteton se kompania mbikëqyrëse Hill Internacional në çdo kohë e kishte njoftuar-*

paralajmëruar MI për ankesën e mundëshme të kontraktorit në Gjykatë të Arbitrazhit si në rastin konkret, por të pandehurit në këtë çështje penale e kanë krijuar vetë këtë verzion- në Arbitrazh, të pa mbështetur në as një provë të vetme.

3.3.30 Lexohet Ekspertiza Financiare, lidhur me projektin „Rruga 6 - Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit“, e datës 07.05.2021,

- *Nga administrimi i kësaj ekspertize gjykata ka vërtetuar faktin se nga konkluzioni i përgjithshëm i ekspertit del se projekti për Rrugën 6 Prishinë – Hani i Elezit është përcjell me pa-rregullsi të shumta si rezultat i menaxhimit jo të mirë nga ana e komiteteve drejtuese ndërmministrore. Projekti ka qenë i kontraktuar si projekt me ‘‘çelësa në dorë’’, pra ka qenë kontratë e tipit Llump Sum, qe të thotë se çmimi ka qenë fiks me mundësi të ankesës së kontratës deri 10% të vlerës së kontratës, ku nga kjo shumë 5% është lejuar për çmimin e tantumës dhe 5% në emër të punëve shtesë. Çmimi i kontraktuar ka qenë për tërë gjatësinë e autostradës duke përfshirë edhe tri tunele të cilat kanë qenë të përfshira në çmimin e kontratës, por të cilat tunele nuk janë realizuar dhe kjo çështje nuk është ngritur as nga kompania mbikëqyrëse Hill International , as nga NJIP, e as nga KDNM, e që do të thotë se projekti ka ndryshuar pa marrë miratimin nga komiteti. Sipas ofertës financiare FIN-3 kosotoja e tuneleve parashihet të jetë mbi 191 milion euro dhe projekti ka përfunduar pa tunele. KDNM që nga viti 2015, kishte filluar negociatat me kompaninë kontraktuese Bechtel & Enka për shtyrje të afatit për përfundim të punimeve dhe fillimisht ishin pajtuar për një shtyrje pa ndonjë kompensim, por marrëveshja nuk ishte arritur. Pas negociatave palët ishin dakorduar që shuma maksimale e kostos për shtyrje të afatit të punimeve për 11 muaj e 13 dite në emër të kostove indirekte kompensimi do të jetë 14.1 milion Euro, por edhe pse aneks kontrata ishte aprovuar në KDNM, ajo nuk kishte miratuar nga Qeveria e Kosovës me arsyetimin se kjo çështje ishte në kompetencë të KDNM-së. Më pas kërkesa kontraktorin Bechtel&Enka ka arrit ne 63 milion euro, por kjo shume e pretenduar nuk i referohet dispozitave të kontratës dhe kjo konfirmohet edhe nga kompania mbikëqyrëse "Hill Internatinal" e cila në të gjitha shkresat e saja kishte kërkuar nga KDNM që të refuzohet shuma e pretenduar pasi qe është konsideruar që shuma prej 14.1 milion euro është e vetmja shumë në emër të kostove indirekte që mund ti paguhet kontraktorit për zgjatje të afatit te punëve për 11 muaj e 13 dite përtej afateve të përcaktuara me kontratë sepse për këtë shume ishin rënë dakord edhe palët. Kryesuesi i Komitetit Drejtues Ndërmnistror ne kundërshtim me rregullat e projektit konkretisht Statutin dhe Kodin e Sjelljes në shtator 2017 se bashku me zyrtarin përgjegjës të prokurimit dhe me Sekretarinë Permanent nënshkruajnë marrëveshjen për shtyrje të afatit të*

punimeve pa përcaktuar koston financiare gjë që i ka hapur rrugën kompanisë kontraktues që të kërkojë kompensim prej 63 milion Euro edhe pse fillimisht ishte dakorduar që për shtyrje të afatit të punimeve në emër të kostove indirekte të kompensohet në shume prej 14.1 milion Euro. Kompania mbikëqyrëse e projektit "Hill International" në të gjitha opinionet e saj në veçanti në opinion e saj në dhjetor të vitit 2017 dhe gusht të vitit 2018 i kishte deklaruar se shuma e pretenduar nga kontraktori është krejtësisht e papranueshme, duke u bazuar në shkresa të lëndës fillimisht kompania mbikëqyrëse nuk e ka njohur as obligimin prej 14.1 milion Euro pasi që ka deklaruar se zgjatja e afatit nuk ka bëj me pune shtese por ka të bëj me zhvendosje të e projektit në kohe dhe njëkohësisht ka deklaruar se edhe përkundër shtyrjes se afatit për përfundim të punimeve deri me 31.12.2018, kompania kontraktuese nuk do të mund të përfundojë punimet dhe kjo ka ndodh pasi që punët në autostrade nuk kane përfunduar deri në fillim të Qershorit 2019 dhe për këtë KDNM nuk ka pas qasje në vendim edhe pse nën klauzula 8.7 e kushteve të kontratës e përcakton shumë që duhet kompensuar kontraktori ndaj punëdhënësit për shkak të vonesave për implementim të kontratës. Projekti ka pësuar ndryshime, por asnjëherë nuk janë pasqyruar dhe trajtuar ndryshimet në projekt, autostrada ishte parapa të ketë tunele, të ketë informim elektronik, sportele të pagesave, të ketë mure izoluese ndaj zhurmës etj. dhe në projekt nuk janë parapare kyqjet në Babush dhe Bibaj dhe nuk kane qenë të përfshira në projektin fillestar dhe për këtë kane qenë në njohuri Komitetet Drejtues Ndërministrorë. Edhe përkundër që rregullat dhe përgjegjësit për menaxhim të projektit kanë qenë të qarta, Kryesuesi i Komitetit Ndërministror se bashku me Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit dhe Sekretarin Permanent të MI kanë nënshkruar marrëveshje në kundërshtim të plot me rregullat e përcaktuar të projektit respektivisht Statutin dhe Kodin e Sjelljes me faktin se fillimisht për nënshkrim të marrëveshjes për zgjatje të afatit ishte dashur të merret miratim nga KDNM.

3.3.31 Nga leximi i komunikimeve elektronik në mes të pandehurit E.B dhe A.K, i datës 31.05.2018 dhe me datë 01.06.2018, si dhe nga leximi i shkresës të datës 22.09.2017 të pandehurit B.T.

- *Nga administrimi i kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 31 maj 2018 ka përcjellë një email tek Drejtori i Departamentit Ligjor A.K me subjekt: ‘memo shpjeguese për kërkesën e Bechtel – Enkes’, në të cilën email A.K, në të njëjtën ditë është përgjigjur se nuk mund të jep opinion sqarues lidhur me kontratën për ndërtimin e autostradës R6 Prishtinë – Hani i Elezit, pasi që asnjëherë nuk ka qenë pjese dhe nuk ka pasur qasje në atë kontratë, e as nuk ka njohuri të specializuara për atë kontratë, andaj opinionin sqarues duhet ta jep ai që ka pasur qasje në kontratë, për këtë edhe i është lutur që të i drejtohet menaxherit të*

kontratës dhe kompanisë mbikëqyrëse dhe ekipit që ka marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kontratës apo këshilltarit të transaksionit të angazhuar për negocimin dhe hartimin e kontratës. Nga kjo provë, gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 01 Qershor 2018 ka përcjellë një email tek Drejtori i Departamentit Ligjor A.K me subjekt: "Shkresa për opinionin ligjor", të cilit email ia ka bashkëngjitur edhe attachments: "Shkresa për ministrin – DL", dhe në atë email ka kërkuar përmirësime tek A.K, në po të njëjtën ditë ia përcjell përmes emailit opinionin sqarues ligjor(ora 12:23), si dhe opinionin ligjor(ora 16:04) në lidhje me marrëveshjen për zgjatjen e afatit të kontratës në mes të MI-së dhe Bechtel Enka, të pandehurit P.L(ish-ministër), duke mbajtur në Cc, të pandehurin E.B dhe N.SH, ku më në detaje këtë komunikime gjykata i ka vlerësuar më lartë.

Po ashtu, gjykata nga kjo provë ka vërtetuar faktin se Drejtori i Divizionit të Prokurimit – MI, B.T me datë 22.09.2027 ka dorëzuar një parashtrësë tek të pandehurit P.L dhe N.SH, protokoll për nënshkrimin e vazhdimit të kohëzgjatjes së afatit të kontratës për projektin: "Projektimi dhe nderimi i rrugës 6 Prishtinë – Hani i Elezit", ku ndër tjera ka shprehur se kjo kontratë është në pajtim të plotë me Ligjin e Prokurimit dhe se është e gatshme për nënshkrim nga ana e tyre.

3.3.32 Lexohen shkresat e drejtorit të departamentit ligjor A.K e datës 01.06.2018.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 01.06.2018 Drejtori i Departamentit Ligjor A.K ka dërguar përgjigje në kërkesë, i ka përcjellë tek hetuesi policor Aziz Sallahu dokumentacion siç janë cekur më lartë, po ashtu nga kjo provë vërtetuar faktin se Departamenti Ligjor i MI-se, e ka dhënë opinion ligjor lidhur me zgjatjen e afatit të kontratës në mes të MI-së dhe operatorit ekonomik Bectel & Enka, për ndërtimin e autostradës R6, Prishtinë-Hani i Elezit të datës 27.09.2017 nr.i prot.356/2017, ndërsa nuk kanë dhënë opinion ligjor, rreth ligjshmërisë për pagesën e shpenzimeve shtesë për ndërtimin e autostradës, rruga 6 Arber Xhaferi, Prishtinë-Hani i Elezit.

3.3.33 Lexohet Shkresa nr.7602, datë 07.08.2018, e zyrtarit policor -hetuesi Aziz Sallahu.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 07.08.2018, hetuesi policor Aziz Sallahu, ka kërkuar nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Infrastrukturës opinionin zyrtar rreth ligjshmërisë së projekt vendimit për pagesën e shpenzimeve shtesë të projektit për ndërtimin e autostradës R6.

3.3.34 Lexohet Vendimi i komisionit disiplinor me nr. 5308 nga ministria e MI-së, i datës 17.05.2019 ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së dëshmitarit A.K.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me Vendimin 01/5308 të datës 17.05.2019 i ka ndërprerë marrëdhënien e punës Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil A.Kt, me arsyetimin se i njëjti ka bërë shkelje serioze të detyrave të punës, meqë i njëjti nuk ka ndërmarrë masat e parapara sipas rekomandimeve të NJAB-së, e po ashtu nuk ka respektuar kërkesën e komisionit të emëruar me vendimin e datës 04.01.2019, Nr.prot:134(prova nr.11) të Sekretarit të Përgjithshëm të MIT lidhur me pranim dorëzimit të detyrës zyrtare dhe shkelje të kodit të mirësjelljes për shërbyesit civil, sipas vlerësimit të gjykatës kjo provë është relevante në këtë çështje penale.

3.3.35 Lexohet shkresa e kompanisë ndërtuese Bechtel&Enka, e datës 11.11.2015 me nr. Protokollit 5389, për pagesë të faturës së muajit shtator 2015 dhe kërkesës për ndarje të buxhetit shtesë për vitin 2015.

3.3.36 Lexohet shkesa e datës 15.02.2016 e Njësia për Implementimin e Projektit për projektin R6 drejtuar kryesuesit të KDMN-së .

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 15.02.2016 Njësia për Implementimin e Projektit të Autostradës R6(z.R.Q) ka përcjellë tek z.L.ZH me të cilën ka kërkuar që i njëjti të kërkojë nga Ministria e Financave mundësi për alokimin e mjeteve shtesë për ndërtimin e projektit: "Ndërtimi i autostradës R6" për vitin 2016, pasi që për vitin 2016 ka një mungesë prej rreth 67 milion euro nga kërkesa e MI-së dhe mungese prej 161.6 milion euro nga Plani i Shpenzimeve i propozuar nga BEGP. Kjo pasi që edhe plani i punës është në një fazë delikate, ku edhe konsorciumi Bechtel Enka ka bërë shkresë zyrtare për mundësinë e aplikimit të dënimeve, në rast se nuk rriten alokimet financiare për plotësimin e nevojave për implementimin e projektit. Po ashtu, kësaj prove i është bashkëngjitur edhe një komunikim elektronik i datës 17.12.2014 në mes të z.L.ZH dhe R.Q, ku z.L.ZH kërkon nga R.Q që t'i tregojë se sa është paguar gjatë vitit 2014 për autostradë(krahasuar me buxhetin e ndarë) dhe i njëjti i kthen përgjigje se: Buxheti i ndarë është 55.900.000,00, pagesat për vitin 2014 janë në shumë prej: 33.436.666,85 Euro dhe se mjete të lira janë: 22.463.333,15 Euro.

3.3 37 Lexohet shkresa e kryesuesit të KDNM-së Lufti Zharku drejtuar anëtareve të KDMN-së.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Kryesuesi i Komitetit Ndërministror për ndërtimin e autostradës Prishtinë – Hani i Elezit, i është drejtuar me shkresë anëtarëve të këtij komiteti, ku është shprehur se ndarjet buxhetore nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat e Bechtel Enkas duke krijuar një mungesë prej 217 Milion euro sipas buxhetit për vitin 2016 dhe e cila me rishikimin e buxhetit është zvogëluar në 177 milion euro, andaj edhe kanë kërkuar shtyrjen e afatit të punëve për 10 muaj nga 20.01.2018(sa ka qenë) në 30.11.2018, me qëllim që kjo shtyrje ti mundësojë Qeverisë financimin edhe të projekteve tjera. Për këtë është arritur pajtueshmëri e plotë edhe me kontraktorin Bechtel Enka me çka është lidhur edhe aneks-kontrata, e cila sipas Departamentit Ligjor të MI-së është në pajtim me ligjin në fuqi, rendin juridik dhe normat e moralit të shoqërisë.

3.3.38 Lexohet shkresa e kompanisë ndërtuese Bechtel&Enka e datës 20.09.2016 me nr. të protokollit 4377, si njoftim për kërkesë për kosto, profit të arsyeshëm në lidhje me propozimin për zgjatje të kontratës.

3.3.39 Shkresa e kompanisë mbikëqyrëse Hill International, e datës 30.09.2016, drejtuar kryesuesit të KDNM-së

- Pas administrimit të kësaj prove, gjykata ka vërtetuar faktin se kompania mbikëqyrëse Hill International ka përcjellur tek KDNM një shkresë me subjekt: “ Nën-artikulli 3.5 përcaktimi”, me të cilën shkresë ka njoftuar se data e përmirësimit për zgjatje të afatit për të cilin palët kanë rënë në ujdë është caktuar të jetë 31.12.2018(pra zgjatje e afatit për 347 ditë) dhe se kjo datë do të përfshihet në aneksin e ardhshëm. Si pasojë e zgjatjes së afatit, do të paraqiten kosto të reja, si: kostot indirekt apo margjina e fitimit, zgjatja e afatit të sigurimit dhe 18% TVSH, e që kalkulimi i këtyre 3 pozicioneve përfshinë shumën prej 14,778,654.87 Euro.

3.3.40 Lexohet procesverbali i KDNM-së, i datës 22.09.2016.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 22.09.2016 është mbajtur takim nga Komiteti Drejtues Ndërministror për Autostradën R6, Prishtinë – Hani Elezit, në të cilin takim është diskutuar rreth aneks kontratës: “Projekti për dizajnimin dhe

ndërtimin e autostradës Prishtinë – Hani i Elezit me konzorciumin Bechtel Enka'', dhe me vendimin e datës 30.09.2016 është aprovuar aneks-kontrata dhe i është rekomanduar Qeverisë së Kosovës të miratojë këtë vendim.

3.3.41 Lexohet shkresa me nr. Prtokoli 3196/3, e datës 07.12.2016.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtori i SKQ-së/ ZKM²³, ka përcjellur shkresën me nr.prot 3196/3 e datës 07.12.2016 te Ministria e Infrastrukturës, me të cilën i ka njoftuar se Zyra e Kryeministrit ka shqyrtuar kërkesën e tyre për procedim të mbledhjes se Qeverisë lidhur me propozimin për aprovimin e Aneks Kontratës për projektin R6 sipas vendimit të KDNM-së të datës 30.09.2016, dhe ka ardhur në përfundim se KDNM të kryej detyrat dhe përgjegjësit në pajtim me mandatin e tij dhe me legjislacionin në fuqi, duke vlerësuar se Qeveria nuk ka nevojë të ndërhyjë në punën e Komitetit.

3.3.42 Lexohet shkresa e kompanisë mbikëqyrëse Hill International, e datës 21.06.2017 me nr. 51/31.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania Mbikëqyrëse Hill International ka përcjellur tek Ministri i MI z.L.ZH shkresën e datës 21.06.2017 me të cilën e ka njoftuar se fondet e tanishme të buxhetit të Qeverisë do të mjaftojnë për punët deri në fund të muajit Korrik 2017, ndërsa nuk do të mjaftojnë për muajt në vijim dhe se mungesa e fondeve të gatshme krijon një rrezik për punëdhënësin nëse kontraktori involvon klauzolën e pezullimit të punimeve e cila do t'i jepte të drejtë për të kërkuar koston dhe kohën sipas klauzolës SC 20.1. Me çka është lutur mirësisht që të marrin këto çështje në konsideratë me rastin e alokimit të fondeve shtesë në mënyrë që të mundësohet vazhdimi i papenguar i punës së kontraktorit.

3.3.43 Lexohet shkresa e operatorit ekonomik Bechtel & Enka e datës 26.02.2017.

3.3.44 Lexohet shkresa e operatorit ekonomik Bechtel&Enka e datës 19.04.2017, me nr. 3267.

²³ Zyra e kryeministrit-(Në tekstin e mëtejme ZKM),

3.3.45 Lexohet shkresa elektronike e të pandehurit E.B, cc. P.L dhe N.SH, e datës 27.12.2017, drejtuar R.Q, si dhe lexohet përgjigjja e R.Q, e datës 28.12.2017.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 27.12.2017 ka dërguar email tek R.Q me subjekt: "Opinionin e Njësisë Menaxhuese të Projektit R6", me të cilën email ka kërkuar një opinion nga ai si kryesues i NJIP, lidhur me njoftimin e kontraktorit për ndërtimin e autostradës R6 sa i përket kostos së ndërtimit për periudhën shtesë të zgjatjes së afatit kontraktues, duke marrë për bazë edhe mendimin e kompanisë Hill International si mbikëqyrës të kontratës. Lidhur me këtë kërkesë, z.R.Q ka kthyer përgjigje me emailin e datës 28.12.2017 ku në kuadër të opinionit të kërkuar ka vlerësuar se zgjatja e afatit të përfundimit të kontratës ka kosto dhe kjo vlerë e koston duhet të definohet në bazë të dokumenteve të cilat janë në dispozicion. Sipas vlerësimit të gjykatës kjo provë vërteton dijeninë e të pandehurit E.B për opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, që është dërguar në MI, me datë 21.12.2017, ku i njëjti e mohon se e ka pranuar këtë opinion, ndërsa nga përmbajtja e kësaj shkrese vërtetohet se e dinë përmbajtjen e këtij opinionin, por i njëjti nuk u bazuar në të gjatë këtij procesi, këtë e ka pasur si sugjerim nga dëshmitari R.Q si " se zgjatja e afatit të përfundimit të kontratës ka kosto dhe kjo vlerë e koston duhet të definohet në bazë të dokumenteve të cilat janë në dispozicion", siç është përcaktuar në opinionin e Hill Internacional.

3.3.46 Lexohet shkresa elektronike nga i pandehuri E.B për të pandehurin N.SH,Cc; R.Q, A.Z, dhe i pandehuri P.L, e datës 26.12.2017.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari E.B me datë 26.12.2017 i është drejtuar me email të pandehurit N.SHt duke mbajtur në Cc: R.Q, A.Z dhe të pandehurin P.Ll me subjekt: "Takim koordinues", ku i ka njoftuar të pandehurin N.SHn dhe R.Q se me kërkesë të ministrit të pandehurit P.L janë caktuar si anëtar të ekipit për vlerësimin e ndikimi të zgjatjes së afatit të kontratës me operatorin ekonomik Bechtel Enka dhe se takimi koordinues do të mbahet të nesërmen pas mbledhjes së stafit të MI-së në zyrën e sekretarit.

3.3.47 Lexohet shkresa elektronike nga R.Q, drejtuar A.Z, N.SHt, P.L, Xhavit Aliaj, Fatos Mani dhe E.B, e datës 18.01.2018.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 17.01.2018, i pandehuri N.SH i është drejtuar me email z.R.Q nga i cili ka kërkuar që të përgatitet përgjigja për pyetjet

e mëposhtme, duke e njoftuar se kërkesa vjen nga Kabineti i Ministrisë dhe është urgjente, ndërsa R.Q me datën 18.01.2018 i është drejtuar me email A.Z dhe N.Sht duke mbajtur në Cc: Xhavit Alijaj, E.B, Fatos Mani dhe Pjetër Ndou, të cilës email i ka bashkëngjitur sqarimet e kërkuara dhe raportin përmbledhës të kompanisë mbikëqyrëse dhe ku është shprehur se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka miratuar koston e propozuar nga ana e Konzorciumit Bechtel Enka dhe përveç pagesave të rregullta, sipas kushteve të kontratës, nuk ka asnjë lloj pagesa për koston e vazhdimit të kontratës, nga kjo provë vërtetohet se të pandehurit N.SH dhe E.B kanë qenë të njoftuar me raportin përmbledhës të kompanisë mbikëqyrëse.

Po ashtu është vërtetuar fakti se se Armend Ademaj i është drejtuar me email Tringa Shkodra të cilën e ka njoftuar se ftohet ministri P.L që të raportojë në Komisionin funksional për zhvillim ekonomik me datë 23.01.2018 ora 11:00 për të raportuar për pretendimet për penale të kontraktuesit Bechtel Enka ndaj Qeverisë së Kosovës, që kanë të bëjnë me ndërtimin e autostradës Arben Xhaferi.

3.3.48 Lexohet shkresën elektronike nga i pandehuri E.B, drejtuar shefit të kabinetit A.Z, në Cc; i pandehuri P.L, Tringa Shkodra, B.A A.Kj, e datës 19.01.2018

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me datë 19.01.2018 i ka dërguar email A.Z në të cilin email ka bashkëngjitur dy draft raportet për të dy pyetjet e parashtruara nga Komisioni parlamentar për ministrin.

3.3.48 Lexohet shkresa përfundimtare e kompanisë mbikëqyrëse Hill International, e datës 09.08.2018, me nr.prot. 7705, e datës 10.08.2018.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Kompania Mbikëqyrëse Hill, duke vepruar sipas kërkesës së Ministrisë P.L, ka paraqitur opinionin e saj lidhur me marrëveshjen për çështjet e ndërlidhura komerciale nga zgjatja e dhënë e afatit për përfundimin e punimeve, ku ndër tjera ka shprehur se duke marrë parasysh presionin kohor është nevoja për zgjidhje urgjente përmes një aneksi të kontratës i cili duhet të përfshijë, edhe detaje se si do të bëhet pagesa e kësaj shume dhe të mos lihen çështje të hapura komerciale të pazgjidhura. Kjo pasi që dështimi për të zyrtarizuar një marrëveshje për zgjatjen e afatit të përfundimeve mund të rezultojë në invokimin e kontraktorit të klauzolës SC 20.1, të cilat pothuajse drejtpërdrejtë dërgojnë në arbitrazh sipas SC 20.6, sipas vlerësimit të gjykatës kjo provë është pas marrjes së vendimit për pagesën prej 53 milion euro.

3.3 .50 Lexohet komunikimi i datës 04.06.2018 nga Tringa Shkodra tek anëtarët e KDNM.

- Pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se z.Tringa Shkodra me datë 04.06.2018 ka përcjellur materiale shtesë për takimin e të nesërmes, i cili ka qenë vazhdimësi i takimeve të fundit 31.05.2018 dhe 01.06.2018

3.3.51 Lexohet komunikim elektronik nga A.Z, drejtuar Tringa Shkodra dhe B.A A.Kj, e datës 05.06.2018, ora 08:22.

- Nga administrimi i kësaj prove, gjykata ka vërtetuar faktin se A.Z me datë 05.06.2018, ora 08:22 i është drejtuar Tringa Shkodra dhe B.A A.Kj, me shkresë elektronike, ku në Cc është edhe i pandehuri E.B me të cilin i ka njoftuar se po atë ditë prej ore 11:00 është takimi i KDNM për projektin R6 i cili takim është paraparë të mbahet në Kabinetin e Kryeministrit R.H, me çka i ka lutur që ti printojnë materialet në 6 kopje nga një për secilin anëtar, plus kryeministri.

3.3.52 Lexohet shkresa elektronike nga E.B tek B.A A.Kj,në kopje A.Z, e datës 05.06.2018, bashkë me draft dokumentet për nënshkrim të ministrit.

3.3.53.Lexohet shkresa elektronike nga E.B tek N.SHt, të datës 05.09.2018, në kopje P.L, Argjend Zenaj, R.Q, Nexhat Krasniqi.

3.3.54.Lexohen shkresat e kompanisë mbikëqyrëse Hill International, të vitit 2016 dhe 2017, të gjitha janë vlerësuar në detaje më lartë.

3.3.55.Lexohet emali zyrtar nga George Papaioannou i datës 09 gusht 2018 është nga e cila i drejtohet ministrit P.L në CC Ramë Qupevës.

3.3.56.Lexohet emali zyrtar nga George Papaioannou i drejtohet ish ministrit L.ZH.

3.3.57.Lexohet Vendimi Nr. Prot. 6147/2017 i Ministrisë së Infrastrukturës, i datës 31.07.2017.

- Nga administrimi i kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Ministria e Infrastrukturës me datë 31.07.2017 ka nxjerr vendimin me nr.01/6147 me të cilin i pandehuri B.T i sistemuar në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për pyetës në Departamentin e Patent Shoferit, është transferuar në

pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit në kuadër të Departamentit të DFSHP-së, ashtu që transferimi do të bëhet nga data 01.08.2017, meqë i njëjti është duke ushtruar këtë detyrë nga data 20.04.2016 në bazë të vendimit nr.1980/2016.

3.3.58 Lexohet Vendimi Nr. Prot. 7767/2017 i Ministrisë së Infrastrukturës, i datës 10.10.2017.

- *Nga administrimi i kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Ministria e Infrastrukturës me datë 10.10.2017 ka nxjerr vendimin me nr.01/7767 me të cilin ka shfuqizuar vendimin me numër prof.6147/2017 të datës 31.07.2017, me të cilin B.T është transferuar si Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit, ashtu që i njëjti vazhdon ti kryej detyrat dhe përgjegjësit e veta si Udhëheqës i Divizionit për Pyetes në Departamentin e Pantet Shoferit sipas akt emërimit.*

3.3.59. Lexohet Kërkesa Nr. 91/2016 për interpretimin e dispozitave të kontratës për “Ndërtimin e Autostradës Route 6 Prishtinë – Hani i Elezit”, e paraqitur nga B.T me datë 21.07.2016, në drejtim të z. Safet Hoxhës, Kryetar i Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik - KRPP.

- *Nga administrimi i kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se B.T Tahiri me datë 21.07.2016 ka paraqitur kërkesë për interpretim të dispozitave të kontratës për ndërtimin e autostradës 6 Prishtinë – Hani i Elezit tek Kryetari i KRPP-së Safet Hoxha, me të cilën kërkesë ka kërkuar që të interpretohen dispozitat e kontratës bazë dhe aneks kontratës për projektin:’’ Ndërtimi i autostradës R6 Prishtinë Hani i Elezit, sa i përket nën-klauzolave 1.1.3.3 dhe nënklauzolave 8.2 të kontratës dhe nenit 40 të aneks kontratës: Kërkesat e punëdhënësit, materialet ndërtimore dhe zonat e shfrytëzimit të materialit ndërtimor.Ndërsa përgjegjja është vlërsuar më lart.*

3.4. Mbrojtja e të pandehurve

3.4.1 I pandehurit **P.L** në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 14.12.2023, dhe me datë 05.12.2023, në mbrojtjen e tij ka deklaruar, unë kam marr mandatin si ministër i Qeverise se Kosovës në MI me datë 09.09.2017, dhe kam qëndruar deri ne janar të viti 2020, ku prej qershorit kam qene UD meqë Qeveria ka dhënë dorëheqje, e që në marrjen e mandatit tim jam informuar për projektet që janë në vazhdimësi dhe për projektet që kane përfunduar, për projektin R6 Prishtine - Hani i Elezit, nuk jam informuar për problemet që ekzistojnë dhe për detyrimet që i ka MI, dhe Qeveria e Kosovës, pas informimit nga zyrtaret që janë marrë me këtë projekt pas një jave që mund ta veçoje kryesuesin e njësisë implementuese R.Q, jam njoftuar që projekti F6 Prishtine- Hani i Elezit është në rrezik që të ndërpritet meqë MI nuk i ka kryer obligimet ndër

vite, meqë kontrata është ligj dhe dallon kontrata kjo kontrate meqë është e fidikut punëdhënësi dhe pune marrësi kane detyrimet e veta, kur jam njoftuar me problemin ekzistues dhe rrezikun e ndërprerjes se kontratës kam dalur menjëherë në teren dhe e kam parë që i tërë projekti që dikund 67 km, janë kane për 3 vite të ndërtuara vetëm 10 km dhe një pjese e trasesë që ka qene e hapur por që mund të them se as 25 % të punës që është dashur me u kry nuk janë kryer dhe jam bind që ish Qeveria e Kosovës dhe MI kanë dështuar në implementimin kontratës në bazë të detyrimeve që i ka pasur kontrata për dy palët, e kam parë atë gjendje kam kontaktuar me punë kryesin përfaqësuesin Riad- in Bechtel Enka, dhe jam ve në dijeni për rrezikun e ndërprerjes se kontratës dhe shkuarjes në arbitrazh, pas konsultimit me zyrtaret në MI dhe konsultimin e kontratës se cilat janë detyrimet apo obligimet e punëdhënësit atëherë ka qene e vetmja zgjidhje s’kemi pasur alternative sepse është diskutuar mjaft gjate përpos që të vazhdohet në mënyrë urgjente kontrata apo të merret vendimi për ndërprerjen e rrugës që kishte me i kushtua me shuma marramendëse buxhetit të konsoliduar të Kosovës, atëherë në konsulta me njësinë implementuese, me zyrën e prokurimit, me zyrën ligjore në MI, me opinionin e KRPP-se, që të gjitha opinionet me kane sugjeruar që të nënshkruajë një kontratë të tillë pa kosto, pasi që zgjatja e kontratës ka qene e diskutuar edhe në ish Qeverinë dhe në komitetin ndërministror është marrë një vendim unanim për zgjatjen të kontratës por nuk është firmosur nga ish komiteti nder qeveritar atëherë, kam vendosur që të nënshkruajë një kontratë të tillë që mos ta dëmtoje me shume buxhetin e Kosovës, se ajo që kam komunikuar me Bechtel Enka me është bërë e qarte që nëse nuk vazhdohet kjo kontrate çështja për ta zgjidhur mos pajtimin mes dy palëve duhet që të shkohet ne arbitrazh të cilën e cakton edhe kontrata, dhe sugjerimet e para që i kam pasur kane qene që vetëm fillimi për të shkuar në arbitrazh qeverise do ti kushtojë hiq me pak se 7 milionë euro vetëm për të filluar procedurat dhe kështu që e kam nënshkruar këtë kontrate dhe pastaj kemi negociuar me Komitetin Ndërministror sa i përket çështjeve të hapura apo kërkesës se Bechtel Enka, ashtu që në takimin e parë në Komitetin Ndërministror që e kam udhëheq unë si ministër e kemi debatuar këtë teme me rëndësi të veçantë për Kosovën dhe buxhetin e saj, është e vërtetë që nuk kanë pasur dokumente të bollshme, kane kërkuar që për mbledhjen e ardhshme ti furnizojë me gjitha dokumentet përkatëse dhe ti analizojmë dhe kështu që pas furnizimit me gjithë dokumentacionin që ka qenë i listuar një nga një, çdo dokument që ka marre një ministër dhe anëtarë i komitetit e kemi diskutuar në mbledhjen e dyte dhe ka qenë një propozim pas këtyre konsultave që ta ftojme në komitete ndërministror përfaqësuesin e Bechtel enkes, e kemi ftuar, kemi diskutuar duke filluar nga ana ime ekzistojnë edhe procesverbalet dhe deri te i fundit anëtarë i komitete kemi dhënë opinionet tona dhe kemi përfunduar takimin pa ndonjë vendim, pas lëshimit të takimit nga Bechtel Enka, prape jemi konsultuar dhe kemi vendosur propozimi i

anëtareve të Komitetit Ndërministror ka qenë e që të komunikohet me Bechtel Enka, me ndihem e këshilltarëve dhe kemi propozuar që gjithë ministrat ti dërgojnë këshilltarët të komunikojnë me Bechtel Enka, ku më kujtohet që MTI ministri B.H, e ka deleguar por për tjerët nuk e di nuk me kujtohen, më pas më është kërkuar nga Komisioni për Ekonomi Tregti dhe Industri dhe Inovacion, që të raportojë për komisionin për çështjen në fjale, kemi qenë në komision dhe kemi raportuar afërisht 2 ore dhe është diskutuar mjaft dhe jemi munduar në mënyrën me të sinqertë që deputete të parlamentit të Kosovës me pozite e opozitë ti njoftojmë nga afër për gjendjen krijuar jo të mire për Kosovën dhe pas debatit dhe kane kërkuar që të debatohet edhe në parlament, ka raportuar ish kryeministri Haradinaj afërisht 3 ore në parlament, është debatuar dhe kam qene edhe unë prezent në atë seance dhe Haradinaj në fjalën mbyllëse të raportit iu ka drejtuar deputeteve të parlamentit të Kosovës që nëse keni ndonjë mendim ndryshe nga ajo që kam thënë po e qesim në votim, ka mbetur vetëm sa i përket kësaj çështje, pastaj kemi filluar procedurën ne kemi mbajtur edhe 2 mbledhje të KDNM-së dhe kemi vendosur që të marrim një vendim që çështja të kalojë për aprovim në Qeverinë e RKS-së meqë buxheti ndër vite, në vitin e parë ka qene i mangët që nuk është alokuar 40%, në vitin e dyte 47% dhe vitin e trete 35 % , dhe ajo që është thënë këtu që kemi qene brenda afatit nga ish ministrit Zharku nuk qëndron, sepse vetëm 20% të punëve të kryera kanë ekzistuar dhe kontrata ka qenë vetëm edhe 3 muaj dhe kjo me përgjegjësi të plotë morale e them që sot po ky Pal, bashke me të akuzuarit për mos veprim ishim para jush dhe me dëme tepër me të mëdha sepse nëse dikush vetëm e ka lexuar historiatin e kompanisë Bechtel enka, e shihni qarte se çfarë kompanie serioze është dhe sa arbitrazhe i ka fituar mund të ja përmend shembull Kroacia 70 milionë, Rumania përmbush 800 milionë, dhe shume vende tjera dhe ne duke u bazuar në këtë ka kërkuar kryeministri me kabinetin e tij që të mblidhemi dhe të komunikojmë direkt me kryeministrin dhe Komiteti Ndërministror, ku kemi pasur debat dhe është kërkuar Opinioni Ligjor në kuadër të MI dhe është kërkuar komplet para procedimit listimi i dokumentacionit që dërgohet në Qeveri duke përfshi opinionin ligjor dhe atë brenda 24 orëve, dhe këtë e kemi bërë pa presion, me vjen keq nuk kam komunikuar me askënd as verbalisht as në zyre sa i përket presionit ndaj zyrtareve, por e kemi marre opinionin dhe çështja me tërë dokumentacion është miratuar në komitete unanimisht dhe është dërgua për aprovim në qeveri dhe po ashtu është miratuar unanimisht pa asnjë vërejtje, atëherë jemi detyruar nga vendimi i Qeverisë, Ministria e Financave që të sigurojë të holla që të paguajë shume 53.1 milion, ajo që është dashur për të vepruar dhe ndihem krenare që jam këtu para jush për të sqaruar veprimet e mija dhe jo atëherë për mos veprim dhe mos pune të ballafaqohem me ju para qytetareve, pasi që kontrata është nënshkruar ne vitin 2014 dhe që në start nuk ka pasur mbështetje financiar kjo kontrate ndër vite dhe me çudit fakti të gjithë e kane

dit edhe ish kryeministri edhe ministri i Financave dhe Zharku që kane obligime ndaj kontratës për të mbështetur sepse janë zotuar dhe ka ndodhë e kundërta, çuditë se kane zhvilluar projekte tjera që kane penguar zhvillimin e kësaj kontrate që në logjiken time është e pa pranueshme, sa i përket vonesave ka pasur vonesa të theksuar të pagesave për të përfunduar ky projekt madhor, për vitin 2014 planifikimi ka qene 70 milion euro janë alokuar 55 milion, për vitin 2015 kane qene të planifikuara 220 milion, janë alokuar 112 milion d.m.th. 50 % me pak, për vitin 2016 kane qene të planifikuara buxhet 205 milion ndërsa janë alokuar 159.777 milion, gjendja ka ndryshuar në fund të vitit 2017 meqë ne kemi planifikuar në bazë të punëve që janë kryer kemi bere një analize buxhetore, kane qenë të planifikuar 104 milion janë alokuar- janë paguar 179 milion, që totali ka qene 502 milion, prej asaj që kontrata ka qene 600 milion prej vitit 2014 deri në fund të vitit 2017 dhe ajo që kemi vërejtur nuk ka qenë planifikuar fare që të përfundojë kontrata nga ish qeveria, më pas deklaroi se ka pasur njohuri që është diskutuar për një aneks kontrate e vitit 2016 dhe nuk është miratuar asnjëherë dhe çështjet i kane lënë në mjegull dhe mund të them patatën e nxehtë kemi marre ne, kur e kemi vërejtur se nuk ka as për se afërmi buxhet për të përmbyllur këtë kontrata është dashur me bisedua me ministrin e financave dhe kryeministrin, ata që kane të bëjnë me vija buxhetore që mos të mbyllet kontrata pas aneks kontratës apo shtyrjes se afatit prej 11 muaj , kemi marre nga buxheti i Kosovës 67 milion afërsisht, ndërsa nga AKP 50 milion për të përmbushur kontratën për të implementuar projektin në tërësi, pasi që sa i përket mos pagesës apo mos kryerjes se obligimeve ndaj kërkesës se Bechtelit çështja kishte shkuar në arbitrazh, ndërsa sa i përket kontratës se Qeverise dhe MI me kompanitë këshillëdhënëse Hill International, kam qene i njoftuar dhe kam kontaktuar në vazhdimësi sepse ai ka qene i punësuar me kontrate në vlere prej 7 milion dhe nuk e kam nënshkruar unë atë kontrate dhe e kam gjetur dhe konsullta që e ka dëshmuar dëshmitari dje ka qenë të vazhdueshme pa presione dhe në të mirë të zhvillimit të projektit sepse është diskutuar mjaft se kinse Hill ka qenë Qeveri dhe ministri, dhe ai është dashur të vendose për çështje të pagesës, nuk është ashtu, e them me të drejte ligjore dhe morale mund ta shikoni në kontrate dhe nuk mundet një punëdhënësi që te jete mbi qeverinë dhe ministrinë, ai ka kryer obligimet ndaj kontratës dhe kualitetin e punës sa është zhvilluar projekti dhe sa është zbatuar kontrata, ka qenë në kordinim me njësinë implementuese dhe ka dhënë raporte çdo 28 dite, e them para qytetarëve se kurrë dokument të Hill nuk kam poseduar në dore sa i përket pozicionit të tij, se nuk duhet paguar këto pozicione e kemi opinionin e Hill- it se nuk kam kohe të mjaftueshme për të dhënë një opinion sepse del jashtë kontratës time ku e tha përfaqësuesi i Hill- it, se asnjë opinion i tij nuk ka qene detyrues ndaj qeverise, për çështjet e kontratës po, por jo me marr vendim ekzekutiv dhe me marr vendim në emër të Qeverise së Kosovës, e them ka qenë i punësuar në MI me një

kontratë që mbikëqyrë projektin dhe jo të jep opinione sa i përket marrëveshjes apo aneks kontratës sepse ka dalë jashtë domenit apo kompetencave që i ka pas, ndërsa, opinionin e vitit 2017 është pranuar pranë kabinetit por unë personalisht nuk e kam pas dhe çdo dokument që është arkivu kanë qenë të obligueshëm me ma dorëzua, i njëjti nuk ka shkua nëpërmes arkivës por nëpërmes zyrtarëve, sipas tij çmimi prej 14.777 milion ka qenë vetëm për zgjatjen e afatit, marrëveshja ka qenë për zgjatjen e afatit por jo për kost benefitet, po ashtu deklaroi se Qeveria çdo kohe ka mujt me tërheq vendimin dhe mos me aprovua rekomandimin Komitetit Ndërmnistror dhe me shku çështja në arbitrazh, më pas deklaroi se sa i përket detyra si ministër ka filluar me datë 9 Shtator 2017, dhe në bazë të vendimit të Qeverisë së RKS , ka qenë në vazhdimësi e formimit të Komitetit ndërmnistror që çdo herë ministri ka qenë kryesues i këtij Komiteti, Komiteti është përbërë nga 5 ministra, asnjë dokument tjetër nuk e kam pas, nuk ka pas status dhe kodë të komitetit ndërmnistror, por jam nisur nga praktika e mëparshme të komitetit ndërmnistror se si funksionon dhe cilat punë i kryen, është bërë koordinimi i projektit në fjalë, rruga “R6 Arben Xhaferi”, Prishtinë- Han i Elezit, prandaj sa i përket autorizimit të këshilltarëve politik si E.B, në takim të komitetit janë caktuar që çdo ministër ta dërgoj një këshilltar politik për të biseduar çështjen dhe të na informojnë qartë kërkesat e menaxherit të projektit z.Riad, të mbledhin informacione kaq, pasi që i njëjti në një takim të komitetit na kanë shpjeguar në mënyrë detale me pozicione dhe ka kërkuar që të kemi mirëkuptim përndryshe do të ndjek rrugën e padisë, po ashtu sqaron se sa i përket kosto që nuk është vendosur në marrëveshje, unë e kam vlerësuar se është në kontratë kosto për zgjatjen e afatit dhe për mua ka qenë 1.1 milion në interval kohor për 11 muaj e 20 ditë dhe nuk kemi mujtë me dalë jashtë asaj dhe këtu është bazuar krejt esenca dhe si përfundim po e them kjo nuk e ka mbyllë problemin, për këtë unë kam marrë opinion nga zyra e prokurimit publik brenda ministrisë MI, se a kam të drejtë të nënshkruaj një kontratë pa kosto, dhe më është thënë po, këtë ma ka thënë shefi i zyrës së prokurimit publik, kanë qenë tri opinione i KRPP-së, i zyrës ligjore dhe i prokurimit publik, si dhe shton se nuk kamë pas as një informacion për presion në dëshmitarin A.K. Ndërsa në mbrojtjen e tij në fazën e hetimeve me datë 02.12.2021 në PSRK, ka deklaruar se të gjitha pagesat për kompaninë ndërtuese janë bërë në harmoni me rregullat dhe kontratat e nënshkruara në mes të qeverisë dhe kompanisë ndërtuese, ndërsa pjesët tjera të mbrojtjes së pandehurit në fazën e hetimeve në deklaratat në prokurori dhe në polici me datë 05.10.2020, janë të njëjta me mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

- *Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit të lartcekur, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se i pandehuri P.L, pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27 Shtator 2017, me*

Bechtel Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën R6 Prishtinë-Hani i Elezit, krejt kjo ka ndodhur pasi që është informuar nga kryesuesi i njësisë implementuese R.Q, që projekti është në rrezik që të ndërpritet meqë MI nuk i ka kryer obligimet ndër vite ndaj Bechtel enkes, sipas gjetjeve të gjykatës këtë mbrojtje i pandehuri P.L ska mundur ta vërtetoj me as një provë të vetëm -faktur që qeveria e Kosovës i ka mbet borxh Bechtel enkes, nga kjo mbrojtje vërtetohet se i pandehuri ka kontaktuar me punë kryesin përfaqësuesin Riad të Bechtel Enka, dhe është vë në dijeni për rrezikun e ndërprerjes së kontratës dhe shkuarjes në arbitrazh, atëherë në konsulta me njësinë implementuese, me shefi i zyrës së prokurimit publik, me zyrën ligjore në MI, me opinionin e KRPP-se, që të gjitha opinionet i kane sugjeruar që të nënshkruajë një kontratë të tillë pa kosto, nga kjo mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme, në kundërshtim me rregullat e prokurimi publik pasi që as një dispozitë nuk e njeh nënshkrimin e marrëveshjes -aneks kontratës apo kontratës pa koso financiar, e në mungesë së këtij elementi e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, po ashtu ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrimin e marrëveshjes së njëjtë, pasi që vendimet për këtë projekt ka qenë kompetent ta marrin anëtarët e KDNM, duke u bazuar në Statusin e Kodin e KNDM, e jo i pandehuri i lartcekur, ndërsa sa i përket mbrojtjes se kjo çështje do të shkoj në arbitrazh nuk është vërtetuar me as një provë të vetme, çoftë ekspertizë profesionale apo të ngjashme, të pandehurit i është kërkuar nga gjykata që ta deponon ndonjë provë-shkresë me njoftimin se kompani Bechtel enka a ju ka njoftuar që do ta dërgoj këtë çështje në arbitrazh, i pandehuri P.L është përgjigjur se nuk kemi as një shkresë për këtë çështje, por vetëm verbalish na kanë thënë përfaqësuesi i Bechtel enkes, andaj sipas gjykatës fjalët e thëna ta pa deponuar në letër nuk e kanë rendësin e provës në çështje penale, nga mbrojtja e të pandehurit gjykata vërteton se i kanë mbajte mbledhjet në takimet e KDNM, i ka njoftuar anëtarët e KDNM për kërkesën e Bechtel enkës, në mbledhjen e dytë ka qenë prezent përfaqësuesin e Bechtel enkes, ka prezantuar kërkesën, më pas kanë vendosur të gjithë ministrat anëtarë të KDNM ti dërgojnë këshilltarët të komunikojnë me përfaqësuesin Bechtel Enka për ti kuptuar më qartë kërkesën e tij, ku është autorizuar edhe këshilltari politik E.B, sipas gjetjes së gjykatës kanë vazhduar veprimet e kundërligjshme të pandehurit P.L, ka autorizuar të pandehurin E.B për të bërë negociata me përfaqësuesin Riad të OE Bechtel enkes, në kundërshtim me detyrat dhe kompetencat e tij, duke anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse Hill Internacional, e paguar nga Qeveria e Kosovës në vlerë 8 milionë, pasi që ka pas mungesë të kuadrave profesionale brenda MI, kjo kompani e ka mbikëqyrë këtë projekt, ka bërë vlerësimin e punëve në teren, vlerësimi i cilësisë, certifikim

i çdo fature të operatori ekonomik Bechtel Enkës për pages në MI, e në rastin konkret vlera e lartë prej 53 milion nuk është certifikuar nga kjo kompani, pasi që këtë e ka penguar i pandehuri P.L ku vet e deklaroi se kjo kompani nuk është mbi qeverinë dhe ministrin vetëm e ka rolin e punëkryerësit dhe asgjë më shumë, po ashtu nga mbrojtja e të pandehurit vërtetohet se kanë vazhduar mbledhje KDNM, sipas gjetjes së gjykatës të pandehurit P.L dhe E.B në vazhdimësi kanë prezantuar para anëtarëve të KDNM verbalisht fakte të pavërteta të pa bazuar në prova duke cituar se duhet të veprohet me urgjencë në të kundërtën do të shkojmë në arbitrazhe dhe dëmet për shtetin e Kosovës do të jenë marramendëse, në këtë mënyrë kanë krijuar frik dhe panik tek anëtarët e KDNM, pasi që të njëjtit janë në dëgjuar në këtë çështje penale se cili veç e veç ka deklaruar se si ju është prezantuar gjendja se të veprohet apo të shkojmë në arbitrazhë, rrethana këto të pa bazuar me realitetin që ka ekzistuar në të vërtetë, në këtë presion anëtarët e KDNM kanë vendosur që të marrim një vendim që çështja të kalojë për aprovim në Qeverinë e RKS-së, ku brenda ditë me një urgjencë të pa nevojshme është aprovuar nga qeveria e Kosovës, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës ka qenë një procesi i kundërligjshëm për realizimin e qëllimeve të pandehurve P.L dhe E.B, me çka është dëmtuar buxheti i shtetit në vlerë prej 38 milion euro, pasi që vetëm vlera prej 14.778 milion euro kanë qenë të bazuar sipas opinionit të kompani Hill Internacional, më pas në mbrojtjen e tij i pandehuri ka deklaruar se kurrë dokumente të Hill nuk ka poseduar në dorë as opinionin e vitit 2017, nuk është pranuar pranë kabinetit, personalisht nuk e ka pa dhe se opinion Hill Internacional nuk ka qenë detyruar ndaj qeverisë, pasi që Hill ka qenë i punësuar në MI me një kontratë që mbikëqyrë projektin dhe jo të jep opinionet sa i përket marrëveshjes apo aneks kontratës sepse ka dalë jashtë domenit apo kompetencave që i ka pas, si në rastin konkret, gjykata gjen se pretendimi i mbrojtjes së pandehurit se nuk e ka pa opinionin e Hill, nuk qëndrojnë, pasi që nga momentit i fillimit të punës i pandehuri në pozitën e ministrit në MI, me të kuptuar rëndësinë e kompanisë Hill në këtë projekt në mënyrë kundërligjore e ka anashkaluar, nuk është konsultuar me kompaninë mbikëqyrëse në kohën e lidhjes së marrëveshjes, lenë për të kuptuar se ky personalisht nuk është konsultuar me opinionet e Hill Internacional të vitit 2017, të njëjtin e ka fshehur, pas që mënyra se si ka kërkuar i njëjti opinion të dërgohet në kabinetin e tij nga përfaqësuesi i Hill Internacional, nuk i ka njoftuar asnjëherë anëtarët e KDNM, për rëndësinë e kompani Hill Internacional në këtë projekt, dhe krejt në fund e pranon se opinionin e Hill nuk ka qenë obligative për qeverinë, e në realitet nuk ka pas të drejtë i pandehuri të ndërmerret as një veprim për këtë projekt pa konsulta dhe opinion të kompani Hill Internacional, po ashtu mohon që ka ekzistuar statuti dhe kodi i komitetit ndërministror, si dhe mohon se ka

informacion për presion në dëshmitarin A.K, andaj gjykata vlerëson se mbrojtja e tij e arsyetuar më lartë është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për veprën penal për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit.

3.4.2 I pandehurit **N.SH** në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.12.2023 dhe me datë 09.01.2024, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nga data 6 shkurt 2017 deri me datë 8 nëntor 2018, ka pas detyrën e sekretarit në MI, me datë 27 Shtator 2017, kemi nënshkruar marrëveshjen me Bechtel Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën R6 Prishtinë-Hani i Elezit, pasi që Qeveria e RKS me Kryeministër Hashim Thaqi kishte nënshkruar marrëveshje për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, pasi që kjo autostradë prej fillimit ka pas probleme me sigurimet e buxhetit dhe ky tip e kishte një kontratë me çelësa në dorë që quhet turn key, që parasheh strikt dy kufijtë që duhet me u përmbajte edhe punëdhënësi edhe punëmarrësi, duhet të jetë shuma është fikse dhe data fikse janë të pandryshueshme edhe pse faktikisht kontrata parasheh mundësitë e ndryshimeve por duhet me u përmbush kushte të caktuara pasi që prej fillimit ka pas problem me buxhetin, në këtë proces nuk ka qenë i përfshirë pozita e sekretarit të përgjithshëm, pasi që udhëheqësi i njësisë për implementimin e projektit z.R.Q kah mesi i shtatorit më ka njoftuar se kemi probleme të mdhaja me implementimin e këtij projekti dhe konkretisht ka qenë rreziku i pezullimit të punimeve nga ana e punëkryersit Bechtel Enka, pasi që z.Qupeva më ka njoftua se për shkak të mungesës së vazhdueshme të buxhetit Bechteli nuk ka pas mundësi me i kry punimet sipas dinamikës së paraparë dhe është e nevojshme të bëhet gjithsesi zgjatja e afatit për arsye se sipas kontratës koha e paraparë për përfundimin e punimeve është janari 2018, dhe normalisht pyetja ime ka qenë se pse duhet sekretari në këtë rast të nënshkruaj marrëveshjen kur unë nuk jam pjesë e projektit, pasi që nënshkrimi i sekretarit është më shumë i karakterit formal sepse nuk kamë qenë në këtë rast drejtpërdrejt i involvuar në projekt, por mendoj se ka qenë vetëm pjesë formale, por prapë se prapë më ka interesua me ditë arsyetje, më pas herën e dytë ka ardhë në zyre më ka thirr z.Qupeva dhe më tha në fund e bonëm një zgjedhje të mirë, Bechteli ka hek dorë prej koston dhe thotë me nënshkrua vetëm zgjatjen e afatit për 1 vit, si dhe nga drejtori i prokurimit B.T ka qenë shkresa për propozim të zgjatjes së afatit të punimeve pa kosto, më pas kemi pas një takim të përbashkët me ministrin P.L edhe R.Q, dhe na ka njoftua për rrezikun e pezullimit të punimeve, pasi që ligji për marrëdhënie të detyrimeve e obligon sekretarin e një ministrie me u marrë me zbatimin e të gjitha kontratave, sipas nevojës edhe me nënshkrua edhe me i zbatu, pasi që kjo kontratë është e nënshkruar sipas rregullave të fidingut dhe është në harmoni me ligjin e prokurimit dhe këtë

marrëveshje e kemi nënshkruar pa kosto, pasi që ka pas vërejtje Bechteli në shumën dhe nuk ka qenë me pëlqimin e dy palëve, sepse ka qenë rreziku i pezullimit ose ndërprerjes së punimeve, e sikur të kishte ndodhë ndërprerja e punimeve atëherë sbesoj që edhe sot rruga kishte me qenë e hapur, unë kam pas për qëllim me përfitua populli i Kosovës, pasi që unë kam veprua në përputhje me kontratën, pika 8.4 e kontratës e parasheh kohën e zgjatjes së punimeve, duke u bazuar në mendimi i KRPP, pasi që para se me nënshkrua këtë marrëveshje, kontratën bazë ka qenë konfidenciale dhe nuk e kamë pa, po ashtu deklaron se në këtë proces nënshkrimi i sekretarit është formalitet, unë e kam një opinion që ka ardhë i fundit me datë 27.09.2017 me nr.prot.74/94 nga drejtori i departamenti të prokurimit B.T që thotë: “autoriteti kontraktues pasi ka zhvilluar procedurat e prokurimit është përgatitur shkresa për zgjatjen e afatit në konsiliumit e datës 31.12.2018...”, ma ka marrë mendja që është në rregull dhe është në kuadër të kompetencave e kamë nënshkruar marrëveshjen e lartcekur, pasi që presion njerëzor ose prej dikujt që kamë qenë i detyruar nuk kam pasur, mirëpo presioni ka qenë që nëse ndërpriten punimet, ne kemi bërë zgjatje të afatit sepse qeveritë e kaluara nuk iu kanë përmbajtur dinamikës së paraparë për kryerjen e punimeve në mënyrë financiare sipas shkresës së Bechtel Enkas, po ashtu është vet qeveria e kaluar që ka kërku shtyrjen e afatit, pas që nuk është e vërtetë që zgjatja e afatit ka pru këtë pagesën prej 53 milion pasi që ka pas edhe rrugë tjera, te unë fillon dhe mbaron me nënshkrimin e marrëveshje për zgjatjen së afatit të kontratës, se si ka ndodhë më tutje nuk jam shumë në ngjarje, po ashtu deklaron se roli i komiteti drejtues ndërministror në kuadër të MI-së ka qenë organi më i lartë për miratimin e vendimeve lidhur me realizimin e projektit autostrada R 6, por në të kaluarën komiteti nuk e ka nënshkruar kontratën, ndërsa kompani Hill Internacional është përfaqësues i punëdhënësit, me kompetenca me bërë kualitetin e cilësisë së punimeve, i certifikon punët e kryera sipas kontratës, është e angazhuar për punimet profesionale pasi që zyrtarët e ministrisë nuk kanë pas kurrfarë përvojë dhe kanë angazhuar një kompani që është në këtë rast Hill Intenational, dhe nuk e di për marrëveshjen e lartcekur a janë konsultuar kompani Hill Internacional. Ndërsa në mbrojtjen e tij në fazën e hetimeve me data 27.01.2022 dhe me datë 28.01.2022 në PSRK, ka deklaruar se Marrëveshja nuk e ka përmbajtur koston financiare ashtu siç parashihet me kontratën bazë dhe rregull kontraktuale, ndërsa pjesët tjera të mbrojtjes së pandehurit në fazën e hetimeve janë të njëjta me mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.

- *Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit të lartcekur, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se i pandehuri N.SHn, pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27 Shtator 2017, me Bechtel Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën R6 Prishtinë-*

Hani i Elezit, krejt kjo ka ndodhur pas një takim të përbashkët me ministrin P.L dhe R.Q, e kanë njoftuar për rrezikun e pezullimit të punimeve për këtë projekt si dhe nga drejtori i prokurimit B.T ka qenë shkresa për propozim të zgjatjes së afatit të punimeve pa kosto, i datës 27.09.2017, me nr.prot.74/94 thotë: “autoriteti kontraktues pasi ka zhvilluar procedurat e prokurimit është përgatitur shkresa për zgjatjen e afatit në konsiliumit e datës 31.12.2018...”, ka menduar se është në rregull dhe është në kuadër të kompetencave të tij dhe e ka nënshkruar marrëveshjen e lartcekur, pasi që sipas mbrojtjes së tij presion njerëzor nuk ka pasur prej dikujt mirëpo presioni ka qenë të ndërpriten punimet, nga kjo mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme në kundërshtim me rregullat e prokurimi publik pasi që as një dispozitë nuk e njeh nënshkrimin e marrëveshjes -aneks kontratës apo kontratës pa koso financiar, e në mungesë së këtij elementi e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, po ashtu ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrimin e marrëveshjes së njëjtë pasi që gjatë mbrojtjes së tij gjejmë se ka deklaruar se roli i komiteti drejtues ndërministror në kuadër të MI-së ka qenë organi më i lartë për miratimin e vendimeve lidhur me realizimin e projektit autostrada R 6, sipas gjetjes së gjykatës një konstatim i të pandehurit është rregulluar me Statutin dhe Kodin e KDNM, pasi që vendimet për këtë projekt kanë qenë kompetent ti marrin anëtarët e KDNM, e jo ministrin Palë Lekaj dhe sekretarin N.SHn, dhe drejtori i departamentit B.T, si në rastin konkret, andaj sipas mbrojtjes së pandehurit para se me nënshkrua këtë marrëveshje, nuk e ka pa kontratën bazë pas që ka qenë konfidenciale, sipas vlerësimit të gjykatës është e pa kuptueshme se si ka arrit i pandehurit ta nënshkruaj një marrëveshje pa u vlerësuar kontratën bazë ku sipas mbrojtje së tij ka deklaruar se në këtë proces nënshkrimi i sekretarit është formalitet pasi që sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve e obligon sekretarin e një ministrie me u marrë me zbatimin e të gjitha kontratave, ky konstatim i të pandehurit sipas vlerësimi të gjykatës është i pa bazuar, po ashtu gjykata vlerëson edhe pjesë e mbrojtjes së pandehurit se kompani Hill Internacional është përfaqësues i punëdhënësit, me kompetenca me bërë kualitetin e cilësisë së punimeve, i certifikon punët e kryera sipas kontratës, është e angazhuar për punimet profesionale pasi që zyrtarët e ministrisë nuk kanë pas kurrfarë përvoja dhe kanë angazhuar një kompani që është në këtë rast Hill Internacional, dhe nuk ka njohuri për marrëveshjen e lartcekur a janë konsultuar kompani Hill Internacional, gjykata gjen se lenë për të kuptuar se ky personalisht nuk është konsultuar me opinionet e Hill Internacional, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës ka pas shumë shkele gjatë këtij procesi pasi para nënshkrimi të marrëveshjes me Bechtel Enkës i pandehuri N.SH ju ka shmangur edhe opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional edhe pse e njëjti në mbrojtjen

e tij ka pasur njohuri të mjaftueshme për rolin e kësaj kompanie në këtë projekte, po ashtu sipas mbrojtjes së tij është konstatuar se nuk është e vërtetë që zgjatja e afatit të përfundimi të punimeve e ka prurë këtë pagesë prej 53 milion, pasi që unë fillon dhe mbaron me nënshkrimin e marrëveshje për zgjatjen së afatit të kontratës, sipas gjetjes së gjykatës i tërë procesi ka filluar me veprime të kundërligjshme që nga nënshkrimi i marrëveshjes nga i pandehuri N.SH, që e njëjta marrëveshje ka prodhuar pasoj të mëtutjeshme të kundërligjshme deri tek përfundimi i këtij projekti, andaj mbrojtja e tij e arsyetuar më lartë është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit.

3.4.3 I pandehuri **E.B** në seancat e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.01.2024 dhe me datë 10.01.2024, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në fund të shtatorit në vitin 2017, jam emëruar si këshilltar i ministrit por për shkak të angazhimeve të mia të asaj kohe në detyrën e përmbartuesit privat, detyrën e këshilltarit e kam filluar pasi me që më është pranuar dorëheqja nga ministri i drejtësisë, në provat që i kemi dorëzuar janë vendimet për emrin dhe plotësimet për emërimin kur ceket saktë data e fillimit të punës sime në zyrën e ministrit, kur kam filluar punën në ministri jam njoftuar me fushën veprimtarisë së ministrisë së MI-së dhe më projektet në zhvillim e sipër, një prej të cilave ka qenë edhe autostrada “Arber Xhaferi”, ose R6 i cili ishte projekt në vazhdimësi që nga viti 2014, pasi që fillimisht me duhet me shpjegua për kërkesën e operatorit “Bechtel Enka” për përshtatjen e çmimit të kontratës si rezultat i vazhdimet të aftit të përfundimit të punimeve që ishte nënshkruar në muajin shtator të viti 2017, kishte mbetur pezull çështja e vlerës së punimeve, me datë 22 shkurt 2018, kompania Bechtel Enka e kishte dorëzuar kërkesën zyrtare për pagesë prej 53 milion euro për mbulimin e shpenzimeve të kohe zgjatjes të afatit të përfundimit të punimeve si dhe të drejtat e tjera kontraktuale të cilat lidheshin me kontratën bazë, të cilën e kishte nënshkruar Bechtel Elenka me MI-në, në vitin 2014, në atë dokument të dorëzuar nga Bechtel Elenka ishte kërkuar kompensimi për vazhdimin e punimeve, për shkak të zgjatje së afatit, ishin kërkuar mjete për shkak të dëmeve indirekte që kishte pësuar kompania kontaktuese për shkak të mos përfundimit me kohë të afatit për përfundimin e këtyre punimeve dhe e drejta e përshtatjes që drejtë e çmimit duke arritur kështu te një shume prej 63 milion euro, pasi e kishte pranuar këtë kërkesë MI-ja, ministri Lekaj ka mbajtur takim me këshilltaret e kabinetit të tij së bashku me kryesuesin e zbatimit të projektit R.Q dhe kemi kërkuar që të vlerësohet kjo pagese nga kompania mbikëqyrëse “Hill International”, ku të njëjtës kompani mbikëqyrëse i kishin dhënë afat një jave (7 ditë) për përgjigje lidhur me kërkesën e operatorit

“Bechtel Enka”, më pas kompania mbikëqyrësi “Hill International”, ka kthyer përgjigje e pranuar më shkrim në mënyrë jo zyrtare- jemi informuar përmes R.Q sipas së cilës ata e kishin konsideruar si të mjaftueshëm opinionin e vitit paraprak të shtatorit të vitit 2016 pa hyrë në detaje dhe e pa elaboruar fare kërkesën e re të operatorit “Bechtel Elenka”, dhe për më tepër ata asnjëherë nuk kanë qëndruar pranë atij opinionit, as nuk e kanë dorëzuar në formë zyrtare siç ishin dorëzuar të gjitha shkresat e tjera dhe komunikimet e rregullta me këtë kompani, nëpërmes arkivit të ministrisë me protokoll zyrtar, unë nuk kam pasur për detyrë as ti pranoj shkresat as ti përcjelli si këshilltar politik, menjëherë pas pranimit të kërkesës zyrtare nga kompania Bechtel Enka ministri si kryesues i komitetit drejtues ndërministror, me datë 9 mars 2018, në takimin KDNM i kishte njoftuar anëtarët e komitetit drejtues lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik dhe në takimin me datë 9 mars 2018 ka raportuar kryesuesi i njësisë për zbatimin e projektit R.Q dhe përfaqësuesit e kompanisë Bechtel Enka, kryesuesi i njësisë zbatuese të projektit e kishte shpjeguar ecurinë e projektit, problemet e shfaqura ndër vite për shkak të shkurtimeve buxhetore dhe pamundësisë së ndarjes së mjeteve për financimin e këtij projekti brenda afatit të kontratës ndërsa përfaqësuesi i Bechtel Enkës i kishte njoftuar anëtarët e komitetit drejtues lidhur me kërkesat e tyre për kompensimin e drejtë të shpenzimeve lidhur me zgjatjen e afatit të punimeve dhe dëmeve të pësuar ndër viteve për shkak të mos alokimit të duhur të mjeteve për financim të projektit dhe dështimeve të vazhdueshme të MI-së për tu dakorduar dhe për të nënshkruar aneksin në të cilin do të zgjatej zyrtarisht afati për përfundimin e punimeve, ndërsa në takimin e datës 5 prill 2018 të KDMN-së, disa anëtarë të këtij komiteti kanë kërkuar sqarime shtesë nga kompania Bechtel Enka, gjithë ministrat anëtar i këtij komiteti kanë autorizuar këshilltarët në mesin e tyre isha edhe unë si këshilltar i ministrit P.L për tu takuar me përfaqësuesit e Bechtel Enkës me qëllim të elaborimit të hollësishëm të kërkesës së tyre, brenda ministrisë kena pas takime, pas këtij takimi unë së bashku me këshilltarët e ministrave jemi takuar kjo vërtetohet me procesverbalin e datës 19 prill dhe 5 prill, me përfaqësuesit e Bechtel Enka, të njëjtit i kanë elaboruar në hollësi kërkesën e tyre lidhur me kompensimin e shpenzimeve dhe unë kam raportuar në takimin tjetër të radhës të datës 19 prill 2018 , të KDNM lidhur me rezultatet e këtij takimi pasi që pas marrjes së sqarimeve nga kompania Bechtel Enka, këshilltarët e anëtarëve të komitetit nuk kishin vërejtje sa i përket arsytimit të kërkesës së kompanisë Bechtel Enka dhe ne të gjithë ishim dakorduar që për këtë çështje të vendoset nga qeveria, pra jo nga komiteti drejtues pasi që kjo çështje dilte jashtë dispozitave të kontratës duhej të merrej aprovimi i qeverisë. Me datë 31 maj 2018, a është mbajtur takimi i KDMN-së në zyrën e kryeministrit ku prezent përveç anëtarëve të rregullt të KDMN ishin edhe zyrtarët e kabinetit të kryeministrit, vet kryeministri, këshilltarët e tij dhe këshilltarët e ministrave të komitetit duke përfshirë edhe vetën,

në atë takim kryeministri kërkoi që të sigurohej një opinion ligjor nga MI-ja, nga Departamenti Ligjor lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik Bechtel Enka, meqenëse kjo çështje ishte urgjente kryeministri kërkoi që ky opinion të sigurohej brenda 1 dite pune, pra deri të nesërmen me datë 1 qershor 2018, ku ishte planifikuar të mbahej takimi i radhës së KDNM –së, pas marrjes së kërkesës nga kryeministri për sigurimin e opinionit ligjor të cilin ma drejtoi mua si këshilltar i ministrit unë menjëherë posa u ktheva në kabinetin e ministrisë në prezencë të shefit të kabinetit të ministrit Lekaj, e kemi ftuar drejtorin e departamenti ligjor A.K dhe ia kemi komunikuar kërkesën e kryeministrit për të hartuar një opinion ligjor brenda afatit të dhënë (1 ditë pune), me atë rast drejtori i departamenti ligjor ia kemi dorëzuar gjitha shkresat që i kemi poseduar në kabinetin e ministrit prej kontratës së nënshkruar në muajin gusht 2014 e deri në atë kohë, posaçërisht kam kërkuar nga shefi i zyrës së njësisë zbatuese të projektit R.Q ti ndihmoj me materialet e nevojshme që i ka në posedim me qëllim të hartimit të opinionit ligjor brenda afatit të dhënë, ndërsa A.K e kishte dërguar një email në adresën time në të cilën e kishte shpjeguar pamundësinë e tij për të hartuar këtë opinion, se nuk ka njohuri lidhur me këtë çështje e as me kontratën e nënshkruar në mes të ministrisë dhe operatorit ekonomik Bechtel Enka, por ne ishim të shtyrë nga kërkesa e kryeministrit dhe unë për vete si këshilltar politik vetëm e kam transmetuar kërkesën e kryeministrit tek drejtori A.K, pas pranimit të këtij emaili unë i kam dërguar A.Kt një shpjegim e quajtur memo shpjeguese që ia kam shpjegua kronologjinë e fakteve dhe kërkesën e operatorit ekonomik Bechtel Enka, këtë shkresë i kamë dërguar atij për ta ndihmuar që ta kuptoj problematikën e çështjes që ai duhej të shkruante opinion ligjor, përveç kësaj shkrese, A.Kt ia kam dërguar edhe një shkresë tjetër e cila ishte identike me shkresën e datës 22 shtator 2017, me të cilën ishte autorizuar nënshkrimi i aneksit për zgjatjen e afatit të punimeve edhe për 11 muaj pa u dakorduar kosto, drejtori i departamentit ligjor i kishte dërguar dy drafte të opinioneve ligjore në bazë të shkresave të lëndës shihet se opinionimi i parë i tij ishte dërguar me datë 1 qershor 2018 rreth orës 12:23 minuta, të cilën ia kishte drejtuar ministrit Lekaj, sekretarit të përgjithshëm N.SH dhe mua, dhe një opinion ligjor tjetër të njëjtën ditë pas orarit të punës në ora 16:04 minuta po ashtu drejtuar ministrit Lekaj, sekretarit të përgjithshëm dhe mua, në këtë opinion ligjor shihet se drejtori i departamentit ligjor kishte konstatuar se vazhdimi i kontratës me datë 27 shtator 2017, ishte bërë plotësisht në pajtim me kontratën dhe ligjin në fuqi, ndërsa sa i përket kërkesës së operatorit ekonomik Bechtel Enka, për kosto shtesë ai ishte referuar se opinionit ligjor më sqaruese rreth kësaj çështje duhet *ta mirren nga personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës*, dhe këtë opinion ligjor së bashku me shkresa tjera e sipas rrugëve zyrtare e kanë përcjellë te zyra e kryeministrit dhe anëtarët e KDNM-së për takimin e datës 1 qershor 2018, kur ishte dorëzuar opinionimi ligjor dhe ishin njoftuar anëtarët e komitetit

drejtues lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor, takimi i datës 5 qershor 2018, ishte vazhdimësi i këtyre dy takimeve dhe me të cilën pas marrjes së mendimit të se cilëve anëtarë të KDNM-së lidhur me shkresat që ishin dorëzuar nga kabineti i ministrit Lekaj si kryesues i komitetit ndërministror, të gjithë anëtarët e KDNM unanimitisht e kanë përkrahur rekomandimin që të dërgohet për aprovim kërkesa e operatorit ekonomik Bechtel Enka, për qeverinë e Kosovës, po me të njëjtën datë Qeveria e Kosovës ka mbajtur takimin ku si pikë e rendit të ditës ishte aprovimi i kërkesës së operatorit ekonomik Bechtel Enka, për pagesën e 53 milion eurove dhe sipas transkriptove të atij takimi të qeverisë nuk kishte pasur kundërshtim nga ndonjë anëtar i kabinetit të qeverisë, ndërsa sa i përket deklaratave të dëshmitarit A.K për presion apo ndikim ndaj tij lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor, asnjëherë nuk e kam takuar prej opinionit ligjor të parë kur ai pretendon se e ka dërguar deri në hartimin e opinionit ligjor të dytë, nuk e kam takuar as në zyrën time e as në ndonjë zyrë tjetër brenda kabinetit të ministrit Lekaj për ti kërkuar që ti shkruaj apo heq ndonjë gjë nga opinionit ligjor që e kishte hartuar, shton se nuk kam qenë person përgjegjës për sigurimin e dokumenteve mbështetëse opinionin ligjor të kompanisë mbikëqyrëse në KDNM lidhur me kërkesën e Bechtel Enkes, pasi që këshilltarët politik nuk e kanë për detyrë të kujdesën as për bazë e as për mbështetje ligjore, pasi që sipas rregullores për fushat e përgjegjësi administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive këshilltarët politik sipas rregullores 9/2012, nuk kanë kompetenca ekzekutive mbikëqyrëse apo administrative në raport me shërbimin civil por mund të transmetojnë kërkesat e eprorëve të tyre, pra stafit politik tek shërbyesit civil nëse nuk gabojnë neni 33. Ndërsa në mbrojtjen e tij në fazën e hetimeve me datë 17.11.2021 në PSRK, ka deklaruar se në periudhën kohore për të cilën dyshohet kamë pranuar vendimin për këshilltar politik me datë 28.09.2017, kam punuar si këshilltar i Ministrit të Infrastrukturës P.L, se kompetencë e tij ka qenë dhënia e këshillave dhe udhëzimeve të Ministrit të Infrastrukturës si dhe transmetimi i udhëzimeve të ministrit tek stafi i Ministrisë apo shërbyesit civil, në pajtim me Rregulloren 2/2011, për fushat e përgjegjësi administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, ndërsa pjesët tjera të mbrojtjes së pandehurit në fazën e hetimeve në deklaratat në prokurori dhe në polici me datë 18.09.2019, janë të njëjta me mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim, sipas vlerësimit të gjykatës nga deklarim i të pandehurit në fazën e hetimeve vërtetohet se me datë 28.09.2017 i pandehuri E.B ka filluar punën si këshilltarë politik në MI, ndërsa në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk qëndroj pranë këtyre deklaratave, andaj gjykata të njëjtat deklarata i ka vlerësuar në bazë të neneve të KPP-së si më poshtë, ku është konstatuar edhe intervali kohor i veprime të kundërligjshme të pandehurit E.B si në diapozitiv II , të këtij aktgjykimit. Pasi që deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim

me dispozitat e nenit 74, paragrafi 2, nenit 128 ose nenit 129 dhe në pajtim me nenet 149 deri 153 të këtij Kodi. Deklaratat e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 257 paragrafin 2 të këtij Kodi”, lidhur me nenin 257 par.2 ku përcaktohet se: “ Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarin të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit”.

- *Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit të lartcekur, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se i pandehuri E.B pohon faktin se pas kërkesës zyrtare të datës 22 shkurt 2018, kompania Bechtel Enka e kishte dorëzuar për pagesë prej 53 milion euro, ministri Lekaj ka mbajtur takim me këshilltarët e kabinetit të tij së bashku me kryesuesin e zbatimit të projektit R.Q dhe kemi kërkuar që të vlerësohet kjo pagese nga kompania mbikëqyrëse “Hill International”, ku të njëjtës kompani mbikëqyrëse i kishin dhënë afat një jave (7 ditë) për përgjigjeje lidhur me kërkesën e operatorit “Bechtel Enka”, më pas kompania mbikëqyrësi “Hill International”, ka kthyer përgjigje të dorëzuar në formë jo zyrtare, jo nëpërmes arkivit të ministrisë me protokoll zyrtar, unë nuk kam pasur për detyrë as ti pranoj shkresat as ti përcjelli si këshilltar politik, sipas gjetjes së gjykatës mbrojtja e të pandehurit është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit B.A, kur ka sqaruar për gjykatën se personalisht e pa pranuar opinionin e lartcekur dhe çdo dokument e ka përcjell në parim tek i pandehuri E.B, andaj mbrojtja e të pandehurit në këtë drejtim është e pa bazuar, ndërsa sa i përket mbrojtjes se tij se me datë 9 mars 2018, kryesuesi në takimin i kishte njoftuar anëtarët e komitetit drejtues lidhur me kërkesën Bechtel Enka, dhe në takimin me datë 9 mars 2018, ka prezantuar përfaqësuesit e kompanisë Bechtel Enka, i kishte njoftuar anëtarët për kërkesat e tyre lidhur me zgjatjen e afatit të punimeve dhe dëmeve të pësuar ndëer viteve për shkak të mos alokimit të duhur të mjeteve për financim të projektit, më pas të gjithë ministrat anëtar i këtij komiteti kanë autorizuar këshilltarët në mesin e tyre isha edhe unë si këshilltar i ministrit P.L për tu takuar me përfaqësuesit e Bechtel Enkës me qëllim të elaborimit të hollësishëm të kërkesës së tyre, sipas gjetjes së gjykatës vërtetohet se kanë vazhduar veprimet e kundërligjshme të pandehurit P.L që autorizon të pandehurin E.B, ku i njëjtit e pranon se në cilësi të këshilltarit merr pjesë në negociata me përfaqësuesin Riad të OE Bechtel enkes, në kundërshtim me detyrat dhe kompetencat e tij, duke anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse Hill Internacional e paguar nga Qeveria e Kosovës në vlerë afër 8 milionë, pasi që ka pas mungesë të kuadrave profesionale për ta mbikëqyrë këtë projekt si dhe për vlerësimin e punëve në teren, vlerësimi i cilësisë së punëve, certifikimi i çdo fature*

të operatori ekonomik Bechtel Enkës për pages në MI, si dhe për vlerësimin e kërkesës si në rastin konkret, më pas gjykata gjen se i pandehurit deklaroi se këshilltarët e anëtarëve të komitetit nuk kishin vërejtje sa i përket arsyetimit të kërkesës së kompanisë Bechtel Enka dhe ne të gjithë ishim dakorduar që për këtë çështje të vendoset nga qeveria, pasi që kjo çështje dilte jashtë dispozitave të kontratës duhej të merrej aprovimi i qeverisë, nga kjo vërtetohet se i pandehurit E.B në takim e KDNM jep konstatim se këshilltarët janë të pajtimi dhe ka pranuar se kjo kërkesë del jashtë kontratës, sipas gjetjes së gjykatës i njëjtit nuk kanë pas të drejtë të merret fare më këtë kërkesë sepse kompetent që ta vlerësoj këtë kërkesë ka qenë mbikëqyrësi i kontratës Hill Internacional, më pas ka deklaruar se në takimin e datës 31 maj 2018, të KDMN prezent ka qenë kryeministri që kërkoi nga unë që të sigurohej një opinion ligjor nga MI-ja, nga Departamenti Ligjor, të njëjtën ditë në kabinet e kemi ftuar drejtorin e departamenti ligjor A.K dhe ia kemi komunikuar kërkesën e kryeministrit për të hartuar një opinion ligjor brenda afatit të dhënë (1 ditë pune), me atë rast drejtori i departamenti ligjor ia kemi dorëzuar gjitha shkresat, më pas A.K e kishte dërguar një email në adresën time në të cilën e kishte shpjeguar pamundësinë e tij për të hartuar këtë opinion, se nuk ka njohuri lidhur me këtë çështje e as me kontratën e nënshkruar në mes të ministrisë dhe operatorit ekonomik Bechtel Enka, unë i kam dërguar A.Kt një shpjegim e quajtur memo shpjeguese si dhe më pas ia kam dërguar edhe një shkresë tjetër, ku drejtori i departamenti ligjor i kishte dërguar dy draftet të opinionëve ligjore, ndërsa në takimin e datës 1 qershor 2018, ishin njoftuar anëtarët e komitetit drejtues lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor, të njëjtën datë Qeveria e Kosovës ka mbajtur takimin ku si pikë e rendit të ditës ishte aprovimi i kërkesës së operatorit ekonomik Bechtel Enka, për pagesën e 53 milion eurove, ndërsa sa i përket deklaratave të dëshmitarit A.K për presion apo ndikim ndaj tij lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor nuk qëndrojnë, gjykata gjen se deklaratime të pandehurit E.B nuk gjej mbështetje në prova dhe në dëshminë e dëshmitarit A.K të n dëgjuar në këtë çështje penale, pasi që dëshmitari i n dëgjuar ka sqarua në detaje veprimet e kundërligjshme të pandehurit E.B, pasi që i njëjtit i ka bërë presion që nga opinionin ligjor të largoj emrin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, kjo e thënë e dëshmitarit gjen mbështetje në opinionin e dërguar në imel në ora 16:03 min, të pandehurit E.B, ku cc ka qenë edhe i pandehurit P.L ku sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri P.L ka qenë në dijen dhe me dashje e ka udhëhequr procesin e kërkesave tek i pandehuri E.B në drejtim të dëshmitarit A.K, për përpilimin dhe ndryshimin e opinionit ligjor, andaj mbrojtja e tij është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për veprën penal për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit.

3.4.4 I pandehuri **B.T**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 10.01.2024, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në MI kam qenë UD drejtor i divizionit të prokurimit nga data 20 prill 2016 e deri me datë 10 tetor 2017, projekti R6 ka qenë nën menaxhimin e KDNM-së i përcjellë edhe nga NJIP si dhe nga organi mbikëqyrës kompania Hill Internacional, ky projekt siç dihet tashmë në fillimin e tij së ekzekutuari kanë fillua edhe problemet/telashet financiare të ministrisë, qeverisë së Kosovës e cila ka nënshkruar kontratë që në aspektin financiar nuk ka mundur ta përballoj afatin kohor të kontratës së nënshkruar, prandaj, edhe kam fillua komunikimet për problemet që mund të dalin për shtyrjen e afatit, me pamundësinë buxhetore të MI për të përcjellë realizimin e kësaj kontrate në afatin kontraktues dhe si rrjedhojë e këtyre komunikimeve në shtator 2016 KDNM i udhëhequr në atë kohë nga ish ministri Zharku ka nxjerrë vendim për miratimin e zgjatjes së afatit kohor për 11 muaj e 13 ditë nëse nuk gaboj e deri me 31 dhjetor 2018, sipas opinionit të Hill International një shumë prej 14.778 milion, për miratim në Qeveri e cila nuk ka kaluar, pastaj janë shkresa dhe komunikime të vazhdueshme që kanë përcjellë projekti dhe shkresa e prillit të vitit 2017 e Bechtel Enkes që jap pëlqimin për shtyrjen e afatit të punimeve pa kosto që kjo të mbetet çështje për tu zgjidhur mes Bechtelit dhe ministrisë dhe kjo sjellë pastaj me ndryshimin e qeverisë, ardhjen e ministrisë P.L në MI ku rreth datë 20 shtator 2017 , kërkesa e udhëheqësit të NJIP R.Q që të bëhet zgjidhje e afatit kohor të kontratës që të mos jetë në 3 muaj shin e fundit të realizimit të saj pa një marrëveshje mes të palëve, R.Q në konsultim me ministrin dhe sekretarin permanent kanë kërkuar që kjo marrëveshje të formalizohet, kjo ka sjell pastaj edhe marrëveshjen për shtyrjen e afatit të punimeve të me datë 27.09.2017, e cila ka qenë formalizim i vendimit të KDNM edhe i opinionit të Hill International, pajtimi i palëve për shtyrjen e afatit për realizimin e këtij projekti si pasojë e mungesës së mjeteve të ndarjeve buxhetore nga Qeveria e Kosovës, ndërsa, pas kësaj me datë 10.10.2017, sipas vendimit të sekretarit të MI-së jam kthyer në pozitën sipas akt emërimit udhëheqës i divizionit PYC, në kuadër të departamentit të shofereve, më pas deklaron në cilësinë e udhëheqësit të prokurimit më është kërkuar që t'iu drejtohem KRPP-së lidhur me mundësinë e implementimit të këtij projekti rreth interpretimit të kushteve të kontratës e cila ka qenë e nënshkruar në atë kohë 100% me rregullat e Fidikut, ndërsa, përgjigja e KRPP në atë kohë ka qenë që KRPP si organ rregullator i prokurimit publik bën interpretimin e rregullave dhe dispozitave ligjore të LPP-së dhe jo interpretimin e ndonjë kontrate, në këtë rast kontratën e MI-së me Bechtel Enken, se MI në këtë rast kontratën e nënshkruar me Bechtel Enken duhet gjetur vet zgjidhje për tejkalimin e këtyre problemeve për zgjatje sipas asaj që qeveria nuk ka bërë ndarje të mjaftueshme buxhetore për përcjelljen e realizimit të kontratës në afatin kohor sipas asaj që është

nënshkrua, andaj marrëveshjes e lidhur me datë 27.09.2017, në këtë rast nuk kemi as kontratë e as aneks të ri por marrëveshje të nënshkruar e cila zgjidhë vetëm një problem, mundësinë e vazhdimit të punimeve deri në realizimin e këtij projekti, ndërsa nuk e konsideroj se është shkaktuar dëm pa kosto, po ashtu sqaron *se anëtarët KDNM ka udhëhequr me projektin mirëpo përfitues i këtij projekti ka qenë MI dhe si e tillë kjo është nënshkruar nga ministri i MI, sekretari dhe drejtori i prokurimit sepse ka qenë projekt përfitues ka qenë MI dhe se normalisht anëtarët e KDNM ministra të tjerë nuk nënshkruajnë projekte në kuadër të MI, ata kanë menaxhura me projektin dhe kanë marrë vendime për projektin, KDNM ka udhëhequr me projektin sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, ndërsa kompania Hill International ka pasur rolin e mbikëqyrësit, këshilltarit të transaksionit për nevoja qoftë inxhinierike, juridike, financiare, ekonomike për realizimin e këtij projekti me interes nacional dhe për realizimin e këtij projektit i përcjellë punët në teren, ndërsa sa i përket dokumentit të datës 27.09.2017, drejtori i prokurimit në këtë rast sikurse edhe në raste tjera për secilin projekt përcjellë për nënshkrim të palët e tjera në këtë rast ministri dhe sekretari përmes një shkresë protokollit e cila është vetëm shkresë përcjellëse nga zyra e prokurimit në zyrën e sekretarit ose ministrit dhe nuk është opinion, shkresa të tilla janë për secilën kontratë të nënshkruar nga prokurimi, kjo shkresë pas finalizimit për nënshkrimin e saj, jep një konfirmim se kjo marrëveshje është në harmoni të plotë me dispozitat e ligjit të prokurimit publik si përgjegjësi e divizionit të prokurimit por assesi si opinion që ju referuar i pandehuri N.SH gjatë mbrojtje së tij. Ndërsa në mbrojtjen e tij në fazën e hetimeve me datë 16.02.2022 në PSRK, ka deklaruar njëjtë si në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk ka ndonjë ndryshim.*

- Gjykata e vlerëson mbrojtjen e të pandehurit të lartcekur, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se i pandehuri B.T pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27.09.2017, pasi që paraprakisht është konsultuar me udhëheqësin e njësisë R.Q, dhe në konsultim me ministrin Palë Lekaj dhe sekretarin N.SHn, janë dakorduar që ta nënshkruaj këtë marrëveshje, pasi që sipas të pandehurit ky nënshkrim ka qenë në kuadër të kompetencave si zyrtar kryesor i prokurimit, pasi që ka qenë ministria që udhëhequr këtë projekt sepse kontrata bazë ka kaluar përmes ministrit dhe sekretarit të asaj kohe, dhe nënshkrimi i kësaj marrëveshje keni qene konform dispozitave të prokurimit publik, po ashtu nga mbrojtja e të njëjtit konstatohet se anëtarët KDNM kanë udhëhequr me projektin mirëpo përfitues i këtij projekti ka qenë MI dhe si e tillë kjo është nënshkruar nga ministri i MI, sekretari dhe drejtori i prokurimit sepse ka qenë projekt përfitues ka qenë MI dhe se normalisht anëtarët e KDNM ministra të tjerë nuk nënshkruajnë projekte në kuadër të MI, sipas gjetjes së gjykatës një konstatim i të

pandehurit është i gabuar në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e KDNM, pasi më pas ka konstatuar se anëtarët e KDNM kanë menaxhura me projektin dhe kanë marrë vendime për projektin, KDNM ka udhëhequr me projektin sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, dhe sipas të pandehurit marrëveshjes e lidhur me datë 27.09.2017, në këtë rast nuk kemi as kontratë e as aneks të ri por marrëveshje të nënshkruar e cila zgjidhë vetëm një problem mundësinë e vazhdimit të punimeve deri në realizimin e këtij projekti, nga kjo mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme në kundërshtim me rregullat e prokurimi publik pasi që as një dispozitë nuk e njeh nënshkrimin e marrëveshjes -aneks kontratës apo kontratës pa kosto financiar, e në mungesë së këtij elementi e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, po ashtu ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrime e marrëveshjes së njëjtë, pasi që për vendimet për këtë projekt kanë qenë kompetent ti marrin anëtarët e KDNM, e jo ministrin Palë Lekaj dhe sekretarin N.SHn, dhe drejtori i departamentit B.T, si në rastin konkret, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri B.T ju ka shmangur edhe opinionëve të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, edhe pse e njëjti në mbrojtjen e tij ka pasur njohuri të mjaftueshme për rolin e kësaj kompanie në këtë projekte, andaj mbrojtja e tij është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për veprën penal për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënua sipas ligjit.

4. . Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin për pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit;

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, së pari do ta shtjelloj: vërtetimin e gjendjeve faktike në këtë çështje penale e për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtor për pikën I. të aktgjykimit; cilësimin juridik të veprës penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale; provat dhe faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjetja fajtor e të pandehurve; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; çështjen e dënimit, dënimit plotësues dhe të shpenzimeve procedurale.

Gjykata në këtë çështje penale si fakte të pa-kontestueshme i ka vërtetuar, faktet si më poshtë:

- Me datë 12.06.2012 Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr vendimin Nr.06/78 për krijimin e Komitetit Drejtues Ndër-ministror për zhvillimin e projektit ‘‘Rruga 6’’ (Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit), i cili komitet është përbërë nga 5 anëtar, ku njeri prej tyre ka qenë Kryesues i Komitetit. Kryesues i Komitetit është vendos Ministri i Infrastrukturës, ndërsa anëtar të komitetit janë vendosur Ministri i Financave, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

- Statuti dhe Kodi i Sjelljes i Komitetit Drejtues Ndërministror, i datës 20.06.2012, përcakton detyrat dhe përgjegjësit e komiteti drejtues ndërministror(KDNM), pasi që në kuadër të përgjegjësi të saj ka pasur përcaktimin e politikave dhe sigurimin e koordinimit ndërministror gjatë gjithë fazave të projektit. Përgjegjësi tjetër e KDNM është edhe shqyrtimi dhe aprovimin i të gjitha dokumenteve vendimtare të projektit, përfshirë këtë termet e referencës për prokurim, kontrata etj. Ndërsa, Njësia për Implementimin e projektit(NJIP) ka qenë përgjegjëse për menaxhimin teknik të projektit dhe ka shërbyer si sekretariat teknik i KDNM. Me këtë dokument janë përcaktuar edhe përgjegjësit e Këshilltarit të Transaksionit i cili ka pasur si detyrë ofrimin e shërbimeve të këshillave strategjike, ligjore, teknike dhe financiare për KDNM dhe NJIP. Me këtë dokument është lënë hapësira edhe e angazhimit të ekspertëve të jashtëm nëse kërkohet. Po ashtu, me këtë dokument është përcaktuar edhe kodi i mirësjelljes me të cilin është përcaktuar parimi i ruajtjes së konfidencialiteti, paanësisë, transparencës etj.

- Me datë 01.07.2014 është nënshkruar kontrata në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë fituese ‘‘Bechtel&Enka’’ me kosto totale prej 599,944,263,55 Euro, për zhvillimin e projektit ‘‘Rruga 6’’ (Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit), dhe afati për kryerje të punimeve është paraparë të jetë 42 muaj konkretisht deri me datë 18 janar 2018.

- Me datë 30.10.2014 Ministria e Infrastrukturës dhe Kompania Hill International kanë lidhur kontratë me të cilën kjo kompani është caktuar si mbikëqyrëse e ndërtimit dhe shërbimeve menaxhuese në rrugën Nr.6 Prishtinë - Hani i Elezit. Si Këshilltar i Transaksionit i cili ka pasur si detyrë ofrimin e shërbimeve të këshillave strategjike, ligjore, teknike dhe financiare për KDNM dhe NJIP.

- Draft Aneks – Kontrata me nr. Prok. MI/12/050/512, e vitit 2016, në mes të Ministrisë se Infrastrukturës dhe OE ‘‘Bechtel&Enka’’; me numër identifikues të kontratës: ID.017/2014 nën-

klauzola 1.1.3.3(afati i përfundimit) dhe nën klauzola 8.2(Afati i përfundimit) në kushtet e veçanta të kontratës është fshirë dhe është zëvendësuar me: ‘Afati i përfundimit të punimeve nuk duhet të kalojë 53 muaj e 19 ditë nga data e fillimit, përveç rastit të ndonjë shtyrje të afatit të përfundimit sipas nën-klauzoles 9.4(shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve)’. Afati i përfundimit të punimeve të tre seksioneve nuk do të jetë më vonë se 31 Dhjetor 2018. Kjo shtyrje vjen si rezultat i shtrëngimeve buxhetore të punëdhënësit, mungesa e buxhetit për këtë projektë, nuk janë alokuar mjete të mjaftueshme për vite me qëllim të rritet edhe inteziteti i punimeve, po sa janë alokuar mjete në buxhet për këtë projekt aq janë kryer punë nga OE ‘Bechtel&Enka’.

- Me datë 30 Shtator 2016, kompania mbikëqyrëse e projektit “Hill Internacional “, përmes dokumentit nr. P XK-000.1.00/GP/SO735, e kishte njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës se aneks kontrata për zgjatje të afatit për përfundim të punimeve, duhet t’i përmbaj dy kërkesat kryesore, siç janë kërkesat teknike dhe ato komerciale.

- Vendim mbi aprovimin e Aneksit të kontratës, i datës 30.09.2016; ku Komiteti Drejtues Ndërmintor në takimin e datës 30.09.2016 ka aprovuar aneks-kontratën ‘’ Projekti për dizajnimin dhe ndërtimin e Rrugës 6 Prishtinë – Hani i Elezit me konzorciumin Bechtel Enka, e cila kishte vlerë 14.778 milion Euro, dhe i ka rekomanduar Qeverisë së RKS-së që të miratojë këtë vendim.

- Me datë 27.09.2017, në Ministrinë e Infrastrukturës në Prishtinë, në cilësi të personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërmintor (KDNM) dhe N.SH - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe B.T - Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërin anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka’’ si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, pa e caktuar koston financiare.

- Ministria e Infrastrukturës në Nëntor të vitit 2017, pranon letrën informuese -BRIEFING PACKAGE nga kontraktori „Bechtel&Enka’’ për kompensimin e shumës prej 63 milion Eurove, të bazuar në tri pika dhe atë: Në piken A në emër të prolongimit të punës ka kërkuar shumën prej

16.6 milion Euro, në piken B, në emër të pajisjeve ka kërkuar shumën prej 36.3 milion Euro si dhe në pikën C në emër të pengesës në realizim të projektit, ka kërkuar shumën prej 10 milion Euro.

- Ministria e Infrastrukturës përmes shkresës nr. 9418, të datës 13.12.2017, kishte kërkuar nga “Hill International” të jap komentet apo vërejtjet lidhur me dokumentin “BRIEFING PACKAGE”, të dorëzuar nga kompania „Bechtel&Enka” në Ministrinë e Infrastrukturës në Nëntor të vitit 2017, dhe për këtë çështje, kompania mbikëqyrëse “Hill International” të përgatit opinion të detajuar.

- Opinionin i kompanisë mbikëqyrëse të projektit “Hill Internacional”, me datë 21.12.2017, i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës, që të jep opinionin e saj lidhur me dokumentin “BRIEFING PACKAGE”, të dorëzuar nga kompania „Bechtel&Enka”, me datë 13.12.2017.

- Vendim mbi Rekomandim i Komitetit Drejtues Ndërministror, me nr. Prot. 5237, i datës 05.06.2018, i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës ta aprovojë kërkesën për shpenzime shtesë për konzorciumin Bechtel Enka, në vlerë prej 45 milion euro dhe me shpenzime të TVSH prej 18%(në shumë prej 8 milion e 100 mijë euro), në shumë të përgjithshme prej 53 milion e 100 mijë euro.

- Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 01/50, i datës 05.06.2018, ka aprovuar kërkesën konzorciumit Bechtel & Enka për të ndarë mjetet me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për vazhdimin e ndërtimit e rrugës nacionale R6, auto-rruga ”Arben Xhaferi, Prishtinë – Hani i Elezit deri me 31.12.2018 sipas Marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës të datës 27.09.2017. Me të njëjtin vendim, ka autorizuar Ministrinë e Infrastrukturës për nënshkrimin e marrëveshjes me konzorciumin Bechtel & Enka për mbulimin e shpenzimeve në shumë prej 45.000.000,00 dhe shpenzimet e TVSH-së prej 18% në shumë prej 8.100.000,00 dhe pagesën e kësaj shume ta bëjë sipas afateve të pagesës në marrëveshje. Po ashtu, është obliguar Ministria e Financave të sigurojë mjetet për mbulimin e shpenzimeve sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe të bëjë alokimin e tyre në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës.

- Sipas gjetjes së gjykatë të gjitha faktet e lartcekura janë veprim të ndërmarr që nga hapi i par për realizimin e projektit R6, auto-rruga ”Arben Xhaferi, Prishtinë – Hani i Elezit, e deri të

Vendimi i Qeverisë që ka aprovuar kërkesën konzorciumit Bechtel & Enka, për pagesën prej 53 milion euro.

Gjykata në këtë çështje penale, për faktet kontestueshme, ka vërtetuar faktet si më poshtë:

- Gjykata, si fakte kontestues në këtë çështje penale, ka gjetur: a kanë pasur të drejtë të pandehurit në cilësi të personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërmnistror (KDNM) dhe N.SH - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe B.T - Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, që kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokoll 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018, siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, pa e caktuar koston financiare.

- Këtë fakt kontestues e kanë ngritur të gjithë mbrojtësit e të pandehurve dhe vetë të pandehurit si nënshkrues të marrëveshjes së lartcekur, ku një zëri kanë deklaruar se kanë pasur të drejtë ligjore për të nënshkruar marrëveshjen e lartcekur, ku sipas mbrojtjes së pandehurve vërtetohet:

- Nga mbrojtja e të pandehurit P.L, vërtetohet se pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27 Shtator 2017, me Bechtel Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën R6 Prishtinë-Hani i Elezit, krejt kjo ka ndodhur pasi që është informuar nga kryesuesi i njësisë implementuese R.Q, që projekti është në rrezik që të ndërpritet meqë MI nuk i ka kryer obligimet ndër vite ndaj Bechtel enkes, sipas gjetjeve të gjykatës këtë mbrojtje i pandehuri i lartcekur ska mundur ta vërtetoj me as një provë të vetem -faktur që qeveria e Kosovës i ka mbet borxh Bechtel enkes, i pandehuri ka deklaruar se ka kontaktuar me punë kryesin përfaqësuesin Riad të operatorit ekonomik Bechtel Enka, dhe është vë në dijeni për rrezikun e ndërprerjes së kontratës dhe shkuarjes në arbitrazh, atëherë në konsulta me njësinë implementuese, me shefi i zyrës së prokurimit publik, me zyrën ligjore në MI, me opinionin e KRPP-se, që të gjitha opinionet i kane sugjeruar që të nënshkruajë një kontratë të tillë pa kosto, nga kjo mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme në kundërshtim me rregullat e prokurimi publik pasi që as një dispozitë nuk e njeh nënshkrimin e marrëveshjes -aneks kontratës apo kontratës pa koso financiar, e në mungesë së këtij elementi e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, po ashtu gjykata gjen se e ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrime e marrëveshjes së njëjtë, pasi që vendimet për këtë projekt ka qenë kompetent ta

marrin anëtarët e KDNM, duke u bazuar në Statusin e Kodin e KNDM, e jo i pandehuri i lartcekur, ndërsa sa i përket mbrojtjes se kjo çështje do të shkojë në arbitrazh nuk është vërtetuar me as një provë të vetme, çoftë ekspertizë profesionale apo të ngjashëm, të pandehurit i është kërkuar që të deponojë në gjykatë ndonjë shkresë me njoftimin se kompani Bechtel enka do ta dërgojë këtë çështje-rast në arbitrazh, i pandehuri i lartcekur është përgjigjur se nuk kemi asnjë shkresë për këtë çështje, por vetëm verbalisht na është thënë, andaj sipas gjykatës fjalët e thëna ta pa deponuar në letër nuk e kanë rëndësinë e provës në çështje penale, andaj mbrojtja e të pandehurit është tersishte e pa bazuar.

- Nga mbrojtja e të pandehurit N.SH vërtetohet "pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27 Shtator 2017, me Bechtel Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në autostradën R6 Prishtinë-Hani i Elezit, krejt kjo ka ndodhur pas një takimi të përbashkët me ministrin P.L dhe R.Q, e kanë njoftuar për rrezikun e pezullimit të punimeve për këtë projekt si dhe nga drejtori i prokurimit B.T ka qenë shkresa për propozim të zgjatjes së afatit të punimeve pa kosto, dhe një opinion i datës 27.09.2017, me nr.prot.74/94, ka menduar se është në rregull dhe është në kuadër të kompetencave të tij dhe e ka nënshkruar marrëveshjen e lartcekur, nga kjo mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, po ashtu ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrimet e marrëveshjes së njëjtë, andaj sipas mbrojtjes së pandehurit para se me nënshkrua këtë marrëveshje, nuk e ka pa kontratën bazë pas së ka qenë konfidenciale, sipas vlerësimit të gjykatës është e pa kuptueshme se si ka arritur i pandehurit ta nënshkruajë një marrëveshje pa vlerësuar kontratën bazë ku sipas mbrojtjes së tij ka deklaruar se në këtë proces nënshkrimi i sekretarit është formalitet pasi që sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve e obligon sekretarin e një ministrie me u marrë me zbatimin e të gjitha kontratave, ky konstatim i të pandehurit sipas vlerësimit të gjykatës është i pa bazuar, po ashtu gjatë mbrojtjes së tij gjejmë se ka deklaruar se roli i komiteti drejtues ndërministror në kuadër të MI-së ka qenë organi më i lartë për miratimin e vendimeve lidhur me realizimin e projektit autostrada R 6, por në të kaluarën komiteti nuk e ka nënshkruar kontratën dhe nuk është anashkaluar komiteti drejtues ndërministror, sipas gjetjes së gjykatës i pandehuri ka pas njohuri të mjaftueshme për rolin KDNM në këtë projekt, ndërsa konstatimi se komiteti nuk e nënshkruar kontratën, një konstatim i të pandehurit është i gabuar në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e KDNM, pasi që vendimet për këtë projekt kanë qenë kompetent të marrin anëtarët e KDNM, e jo ministrin P.L dhe sekretarin N.SHn, dhe drejtori i departamentit B.T, si në rastin konkret, po ashtu gjykata vlerëson edhe pjesë e mbrojtjes së pandehurit se kompani Hill Internacional është përfaqësues i punëdhënësit, me kompetenca me

bërë kualitetin e cilësisë së punimeve, i çertifikon punët e kryera sipas kontratës, është e angazhuar për punimet profesionale pasi që zyrtarët e ministrisë nuk kanë pas kurrfarë përvoja dhe kanë angazhuar një kompani që është në këtë rast Hill Intenational, dhe nuk ka njohuri për marrëveshjen e lartcekur a janë konsultuar kompani Hill Internaciona, gjykata gjen se lenë për të kuptuar se ky personalisht nuk është konsultuar me opinionet e Hill Internacional, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës ka pas shumë shkelje gjatë këtij procesi pasi para nënshkrimi të marrëveshjes me Bechtel Enkës i pandehuri N.SH ju ka shmangur edhe opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional edhe pse e njëjti në mbrojtjen e tij ka pasur njohuri të mjaftueshme për rolin e kësaj kompanie në këtë projekte, po ashtu sipas mbrojtjes së tij është konstatuar se nuk është e vërtetë që zgjatja e afatit të përfundimi të punimeve e ka pru këtë pagesë prej 53 milion, pasi që unë fillon dhe mbaron me nënshkrimin e marrëveshje për zgjatjen së afatit të kontratës, sipas gjetjes së gjykatës i tërë procesi ka filluar me veprime të kundërligjshme që nga nënshkrimi i marrëveshjes nga i pandehuri N.SH, që e njëjta marrëveshje ka prodhuar pasoj të mëtutjeshme të kundërligjshme deri tek përfundimi i këtij projekti.

- Nga mbrojtja e të pandehurit B.T vërtetohet se pohon faktin se ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27.09.2017, pasi që paraprakisht është konsultuar me udhëheqësin e njësisë R.Q, dhe në konsultim me ministrin Palë Lekaj dhe sekretarin N.SHn, janë dakorduar që ta nënshkruaj këtë marrëveshje, pasi që sipas të pandehurit ky nënshkrim ka qenë në kuadër të kompetencave si zyrtar kryesor i prokurimit, pasi që ka qenë ministria që udhëhequr këtë projekt sepse kontrata bazë ka kaluar përmes ministrit dhe sekretarit të asaj kohe, dhe nënshkrimi i kësaj marrëveshje keni qene konform dispozitave të prokurimit publik, po ashtu nga mbrojtja e të njëjtit konstatohet se anëtarët KDNM kanë udhëhequr me projektin mirëpo përfitues i këtij projekti ka qenë MI dhe si e tillë kjo është nënshkruar nga ministri i MI, sekretari dhe drejtori i prokurimit sepse ka qenë projekt përfitues ka qenë MI dhe se normalisht anëtarët e KDNM ministra të tjerë nuk nënshkruajnë projekte në kuadër të MI, sipas gjetjes së gjykatës një konstatim i të pandehurit është i gabuar në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e KDNM, pasi më pas ka konstatuar se anëtarët e KDNM kanë menaxhua me projektin dhe kanë marrë vendime për projektin, KDNM ka udhëhequr me projektin sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës ,gjykata gjen njohurit e mjaftueshme të pandehurit për rolin e KDNM në këtë projekt, ndërsa për arsyet e lartcekura ndërmerr veprim ndryshe, ndërsa sipas të pandehurit marrëveshjes e lidhur me datë 27.09.2017, në këtë rast nuk kemi as kontratë e as aneks të ri por marrëveshje të nënshkruar e cila zgjidhë vetëm një problem mundësinë e vazhdimit të punimeve deri në realizimin e këtij projekti, nga kjo

mbrojtje gjykata gjen se veprimet e të pandehurit kanë qenë të kundërligjshme në kundërshtim me rregullat e prokurimi publik pasi që as një dispozitë nuk e njeh nënshkrimin e marrëveshjes -aneks kontratës apo kontratës pa koso financiar, e në mungesë së këtij elementi e njëjta marrëveshje është e kundërligjshme, po ashtu ka nënshkruar një marrëveshje pa qenë kompetent për nënshkrime e marrëveshjes së njëjtë, pasi që për vendimet për këtë projekt kanë qenë kompetent ti marrin anëtarët e KDNM, e jo ministrin Palë Lekaj dhe sekretarin N.SHn, dhe drejtori i departamentit B.T, si në rastin konkret, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës ka pas shumë shkele gjatë këtij procesi pasi para nënshkrimit të marrëveshjes me Bechtel Enkës i pandehuri B.T ju ka shmangur edhe opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional edhe pse e njëjti në mbrojtjen e tij ka pasur njohuri të mjaftueshme për rolin e kësaj kompanie në këtë projekte.

Lidhur me të lartcekurat, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike si më poshtë:

- Sipas Statutit dhe Kodit të Sjelljes të datës 20 Qershor 2012, që i përcakton përgjegjësitë e KDNM, pas administrimit të kësaj prove gjykata ka vërtetuar faktin se Komiteti drejtues ndërministror është organi kryesor dhe i vetëm vendimmarrës në realizmin e projektit duke përfshirë edhe anën financiare, gjithashtu do të kuptohet edhe roli i kryesuesit të KDNM-së, i cili është person kyç në funksionimin e këtij projekti, pra në këtë status do të kuptohet se janë të caktuara përgjegjësit në mënyrë të detajuar të komitetit ndërministror, nga kjo vërtetohet se të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, në cilësi të personave zyrtar në bashkëveprim dhe me dashje, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare ashtu që e kanë nënshkruar marrëveshje me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara Statutin dhe Kodin e Sjelljes, ku është konstatuar se KDNM është organi kryesor dhe i vetëm vendimmarrës në realizmin e projektit duke përfshirë edhe anën financiare, pasi që sipas gjetjes së gjykatës kompetent për të vendosur për këtë kanë qenë anëtarët e KDNM, pasi që të njëjtit kanë qenë kompetent që në mbledhjet e tyre të bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e marrëveshjes për zgjatje të afatit për përfundimit të punimeve dhe më pas ta merr miratim nga anëtarët e KDNM, kjo ka qenë kompetencë ekskluzivë e këtij komitetit për zhvillimin e projektit R6, auto-rruga ”Arben Xhaferi, Prishtinë – Hani i Elezit.

- Sipas vlerësimit të gjykatës duke ju referuar kushteve kontraktuale, pasi që çdo marrëveshje-aneks marrëveshja dhe kontratë, duke e bazuar në rregullat e prokurimi publik duhet të ketë elementin e kostos financiare, pasi që në të kundërtën konsiderohet si e pa ligjshme, pasi që sipas

Ligjit të prokurimit publik në rastin e nevojës së paraqitjes për ndryshmin dhe plotësimin e kontratës lejohet aneks kontrata ku palët i përcaktojnë kushtet e veçanta të kontratës, pasi që për të qenë një kontratë valide dhe të prodhojë efekt juridik duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme, ato janë aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit, objekti dhe baza e kontratës dhe kushtet e veçanta siç janë forma e kontratës, lidhje e kontratës me dorëzimin e sendit dhe dhënia e pëlqimit. andaj gjykata konstaton në rastin konkret e njëjta marrëveshje është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publikë për shkak të mungesës së kushtit- elementit kosto financiare, andaj e njëjta marrëveshje është kundërligjore, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës pagesa në shumës prej 53.1 milion Euro OE „Bechtel&Enka”, rrjedh se të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T kanë nënshkruajne marrëveshjen për shtyrje të afatit të punimeve, pa përcaktuar koston financiare, veprim ky që i ka hapur rrugën kompanisë kontraktuese që të kërkojë kompensim prej 53 milion Euro, pasi që të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, kanë qenë në njohuri se në vitin 2016 është draftuar aneks kontrata, për të njëjtën çështje dhe për interval të njëjtë kohor ku palët ishin pajtuar që në emër të shtyrjes së afatit të punimeve, kostoja shtesë të jetë 14,778,654.87 €, prandaj sipas gjetjes së gjykatës të pandehurit e lartcekur nuk kanë pasur asnjë arsye që të nënshkruajnë marrëveshje pa kosto, kur kanë qenë në njohuri të plotë se ekziston një draft kontratës, e dakorduar mes kontraktorit - operatorit ekonomik “Bechtel&Enka” dhe Ministrisë së Infrastrukturës, për intervalin e njëjtë kohorë në vlerë prej 14,778,654.87 €.

- Sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri P.L vërtetohet se ka pas njohuri për aneks kontrata, ku palët ishin pajtuar që në emër të shtyrjes së afatit të punimeve kostoja shtesë të jetë 14,778,654.87 €, pasi që në mbrojtjen e tij ka deklaruar “se kjo kosto ka qenë vetëm për zgjatjen e afatit dhe merrne kontratën edhe këqyrni nenin që përcakton se nëse nuk kryhen punimet në afatin e caktuar për shkak të mos pagesës së Qeverisë së RKS atëherë çmimi për zgjatje të afatit është 1 milion euro dhe nëse nuk del qajo shumë atëherë me të vërtetë keni të drejtë”, nga mbrojtja e të pandehurit N.SH vërtetohet se ka pas njohuri për aneks kontratën e vitit 2016, ka deklaruar “qysh me lexua kur marrëveshja është nënshkrua ma herët, asnjëherë nuk e kam lexuar asnjë opinion për këtë kontratë”, ndërsa nga mbrojtja e të pandehurit B.T vërtetohet se ka pas njohuri për aneks kontratën e vitit 2016, pasi që me datë 30 Shtator 2016, kompania mbikëqyrëse e projektit “Hill Internacional”, përmes dokumentit nr. P XK-000.1.00/GP/SO735, e kishte njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës se aneks kontrata për zgjatje të afatit për përfundim të punimeve, duhet t’i përmbaj dy kërkesat kryesore, siç janë kërkesat teknike dhe ato komerciale dhe për këtë shkresë ishte njoftuar edhe i pandehuri B.T në cilësi të Ushtruesit të Drejtorit të prokurimit në Ministri të Infrastrukturës dhe duke qenë në njohuri për aneks marrëveshjen në vlerë prej 14.778

milion Euro të arritur në mes MI-se dhe operatorit ekonomik “Bechtel Enka”, andaj ka pas njohuri se nuk ka qenë në kompetencë ti tij, të Ministrit dhe të Sekretarit Përgjithshëm që të nënshkruajnë marrëveshjen e datës 29.09.2017, andaj në rrethana e lartcekura të pandehurit në cilësi të personave zyrtar në bashkëveprim dhe me dashje, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare, pasi që përmes kësaj prove, demantohen qartë pretendimet i të pandehurit B.T se nuk kanë pas në disponim opinione e kompanisë „Hill International” dhe se nuk kanë qenë në njohuri lidhur me përmbajtjen e tij. Pikërisht prova si kjo, i kanë vu në dijeni të pandehurin se për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve, vlera reale që i takonin OE “Bechtel Enka”, ishte 14,778,654.87 Euro. Nga kjo është vërtetuar fakti se opinionet e kompanisë mbikëqyrëse Hill Interncional janë injoruar më qëllim nga të pandehurit e lartcekur.

- Nga dëshmia e dëshmitarit George Papaioannou është vërtetuar se ne nuk jemi konsultua nga MI për marrëveshjen e nënshkruar me datë 27.09.2017, një kopjen e këtij dokumenti e kemi marr në dhjetor të viti 2017, pasi që punëdhënësi MI na ka kërkuar neve me leshu një opinion dhe brenda 6 dite e kemi dhënë mendimin ton me datë 21 dhjetor 2017, letra referues është S1513, dhe përshtypja ime lidhur me dokumentin është shpreh në këtë shkresë, dy pikat B me vlerë prej 30.8 milion dhe artikulli C në vlerë prej 8.5 milion, të kërkesës së kontraktori Bechtel Enka , nuk ka pas dokumentacion mbështetës për me arsyetuar shifrat e parave, ndërsa shumen 14.778,00 milion euro, është e bazuar, pasi që opinionin jonë është dorëzuar drejt në kabinetin të ministrit MI, pranuesi personalisht e ka marr nga kabineti i ministrit, do te thotë na jena udhëzuar nga MI që këtë opinion të mos përcjellët përmes arkives por me shku përmes kabinetit të ministrit, kemi gjet si fakt se si MI ministria e ka pas opinionin ton që nga dhjetori i vitit 2017, pas 6 muajve të këtyre negociatave me kontraktorin është vendos mi paguar 53 milion euro, meqenëse se Hill International ska qen pjesë e këtyre përcaktimeve pasi që deri me datë 5 qershor 2018, ne sjemi kontaktua fare nga MI, 53.1 milion nuk eshte pagua me mbulua deficitin buxhetor, sipas gjetjes së gjykatës me këtë demanton qëndrimin e të pandehurit P.L, pasi që sipas dëshmitarit se qëllimi i kësaj shume 53.1 milion ka qen me i mbulua shumen gjithsej që e ka krijuar Bechtel enka, për me i përfundua punët deri me datë 31.12.2018, ndërsa sa i përket arbitrazhit dëshmitari përgjigjet se nuk e di se çfarë do të ndodhte në të ardhmen ka qen pjesë e përgjegjës tone ta këshillomi MI për buxhetin e planifikuar. Nga kjo dëshmi vërtetohet se MI nuk e ka kontaktuar as një herë kompania e lartcekur deri me datë 5 qershor 2018, dhe nuk e di si është ardhur deri tek pjesa e përcaktimeve për pagesën prej 53 milion, edhe pse me lartë ka deklaruar se nga kjo kërkesë vlera prej 14.778,00 milion euro, ka qenë e bazuar, ndërsa dy pikat B me vlerë prej 30.8 milion dhe

artikulli C në vlerë prej 8.5 milion, kontraktori nuk ka jep asnjë arsytim që ka qenë bindës për të lejuar shumën gjithsej të këtyre 46 milionëve me tvsh, mbështetja për këtë ka qenë pothuajse jo-ekzistente, nuk ka pas dokumentacion mbështetës për me arsyetua shifrën e parave, ku me datë 21 dhjetor 2017 e kemi dhënë opinionin tonë pranë MI, sipas gjetjes së gjykatës të njëjtit opinionë e kanë kërkuar të pandehurit P.L dhe E.B dhe të njëjtit opinionë e kanë fshehur të njëjtit me qëllime të realizimit të kërkesës së kundërligjshme prej 53 milion euro në dëme të buxhetit të Republikës së Kosovës, nga kjo dëshmi vërtetohet se MI nuk e ka kontaktuar kompania mbikëqyrëse Hill Internacional për konsultë profesionale për marrëveshjen e datë 29.09.2017, andaj si kompani nuk mundën me jepmi qëndrim rreth kësaj, sipas vlerësimit të gjykatës MI-kabineti i saj për çdo veprim për këtë projektë është dashtë që të kërkoj opinion- ndihmë profesionale nga kompania mbikëqyrëse „Hill International”, pasi që e njëjta kompani është e kontraktuar nga Qeveria e Kosovës, për mbikëqyrjen e këtij projekti dhe dhënien e ndihmës profesionale të stafit të MI, andaj të pandehurit e lartcekur në njohuri të plotë për rëndësinë e kompanisë mbikëqyrëse „Hill International”, me qëllimë nuk e kontaktuan fare si ka deklaruar edhe përfaqësuesi i kësaj kompanie të cekur më lartë, veprojnë në kundërshtime të plotë të rregullave që e kanë rregulluar këtë projektë, pasi që sipas provës materiale, shkresë nga kompania mbikëqyrëse „Hill International”, me nr. PXX-00001.00/GP/S1882, e datës 09.08.2018, vërtetohet dhe rezulton se kompania mbikëqyrëse „Hill International”, i ka përsëritur MI qëndrimet e saj lidhur me kërkesën e OE „Bechtel&Enka”, duke shtuar se marrëveshjet që nuk kanë të përcaktuara kosto financiare janë vështirë të interpretueshme, që le të kuptohet se marrëveshja e datës 27.09.2017, në të cilën nuk është përcaktuar kostoja financiare, ka qenë përtej dispozitave të kontratës bazë, kjo vërtetohet se kjo marrëveshje është nënshkruar në kundërshtim me dispozitat e kontratës bazë për këtë projektë.

- Nga dëshmitë e dëshmitarit L.ZH, ish ministër i MI, vërtetohet se menaxheri i kontratës është ai që e përcakton vlerën e kontratës në këtë rast është kompania mbikëqyrëse “Hill Internacional”, pas që lidhja e një marrëveshje pa kosto është gabim, pasi që ministri Lekaj nuk ka pas të drejtë të lidh marrëveshje pa mendimin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, sepse është kundërligjore, është gabim të lidhet një kontratë pa kosto sepse ju i hapni rrugë për definim apo rishqyrtim të asaj kostoje, pa kosto është e kundërligjshme dhe në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, sipas dëshmitarit është vërtetohet se është çështje ligjore se nuk kanë pas të drejtë MI e drejtuar nga i pandehurit P.L ta procedojnë marrëveshjen pa mendimin e menaxherit të kompanisë “Hill Internacional”, po ashtu vërtetohet se nuk ka qenë e nevojshme të bëhet pagesa prej 53milion, se ka qenë keq menaxhim i nënshkrimit të një shume që ka qenë në

kundërshtim me kontratën dhe rekomandimit të dhënë nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional, po ashtu nga kjo dëshmi vërtetohet se në rastin konkret ministër Lekaj nuk besoj se do të kishte shkuar në arbitrazh pa kurrfarë baze aktuale pasi që faturat janë paguar të gjitha, kjo vërtetohet me raportet financiare të qeverisë së Kosovës, të vlerësuara më lartë nga ana e gjykatës, nga kjo dëshmi vërtetohet se nga mesi i vitit 2016, nuk ka mujt me u kry kontrata sipas afatit kohor të përcaktuar deri në janar 2018, kanë biseduar me mbikëqyrësin e punimeve me menaxherin e kontratës Hill Internacional, për me e gjetë një zgjidhje, kemi ardhë në përfundim që në përputhje me kontratën të zgjasim afatin e punimeve për 11 muaj deri në fund të vitin 2018, e kemi shqyrtuar propozimin e Hillit dhe e kemi aprovuar, ka qenë zgjatja e afatit ka qenë 18 janar 2018 dhe deri me 31.12.2018, ndërsa kostoja e përgjithshme ka qenë 14 milion e 788 mije euro, është e drejtë e komitetit me marr një vendim të tillë e pastaj e kemi përcjellë ankës kontratën në qeveri dhe pas dy muajve, në dhjetor qeveria e ka kthyer me përgjigjen se nuk kemi nevojë me ndërhyrë në proces, me arsyeje se KNDM, ka kompetenca të mjaftueshme më u marr me të, kemi pritë me përfundua kjo kontratë, pastaj me zgjatë afatit, gjykata vlerëson se të gjitha veprimet janë marrë nga dëshmitari i lartcekur në pozitën e ish ministrit MI-ish kryesues i KDNM, në lidhje për këtë projekt janë marr sipas rekomandime të kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, pasi që i njëjtit dëshmitare decidvishtë ka deklaruar se çdo veprim për këtë projekt duhet të merret sipas rekomandime të kompanisë mbikëqyrëse Hill Intenacional, pasi që e njëjta e mbikëqyrë realizimin e kontratës për këtë projekt.

- Sipas vlerësimit të gjykatës duke ju referuar kushteve kontraktuale, është vërtetuar si më poshtë;
- *Me datë 01.07.2014 është nënshkruar kontrata në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe kompanisë fituese „Bechtel&Enka” me kosto totale prej 599,944,263,55 Euro dhe afati për kryerje të punimeve është paraparë të jetë 42 muaj konkretisht deri me datë 18 janar 2018, sipas vlersimit të gjykatës Kontrata përmban kushtet e veçanta dhe kushtet e përgjithshme ku përcaktohen obligimet dhe përgjegjësit si të punëdhënësit njëkohësisht edhe të punëmarrësit.*
- *Sipas kushteve të kontratës, neni 8.1 parasheh fillimin e punimeve, neni 8.2 përfundimin e punimeve, neni 8.3 programin e punimeve, neni 8.4 e trajton zgjatjen kohës për përfundim në rast se kontraktuesi nuk arrin të përfundoj kontratën në afatin e përcaktuar, neni 8.5 vonesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, neni 8.7 përcakton rastet kur vonesat shkaktohen nga kontraktori, sipas të cilit vlera e ndëshkimeve për vonesa, ka qenë 40.000.00 Euro në ditë, për çdo ditë vonesë. Sipas gjetjes së gjykatës duke u bazuar në këtë kushte të kontratës bazë ku palët ishin pajtuar që në emër të shtyrjes së afatit të punimeve kostoja shtesë të jetë 14,778,654.87 €, në*

opinionin e kompania mbikëqyrëse “Hill Internacional”, duke u bazuar në këtë është konstatuar se marrëveshja e datës 27.09.2017, në të cilën nuk është përcaktuar kostoja financiare, ka qenë përtej dispozitave të kontratës bazë.

- Neni 13.1 i kontratës parasheh të drejtën për të ndryshuar variacionet - alternativat që janë dhënë nga ofertuesit, por gjithashtu parasheh mundësinë që këto ndryshime të iniciohen edhe nga punëdhënësi, por sipas nën klauzolës (kushteve të veçanta), kjo nuk duhet të rezultojë me ngritje me të lartë se 10% të vlerës së kontratës.

- Neni 14 i kontratës e përcakton që, shuma e kontratës është fikse dhe neni 14.8 trajton pagesat e vonuara dhe sipas dispozitave të këtij neni, kontraktuesit i lejohet të marrë pagesa për financim për shumën e papaguar për gjatë periudhës së vonesës.

- Në nenin 16.1 të kontratës parashihen rastet kur kontraktuesi mund ta pezulloj ose të e reduktoj punën dhe për këtë mund të kërkojë kosto shtesë që do t'i shtohet çmimit të kontratës.

- Sipas kushteve të kontratës, konkretisht neni 14.8, nëse kontraktuesi nuk merr shumën e pagesave në përputhje me kushtet e kontratës, ka pasur të drejtë të marrë financim për shumën e papaguar, që do të thotë se nëse Qeveria vonohet me pagesa, çështja e financimit ka qenë e rregulluar me dispozitë të Kontratës sikurse ka qenë e rregulluar çështja në rast se kontraktori ka vonesa në implementim të kontratës, ku është paraparë që në rast se kontraktori ka vonesa në përfundim të punimeve të kontratës, atëherë Qeverisë së Kosovës do t'i paguhet shuma prej 40.000.00 Euro në baza ditore, kjo vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit George Papaioannou që ka deklaruar se në shtator të vitit 2016, neve na është kërkuar nga MI për me dorëzuar planin e ndryshimeve me shumën e dakorduar, duke vijuar marrëveshjen mes palëve për zgjatjen e kësaj periudhe 11 muaj e diçka, do të thotë ne është dashtë me bo kosoto për këtë periudhën e zgjatjes për periudhën që jemi dakordu, sipas ofertës financiare që e ka paraqit Bechtel enka, do te thotë shpenzimet e përgjithshme për operimet në vend ose lokacion, ka qen 1 milion euro për muaj, do të thotë 11.4 muaj nëse shumëzohen me 1 milion euro na ipen 11 milion euro, edhe 1 milion për sigurimin e vend punishtes, dhe tvsh 18% , arrin shumën 14.778 milion euro, kjo eshte paraqit nga ne si shume minimale që MI te ja paguaj për kontraktorin për këtë periudhën e zgjatjen prej 11 muaj deri me datë 21.12.2018, për zgjatjen e afatit për përfundimin e punimeve, un jam një prej atyre që e kam nënshkrua këtë vlerësim, kam pas përgjegjësin e plot ose përfundimtare për koordinimin dhe miratim, sipas gjetjes së gjykatës kjo shumë e përcaktuar nga kompania mbikëqyrëse Hill Internacional, është shuma e përcaktuar brenda kontratës bazë, ndërsa për

kohen e njëjtë, për situatën e njëjtë është paguar nga veprimet vazhdueshme të kundërligjshme të pandehurve P.L dhe E.B në vlerë prej 53 milion për operatorin ekonomik Bechtel enka, pasi që dy të pandehurit në vazhdimësi kanë fsheh dhe injoruar në tersi rolin e kompanisë mbikëqyrëse në këtë proces, me qëllim të realizimit të qëllimit të tyre të kundërligjshme ku si pasoj i shkaktojnë dëmë buxhetit të Republikës së Kosovës.

- Gjykata gjen se dispozitat e kontratës nuk e kanë paraparë mundësinë e shtyrjes së afatit me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, si rezultat i mungesës së buxhetit.

- Gjykata vërteton se marrëveshja e datës 27.09.2017, ka qenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, pasi që çdo marrëveshje-aneks marrëveshja dhe kontratë, duke e bazuar duke e bazuar në rregullat e prokurimi publik duhet të ketë elementin e kosto financiare, pasi që në të kundërtën konsiderohet si e pa ligjshme, pasi që sipas Ligjit të prokurimit publik në rastin e nevojës së paraqitjes për ndryshmin dhe plotësimin e kontratës lejohet aneks kontrata ku palët i përcaktojnë kushtet e veçanta të kontratës, pasi që për të qenë një kontratë valide dhe të prodhojë efekt juridik duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme, ato janë aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullneti, objekti dhe baza e kontratës dhe kushtet e veçanta siç janë forma e kontratës, lidhje e kontratës me dorëzimin e sendit dhe dhënia e pëlqimit. andaj gjykata konstaton në rastin konkret e njëjta marrëveshje është në kundërshtim me rregullat e prokurimi publikë për shkak të mungesës së kushtit- elementit kosto financiare, andaj e njëjta marrëveshje është kundërligjore, ndërsa marrëveshja ka qenë në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së që përcakton detyrat dhe përgjegjësit e komiteti drejtues ndërministror(KDNM), pasi që në kuadër të përgjegjësi të saj ka pasur përcaktimin e politikave dhe sigurimin e koordinimit ndërministror gjatë gjithë fazave të projektit. Përgjegjësi tjetër e KDNM është edhe shqyrtimi dhe aprovimi i të gjitha dokumenteve vendimtare të projektit, përfshirë këti termet e referencës për prokurim, kontratat etj, siç është marrëveshja në rastin konkret nuk është shqyrtuar nga anëtarët kompetent të KDNM, ndërsa marrëveshja ka qenë në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, kjo vërtetohet dhe rezulton se kompania mbikëqyrëse „Hill International”, i ka përsëritur MI qëndrimet e saj lidhur me kërkesën e OE „Bechtel&Enka”, duke shtuar se marrëveshjet që nuk kanë të përcaktuara kosto financiare janë vështirë të interpretueshme, që le të kuptohet se marrëveshja e datës 27.09.2017, në të cilën nuk është përcaktuar kostoja financiare, ka qenë përtej dispozitave të kontratës bazë, kjo vërteton se kjo marrëveshje është nënshkruar në kundërshtim me dispozitat e kontratës bazë për këtë projektë, pasi që të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, në cilësi të personave zyrtar në bashkëveprim dhe me dashje, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkalluar kompetencat dhe kanë nënshkruar marrëveshjen me numër

protokolli 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënëse në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, duke mos e përcaktuar koston financiare.

- Pasi që Ministri/Kryesuesi i Komitetit Ndërministror, Sekretari i Përgjithshëm dhe UD i Drejtorit të zyrës së prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës, nuk kanë qenë kompetent që të nënshkruajnë marrëveshje pa kosto, pasi që lidhur me këtë projekt infrastrukturor, KDNM, me datë 20 Qershor 2012, ka hartuar Statutin dhe Kodin e Sjelljes sipas së cilit përcaktohen përgjegjësitë e KDNM, Njësisë për Implementim të Projektit (NJIP), përgjegjësitë e Ekspertëve të Jashtëm dhe përgjegjësitë e Këshilltarit të Transaksionit (KT).

- Sipas Statutit dhe Kodit të Sjelljes, Komiteti Drejtues Ndërministror i Projektit përcakton politikat dhe siguron koordinim ndërministror gjatë gjithë fazave të projektit, dhe mbikëqyr implementimin me kohë të projektit. Roli i komiteti drejtues ndërministror në kuadër të MI-së ka qenë organi më i lartë për miratimin e vendimeve lidhur me realizimin e projektit autostrada R 6.

- NJIP është njësi për menaxhim teknik të projektit dhe shërben si sekretariat teknik për KDNM, është e ngarkuar me përgjegjësitë e përditshme për ekzekutim, menaxhim dhe mbikëqyrje të projektit dhe kjo njësi është parapa të përbëhet nga profesionistë të fushës ligjore financiare dhe njëkohësisht që të koordinon punën me zyrtaret e prokurimit dhe punon ngushtë me këshilltarin e transaksionit dhe konsulentë tjerë siç janë ekspertët e jashtëm që parashihen me Statut dhe Kod të Sjelljes.

5. Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin për pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit;

- Gjykata gjen se të pandehurit P.L dhe E.B, në vazhdimësi nga data 27.09.2017 e deri më 05.06.2018, në Prishtinë në cilësinë e personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërministror dhe E.B - Këshilltar i lartë politik i Ministrisë P.L, me dashje, në bashkëveprim me njëri-tjetrin, duke keqpërdorë detyrën dhe autoritetin zyrtar, kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, ashtu që duke i shfrytëzuar pozitat zyrtare, me rastin e zbatimit (ekzekutimit) të projektit “Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit R6”, sipas

kontratës nr. 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik me nr.04/L-042, Rregulloren nr.02/2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe Statutin dhe Kodin e Sjelljes së Komitetit Drejtues Ndërministror, ku sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri P.L si Kryesues i Komitetit Ndërministror të gjitha pengesat në lidhje për këtë projekte duhet ti adresojnë në mbledhjet e KDNM, që pas diskutimit dhe vlerësimit gjithëherë duke ju referuar opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse „Hill International”, të ndërmarrin veprime të mëtutjeshme, pasi që sipas gjetjes së gjykatës pas nënshkrimit të marrëveshjes së datë 27.09.2017, veprimet e tija të mëtutjeshme inkriminuese kanë qenë në bashkëkryerje me të pandehurin E.B, që gjykata do ti vlerësoj një nga një si më poshtë;

- Gjykata gjen se i pandehuri P.L, në cilësinë e kryesuesit të KDNM-së, pa e informuar dhe pa e marrë pëlqimin e anëtarëve të tjerë të KDNM-së, e ka angazhuar të pandehurin E.B në cilësinë e këshilltarit të tij politik, që të merr pjesë në negociatën me OE “Bechtel&Enka”, me qëllim të përcaktimit të kostos financiare sipas marrëveshjes së datës 27.09.2017 detyra këto jashtë fushëveprimit dhe kompetencave të cilat i ka këshilltari politik i pandehuri E.B,

- A ka pas të drejtë i pandehurit P.L, siç thot i njëjtit në mbrojtjen e tij të autorizoj këshilltarin e tij politik të pandehurin E.B, të takohet me përfasusest e OE “Bechtel&Enka”, thjeshtë për ta kuptuar kërkesën e tyre, e nuk thotë që për negociimin e vlerës së kërkuar prej 63 milion e paraqitur pran MI nga i njëjti operator ekonomik.

- Sipas gjetjes së gjykatës i pandehurit P.L nuk ka pas të drejtë as të caktoj as ta autorizoj askënd për takime-bisedime për të negociuar me OE “Bechtel&Enka”, pasi që këshilltari politik i pandehuri E.B nuk është personi kompetent për ta ndërmarr një veprim të tillë, pasi që pas vlerësimit të shkresave të lëndës vërtetohet se mbikëqyrësi i kontratës Hill Internacional është i vetmi person përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij projekti, pasi që i njëjti e mbikëqyrë realizimin e këtij projekti deri te përfundim i tij, andaj veprime e të pandehurit P.L lënë për të kuptuar shumë, pasi që qëllimi i tija i vetëm gjatë këtij procesi ka qenë vetëm shmangjja e procedurave të rregulla, pasi se i njëjtit në mbrojtjen e tij ka deklaruar se kanë vendosur të gjithë ministrat anëtarë të KDNM ti dërgojnë këshilltarët të komunikojnë me përfaqësuesin Bechtel Enka për ti kuptuar më qartë kërkesën e tij, ku është autorizuar edhe këshilltari politik i pandehuri E.B, sipas gjetjes së gjykatës kanë vazhduar veprimet e kundërligjshme të pandehurit P.L, ka autorizuar verbalisht të pandehurin E.B për të bërë negociatat me përfaqësuesin Riad, nga OP Bechtel enkes, në kundërshtim me detyrat dhe kompetencat e tij, duke anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse Hill

Internaciona i paguar nga Qeveria e Kosovës në vlerë 8 milionë, për ta mbikëqyrë këtë projekt si dhe për vlerësimin e punëve në teren, vlerësimin e cilësisë së punëve, si dhe certifikim i çdo fature të operatori ekonomik Bechtel Enkës për pagesë në MI, andaj i pandehuri P.L në mbrojtjen e tij ka deklaruar se kjo kompani nuk është mbi qeverinë dhe ministrin vetëm e ka rolin e punëkryerit dhe asgjë më shumë, gjykata vërteton se i pandehurit P.L e pranon se kompania mbikëqyrëse Hill Internacional sa i përket këtij projekti nuk është mbi të si ministri-por është si dëshiron ai ta ketë rolin kjo kompani si punë kryerës e asgjë më shumë, me këtë vërtetohet se i pandehuri P.L edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka injoruar në tersi rolin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional në këtë projekte.

- Gjykata gjen se i pandehuri E.B në cilësi të këshilltarit politik, sipas udhëzimeve dhe në bashkëpunim me të pandehurin P.L, duke i tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, në mënyrë të pavarur, jo zyrtare, ka zhvilluar biseda me përfaqësuesit e OE „Bechtel&Enka” dhe në pajtim të plotë me të pandehurin P.L, janë dakorduar që në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve deri më datë 31.12.2018, Ministria e Infrastrukturës të paguaj kosto financiare shtesë në llogari të OE „Bechtel&Enka” në vlerë prej 45 milionë Euro, e cila shumë me shpenzimet e TVSH prej 18% arrin shumën prej 53,100,000.00 Euro;

- A ka pas të drejtë i pandehurit E.B, të takohet me përfasusest e OE “Bechtel&Enka”, të zhvillojë biseda, për të negocuar me përfaqësuesit e OE „Bechtel&Enka” për ta kuptuar kërkesën e tyre.

- Sipas gjetjes së gjykatës i pandehurit E.B nuk ka pas të drejtë të marr pjesë në takime-bisedime për të negocuar me OE “Bechtel&Enka”, pasi që në cilësi të këshilltari politik i pandehuri E.B nuk është personi kompetent për ta nderrmar një veprim të tillë, pasi që kompetentë për vlerësimin e kërkesës së OE “Bechtel&Enka”, është mbikëqyrësi i kontratës Hill Internacional ku është i vetmi person përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij projekti, pasi që i njëjti e mbikëqyrë realizimin e këtij projekti deri te përfundim i tij, andaj veprime e të pandehurit E.B janë në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare, pasi se i njëjtit në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në takimin me datë 9 mars 2018 ,të KDNM ka prezentu përfaqësuesit e kompanisë Bechtel Enka, i kishte njoftuar anëtarët për kërkesat e tyre lidhur me zgjatjen e afatit të punimeve dhe dëmeve të pësuar ndë viteve për shkak të mos alokimit të duhur të mjeteve për financim të projektit, më pas të gjithë ministrat anëtar i këtij komiteti kanë autorizuar këshilltarët në mesin e tyre isha edhe unë si këshilltar i ministrit P.L për tu takuar me përfaqësuesit e Bechtel Enkës me qëllim të elaborimit të hollësishëm të kërkesës së tyre, sipas gjetjes së gjykatës vërtetohet se kanë vazhduar veprimet e kundërligjshme të pandehurit P.L që autorizon të pandehurin E.B, ku i njëjtit e pranon se në cilësi

të këshilltarit merr pjesë në negociata me përfaqësuesin Riad të OE "Bechtel enkes", në kundërshtim me detyrat dhe kompetencat e tij, duke anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse "Hill Internacional", e paguar nga Qeveria e Kosovës për ta mbikëqyrë këtë projekt si dhe për vlerësimin e kërkesës si në rastin konkret, më pas gjykata gjen se i pandehurit deklaron se këshilltarët e anëtarëve të komitetit nuk kishin vërejtje sa i përket arsyetimit të kërkesës së operatorit ekonomik Bechtel Enka dhe në të gjithë ishim dakorduar që për këtë çështje të vendoset nga qeveria, pasi që kjo çështje dilte jashtë dispozitave të kontratës duhej të merrej aprovimi i qeverisë, nga kjo vërtetohet se i pandehurit E.B në takim e KDNM jep konstatim se këshilltarët janë të pajtimi, sipas gjetjes së gjykatës çfarë roli kanë këshilltarët e anëtarëve të KDNM që me dhanë pajtim për një vlerë të lartë të kërkesës të operatorit ekonomik Bechteë enka, i njëjti e pranon se kjo kërkesë del jashtë kontratës, i pandehuri E.B nuk kanë pas të drejtë të merr fare më këtë kërkesë sepse kompetent që ta vlerësoj këtë kërkesë ka qenë mbikëqyrësit i kontratës Hill Internacional, e jo i pandehuri E.B në cilësi të këshilltarit politik.

- Sipas gjetjeve të gjykatës në takimin me datë 9 mars 2018, të KDNM i pandehuri P.L i ka njoftuar anëtarët e komitetit se arsyeja e këtij takimi është marrja e një vendimi lidhur me kërkesën e kompanisë ndërtuese në emër të shtyrjes së afateve dhe vonesave të pagesave që ti paguhen edhe 63 milionë euro, e për të cilat pas 4 muaj negociatash nga ekipi negociator i Ministrisë së Infrastrukturës është arritur të ulet në 45 milionë euro pa TVSH dhe se tashme ka ardhur deri në piken që ose të shkohet në ankimim, ose të behet pagesa, dhe u ka dhënë një mendim lidhur me mundësinë e shkuarjes në arbitrazh, e që sipas të pandehurit P.L kompania Bechtel & Enka deri më tani në historiatin e saj nuk ka humbur asnjë betejë dhe që nëse shkohet në këtë variant Buxheti i Kosovës do të humbiste shumë më shumë se sa shuma e pretenduar dhe kërkuar nga kjo kompani, nga ky procesverbal vërtetohet se i pandehuri P.L ka konfirmuar se ekipi i Ministrisë së Infrastrukturës pas 4 muaj negociatash ka arritur të ulet në vlerë 45 milionë euro pa TVSH, sipas gjetjes së gjykatës nuk qëndron mbrojtja e të pandehurve P.L dhe E.B që kanë deklaruar se në takimin me përfaqësuesit OE "Bechtel & Enka", janë realizuar për të kuptuar kërkesën e tyre, ndërsa në mbledhje e lartcekur i pandehurit P.L e konsideron të arritur që ekipi i Ministrisë së Infrastrukturës pas 4 muaj negociatash ka arritur të ulet në vlerë 45 milionë euro pa TVSH, pasi që sipas tij ministria e Infrastrukturës ka negociua me këtë me operatorin për uljen e çmimit, krejt si përfundim gjykata gjen se negociimin është bërë nga të pandehurit P.L dhe E.B sepse këtë e konfimon edhe i pandehuri P.L në këtë takime-procesverbal. Ndërsa sipas gjetjeve të gjykatës në takimin e radhës të KDNM, të datës 05.04.2018 i pandehuri P.L ka pohuar se MI ka negociuar shumë prej 63 milion të pretenduar nga Bechtel Enka, nëpërmjet këshilltarit E.B dhe kanë ardhë

në përfundim që pretendimet e Bechtel Enka nga 63 milion të zbriten në 45 milion(pa TVSH), tutje, i është dhënë fjala Këshilltarit të pandehurit E.B i cili ka informuar anëtarët për procesin e ri negocimit me kontraktuesin dhe se kontraktuesi ka paraqitur në mënyrë analitike koston e zgjatjes së kontratës, e cila ka ardhur si rrjedhojë e mos pagesave të shumave të parapara nga Qeveria e Kosovës ndaj kontraktorit, sipas gjetjes së gjykatës ky konstatim nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit E.B të dhëne në shqyrtim gjyqësor ku ka deklaruar se ka pas mungesë së alokimin të mjeteve në buxhet për këtë projekt dhe nuk ka deklaruar as një her për shkak të borxhit është kërkuar pagesa prej 53 milion euro, me pas i pandehurit E.B ka deklaruar në këtë mbledhje, se në këtë proces ri-negocimi ka qenë prezent edhe këshilltari i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë i cili e ka parë se kostoja e kontraktorit është kosto reale pa fitim, ku sipas gjetjes së gjykatës është takimi që ka marr pjesë një këshilltarë i MTI, ndërsa në takime prej 4 muaj negociatave ka qenë vetëm ekipi i MI, me ministër të pandehuri P.L dhe të pandehurin E.B pa i informuar fare antartë e KDNM për këtë negociata siç i quan i pandehuri P.L në procesverbalin më lartë, dhe krejt në fund i pandehuri E.B në këtë mbledhje ka konstatuar se kjo është kosto reale që e mbulon nevojën për ndërtim të kësaj pjese të autostradës për ta kompletuar kontratën me sukses, nga kjo vërtetohet se i pandehurit E.B merr pjesë në negociata me përfaqësuesin Riad të OE “Bechtel enkes”, në kundërshtim me detyrat dhe kompetencat e tij, duke anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse “Hill Internacional”. Pas këtij raportimi, anëtarja e KDNM-së ka deklaruar se duhet pasur vigjilencë lidhur me këtë çështje, në mënyrë që të jenë në një linjë, qoftë tash ky komitet me atë që ka qenë përpara sepse ka kundërthënie mes asaj çka ata kanë marrë vendim dhe asaj çfarë po bëjmë në tash, tutje ka shtuar se këshilltari ligjor i ka thënë se meqë është kontrata me para publike, nuk duhet të jetë konfidenciale, në mënyrë të shprehur nënin që përcakton penalet në rast të vonësive. Sipas gjetjes së gjykatës anëtarja e KDNM, A.R është e shqetësuar për situatën e krijuar tani në raport me komitetin e më hershëm që ka pas njohuri për vendimin e më hershëm por nuk është konstatuar në procesverbal, po ashtu ka kërkuar të ketë qasje në kontratë bazë për të konsultuar me nene përkatës ku parashihen penalti si në rastin konkret, ku sipas saj nuk është pajisur sepse kjo kontrata është konfidenciale, ka kërkuar që të ketë një opinion ligjor nga Ministria e Infrastrukturës dhe një opinion financiar nga Ministria e Financave që do t’ia lehtësonte punën shumë, të njëjtin mendim e ka shprehur edhe anëtarja V.LL. Lidhur me këtë, i pandehuri P.L ka shtuar se ajo që e shqetëson atë është stërzgjatja e marrjes së vendimeve në Komitetin Ndërministror, sepse kjo mund t’i kushtojë Qeverisë së Kosovës, sepse sipas informacioneve dhe të dhënave që i ka dhe përvojës që e ka kompania kontraktuese edhe në shumë shtete të botës, asnjëherë nuk i ka humbur rastet dhe kjo mund t’i kushtojë me së paku afro 180 milionë Qeverisë së Kosovës, sipas gjetjes së gjykatës i pandehuri P.L deri në këtë takim nuk

i ka pajisur as me kontratë bazë anëtarët e KDNM, në vazhdimësi e ka shfrytëzuar panjohurit e tyre në lidhje me këtë projekt duke ju cituar vazhdimisht arbitrazhin me shifra marramendëse sipas imagjinatës së tij të pa bazuar në asnjë prove konkret, kreu ky veprim me qëllim të realizimit në mënyrë të kundërligjshme të pagese prej 53 milion euro në favor të OE "Bechtel & Enka",

- Këto veprime vënë në pah dy parregullsi ligjore, me vet faktin se thuhet se kostoja fillestare është 63 milion Euro, ndërsa më pas, e njëjta kërkesë/shumë pas negociatave është reduktuar në 53.1 milion, pra pa e cekur se si është reduktuar-zvogëluar nga stafi i MI, i drejtuar nga ministri i pandehurit P.L në bashkëveprim me të pandehurit E.B, kur marrëveshja është nënshkruar me datë 27 shtator 2017, pa e përcaktuar koston financiare, dhe nga veprimet e kundërligjshme të vazhdueshëm të pandehurve të lartcekur në qershor të vitit 2018 është aprovuar nga Qeveria e Kosovës për kompensim të shumës prej 53.1 milion Euro.

- Sipas gjetjeve të gjykatës në takimin me datë 19.04.2018, të KDNM në të cilin takim i pandehuri P.L ia ka kaluar falën këshilltarit të pandehurit E.B, për të shpjeguar procesin e negociatave për ulje të shumës së pretenduar nga kontraktori dhe deri ku është arritur me këto negociata, i pandehuri E.B ka shpjeguar se kanë mbajtur një takim me këshilltarët e ministrave anëtarë të Komitetit (Këshilltari i Ministrisë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor, Këshilltari i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe ai i Tregtisë dhe Industrisë), të cilët janë takuar dhe kanë shtjelluar pretendimet e kontraktorit, ku prezent ka qenë edhe përfaqësuesi i kontraktorit "Bechtel & Enka", i cili kishte prezantuar shkurtimisht kërkesat për shpenzime indirekte të cilat ata i kanë si pasojë e zgjatjes së kontratës për 11.4 muaj dhe mbulimin e kostos së këtyre shpenzimeve. Si përfundim i pandehuri E.B në emër edhe të këshilltareve tjerë të pranishëm në atë takim, ka sugjeruar që kjo çështje të vendoset nga Komiteti Ndërmnistror në mënyrë që të rekomandohet me tutje për në Qeveri. KDNM në këtë mbledhje ka votuar me 3 vota pro (pro ka votuar edhe i pandehuri P.L) dhe 2 abstenime rekomandimin që çështja të dërgohet në Qeveri, sipas gjetjes së gjykatës i pandehuri E.B në vazhdimësi ka vepruar jashtë kompetencave të tij zyrtare duke marr pjesë në negociatë pa qenë kompetent për veprime të tilla, që në këtë procesverbale janë konstatuar si takime për negociatë me përfaqësuesin e kontraktorit "Bechtel & Enka", të cilat negociatë i ka kundërshtuar ashpër i pandehuri E.B në mbrojtjen e tij, siç thot është takuar më së shumti dy here me përfaqësuesin e kontraktorit "Bechtel & Enka", për ta kuptuar kërkesën e tyre, nuk ka pas negociatë siç pretendon PSRK-së, andaj gjykata gjen se mbrojtja e tij në kontest të takimeve të lartcekura është në kundërshtim me provat materiale-procesverbale që konstatohet se ka pas një

numër të madhe të takimeve për negociata nga stafi i MI afër 4 muaj, po ashtu duke u bazuar në procesverbalet e takimeve të KDNM, roli i të pandehurit E.B ka qenë dominant në këtë procese, këtë dominim e ka fituar në mënyrë të kundërligjshme nga i pandehuri P.L, sipas vlerësimit të gjykatës nuk është kompetent që këshilltari politik i pandehuri E.B, dhe ndonjë këshilltar tjetër të pajtohen për një vlerë të madhe të kërkesës të operatorit ekonomik që shkon në dëm të buxhetit të shtetit, pasi që anëtarët e KDNM, kanë qenë kompetent dhe të thirrur për vlerësimin e asaj kërkesë duke u bazuar në rekomandimet e kompanisë mbikëqyrës Hill Internacionaë, por me performimin e të pandehurit E.B në takimet e KDNM, vërtetohet dashja direkte e tij për realizimin e kundërligjshme të pagesës në vlerë prej 53 milion euro.

- Gjykata vërteton se i pandehuri E.B, në cilësi të këshilltarit të lartë të Ministrisë të Infrastrukturës, e që rrjedhimisht konsiderohet të jetë person zyrtar, në kundërshtim me detyrat dhe të drejtat e tij, merr pjesë në negociata për arritje të marrëveshjes me “Bechtel Enka”, pasi që caktohet nga vet Ministri i kësaj Ministrie, i pandehuri P.L.

- Edhe pse i caktuar nga Ministri, i pandehuri E.B, nuk është dashur që të merr pjesë në cilësi të negociuesit, e për më tepër të negocioj një propozim, i cili si i tillë më pas edhe është ekzekutuar, sepse një gjë e tillë nuk është e përfshirë në detyrat dhe kompetencat e tij sipas Ligjit dhe Statutit të projektit.

- Sipas gjetjeve të gjykatës në takimin me datë 31.05.2018, të KDNM, ka marrë pjesë edhe Kryeministri i Kosovës R.H. Në këtë takim, i pandehuri P.L ka bërë një ekspozitë të projekt-marrëveshjes me OP'' Bechtel Enka'', për shpenzime shtesë për shkak të zgjatjes së afatit të kontratës. Anëtari i KDNM-së B.H ka kërkuar që dokumentacioni rreth kësaj çështje të plotësohet edhe me Opinionin Ligjor të Departamentit Ligjor të MI-së, ngase sipas tij anëtarët e komisionit nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë vendim për këtë çështje, e po ashtu ka kërkuar shpjegim se pse anëtarët e KDNM-së nuk mund ta kenë kontratën e nënshkruar me Bechtel Enka, kur vendimi që kanë marrë derivon si pasojë e mos zbatimit të asaj kontrate. Lidhur me këtë, Kryeministri R.H ka kërkuar nëse ka vendim zyrtar nga Departamenti Ligjor i MI lidhur me ligjshmërinë e pagesave shtesë, e për të cilën çështje i pandehuri P.L ka thënë se nuk ka vendim zyrtar, por janë bërë konsultime me këtë departament dhe këshilltarin juridik të pandehurit E.B, ku kanë ardhur në përfundim se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që ky projekt-vendim të aprovohet për procedim të mëtejshëm. Kryeministri i Kosovës në këtë takim e ka ngarkuar të pandehurin E.B që të merr një opinion zyrtar nga Departamenti Ligjor i MI, e pastaj në mbledhjen e radhës të merret vendimi. Sipas vlerësimit të gjykatës deri me datë 31.05.2018, anëtarët e

KDNM nuk kanë qenë të pajisur me kontratë bazë e as më dokumentacion shtesë në lidhje me këtë projekte, hallin e kanë se si të votojnë rrethe kësaj kërkesë pa pasur dokumentacion në dorë për vlerësime, pasi që kështu dëshirojnë të pandehurit P.L dhe E.B, ku vërtetohet se të njëjtit deri me tani nuk i kanë njoftuar anëtarët e KDNM për rëndësinë e mbikëqyrësit të kontratës “Hill Internacional” në këtë projekte, vërtetohet se anëtarët e KDNM nuk i dinë dispozitat e kontratës bazë të këtij projekti, vetëm kanë njohuri rreth të thënave të pandehurve P.L dhe E.B, të dhëna imagjinare të pa bazuara në as një provë të vetme në këtë çështje penale.

- Andaj nga të lartcekurat gjykata vërteton dashjen me qellim të realizimit të planit të tyre, i pandehuri P.L me ndihmën e të pandehurit E.B, duke vepruar në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së Komitetit Drejtues Ndërministror, në tërësi kanë injoruar dhe anashkaluar anëtarët e tjerë të KDNM-se, siç është vërtetuar nga dëshmitë e anëtarëve të KDNM, në procesverbalin të vlerësuar më lartë, si dhe kanë anashkaluar Njësinë për Implementimin e Projektit, kjo vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit R.Q- udhëheqës i NJIP, ka deklaruar se nuk jemi konsultuar për kërkesën e OE Bechtel enka për vlerën prej 53 milion euro, organe këto të cilat sipas Statutit kanë pasur autorizime të zhvillojnë biseda dhe të marrin vendime për të gjitha çështjet që ndërlidhen me realizimin e këtij projekti, e për më tepër edhe për çështjen e zhvillimit të bisedimeve dhe përcaktimin e kostos për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve,

- Sipas gjetjeve të gjykatës në takimin e datës 05.06.2018, të KDNM, ku prezent ka qenë edhe Kryeministri R.H, i cili ka deklaruar se meqë janë siguruar dokumentet e kërkuar nga mbledhja e kaluar janë krijuar kushtet për të marrë vendim, ashtu që në këtë takim KDNM unanimisht ka miratuar vendimin që Qeveria e RKS-së ta aprovojë kërkesën për shpenzime shtesë për konzorciumin Bechtel Enka, në vlerë prej 45 milion euro dhe me shpenzime të TVSH prej 18% (në shumë prej 8 milion e 100 mijë euro), në shumë të përgjithshme prej 53 milion e 100 mijë euro, sipas gjetjes së gjykatës cila dokumente janë siguruar do të vërtetohet pas vlerësimi të dëshmimeve të dëshmitarëve- anëtarëve të KDNM, të n dëgjuar në këtë çështje penale si më poshtë;

- Gjykata, nga dëshmia e dëshmitarit B.H ka vërtetuar faktin se në takimin e KDNM, kryeministri z.Haradinaj në atë kohë më është drejtuar me fjalët “ Ministri Hasani , në qofëitse dështon kjo pagesë, Kosova do ti humb së paku 2-3 qind milion euro”, e sipas vlerësimit të gjykatës dëshmitari i lartcekur i gjendur në një pozitë të tillë, nga frika se siç thotë vetë nuk e ka marrë mbi supe rrethanën e pa vërtetë të paraqitur nga të pandehurit të lartcekur dhe nga kryeministri i asaj kohe

R.H, të pa bazuara në ekspertizë profesionale të kompania mbikëqyrëse të projektit Hill Internacional, nënë presionin e të thënave të lartcekura ka vendosur pro votimi të shumës prej 53 milion euro për OE Bechtel enka, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit kuptojnë se i njëjti nuk e ka pasur në shikim dhe vlerësim opinion ligjor të Ministrisë së infrastrukturës pasi që sipas tij ky opinion mundë të ket jetë negative, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit B.H vërtetohet se në takimet e tij si anëtarë i KDNM, nuk i është përmendur as një here kompani Hill Internacional, për here të pare për këtë kompani ka n dëgjuar gjatë marrjes në pyetje në polici dhe në prokurori, ku gjykata gjen se të pandehurit P.L dhe E.B kanë prezantuar rrethana, faktike të pa vërteta tek anëtarët e KDNM, duke ju thënë se i kemi dy rrugë të paguhet pagesa prej 53 milion euro kompanisë Bechtel enka, apo çështje të shkoj në arbitrazhë dhe qeverisë së RKS të pësoj dëme marramendëse.

- Gjykata, po ashtu nga dëshmia e dëshmitares A.R, ka vërtetuar faktin se në mbledhjen e KDNM, i pandehuri P.L ka konstatuar se tani e kemi opinionin ligjor, po nuk ja ka prezantuar anëtarëve të KDNM në shikim dhe vlerësim, dhe deklaroi se unë jam bazuar në mirëB.Tn e asaj që ju është sqaruar nga i pandehuri P.L në rastin e opinionit ligjorë e kam vendosur më tutje, që të procedohet në qeveri për vlerësim dhe votim, ku sipas vlerësimit të gjykatës mos ofrimin në shikim dhe vlerësimit i opinionit ligjor të MI, nga të pandehurit P.L dhe E.B, është bërë që të mos kuptohet nga anëtarët KDNM se i njëjti opinion ka qenë i dedikuar vetëm për nevoja të kabinetit e jo për çështjen në fjalë, po ashtu nga dëshmia e dëshmitares vërtetohet se në takimet e KDNM as një here nuk është diskutuar për marrëveshjen e zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve dhe nuk është përmendur as një here kompania Hill Internacional, pasi që gjykata gjen se të pandehurit P.L dhe E.B kanë prezantuar rrethana, faktike të pa vërteta tek anëtarët e KDNM, se i kemi dy rrugë të paguhet pagesa prej 53 milion euro kompanisë Bechtel enka, apo çështje të shkoj në arbitrazhë dhe qeverisë së RKS të pësoj dëme marramendëse të pa bazuar në as një provë të vetme, nga kjo vërtetohet se të pandehurit e lartcekur i jonë shmangë të marrin opinion ligjorë nga kompania Hill Internacional, e njëjta kompani e thirrur dhe e paguar nga RKS për këtë projektë.

- Gjykata, nga dëshmia e dëshmitarit V.LL ka vërtetuar faktin se si anëtar i komitetit ndërministror për këtë projekt, në takimet e këtij komiteti ka pasur diskutime për vlerën shtesë mbi 63 milion € që ka kërkuar kompania Bechtel Enka për shkak të vonesave të pagesave, sipas gjetjes së gjykatës kështu i është raportua në mbledhje nga kryesuesi i komitetit i pandehuri P.L dhe stafit i MI, i njëjti ka paraqit para anëtarëve të komiteti fakte të pa vërteta, të pa bazuar në

dokumentacione përkatës, qëllimi i tij dhe i të pandehurit E.B ka qenë vetëm të krijojnë një pasqyrë jo ekzistuese, duke shfrytëzuar B.Tn e anëtarëve të KDNM, të njëjtët anëtar për shkak të neglizhencës dhe mos hulumtimit të njohurive bazike rreth këtij projekti ju kanë besuar të pandehurve të lartcekur dhe nga të thënat e tyre janë shqetësuar se mos pagesa e një detyrimi të tillë mundë të përfundoj në arbitrazh, pasi që sipas dëshmitë së dëshmitarit të lartcekur gjykata gjen se mbledhjet e KDNM informatat kanë qenë të limituara nuk është përmendë asnjëherë kompani mbikëqyrëse Hill International, pasi që të pandehurit P.L dhe E.B në takimet e KDNM, e kanë fsheh ekzistencën e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, nga të njëjtit është fshehur edhe opinion ligjor me arsyetimin se të njëjtit opinion ligjor nuk është pranuar MI, gjykata gjen se dëshmitaret e lartcekur si anëtar i komiteti ndërministror ka qenë në presion nga prezantimi i të pandehurve P.L dhe E.B se në rast se mos aprovimit të kërkesës së Bechtel Enkes ky projekt të përfundoj në arbitrazh dhe dëmin që mundë të jetë shumë më i madh, në një situatë të tillë të krijuar me dashje direktet nga të pandehurit P.L dhe E.B, me qëllim të realizimit kundërligjshme të pagesës prej 53 milion, nga këto dëshmi vërtetohet se që tre anëtarët e KDNM, të n dëgjuar në këtë çështje penale vërtetojnë për gjykatën se nuk janë pajisur me kontratë bazë të këtij projekti, nuk janë pajisur me opinionin ligjor të MI, nuk janë njoftuar për opinionin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, nuk i kanë njoftuar as për rendësin e kësaj kompanie në këtë projekte, pasi që të pandehurit e kanë injoruar në tërësi rolin e kësaj kompanie mbikëqyrës Hill Internacional, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës e njëjta kompani me opinionet e saj do tju ndalonte të pandehurve të lartcekur që të njëjtit ti ndërmerrnin në vazhdimësi veprimet e kundërligjshme si në rastin konkretë, nga këtë dëshmi vërtetohet se për deri sa të pandehurve P.L dhe E.B që në mbrojtjen e tyre kanë deklaruar se anëtarët e KDNM janë pajisur me opinion ligjor dhe me shkresa tjera, ndërsa anëtarët e KDNM dëshmojnë të kundërte të vlerësuar si më lartë, andaj anëtarët e KDNM në mungesë të dokumentacioni përkatës duke u bazuar në deklaratimet të pavërteta të pandehurve të lartcekur kanë votuar pro vendimit për pagesë në vlerë prej 53 milion euro.

- Sipas gjetjeve të gjykatës injorimi i opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse „Hill International” vjen në pah edhe atëherë kur vet i pandehuri P.L këtë opinion fare nuk e ka prezantuar në asnjërin prej takimeve të KDNM-së të mbajtura për këtë qëllim, edhe për kundër faktit se i njëjti me datë 13.12.2017, së bashku me të pandehurin E.B, kanë kërkuar nga Drejtori i Njësisë së Implementimit të Projektit, që të kërkoj opinion/raport nga kompania mbikëqyrëse rreth kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për shumën prej 63 milion Euro, e cila kompani me datë 21.12.2017

kishte dhënë opinionin, sipas të cilit ka konsideruar se shuma e arsyeshme e kostos shtesë për zgjatje të afatit për përfundim të punimeve është 14.778,654.87 Euro;

- Andaj nga të lartcekurat në këtë çështje penale gjykata vërtetona se i pandehuri P.L me ndihmën e të pandehurit E.B, në drejtim të realizimit të qëllimit, respektivisht pranimit të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro, ka injoruar në tërësi opinionin e kompanisë mbikëqyrëse të projektit „Hill International”, sipas të cilit opinion shuma reale dhe e lejuar për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve është 14,778,654.87 Euro, pikërisht siç ishte paraqitur në pikën A të kërkesës së OE „Bechtel&Enka”, për dallim nga pika B dhe C e kërkesës për kosto financiare shtese, të cilat janë totalisht të pa arsyetuara dhe të papranueshme kjo vërtetohet edhe nga mbrojtja e të pandehurit P.L ka deklaruar se kompani mbikëqyrëse Hill Internacional, nuk është mbi ministria as mbi qeverinë është thjesht një pune kryerës asgjë më shumë, me këtë deklaram vërtetohet se i pandehuri P.L e ka injoruar në tersi opinionin e kompanisë Hill Internacional, po ashtu vërtetohet edhe nga mbrojtja e të pandehurit E.B ka deklaruar se nuk kam qenë person përgjegjës për sigurimin e dokumenteve mbështetëse si opinionin ligjor të kompanisë mbikëqyrëse në KDNM lidhur me kërkesën e Bechtel Enkes, pasi që këshilltarët politik nuk e kanë për detyrë të kujdesën as për bazë e as për mbështetje ligjore, sipas vlerësimit të gjykatës një konstatim i till nuk qëndron sepse i njëjtit ka pas njohuri për rolin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional në këtë projekt, po me dashje dirkete ju ka shmangë opinionit të kësaj kompanie.

- Sipas gjetjeve të gjykatës në vazhdim të realizimit të qëllimit të tyre i pandehuri E.B, me datë 01.06.2018 në kundërshtim të plotë me përgjegjësitë dhe detyrat e tij, në bashkëpunim me të pandehurin P.L, i kanë bërë presion Drejtorit të Departamentit Ligjor të MI-së, A.K, duke i kërkuar ndryshim të opinionit ligjor paraprak në të cilin opinion rreth kërkesës për kosto financiare, përveç tjerash është konstatuar se: „Opinione sqaruese të tjera konsideroj se mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe kompania mbikëqyrëse „Hill International” si përfaqësues i punëdhënësit dhe Departamenti i Prokurimit Publik si nënshkrues i kontratës të cilët posedojnë njohuri të specializuara”, ashtu që, për ta realizuar këtë i pandehuri E.B, përmes e-mailit zyrtar i ka dërguar të njëjtit, draft opinionin të shkruar që sipas tij duhej të ishte i shkruar dhe nënshkruar nga vet A.K, i cili nën presion është detyruar ta ndryshoj versionin origjinal të opinionit të parë ligjor dhe duke rënë nën presionin e të pandehurve ka hartuar versionin e ri të opinionit ligjor, duke e hequr emrin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill International”, dhe duke e lënë si palë kompetente për opinionet shtesë “personat përgjegjës për

menaxhimin e kontratës dhe Departamentin e Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës”, dhe ka konstatuar se opinionin ligjor i Departamenti ligjor ipet për kabinetin e ministrit dhe nuk është obligativ, të njëjtit opinion të MI nuk ju ka dhënë në posedim anëtareve të KDNM, e kanë fsheh të pandehurit P.L dhe E.B nga anëtarët e KDNM- me qellim që të njëjtit të mos e kuptojnë rolin e personave përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe konstatimin se i njëjtit opinion nuk është obligativ, veprime këto që i kanë paraprirë ekzekutimit të pagesës për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Gjykata, nga dëshmia e dëshmitarit A.K, ka vërtetuar faktin se i pandehuri E.B me dashje, në bash kryerje dhe në dijeninë e të pandehurit P.L i ka bërë presion dëshmitarit të lartcekur për hartimin e opinionit ligjorë, ashtu që me datë 31 maj 2018, e ka ftuar në zyrën e tij dhe i ka prezantuar një shkresë dhe i ka thanë se kërkesë e kabinetit të ministrit është që me e përpunua shkresën e lartcekur në opinionin ligjor, ku shkresa kishte përshkrimin se si ministria i 'a ka borxh 63 milion € “Bechtel Enka”, ku gjykata vërteton se të pandehurit e lartcekur donin që përmes dëshmitarit atë shkresë ta kthejnë në opinion ligjor, dëshmitari të njëjtën ditë i 'a ka kthye përgjigjen me email të pandehurit E.B, ku ka deklaruar që unë skam njohuri për kontratën me “Bechtel Enka”, ka kërkuar që për këtë opinion ju drejtoheni kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, i pandehuri E.B ditën e nesërme me datë 1 qershor 2018, e ka ftuar në zyre dëshmitarin dhe i ka prezantuar një opinion me emrin e tij dhe i kanë thanë me nënshkruaje, dëshmitari nuk e ka nënshkruar pasi që në katër rreshta ceket se kërkesat e “Bechtel Enka” për borxhin 63 milion € janë në harmoni me kontratën, ka vazhduar duke i bërë presion i pandehuri E.B dëshmitarit se “nuk bon ti me pengu kabinetin e ministrit dhe nëse nuk i zbaton politikat e kabinetit ke me pas pasoja”, nënë presion të njëjtën ditë dëshmitari e ka përgatit opinion sa i përket zgjatjes së kontratës, ndërsa sa i përket borxhit nuk ka dhanë opinion as nuk ka konfirmuar se na i kemi borxh “Bechtel Enka”, ndërsa lidhur me këtë temë për opinion sqarues ju kam thanë ju lutem drejtojuni kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, e në formë elektrike ja ka dërguar ministrit P.L pasi që i ka thënë i pandehuri E.B me ja dërgua ministrit, gjatë të njëjtës ditë e ka thirr urgjent i pandehuri E.B, duke i bërë presion të madhë me hjek kompaninë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, për arsye se i ka thanë se kjo nuk ka kompetencë për këtë punë, dëshmitari ka hartua opinionin ligjor e ka hjek vetëm fjalën të kompanisë “Hill Internacional”, pastaj ka mbetur prapë që opinionin sqarues rreth borxhit me kërkuar prej Departamentit të Prokurimit, nga personi përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe opinionin ligjor është vetëm për kabinetin dhe jo obligativ, prap e ka thirr i pandehuri E.B duke i bërë presion se pse nuk e ke hjek pjesën përfundimtare, dëshmitari nuk ka pranuar me bo ndryshime, e ka fik telefonin dhe ka

shkuar në shtëpi, gjykata vlerëson se të pandehurit E.B dhe P.L e kanë ditë në detaje rolin e kompanisë mbikëqyrës “Hill Internacional”, në këtë projekt, sipas gjykatës përpjekjet e mdhaja të pandehurve të lartcekur për fshehjen e rolit të kompanisë mbikëqyrës në këtë projekte vërtetohet se me dashje drektë kanë bërë presion në dëshmitarin që të largoj nga opinioni emrin e kësaj kompanie, për realizimin e veprimeve të kundërligjshme me qëllim të dëmtimit të buxhetit të Kosovës.

- Sipas gjetjes së gjykatës vërtetohet se i pandehuri E.B me qëllim të realizimit të veprimeve të tij, të kryera në bashkëveprim me të pandehurin P.L, me dashje dhe planifikim, e fton në zyrën e tij Drejtorin e Departamentit ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës A.K, të cilit i bënë presion me qëllim të imponimit të përmbajtjes së opinionit ligjor, ashtu që në imel zyrtare i'a dërgon draft opinionin që sipas tij do duhej të ishte, e i cili opinion ishte në kundërshtim të plotë me opinion e përpiluar nga dëshmitari A.K, i cili kishte konstatuar se opinione sqaruese lidhur me koston financiare mund të japin personat përgjegjës të kompanisë mbikëqyrëse „Hill Internacional” dhe Departamentit të Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës.

- Sipas gjetjes së gjykatës duke qenë në presion e të pandehurit E.B me rekomandim të të pandehurit P.L, dëshmitari A.K ka qenë i detyruar që ta bëj edhe një version tjetër të opinionit ligjor, në të cilin e ka hequr emrin e kompanisë mbikëqyrëse “Hill Internacional”, ashtu që si palë kompetente për dhënien e opinioneve shtesë, ka mbetur “Opinione sqaruese të tjera konsideroj se mund të japin personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe Departamenti i Prokurimit Publik si nënshkrues i kontratës të cilët posedojnë njohuri të specializuara dhe ky opinion ligjor është vetëm për kabinetin dhe nuk është obligativ”.

- Pra, nëpërmjet presionit të vazhdueshëm që e ka shkaktuar te Drejtori i Zyrës Ligjore, në mënyrë të qartë vërtetohet dashja, e të pandehurve P.L dhe E.B që me çdo kusht të arrihet deri të qëllimi që kjo pagesë të kryhet, veprime këto që i kanë shkaktuar dëm në shumë prej 38.32 milion Euro, buxhetit të Republikës së Kosovës.

- Prova me rëndësi në drejtim të vërtetimit të gjendjes faktike, që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, ishin edhe Opinione Ligjor me nr. protokollit 5142 dhe 5124, të datës 01.06.2018, në dy verizone dhe komunikimi përmes e-mailit zyrtar të datës 31.05.2018 dhe 01.06.2018, në mes të pandehurit E.B dhe dëshmitarëve A.K dhe R.Q. Përmes këtyre provave, janë vërtetuar veprimet inkriminuese të të pandehurve P.L dhe E.B.

- Sipas gjetjes së gjykatës Drejtori i Departamentit Ligjor A.K, në versionin e parë të këtij opinionioni ka konstatuar se „opinione sqaruese lidhur me koston financiare mund të japin personat përgjegjës të kompanisë mbikëqyrëse „Hill International” dhe „Departamentit të Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës”, duke mos qenë të kënaqur me këtë opinion, i pandehuri E.B me veprimet e tij ka ushtruar presion te i njëjti, me ç ‘rast si përfundim i gjithë kësaj, ka rezultuar që Departamenti Ligjor i MI-së, ka përgatitur opinion tjetër i cili ishte në favor të kërkesës së të pandehurve të lartcekur dhe si rrjedhojë e kësaj të njëjtit kanë anashkaluar kompaninë mbikëqyrëse të projektit, përmes opinionit të dytë të lëshuar, të pandehurit P.L dhe E.B, kanë tentuar të përgatisin bazën ligjore e cila do të arsyetonte veprimet inkriminuese të tyre për finalizimin e pagesave shtesë në shumë prej 53.1 milion Euro, ashtu siç është sqaruar deri më tani, ajo çka vërtetojnë këto prova materiale, është konfirmuar edhe nga dëshmitari A.K, e cila dëshmi është në përputhje të plotë me këto prova.

- Po ashtu gjykata gjen se në versionin e dytë të opinionit të zyrës ligjore të MI është theksuar se lidhur me çështjen e kompensimit duhet të merret opinion nga personat përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe Departamenti i Prokurimit Publik si nënshkrues i kontratës të cilët posedojnë njohuri të specializuara, mirëpo ky opinion i zyrës ligjore ishte injoruar në tersi nga të pandehurit.

- Sipas gjetjeve të gjykatës vërtetohet se i pandehuri P.L si kryesues i KDNM-së, me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë me Statut për këtë projekt, duke fshehur dhe mos paraqitur para anëtareve të tjerë të KDNM-së gjendjen reale, respektivisht opinionin e kompanisë mbikëqyrëse „Hill International” dhe duke prezantuar opinionin ligjor të zyrës ligjore në versionin të cilin se bashku me të pandehurin E.B ia kishin imponuar Drejtorit të Zyrës Ligjore A.K, i ka shtyrë anëtarët e KDNM-së të cilët të gjendur në një situatë të tillë para fakteve të pa vërteta, që në takimin e datës 05.06.2018, të marrin vendim duke i rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të aprovoj kërkesën e OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro në emër të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve, e që përfundimisht, me datë 05.06.2018, Qeveria, e gjendur në një situatë të tillë bazuar mbi faktet e prezantuara nga i pandehuri P.L dhe pas propozimit të tij, ka marrë vendim që OE “Bechtel&Enka”, t’i paguhet shuma prej 53,100,000.00 Euro.

- Gjykata nga mbrojtja e të pandehuri E.B konstatohet se ka deklaruar se unë i kam dërguar A.Kt një shpjegim e quajtur memo shpjeguese, më pas ia kam dërguar edhe një shkresë tjetër, më pas drejtori i departamentit ligjor i kishte dërguar dy drafte të opinioneve ligjore, takimin e datës 1 qershor 2018, ishin njoftuar anëtarët e komitetit drejtues lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor, të njëjtën datë Qeveria e Kosovës ka mbajtur takimin ku si pikë e rendit të ditës ishte aprovimi i kërkesës së operatorit ekonomik Bechtel Enka, për pagesën e 53 milion eurove, ndërsa sa i përket deklaratave të dëshmitarit A.K për presion apo ndikim ndaj tij lidhur me përmbajtjen e opinionit ligjor nuk qëndrojnë, gjykata gjen se deklaratime e të pandehur të lartcekur nuk gjej mbështetje në prova dhe në dëshminë e dëshmitarit A.K të n dëgjuar në këtë çështje penale, pasi që dëshmitari i n dëgjuar ka sqarua në detaje veprimet e kundërligjshme të pandehurit E.B, pasi që i njëjtit i ka bërë presion që nga opinionit ligjor të largoj emrin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional, kjo e thënë e dëshmitarit gjen mbështetje në opinionin në versionin e dytë ku me insistimin e të pandehurit E.B është larguar nga opinionit ligjor emrin Hill Internacional, dhe është dërguar në ora 16:03 min, në imel e të pandehurit P.L, ku cc ka qenë edhe i pandehurit E.B ku sipas vlerësimit të gjykatës i pandehuri P.L ka qenë në dijen dhe me dashje e ka udhëhequr procesin e kërkesave të pandehurit E.B në drejtim të dëshmitarit A.K, duke i bërë presion për përpilimin dhe ndryshimin e opinionit ligjor .

- Gjykata nga mbrojtja e të pandehurit E.B vërteton faktin se pas kërkesës zyrtare të datës 22 shkurt 2018, kompania Bechtel Enka e kishte dorëzuar për pagesë prej 53 milion euro, ministri Lekaj ka mbajtur takim me këshilltaret e kabinetit të tij së bashku me kryesuesin e zbatimit të projektit R.Q dhe kemi kërkuar që të vlerësohet kjo pagesë nga kompania mbikëqyrëse “Hill International”, ku të njëjtës kompani mbikëqyrëse i kishin dhënë afat një jave (7 ditë) për përgjigje lidhur me kërkesën e operatorit “Bechtel Enka”, më pas kompania mbikëqyrësi “Hill International”, ka kthyer përgjigje të dorëzuar në formë jo zyrtare, jo nëpërmes arkivit të ministrisë me protokoll zyrtar, unë nuk kam pasur për detyrë as ti pranoj shkresat as ti përcjelli si këshilltar politik, sipas gjetjes së gjykatës mbrojtja e të pandehurit E.B është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit B.A i n dëgjuar në këtë çështje penale si dhe me provat materiale.

- Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit B.A, vërteton se opinion e kompanisë mbikëqyrëse ‘Hill international’ të dërguar në MI, me datë 21 dhjetor 2017, e ka pranuar personalisht vet dhe në parim dhe çdo dokument që e ka pranuar e ka përcjell në parim tek i pandehuri E.B, dhe sipas udhëzimit të tij e ka dërguar dokumentin në adresën përkatëse, gjykata gjen se i pandehuri E.B e ka pranuar opinionin e lartë cekur, duke marr parasysh se në vazhdimësi të pandehurit P.L dhe

E.B në takimet e KDNM, e kanë fsheh ekzistencën e kompanisë mbikëqyrës Hill Internacional, nga të njëjtit është fshehur edhe opinion ligjor me arsyetimin se të njëjtit opinion ligjor nuk është pranuar MI, edhe pse i pandehuri E.B e pranon se kanë paraqitur kërkesë për këtë opinion për kompaninë Hill Internacional, si dhe nga dëgjimi i përfaqësuesit të kompanisë Hill Internacional është vërtetuar se opinion ligjor e kemi dërguar direkt në kabinet e MI pa vulë të protokoli sepse kështu na është kërkuar nga MI, ku si dëshmi për pranimin personal të opinion ligjore nga ana e dëshmitarit B.A, përfaqësuesi i Hill e kanë dërguar shkresën në polici, të cilën shkresë pas shikimi nga ana e dëshmitarit B.A në polici dhe në gjykatë e ka pranuar se personalisht e ka pranuar opinion ligjor të Hill Internacional, andaj gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitari të lartcekur gjen mbështetje në provat material, në dëshminë e dëshmitareve të dëgjuar në këtë çështje penale, dhe nga të lartcekurat vërtetohet se opinion ligjor i Hill Internacional, është dërguar në MI, me datë 21 dhjetor 2017, e ka pranuar personalisht dëshmitari B.A, dhe në parim si çdo dokument që e ka pranuar e ka përcjell në parim tek i pandehuri E.B,e i njëjti në bashkëkryerje me të pandehurin P.L e kanë fsheh këtë opinione, siç e kanë fsheh gjatë gjithë këtij procesi ekzistencën e kompanisë mbikëqyrëse Hill internacional, edhe gjithë kjo me qëllim të realizimit të veprime të vazhdueshme të kundërligjshme të tyre.

- Sipas vlerësimit të gjykatës krejt kjo duke u bazuar në faktin se kompania mbikëqyrëse „Hill International” ka dhënë opinionin se vlera prej 14,778,654.87 Euro, është vlerë reale dhe e vetmja që duhet t’i paguhet OE „Bechtel-Enka” në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve për projektin në fjalë, me të cilin vlerësim është pajtuar edhe OE „Bechtel&Enka”²⁴, si dhe duke iu referuar diferencës me shumën prej 53,100,000.00 Euro të aprovuara për pagesë, rrjedhë se si pasojë e veprimeve inkriminuese të të pandehurve, buxhetit të Republikës së Kosovës i është shkaktuar dëm në shkallë të madhe në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

- Opinionin i kompanisë mbikëqyrëse të projektit “Hill Internacional”, me datë 21.12.2017, bëhet një elaborim dhe përshkrim i gjendjes që nga nënshkrimi i kontratës e deri tek situata ku kërkohet nga kontraktori që t’i kompensohen 53.1 milion Euro, të vlerësuar si më poshtë:

- Sipas kompanisë mbikëqyrëse të projektit, çështja e zgjatjes së kontratës nuk ka qenë çështje në vete, pasi që drejtpërdrejtë lidhet me draft aneks - kontratën e dakorduar me datë 30.09.2016,

²⁴ Drafti i Aneks-kontratës në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bechtel-Enkës, e datës 15.08.2016.

me ç' rast palët përfundimisht dakordohen për zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve deri me datë 31.12.2018, me kosto prej 14. 778 milion Euro, përfshirë TVSH-në.

- Sipas opinionit, gjithashtu thuhet se në bazë të takimeve në MI dhe BEGP në Maj, Qershor dhe 30 Shtator 2016, ka lëshuar dokument final nr. P XK00001.0/GP/S0735, ku determinohen kushtet e marrëveshjes, por edhe pse palët ishin dakorduar, dokumenti nuk ka arritur të nënshkruhet, pasi që propozimi i Komitetit Ndërministror, nuk aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

- Ky dokument i marrëveshjes kishte paraparë që të zgjatet afati i kontratës për përfundim të punimeve shtesë edhe për 11 muaj e 13 ditë, konkretisht deri me 31/12/2018, me një kosto prej 14,778,654.87 Euro.

- Nga të lartcekurat gjykata vërteton se të pandehurit, përpos që në vazhdimësi kanë injoruar opinionin e mbikëqyrësit të projektit, të njëjti kanë anashkaluar krejtësisht NJIP-in edhe përkundër që Statuti i miratuar për këtë projekt, kërkon që të gjitha aktivitetet që parashihen, duhet të koordinohen përmes kësaj Njësie, ku në detaje është bërë vlerësimi i dëshmisë së dëshmitarit R.Q, drejtor i NJIP, që ka deklaruar se nuk jemi konsultuar nga MI për pagesën prej 53 milionë euro, nga kjo vërtetohet se është anashkaluar kjo njësi nga të pandehurit e lartcekur.

- Provat materiale, si Procesverbali i mbledhjeve të 49 dhe 50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 29.05.2018 dhe 05.06.2018, kanë vërtetuar faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës, fillimisht me 29.05.2018 në mbledhjen e 49, ka futur në rëndë dite shqyrtimin e kërkesës se konsorciumit „Bechtel&Enka” për shpenzime shtesë, sipas aneksit të kontratës për projektin „Rruga 6” (Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit). Në këtë mbledhje, ka prezantuar edhe i pandehuri P.L, i cili ka bërë elaborim të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumë prej 53 milion Euro. I njëjti me këtë rast e pohon faktin se ka nënshkruar aneks marrëveshjen me OE „Bechtel&Enka”, për zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve, mirëpo nuk e ka potencuar faktin se kjo marrëveshje ishte nënshkruar pa u përcaktuar kostoja financiare. Referuar kësaj prove, rrjedh se i pandehuri P.L e ka konsideruar si të arritur faktin se nga kërkesa prej 63 milion euro, përmes negociatave intensive me OE „Bechtel&Enka”, kjo shumë është zbritur në 53 milion Euro. Gjithashtu, përmes kësaj prove është vërtetuar edhe fakti se të pandehurit P.L dhe E.B, kanë negociuar në vazhdimësi me OE „Bechtel&Enka” lidhur shumë për pagesë për OE „Bechtel&Enka”. Në këtë mënyrë, demantohet pretendimi i të pandehurve se të njëjtit nuk kanë zhvilluar biseda-negociata me këtë OE, lidhur me shumë e kërkuar nga ky operator. Po ashtu,

nga kjo provë vërtetohet edhe fakti se i pandehuri P.L, nuk e ka informuar kabinetin qeveritar lidhur me opinionet e kompanisë mbikëqyrëse të projekti „Hill International”, sipas së cilës shuma reale që do duhej të kompensohej OE „Bechtel&Enka”, ishte 14,778,654.87 Euro. Kjo provë pasqyron edhe faktin se në këtë takim, Ministri Besim Beqaj, ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me kërkesën e OE „Bechtel&Enka” për pagës të shumë prej 53 milion Euro, pasi që sipas tij, nuk është ofruar dokumentacioni bazë dhe se kjo çështje duhet të shqyrtohet nga Komiteti Drejtues Ndërmintoror i projektit në fjalë. Ndërkaq, referuar procesverbalit të Qeverisë të datës 05.06.2018, në mbledhjen e 50 të saj, është vërtetuar fakti se në rënd dite nuk figuronte shqyrtimi i kërkesës së OE „Bechtel&Enka”, mirëpo pavarësisht kësaj, në fillim të mbledhjes, është hapur për diskutim kjo çështje, ku i pandehuri P.L, përsëri e ka arsyetuar kërkesën e OE „Bechtel&Enka”, duke i dhënë të drejtë të njëjtës në këtë kërkesë, me arsyetimin se kjo kompani mundë ta paditë Qeverinë në Gjykatën e Arbitrazhit. Edhe në këtë takim, Ministri Lekaj tani i pandehur, nuk ka ofruar për Kabinetin Qeveritar, asnjë dokumentacion, për çka edhe ka krijuar një situatë të atillë që Kabineti Qeveritar të vendos për këtë kërkesë, edhe përkundër faktit se nuk ka qenë në kompetencë të tyre, ngase referuar Statutit dhe Kodit të Sjelljes së projektit në fjalë, këtë kompetencë e kishte KDNM. Ky fakt vërtetohet edhe me një vendim të Qeverisë së Kosovës të vitit 2016, kur nuk e ka pranuar për shqyrtim kërkesën e ish Ministrit L.ZH për të njëjtën çështje, me arsyetimin se kjo është kompetencë ekskluzive e Komitetit Drejtues Ndërmintoror (KDNM).

Gjykata vlerëson se provat e lartcekura të arsyetuara si me lartë, përshkruajnë në mënyrë të detajuar veprimet, vendin, kohën e kryerjes, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale si dhe dëmin e shkaktuar Buxhetit të Republikës së Kosovës, në këtë mënyrën është përshkruar si në pikën I, dhe II, të këtij aktgjykimit, më këtë vërtetohet se i pandehuri P.L në bashkëkryerje me të pandehurit N.SH Sharti dhe B.T, si dhe në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurin E.B kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

6 .Qëllimi për kryerjen e veprës penale dhe keqpërdorimi apo tejkalimi i autorizimeve apo mos përmbushja e detyrave zyrtare:

Qëllimi për ta kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar është një nga elementet esenciale të veprës penale, pra për tu gjetur fajtor një person për këtë vepër penale, personi zyrtar duhet ti tejkaloj kompetencat e tij ose mos ti përmbush ato me qëllim të përfitimit për vete apo për personin tjetër, apo shkaktimit të dëmit dikujt tjetër.

Pra në rastin konkret duhet të shqyrtohet çështja se me nxjerrjen e vendimeve, apo me ndërmarrjen e veprimeve nga ana e të pandehurve P.L , N.SH, E.B dhe B.T, a i'u është mundësuar përfitim të ndonjë dobie dikujt tjetër, a ka përfituar për vete apo i ka shkaktuar dëm ndokujt tjetër.

Qëllimi i të pandehurve P.L, N.SH dhe B.T, ishte që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në mënyrën e përshkruar si në pikën I, të këtij aktgjykimit.

Pra, qëllimi dhe dashja vërtetohet nga fakti se që të tre të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T ishin në dijeni, se me veprimet e veta janë duke tejkuluar kompetencat e tyre të përshkrhuara në detaje si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimit, të cilat veprime janë vërtetuar në bazë të provave të elaboruara më lartë, për çka edhe gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e tyre konsumohen elementet e veprës penale se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me vet faktin se të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T ne dashje duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkuluar kompetencat me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në atë mënyrë që të njëjtit, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë nënshkruar marrëveshjen me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në një të anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nga data 18.01.2018 siç ishte e përcaktuar në kontratën bazë, deri me datën 31.12.2018, saktësisht edhe për 347 (treqind e katër dhjetë e shtatë) ditë të tjera, duke mos e përcaktuar koston financiare, veprim ky që i lë hapur mundësinë OE “Bechtel&Enka” që me datë 27.11.2017 të paraqes pranë punëdhënësit kërkesën për pagesën e shumës shtesë „Briefing Package” në vlerë prej 63 milion Euro në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve, e cila kërkesë me pas ka zbritur në vlerën prej 53,100,000.00 Euro, ku si pasojë e këtyre veprimeve të të pandehurve, sipas rekomandimit të Komitetit Drejtues Ndërmarrës, kërkesa e OE „Bechtel&Enka” është aprovuar për pagesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/50 i datës 05.06.2018, shumë kjo e cila është në kundërshtim të plotë me opinionin e mbikëqyrësit të kontratës “Hill Internacional” në lidhje me pakon informative të kontraktuesit të titulluar

“autorizim për zgjatjen e afatit kohor për përfundimin e punës dhe adaptimit të drejtë çmimi kontraktues” i datës dhjetor 2017, me ç ‘rast, si pasojë e veprimeve të të pandehurve buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

Gjykata vërteton se në raport me të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, PSRK të njëjtit i kishte akuzuar se duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat dhe nuk i kanë përmbushë detyrat zyrtare, mirëpo gjykata pas administrimit të provave si dhe analizimit të dispozitave në të cilat janë përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ku pretendohet se të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T kishin vepruar në kundërshtim me përgjegjësitë e tyre ligjore, gjykata në rastin konkret ka ardhur në përfundim se nuk kemi të bëjmë me mos përmbushje të detyrave zyrtare, por në veprimet e të pandehurve P.L, N.SH dhe B.T kemi të bëjmë se duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare si element i veprës penale nga neni 422 par.1 të KPRK-së, siç është përshkruar në dispozitivin **I**, të këtij aktgjykimit.

Në rastin konkret duhet të shqyrtohet çështja se me ndërmarrjen e veprimeve nga ana e të pandehurve P.L dhe E.B, a i'u është mundësuar përfitim të ndonjë dobie dikujt tjetër, a ka përfituar për vete apo i ka shkaktuar dëm ndokujt tjetër.

Qëllimi i të pandehurve P.L dhe E.B, ishte që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, në mënyrën e përshkruar si në piken **II**, të këtij aktgjykimit.

Pra, qëllimi dhe dashja vërtetohet nga fakti se që të dy të pandehurit P.L dhe E.B ishin në dijeni, se me veprimet e veta janë duke tejkaluar kompetencat e tyre të përshkruara në detaje si në dispozitivin **II**, të këtij aktgjykimit, të cilat veprime janë vërtetuar në bazë të provave të elaboruara më lartë, për çka edhe gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e tyre konsumohen elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me vet faktin se të pandehurit P.L dhe E.B në vazhdimësi nga data 27.09.2017 e deri më 05.06.2018, në Prishtinë në cilësinë e personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërministror dhe E.B - Këshilltar i lartë politik i Ministrit P.L, me dashje, në bashkëveprim me njëri-tjetrin, duke

keqpërdorë detyrën dhe autoritetin zyrtar, kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim që t'i shkaktojnë dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në dobi të personit tjetër, ashtu që duke i shfrytëzuar pozitën zyrtare, me rastin e zbatimit (ekzekutimit) të projektit "Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit R6", sipas kontratës nr. 017/2014 të datës 01.07.2014, kanë vepruar në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik me nr.04/L-042, Rregulloren nr.02/2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe Statutin dhe Kodin e Sjelljes së Komitetit Drejtues Ndërmator, në mënyrë më të detajuar si në pikat e dispozitivit **II**, të këtij aktgjykimi, me ç' rast, si pasojë e veprimeve të të pandehurve buxhetit të Republikës së Kosovës, i është shkaktuar dëm në vlerë prej 38,321,346.00 Euro.

Veprimet e të pandehurve të lartcekur vërtetohen edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit A.SH, i njëjti në ekspertizën e tij kishte konstatuar se projekti për Rrugën 6 Prishtinë – Hani i Elezit është përcjell me pa-rregullsi të shumta si rezultat i menaxhimit jo të mirë nga ana e komiteteve drejtuese ndërmatorre, pasi që Kryesuesi i Komitetit Drejtues Ndërmator në kundërshtim me rregullat e projektit konkretisht Statutin dhe Kodin e Sjelljes në shtator 2017 së bashku me zyrtarin Përgjegjës Prokurimit dhe me Sekretarinë Permanent nënshkruajnë marrëveshjen për shtyrje të afatit të punimeve pa përcaktuar koston financiare gjë që i ka hapur rrugën kompanisë kontraktues që të kërkojë kompensim prej 63 milion Euro edhe pse fillimisht ishte dakorduar që për shtyrje të afatit të punimeve në emër të kostove indirekte të kompensohet në shume prej 14.1 milion Euro, pasi që kompania mbikëqyrëse e projektit "Hill International" në të gjitha opinionet e saj në veçanti në opinion e saj në dhjetor të vitit 2017 dhe gusht të vitit 2018 i kishte deklaruar se shuma në 63 milion euro, e pretenduar nga kontraktori Bexhtel ende është krejtësisht e papranueshme, dhe kjo shume e pretenduar nuk i referohet dispozitivave të kontratës bazë.

Po ashtu, eksperti ka konstatuar se Kryesuesi i Komitetit Ndërmator se bashku me Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit dhe Sekretarin Permanent të MI kanë nënshkruar marrëveshje në kundërshtim të plotë me rregullat e përcaktuara të projektit respektivisht Statutin dhe Kodin e Sjelljes me faktin se fillimisht për nënshkrim të marrëveshjes për zgjatje të afatit ishte dashur të merret miratim nga KDNM.

7.Pretendimet e mbrojtjes,

- ❖ Mbrojtësi i të pandehurit **P.L – Av.M.D** ka paraqitur si pretendim faktin se roli i të mbrojturit të tij ka qenë rekomandues në këtë procesë, e jo vendimmarrës, sepse qeveria e ka marr vendimin për pagesën për OE Bechtel enkës.
- ❖ Sipas mbrojtjes, lidhur me çështjen e shtyrjes së afateve dhe alokimin e mjeteve për këtë projekt, çështje të tilla janë jashtë përgjegjësive të kompanisë mbikëqyrëse Hill International, dhe të njëjtat kanë qenë në kompetencë të vetëm palëve kontraktuese që janë operatori ekonomik ‘‘Bechtel Enka’’ dhe Qeveria e Kosovës;
- ❖ Sipas mbrojtjes nuk qëndron pretendimi se ndaj A.Kt është ushtruar presion pasi që nga dëgjimi i dëshmitarit A.K është vërtetuar faktin se i njëjti nuk ka pasur presion nga i mbrojturi i tij;
- ❖ Po ashtu nga dëgjimi i dëshmitarit B.A sipas mbrojtjes është vërtetuar fakti se opinioni i kompanisë Hill nuk është pranuar në formën zyrtare pasi që i njëjti ka deklaruar se nuk e dinë se a e ka përcjellur opinionin apo jo;
- ❖ Lidhur me statutin dhe kodin e sjelljes ka deklaruar se i njëjti është dokument irrelevant pasi që nuk ka datë e as emër se kush e ka nxjerr atë statut, e as nuk e ka të përcaktuar kohën e hyrjes në fuqi;

Sipas vlerësimit të gjykatës të gjitha pretendimet e mbrojtësit të lartcekur janë të pabazuar për shkak nga provat e vlerësuara në këtë çështje penale roli i të pandehurit P.L në këtë procese ka qenë primar, pasi që kryeministri i asaj kohe procesin ja kishte besuar ministrit të linjës përkatës të pandehurit P.L e në bazë të rekomandimeve të pa bazuar të tij është aprovuar kërkesën e OE Bechtele enka nga qeveria e Kosovës, ndërsa sa i përket rolit të kompanisë mbikëqyrës për këtë projekt është vlerësuar mjaftueshme në këtë aktgjykim, më pas sa i përket presionit në dëshmitarin A.K gjykata ka gjet se i pandehuri P.L këtë presion e ka ushtruar përmes të pandehurit E.B e jo drejt për drejt vet, këtë e vërtetoj edhe provat materiale të vlerësuar më lartë në detaje, po ashtu pretendimi për dëshmitarin B.A është i pa bazuar kjo vërtetohet në vlerësimin e dëshmisë së tij në këtë aktgjykim, e cila dëshmi gjen mbështetje në prova materiale, ndërsa statuti është kundërshtuar për prejardhjen e tij edhe nga mbrojtësi e të pandehurve B.T dhe N.SH Sharti, ku sipas vlerësimit të gjykatës ky Statuti& Kodi i Sjelljes së KDNM në pamje vizuele kuptohet qartë se është i punuar për përcaktimin e rregullave të funksionimit të KDNM, për projektin Autostrada Prishtinë –Hani Elezit, me datë 20 qershor 2012, pas që në çdo flet e ka këtë logo, dhe sipas dëshmitarit R.Q drejtor i NJIP, ka deklaruar se prej fillimi ka qenë në këtë projekte, dhe ka vërtetuar për gjykatën se Statutin dhe Kodin e Sjelljes e kanë vendosur dhe

votuar anëtarët e KDNM gjatë vitit 2012, andaj qëndrimet e mbrojtjeve të lartcekur janë të pa bazuara.

- ❖ Mbrojtësi i të pandehurit **N.SH– av.F.L** pretendon se me ju thanë të pandehurve N.SHT dhe dy të tjerëve se keni veprua në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe në kundërshtim me statutin dhe kodin e mirësjelljes, pa u thirre specifikisht në asnjë nen në asnjë paragraf.
- ❖ Lidhur me pretendimet se kanë nënshkruar marrëveshje mbi zgjatjen e një afati pa kosto, e që shuma e kostos duhet me qenë 14.788 milion euro, po pse atëherë ai që ka paraparë shumën prej 14 milion euro, se ka nënshkrua kontratën, a paska mujtë Qeveria me dërgua në arbitrazh.
- ❖ Lidhur me pretendimet se i pandehuri N.SH ka veprua konform ligjit, ka pas shkresën protokorale nga zyra e prokurimit, mendimin e Ramë Qupeves drejtor i NJIP, opinionin e A.K drejtor i zyrës ligjore, mendimin e zyrës ligjore të Kryeministrit të RKS, mendimin e KRPP dhe gjitha këto i kanë dhënë të drejtë dhe i japin edhe sot të drejtë me veprua në mënyrën qysh ka veprua dhe se me veprimin e tij dhe të bashkakuarve në këtë dispropozitiv ka përfitua vetëm vendi jonë dhe qytetarët e RKS.

Sipas vlerësimit të gjykatës të gjitha pretendimet e mbrojtësit të lartcekur janë të pabazuar për shkak se gjatë këtij procesi gjyqësor është vërtetohet se marrëveshja e datës 27.09.2017, ka qenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, pasi që çdo marrëveshje-aneks marrëveshja dhe kontratë, duke e bazuar në rregullat e prokurimit publik duhet të ketë elementin e kostos financiare, pasi që në të kundërtën konsiderohet si e pa ligjshme, ku është vlerësuar më lartë në detaje, ndërsa marrëveshja ka qenë në kundërshtim me Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së që përcakton detyrat dhe përgjegjësit e komiteti drejtues ndërministror, pasi që në kuadër të përgjegjësisë të saj ka pasur përcaktimin e politikave dhe sigurimin e koordinimit ndërministror gjatë gjithë fazave të projektit. Përgjegjësi tjetër e KDNM është edhe shqyrtimi dhe aprovimi i të gjitha dokumenteve vendimtare të projektit, përfshirë këti termet e referencës për prokurim, kontratat etj, siç është marrëveshja në rastin konkret nuk është shqyrtuar nga anëtarët kompetent të KDNM, ndërsa sa i përket pretendimeve se pse e njëjta marrëveshje është nënshkruar pa kosto, duke u bazuar në shkresën protokorale nga zyra e prokurimit, mendimin e Ramë Qupeves drejtor i NJIP, opinionin e A.K drejtor i zyrës ligjore, mendimin e zyrës ligjore të Kryeministrit të RKS, mendimin e KRPP dhe ku sipas mbrojtjen të gjitha këto i kanë dhënë

të drejtë të pandehurit, këto konstatime janë të pa bazuar pasi që gjykata i ka vlerësuar në detaje me lartë.

- ❖ Mbrojtësi i të pandehurit **E.B – av.A.S** pretendon se vepra penale sipas dispozitivit të aktakuzës nuk do të mund të kryhej nga këshilltari politik pa i uzurpuar kompetencat e dikujt tjetër, pasi që këshilltari sipas kësaj rregullore nuk ka kompetenca ekzekutive, administrative dhe as të drejtë për ndërhyrje në shërbimin civil, por vetëm të i përcjellin mesazhet e eprorit tek shërbyesit civil;
- ❖ Pretendimi tjetër është se nuk qëndron Konstatimi i prokurorisë se pjesëmarrja e E.Bsi këshilltar i ministrit në takimet e KDNM-së, ishte në kundërshtim me kompetencat e këshilltarit është gabim: sepse përgjigja mund të kuptohet në nenin 51 par. 3 të Rregullores nr. 09/2011 se Punës se Qeverisë, në të cilin thuhet: *“Me pajtimin e Kryesuesit, zyrtarët tjerë ose ekspertët e jashtëm mund të marrin pjesë në takimet e Komisionit, por pa të drejtë vote”*;
- ❖ Lidhur me pranimin e shkresave, i njëjti ka shtuar se nga dëshmia e B.A A.Kj, asistent ekzekutiv i kabinetit të ministrit dhe dëshmitarit A.Z, shef i kabinetit të ministrit, mund të kuptohet se kush ishte përgjegjës për pranimin e shkresave dhe si bëhej pranimi i shkresave dhe se Këshilltari politik, nuk e ka për detyrë të pranojë shkresa në emër të njësisë për administrimin e dokumenteve apo si arkivist dhe as t’i përcjell ato më tutje;
- ❖ Tutje, ka pretenduar se ndaj A.K nuk është ushtruar presion, por ky dëshmitar duke dashur që të shmangë përgjegjësinë nga vetja për hartimin e opinionit joprofesional, ka lajthitur prokurorinë për t’i drejtuar hetimet ndaj personit tjetër dhe jo ndaj tij si hartues i atij opinionit;
- ❖ Lidhur me raportin e ekspertit të prokurorisë, mbrojtja ka deklaruar se prokuroria e kishte ngarkuar ekspertin me detyra jashtë kompetencave të saja . Një prej detyrave ishte përcaktimi i kompetencave, detyrave dhe përgjegjësive të personave përgjegjës, e që *eksperti financiar nuk mund të ketë për detyrë përcaktimin e kompetencave të personave përgjegjës*, pasi nuk bëhet fjalë për ekspertizë ligjore, *por për atë financiare të përllogaritjes së dëmit të shkaktuar ndaj palës së dëmtuar*;
- ❖ Lidhur me pretendimet për mashtrim apo lajthitje, mbrojtja ka deklaruar se nuk qëndron pretendimi i tillë, pasi që anëtarët e KDNM-se i kishin pasur të gjitha materialet në dispozicion përfshirë kërkesën e Behtel Enka dhe raportet e rregullta të kompanisë mbikëqyrëse Hill International, poashtu në opinionin ligjor të MI-së (nga dëshmitari A.K)

dorëzuar në ZKM shkruante se opinionet tjera profesionale duhet të kërkohen nga organet për mbikëqyrjen e kontratës;

Sipas vlerësimit të gjykatës të gjitha pretendimet e mbrojtësit të lartcekur janë të pabazuar për shkak se i pandehuri E.B ka qenë person zyrtar i emëruar në organin shtetëror që kryen punët zyrtare, ndërsa pretendimi se pjesëmarrja e E.B si këshilltar i ministrit në takimet e KDNM-së, i ishte në kundërshtim me kompetencat e këshilltarit, është i pa bazuar sepse nuk është konstatuar as një her ky konstatim nga prokuroria, pasi që është konstatuar vetëm se pjesëmarrja e E.Bsi këshilltar i ministrit në takimet e përfaqësuesit e OE Bechtel enkes, ishte në kundërshtim me kompetencat e këshilltarit, ndërsa sa i perket pretendimeve në lidhje me dëshmitë e dëshmitareve B.A, A.Z dhe A.K, gjykata i ka vlerësuar më lartë në detaje në raporte me përgjegjësën e të pandehurit E.B, ndërsa ekspertiza financiare është vlerësuar nga gjykata vetëm se i perketë njohurive të profesionalizuar të cila është kërkuar dhe hartuar kjo ekspertizë që ka sellje edhe mendimin përfundimtarë, ndërsa sa i perket përgjegjësit së pandehurve në këtë procesi gjyqësor gjykata është bazuar pas vlerësimit të gjitha dëshmive, provave materiale të vlerësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu sa i perket pretendimet të mbrojtësit për pranimin e shkresa të anëtareve të KDNM, gjykata këtë e ka vlerësuar më lartë pas n dëgjimit të anëtareve KDNM, të n dëgjuar në cilësi të dëshmitareve në këtë çështje penale.

- ❖ Mbrojtësi i të pandehurit B.T – **Av.U.V** ka paraqitur si pretendim faktin se mbrojtja pretendon se në raste të tilla kur kemi të bëjmë me norma blankete duhet të përcaktohet në mënyrë konkrete neni apo norma e shkelur ligjit tjetër, në këtë rast të ligjit të prokurimit, e që këtë nuk e ka bërë prokuroria dhe kjo përbënë shkelje;
- ❖ Ka pretenduar se KDNM-ja nuk bënë lidhjen e kontratave/marrëveshjeve dhe se Ministri, Sekretari dhe Drejtori i Prokurimit të Ministrisë kanë qenë përgjegjësit e vetëm për nënshkrimin e marrëveshjeve;
- ❖ *Lidhur me mos përcaktimin e koston në marrëveshjen e datës 27.09.2017 dhe ligjshmërinë e saj*, mbrojtja konsideron se pretendimi i prokurorisë në aktakuzë lidhur me këtë çështje, paraqet një kontradiktoritet nga ajo që është shprehur nga prokuroria në shqyrtim gjyqësor. Kjo pasi që në aktakuzë prokuroria pretendon se mos-përcaktimi i koston i ka lënë hapur mundësinë Operatorit Ekonomik të paraqes kërkesë për kosto shtesë, ndërsa gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka pretenduar se mos-përcaktimi koston i ka hapur apo i ka krijuar mundësinë Operatorit Ekonomik të paraqes kërkesë për kosto shtesë;

- ❖ *Lidhur me ekspertizën*, mbrojtja konsideron se ekspertiza nuk është punuar nga eksperti i licencuar gjyqësor pasi që gjatë hetimeve eksperti është cilësuar si ekspert financiar, ndërsa në shqyrtim gjyqësor si ekspert i prokurimit. Eksperti A.SH në kohën kur është punuar ekspertiza nuk figuron në listën e eksperteve gjyqësor(as financiar, e as të prokurimit), e po ashtu në listën e eksperteve gjyqësor të publikuar në vitin 2023 figuron në listën e eksperteve financiar, por jo në listën e eksperteve të prokurimit. Mbrojtja, për më tepër konsideron se eksperti ka vepruar në kundërshtim me nenin 136.2 të KPP-së duke qenë se i njëjti është deklaruar lidhur me fajësinë e të pandehurve, e që në bazë të paragrafit 3 të këtij neni, kur raporti i ekspertit nuk është në pajtim me këtë nen, nuk është i pranueshëm;
- ❖ - *Lidhur me opinionin e kompanisë mbikëqyrëse ‘Hill International’*, mbrojtja konsideron se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se para nënshkrimit të kontratës së datës 27.09.2017, paraprakisht është dashur të kërkohet opinion nga kompania mbikëqyrëse, pasi që Hill International vetëm se kishte dhënë opinionin e saj në vitin 2016.
- ❖ - *Lidhur me marrëveshjen e datës 27.09.2017 dhe kërkesën e operatorit*, mbrojtja pretendon se pretendimi i prokurorisë se kjo marrëveshje i ka mundësuar OE të paraqesë kërkesë në vlerë prej 63 milion euro është absurd, pasi që OE ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve nga viti 2015, dhe si rrjedhojë e pamjaftueshmërisë buxhetore ka realizuar punë as sa ka pasur buxhet të ndarë, e që ka dërguar në vonesën e realizimit të projektit dhe çështja e kostos shtesë ka qenë e hapur në kontratën bazë(neni 2) dhe këtë nuk e ka mundësuar marrëveshja e datës 27.09.2017, pasi me këtë marrëveshje është zgjidhur çështja e afatit, ndërsa çështja e kostos ka mbetur të zgjidhet me vonë pasi që të aprovohet në Qeveri;
- ❖ - *Lidhur me protokollin e datës 22.09.2017 të lëshuar nga i mbrojturi i tij në cilësi të UD të Drejtorit të Departamentit të Prokurimit*, mbrojtja konsideron se opinionin i tillë nuk e ka cilësinë e opinionit ligjor apo të rekomandimit, siç kanë pretenduar të pandehurit P.L dhe N.SH, pasi që ky protokoll nuk është asgjë më shumë se sa një akt-përcjellës përmes të cilit aneks-kontrata pasi që ishte nënshkruar nga i mbrojturi i tij, ka kaluar për nënshkrim tek persona tjerë, gjegjësisht te z.Lekaj dhe z.Shatiri.
- ❖ - *Lidhur me dashjen për kryerjen e veprës penale*, mbrojtja konsideron se te i mbrojturi i tij nuk ekziston dashja për dëmtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, pasi që i njëjti për të konstatuar se nënshkrimi i marrëveshjes është i ligjshëm, i është drejtuar KRPP-së nëse zgjatja e afatit të punimeve ishte i rregullt. Po ashtu, i njëjti ka qenë i gatshëm të nënshkruaj draft-aneksin e vitit 2016, ku shuma e përcaktuar për kosto shtesë ka qenë 14.778 milion euro dhe një fakt i tillë vërtetohet edhe nga dëgjimi i dëshmitarit L.ZH, i cili ka deklaruar

se:” Besoj që do ta kishte nënshkruar, pasi nuk ka drejtë me refuzuar si Drejtor i Prokurimit”.

Sipas vlerësimit të gjykatës të gjitha pretendimet e mbrojtësit të lartcekur janë të pabazuar për shkak se pas procesit gjyqësor është vërtetë se marrëveshja e datës 27.09.2017, ka qenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, pasi që çdo marrëveshje-aneks marrëveshja dhe kontratë, duke e bazuar në rregullat e prokurimit publik duhet të ketë elementin e kosto financiare, pasi që në të kundërtën konsiderohet si e pa ligjshme, pasi që sipas Ligjit të prokurimit publik në rastin e nevojës së paraqitjes për ndryshmin dhe plotësimin e kontratës lejohet aneks kontrata ku palët i përcaktojnë kushtet e veçanta të kontratës, pasi që për të qenë një kontratë valide dhe të prodhojë efekt juridik duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme, ato janë aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit, objekti dhe baza e kontratës dhe kushtet e veçanta siç janë forma e kontratës, lidhje e kontratës me dorëzimin e sendit dhe dhënia e pëlqimit. andaj gjykata konstaton në rastin konkret e njëjta marrëveshje është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik për shkak të mungesës së kushtit- elementit kosto financiare, andaj e njëjta marrëveshje është kundërligjore, ndërsa sa i përket nënshkrimit të marrëveshje e datës 27.09.2017, dhe mos përcaktimit të kosto, si dhe për rolin e kompanisë mbikëqyrëse Hill Internacional dhe rolin e KDNM, janë vlerësuar në detaje më lartë, po ashtu se i përket ekspertit financiar A.SH gjykata vërteton se i njëjtit është ekspert i licencuar financiar dhe nuk ka as një dilemë rreth kësaj, ndërsa sa i përket përgjegjësit të pandehurve në këtë procese gjyqësor gjykata është bazuar pas vlerësimit të gjitha dëshmimeve, provave materiale të vlerësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa ekspertiza financiare është vlerësuar nga gjykata vetëm se i përket njohurive të profesionalizuar të cilat është kërkuar dhe hartuar kjo ekspertizë që ka sellje edhe mendimin përfundimtarë, ndërsa sa i përket dashjes së pandehurit B.T, gjykata gjen se i njëjtit ka pas njohuri të mjaftueshme për këtë projekt, si njohuri: për aneks kontratën e vitit 2016 në vlerë prej 14.788 milion, për rolin e kompanisë mbikëqyrëse , për rolin e KDNM, për elementet e kontratës –marrëveshjesë, ku pavarshitet të gjithave këtyre me dashje *me dates 22.09.2017, ka lëshuar protokoll ku ka nënshkruar marrëveshjen dhe ka kaluar për nënshkrim tek i pandehuri P.L dhe i pandehuri N.SH, me konstatimin se e njëjta marrëveshje është bazuar në rregullat e prokurimit publik.*

Gjykata, pas analizimit të pretendimeve të mbrojtësve të të pandehurve si më lartë, se në rastin konkret nuk është provuar përtej çdo dyshimi që të mbrojturit e tyre kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet e mbrojtësve të tyre janë

të pabazuara, pasi që nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor, e të cilat prova gjykata i ka elaboruar secilën veç e veç si më lartë, është vërtetuar përtej çdo dyshimi gjendja faktike si në këtë aktgjykim dhe në veprimet e secilit prej të pandehurve, me çka gjykata ka krijuar bindjen se veprimet e tyre përbëjnë elemente të veprës penale për të cilën akuzohen, andaj edhe i ka shpallur fajtor.

Sa i përket pretendimeve të tjera të mbrojtësve të të pandehurve të paraqitura, gjykata konsideron se të njëjtat janë trajtuar gjatë elaborimit të gjetjes së gjykatës në raport me përgjegjësitë e të pandehurve.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të pandehurve P.L, N.SH, E.B dhe B.T ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

8. Elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

- Në nenin 422 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar e kryen: *“Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.*

Nga provat e elaboruara në këtë aktgjykim vërtetohen qartë elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, në veprimet e të pandehurve, e në veçanti Opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse „ Hill International “, Opinioneve ligjore, Procesverbaleve të takimeve të KDNM-së, dëshmimeve të dëshmitarëve, është vërtetuar pa asnjë dilemë se të pandehurit kanë pasur qëllim në realizimin e veprimeve të tyre dhe veprimet i kanë ndërmarrë me dashje direkte ngase të njëjtit në cilësinë e personave zyrtar duke pas parasysh pozitat e secilit prej tyre, kanë qenë në dijeni se veprimet e tyre janë të ndaluara me ligj, dhe se do t’i shkaktojnë dëm buxhetit të shtetit. Dashjen dhe qëllimin e tyre e vërteton bindshëm fakti i injorimit nga ana e tyre të opinioneve të kompanisë mbikëqyrëse të projektit për çështjen

konkrete, ndërhyrja në opinionet e zyrës ligjore të MI-së, si dhe fshehja e gjendjes reale dhe e dokumentacionit esencial para anëtarëve të KDNM-së, për më tepër, i pandehuri P.L asnjëherë nuk i ka njoftuar anëtarët e komitetit për lidhjen e marrëveshjes të datës 27.09.2017, nënshkrues i të cilës ishin të pandehurit P.L, N.SH dhe B.T, nga këto fakte shihet se nuk ka asnjë dilemë rreth ekzistimit të elementit të dashjes dhe qëllimit në veprimet e të pandehurve P.L, N.SH, E.B dhe B.T.

9. Bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit

Bazuar nenit 31 të KPRK-së: “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”

10. Vepra penale në vazhdim

Bazuar nenit 77 të KPRK-së: “Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: 1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale; 1.2. objekti i njëjtë i veprës; 1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; ose 1.5. dashja e njëjtë e kryesit, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”, ku sipas vlerësimit të gjykatës veprimet e të pandehurve P.L dhe E.B janë të përshkruar edhe në dispozitiv të prokurorit të shtetit në vazhdimësi por nuk është cekur në kualifikim të veprës penale neni 77, andaj nga përshkrimin faktikë i dispozitivive I dhe II. të këtij aktgjykimit gjykata bënë cilësimin e kualifikimi juridik dhe vërtetohet se i pandehuri P.L në bashkëkryerje me të pandehurit N.SH Sharti dhe B.T, si dhe në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurin E.B kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së. Nga provat e vlerësuara në rastin konkret, është vërtetuar fakti se të pandehurit P.L dhe E.B veprën penale që u vihet në barrë e kanë kryer se bashku sikurse përshkrimin e fakteve në pikat e dispozitiveve II të këtij aktgjykimit, pasi që të gjitha provat tregojë se të njëjtit në vazhdimësi kanë planifikuar dhe organizuar mënyrën se si do t’i realizojnë qëllimet e tyre.

11. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë dhe në nenin 364 par.1 dhe 2 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që të pandehurit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre dhe atë:

- Të pandehurit P.L, N.SH, E.B dhe B.T, i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën janë ngarkuar me aktakuzë, ngase në veprimet e të pandehurve të përshkruara në dispozitivin **I.** dhe **II.** të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale:
Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 dhe neni 77 të KPRK-së.

12. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurve me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese.

Si rrethana rënduese për të pandehuri P.L, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana:

- shkallën e përgjegjësisë penale që i pandehuri ka qenë përgjegjës i nivelit të lartë zyrtar – gjegjësisht i njëjti ka qenë Minister i MI, ku i pandehuri është mirë i edukuar - me përgatitje profesionale dhe i njëjti duke e ditur ka nënshkruar marrëveshjen me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, duke mos e përcaktuar koston financiare, mirëpo përkundër kësaj i njëjti kishte marr veprim në vazhdimësi duke tejkalluar autorizimet e tij zyrtar në drejtim të realizimit të qëllimit, respektivisht pranimit të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro, ka injoruar në tërësi

opinionin e kompanisë mbikëqyrëse të projektit „Hill International”, sipas të cilit opinion shuma reale dhe e lejuar për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve është 14,778,654.87 Euro, pikërisht siç ishte paraqitur në pikën A të kërkesës së OE „Bechtel&Enka”, për dallim nga pika B dhe C e kërkesës për kosto financiare shtese, të cilat janë totalisht të pa arsyetuara dhe të papranueshme, me këto veprime i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës si në dispozitiv të aktgjykimit.

- Si ministër ka qenë i thirrur që të kujdE.B dhe të mbikëqyr politikat në harmoni me ligjin dhe jo të veproj me dashje në kundërshtim me ligjet, në kundërshtim me rregullat që e rregullojnë procesin e realizimit të projektin R6 Autostrada Prishtinë - Hani Elezit, që janë në përgjegjësin e të pandehurit, andaj, gjykata gjen se i pandehurit ka vepruar me dashje, në këtë mënyrë e ka vlerësuar si rrethanë rënduese. Involvimi dhe roli në kryerjen e veprës penale, ku të pandehurin gjykata e ka dënuar me dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë në konsideratë rolin e tij në kryerjen e veprës penale. Shkallën e përgjegjësisë penale, ku varësisht pjesëmarrjes dhe rolit të të pandehurve në kryerjen e veprës penale, gjykata për disa nga të pandehur bazuar në këtë rrethanë ka shqiptuar dënim më të ashpër e për disa të pandehur dënim më të butë.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këtë: se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Si rrethana rënduese për të pandehurin N.SH, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana:

- shkallën e përgjegjësisë penale që i pandehuri ka qenë përgjegjës i nivelit të lartë zyrtar – gjegjësisht i njëjti ka qenë sekretar i përgjithshëm i MI-së, ku i pandehuri është mirë i edukuar - me përgatitje profesionale dhe i njëjti duke e ditur kishte marr veprim duke tejkalluar autorizimet e tij zyrtare ka nënshkruar marrëveshjen me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënëse në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, duke mos e përcaktuar koston financiare, veprim ky qe i lë hapur mundësinë OE “Bechtel&Enka” që me datë 27.11.2017

të paraqes pranë punëdhënësit kërkesën për pagesën e shumës shtesë „Briefing Package” në vlerë prej 63 milion Euro në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve, e cila kërkesë me pas ka zbritur në vlerën prej 53,100,000.00 Euro, ku si pasojë e këtyre veprimeve të të pandehurve, sipas rekomandimit të Komitetit Drejtues Ndërministror, kërkesa e OE „Bechtel&Enka” është aprovuar për pagesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/50 i datës 05.06.2018, me këtë i kishte shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës si në dispozitiv të aktgjykimit.

- Si sekretar i përgjithshëm i ministrisë i pandehuri N.SH, ka qenë i thirrur që të këshilloj ministrin, që të siguroj që kontratat të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive, në harmoni me rregullat që e rregullojnë procesin e realizimit të projektin R6 Autostrada Prishtinë - Hani Elezit, mirëpo përkundër detyrimeve ligjore i pandehuri me dashje kishte marr veprim duke tejkalluar autorizimet e tij zyrtare, Prandaj, gjykata dashjen e të pandehurit për të vepruar në këtë mënyrë e ka vlerësuar si rrethanë rënduese.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto: faktin se sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke respektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Si rrethana rënduese për të pandehurin E.B , gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana:

- shkallën e përgjegjësisë penale që i pandehuri ka qenë përgjegjës i nivelit zyrtar – gjegjësisht i njëjti ka qenë Këshilltar i lartë politik i Ministrisë së Infrastrukturës, ku i pandehuri është mirë i edukuar - me përgatitje profesionale dhe i njëjti duke e ditur kishte marr veprim në vazhdimësi duke tejkalluar autorizimet e tij zyrtar në drejtim të realizimit të qëllimit, respektivisht pranimi të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” për pagesën e shumës prej 53,100,000.00 Euro, ka injoruar në tërësi opinionin e kompanisë mbikëqyrëse të projektit „Hill International”, sipas të cilit opinion shuma reale dhe e lejuar për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve është 14,778,654.87 Euro, pikërisht siç ishte paraqitur në pikën A të kërkesës së OE „Bechtel&Enka” , për dallim nga pika B dhe C e kërkesës për kosto financiare

shtese, të cilat janë totalisht të pa arsyetuara dhe të papranueshme, me këto veprime i ka shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës si në dispozitiv II. të aktgjykimit.

- Si Këshilltar i lartë politik i Ministrisë së Infrastrukturës i pandehuri E.B, ka qenë i thirrur që të këshilloj ministrin, që të siguroj që kontratat të ministrisë të zbatohen në harmoni me rregullat që e rregullojnë procesin e realizimit të projektin R6 Autostrada Prishtinë - Hani Elezit, mirëpo përkundër detyrimeve ligjore i pandehuri me dashje në vazhdimësi kishte marr veprim duke tejkualuar autorizimet e tij zyrtare, gjykata dashjen e të pandehurit për të vepruar në këtë mënyrë e ka vlerësuar si rrethanë rënduese. Involvimi dhe roli në kryerjen e veprës penale, ku të pandehurin gjykata e ka dënuar me dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë në konsideratë rolin e tij në kryerjen e veprës penale.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto: faktin se sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Si rrethana rënduese për të pandehurin B.T, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana:

- shkallën e përgjegjësisë penale që i pandehuri ka qenë përgjegjës i nivelit zyrtar – gjegjësisht i njëjti ka qenë Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, ku i pandehuri është mirë i edukuar - me përgatitje profesionale dhe i njëjti duke e ditur kishte marr veprim duke tejkualuar autorizimet e tij zyrtare ka nënshkruar marrëveshjen me numër protokollit 356/17 të datës 27.09.2017 në emër të Ministrisë së Infrastrukturës si punëdhënës në njërën anë dhe ndërmarrjes së përbashkët „Bechtel&Enka” si kontraktor në anën tjetër, në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik 04/L-042, Statutin dhe Kodin e Sjelljes së KDNM-së dhe me kushtet e kontratës nr. ID 017/2014 të datës 01.07.2014, duke mos e përcaktuar koston financiare, veprim ky që i lë hapur mundësinë OE “Bechtel&Enka” që me datë 27.11.2017 të paraqes pranë punëdhënësit kërkesën për pagesën e shumës shtesë „Briefing Package” në vlerë prej 63 milion Euro në emër të zgjatjes së afatit të përfundimit të punimeve, e cila kërkesë me pas ka zbritur në vlerën prej 53,100,000.00 Euro, ku si pasojë e këtyre veprimeve të të pandehurve, sipas rekomandimit të Komitetit Drejtues Ndërmnistror, kërkesa e OE „Bechtel&Enka” është aprovuar për pagesë nga Qeveria e

Republikës së Kosovës me Vendimin numër 01/50 i datës 05.06.2018, dhe për çka edhe i kishe shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës si në dispozitiv të aktgjykimit. .

- Si Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës i pandehuri B.T, ka qenë i thirrur që të siguroj që kontratat të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive duke u bazuar në rregullat e Ligjit për Prokurim Publik 04/L-042, dhe në harmoni rregullat që e rregullojnë procesin e realizimit të projektin R6 Autostrada Prishtinë - Hani Elezit, mirëpo përkundër detyrimeve ligjore i pandehuri me dashje kishte marr veprim duke tejkalluar autorizimet e tij zyrtare, dashjen e të pandehurit për të vepruar në këtë mënyrë e ka vlerësuar gjykata si rrethanë rënduese.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë këto: faktin se sjella e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore ka qenë e mirë ka pasur qëndrim tejet korrekt, si dhe faktin se për të pandehurin zhvillohet edhe një procedurë tjetër për veprë penale tjetër, por gjykata nuk e ka konsideruar si rrethanë rënduese për faktin se kjo çështje penale nuk është përfunduar me vendim të formës përfundimtare.

Prandaj duke marrë për bazë të lartpërmendurat gjykata ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të pandehurit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

13. Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues

Duke u bazuar në nenin 62 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 dhe nenin 65 par.1 të KPRK-së, përveç dënimit me burgim ndaj të pandehurve P.L, N.SH, E.B dhe B.T, është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar si në këtë aktgjykim. Ky dënim plotësues i është

shqiptuar të pandehurve për faktin se të njëjtit në cilësi të personave zyrtar, P.L - Ministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe si Kryesues i Komitetit Ndërministror (KDNM), N.SH - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, B.T - Drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe E.B - Këshilltar i lartë politik i Ministrit të Infrastrukturës, – me veprimet e tyre të përshkruara në dispozitivin I dhe II të aktgjykimit duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit plotësues duke marrë për bazë dispozitat e lartpërmendura.

14. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe nenin 452 të KPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që të pandehurit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

15. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Duke u bazuar në nenin 457 par.1 të KPP-së gjykata ka vendosur që e dëmtuara Avokatura Shtetërore e Kosovës pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë, të udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil, ngase e njëjta përmes parashtrësës së datës 22.11.2022, kishte kërkuar nga gjykata që të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil për shkak se këtë të drejtë do ta realizonin në procedurë të rregullt juridiko-civile.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 par.1 dhe 2 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI SPECIAL -

PS.nr.4/22, me datë 31.01.2024

Bashkëpunëtori profesional,

Albert Haliti

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,

Violeta Namani-Hajra

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.